

LIBËR PËR MËSUESIN **GJUHË SHQIPE 6**

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



BOTIME



Redaktor letrar: Eni MYRTOLLARI
Paraqitja grafike: Enkeleda REXHA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, mars 2019

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohej çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë. Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por dhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë. Korniza Kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyç nga nxënësit. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave kyç janë të domosdoshëm për një individ, me qëllim që të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo fushë të nxëni dhe lëndë synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së gjuhës shqipe, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës

PLANI MËSIMOR VJETOR 2018-2019
FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI
LËNDA: GJUHË SHQIPE
KLASA: VI

35 javë x 5 orë = 175 orë

	Kompetencat e fushës		Shkathtësitë që do të realizohen në komunikim përmes:	Orë
1	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshëm	10	Gjuhës së dëgjuar	10
2	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	10	Gjuhës së folur	10
3	Të lexuarit e teksteve letrare dhe Teksteve joletrare	70	Teksteve në prozë Teksteve poetike Teksteve dramatike Teksteve joletrare	70
4	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	25	Gjuhës së shkruar	25
5	Përdorimi i drejtë i gjuhës	60	Njohuri gramatikore Sintaksë Morfologji Leksikologji Fjalëformim Drejtshkrim Fonetikë	60 20 24 3 3 6 4
	Gjithsej			175

Shënime: Orët për testime, projekte, panair portofoli, biseda letrare dhe diktme janë parashikuar nga të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe njohuri gjuhësore.

(P.s. Fletore e vlerësimit të kompetencave = **FVK**)

KOMPETENCAT E FUSHËS	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR	JANAR – MARS	PRILL – QERSHOR
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	3 orë	4 orë	3 orë
Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	4 orë	2 orë	4 orë
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	21 orë	28 orë	21 orë
Të shkruarit për qëllime formale dhe funksionale	8 orë	8 orë	9 orë
Përdorimi i drejtë i gjuhës	24 orë	18 orë	18 orë

Brenda tyre ka: 1 orë test
3 orë projekt
2 orë bisedë letrare
1 orë diktim
1 orë panair portofoli

1 orë test
3 orë projekt
2 orë bisedë letrare
1 orë diktim
1 orë panair portofoli

1 orë test
4 orë projekt
2 orë bisedë letrare
1 orë diktim
1 orë panair portofoli

**PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE
NDARË NË TREMUJORË**

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: GJUHË SHQIPE

Shkalla: III

Klasa: VI

Viti shkollor: 2018-2019

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCEVE KYÇ Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç:
KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT Nxënësi: - shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; - dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime; - lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim; - shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
KOMPETENCA E TË MENDUARIT Nxënësi: - shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme; - harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; - përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.
KOMPETENCA E TË NXËNIT Nxënësi: - zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; - shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit; - ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN Nxënësi: - përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses; - bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tij social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
KOMPETENCA QYTETARE Nxënësi: - zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.
KOMPETENCA DIGJITALE Nxënësi: - përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar. - analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS**Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme**

Nxënësi:

- kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to;
- jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi:

- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;
- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi:

- dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;
- lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

α)

β) Tekste letrare

- dallon temën, mesazhin dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;
- dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

α)

β) Tekste joletrare

- dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.).

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi:

- përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkuese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi:

- dallon dhe përcaktont heksin e fjalës dhe llojet e intonacionit në fjali;
- dallon zanoret dhe llojet e bashkëtingëlloreve (të zëshme dhe të pazëshme, të shurdhëta dhe të tingullta);
- përcakton mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- dallon, përdor dhe krijon fjalë të prejardhura;
- dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve dhe krijon vetë fusha dhe familje fjalësh;
- përcakton klasat e fjalëve;
- klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- analizon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (dallon gjininë asnjansë dhe shumësin e emrave);
- dallon dhe analizon mbiemrat (të nyjshëm, të panyjshëm, gjini, numër, rasë);
- dallon llojet e përemrave dhe analizon përemrin vector dhe trajtat e shkurtra;
- dallon dhe përcakton mënyrën dhe kohët e foljes;
- zgjedhon foljen në mënyrën dëftore.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Sugjerohet që gjatë orëve të mësimit do të përdoren metoda, teknika dhe strategji të tilla, si: *stuhi mendimi, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, diskutim për njohuritë paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, kubimi, diagrame piramidale, pyetje autorit, ditarët e të nxënës, pyetja sjell pyetjen, diagram i Venit* etj.

Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, në çift, në mënyrë të pavarur dhe individuale etj.

Vlerësimi

Disa nga teknikat dhe instrumentet e vlerësimit do të jenë: vlerësim i vazhdueshëm me gojë, vlerësim i punëve me shkrim, vlerësim i projekteve, testeve, pjesëmarrja në biseda e diskutime e leximet jashtëklase, diktimet etj.

Nr.	Kompetenca/ Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burime
1.	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar 1.	Një mjedis i ri	Si të prezantohemi në një mjedis të ri.	Prezantim. Bisedë. Punë në grupe. Pema e mendimit.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti, material nga interneti, foto.
2.	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar 2.	Ju dhe të lexuarit	Anketë në lidhje me të lexuarin.	Plotësim ankete. Diskutim. Punë në grup.	Vlerësim i vazhdueshëm për pjesëmarrje në diskutim.	Anketa të ndryshme, teksti, biblioteka.
3.	Përdorimi i drejtë i gjuhës (fonetikë) 1.	Zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe	Nxënësit dallojnë bashkëtingëlloret: e zëshme, e shurdhëta, e zëshme.	Punë në grup. Stuhi mendimi. Lojë gjuhësore.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, material ndihmëse, tabakë..
4	Fonetikë 2	Theksi i fjalës	Nxënësit dallojnë theksin e fjalëve.	Punë në grupe. Punë në dyshe. Punë e pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, material ndihmëse, tabakë.
5	Përdorimi i drejtë i gjuhës (fonetikë) 3.	Intonacioni dhe theksi i fjalisë.	Minikonkurs. Nx. dallojnë theksin e fjalës.	Punë në grupe. Punë individuale. Lexim shpjegues.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti mësimor, FVK.
6	Java II Të lexuarit e teksteve let. e jolet. 1.	Mësuesi ynë i dashur	Nxënësit diskutojnë për rëndësinë e shkollës.	Diskutim. Të nxënit me këmbime. Pema e mendimit.	Vlerësim për punën hulumtuese.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx.
7	Të lexuarit e tekstit let. e jolet. 2.	Mësuesi ynë i dashur	Nxënësit analizojnë një personazh.	Diskutim. Të nxënit me këmbime. Pema e mendimit. Pyetja binare.	Vlerësim për punën hulumtuese.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx.
8	Përdorimi i drejtë i gjuhës (drejtshkrim) 4.	Përdorimi i shkronjës së madhe	Korrigjohen gabimet në përdorimin e shkronjës së madhe.	Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , shkumësa me ngjyra.
9	Përdorimi i drejtë i gjuhës (drejtshkrim) 5.	Drejtshkrimi i fjalëve që kanë zanoren e në pozicione të ndryshme.	Nxënësit vendosin zanoren e në fjalë të ndryshme.	Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , shkumësa me ngjyra.

10	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 1.	Rrëfime personale	Nx. rrëfejnë bukur ndodhi personale.	Punë në grupe. Marrëdhënia pyetje-përgjigje. Dëgjim.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Histori të regjistruara në CD, magnetofon, teksti i nx.
11	Java III Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 3.	Kur isha fëmijë	Parashikohet ngjarje nisur nga titulli.	Imagjinatë e drejtuar. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore.
12	Përdorimi i drejtë i gjuhës (drejtshkrim) 6.	Drejtshkrimi i fjalëve që kanë zanoren <u>ë</u> në pozicione të ndryshme	Nx. vendosin zanoren <u>ë</u> në fjalë të ndryshme.	Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , tabela.
13	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 1.	Përgatitja për procesin e të shkruarit	Mbledhja e ideve nga burime të ndryshme.	Diskutim. Hapa sipas këshillave.	Vlerësim me gojë, me notë dhe me shkrim.	Revista dhe materiale për fëmijët sot, teksti.
14	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 2.	Përgatitja për procesin e të shkruarit	Përgatitja e draftit të parë të shkrimit.	Puno në dyshe/këmbë. Punë individuale.	Vlerësim me gojë, me notë dhe me shkrim.	Revista dhe materiale për fëmijët sot, teksti.
15	Përdorimi i drejtë i gjuhës (drejtshkrim) 7.	Drejtshkrimi i fjalëve me zanoren <u>ë</u> fundore	Nx. vendosin zanoren <u>ë</u> fundore, fjalë të ndryshme.	Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , tabela.
16	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 5.	Zeneli	Vjersha dhe prozë nga Migjeni.	Diskutim. Lexim zinxhir. Kllaster.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore.
17	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 6.	Zeneli	Interpretimi i fragmentit.	Ditari dypjesësh. Puno dyshe/shkëmbe Ide.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore.
18	Përdorimi i drejtë i gjuhës (drejtshkrim) 8.	Drejtshkrimi i ndajfoljeve dhe i parafrasalëve	Nx. përdorin drejt ndajfoljet dhe parafrasalët.	Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , tabela, shkumës.

19	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 2.	Projekti: “Mjedisi dhe ne” (ora e parë)	Nxënësit japin mendime rreth temës.	Bisedë e lirë. Punë në grupe.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore.
20	Java V Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 7.	Provimi	Nx. diskutojnë në lidhje me ndershmërinë.	Kllaster. Të nxënit me këmbime. Lexim zinxhir.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore.
21	Përdorimi i drejtë i gjuhës (fjalëformim) 9.	Fjala dhe përbërësit e saj.	Nxënësit dallojnë mënyrat e formimit të fjalëve.	Punë në grupe. Punë e pavarur e drejt. Tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletore FVK, shkurtesa me ngjyra.
22	Përdorimi i drejtë i gjuhës (fjalëformim) 10.	Ushtrime për përbërësit e fjalës (FVK).	Nx. plotësojnë fletën e verifikimit të kompetencave.	Punë individuale. Puno/shkëmbe në dyshe. Vlerësim i vazhdueshëm.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Fletore e vlerësimit të kompetencave
23	Java VI Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 4.	Rishkruajmë një tregim.	Nx. interpretojnë figurat e dhëna.	Rrëfim. Punë individuale.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, libra me tregime, fletore punëve me shkrim.
24	Të folurit për të komunikuar dhe mesuar 3.	Komunikimi me të rriturit	Format e komunikimit sipas hierarkisë.	Bisedë e lirë. Rrjeti i diskutimit. Kllaster.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti mësimor, informacione nga interneti.
25	Java VII Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 9	Dashuria e nënës	Plotësohet kllasteri i konceptit kyç.	Diskutim. Lexim zinxhir. Pyetje-përgjigje. Tryeza rrethore.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti mësimor, informacione nga interneti.
26	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 6	Kujtime të gëzueshme	Nxënësit tregojnë kujtime të ndryshme përmes fotove.	Prezantim. Bashkëbisedim në grupe.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, interneti, fotografi, fletore punës me shkrim.

27	Shkruajmë 5	Si ta kontrollojmë një tekst që shkruajmë	Kontroll i një diktimi	Punë individuale	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Punime me shkrim, tabela e shenjave konvencionale, materiale në <i>power point</i> i këshillave për ndjekjen dhe kontrollin e punëve me shkrim.
28	Java VIII Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 11.	Sënduku i gjyshes	Traditat dhe objektet e çmuara të familjes.	Diskutim. Lexim zinxhir. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., teksti, interneti, biblioteka objekte të vjetra.
29	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 12.	Sënduku i gjyshes	Puna me tekstin	Diskutim për objekte të çmuara. Të nxënit me Këmbime.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., teksti, interneti, biblioteka objekte të vjetra.
30	Përdorimi i drejtë i gjuhës (fjalëformim) 11.	Fjalët e prejardhura	Nx. nxiten që të dallojnë fjalët e prejardhura.	Punë individuale. Puno/shkëmbe në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra.
31	Java IX Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 14.	Pianoja	Të krijojmë nisur nga fjalët kyçe.	Parashikim me terma Paraprakë. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., teksti, interneti, biblioteka.
32	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 15.	Pianoja	Dëgjojmë një pjesë për piano.	Punë në grupe. Pesëvargëshi.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nx., teksti, interneti, biblioteka.
33	Përdorimi i drejtë i gjuhës 8 (leksikologji) 12. 1	Fusha leksikore	Përcaktohet fusha leksikore e disa fjalëve	Punë në grup. Punë e pavarur. Tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra FVK.
34	Përdorimi i drejtë i gjuhës 8 (leksikologji) 13.	Familja e fjalëve	Nx krijojnë familjen e disa fjalëve.	Punë në grup. Punë e pavarur. Tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra FVK.

35	Dëgjimë 2	Diktim	Nxënësit përdorin drejt zanoret e, ë	Prezantim. Diskutim në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore
36	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 13.	Projekti: “Mjedisi dhe ne” (ora e dytë)	Nxënësit prezantojnë materialet.	Punë në grupe. Punë e pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm	Fotografi, biblioteka.
37	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 8.	Letra personale	Shkruajmë një letër personale.	Punë në grupe. Punë e pavarur.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, modele letrash, fletore e punës me shkrim.
38	Java X Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 16.	Kështjella	Flasim rreth figurës së Skënderbeut.	Diskutim. Prezantim. Lexim zinxhir. Puno në dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, teksti, interneti, biblioteka.
39	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 17.	Kështjella	Episode nga filmi.	Pema e mendimit. Pyetja binare (rrjeti i diskutimit).	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, teksti, interneti, biblioteka.
40	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 18.	Gjinia dhe numri i emrit.	Dallojmë gjininë dhe numrin e emrit.	Pema e mendimit. Punë në grupe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fisha, tabela, shkurtesa me ngjyrë.
41	Java XI Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 18.	Njeriu që mbillte pemë.	Parashikimi i ngjarjes nisur nga ilustrimet e titullit.	Imagjinata e drejtuar. Pyetje-përgjigje	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka.
42	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 19.	Njeriu që mbillte pemë.	Flasim për problemet mjedisore.	Tryeza e rrumbullakët. Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka.
43	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 16.	Klasa e emrave	Dallojmë emrat e përgj., përve., konkretë.	Pema e mendimit. Punë në dyshe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra FVK, tabela.
44	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 3.	Identifikimi dhe zgjidhja e problemit në një tekst rrëfimtari	Dëgjojmë me vëmendje pjesë të ndryshme.	Dëgjim me ndalesa. Plotësim skede.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	CD, magnetofon, kompjuter.

45	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 17.	Rasat dhe trajtat e emrit	Dallojmë rasën dhe trajtën e emrit.	Pema e mendimit. Punë në dyshe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletore, shumës me ngjyra FVK, tabela.
46	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 18.	Gjinia dhe numri i emrit	Dallojmë gjininë dhe numrin e emrit.	Pema e mendimit. Punë në grupe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fisha, tabela, shumës me ngjyrë.
47	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 19.	Ushtrime për emrin (FVK)	Dallojmë kategoritë grupit të emrit.	Punë në grupe. Diskutim. Punë në dyshe.	Vlerësim i Vazhdueshëm.	FVK, shumës me ngjyra, tabela.
48	Java XI Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 18.	Njeriu që mbillte pemë	Parashikimi i ngjarjes nisur nga ilustrimet e titullit.	Imagjinata e drejtuar. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka.
49	Të folurit për të komunikuar dhe mësuar 4.	Mjedisi rreth nesh	Flasim rreth problemeve mjedisore	Diskutim. Punë në grupe katërshe. Krijim. Postera. Interpretim.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Interneti, teksti biblioteka, revista; histori të regjistruara.
50	Të folurit për të komunikuar dhe mësuar 4.	Projekt: “Mjedisi dhe ne” (ora e tretë)	Flasim rreth problemeve mjedisore	Diskutim. Punë në grupe katërshe. Krijim. Postera. Interpretim.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Interneti, teksti biblioteka, revista; histori të regjistruara.
51	Lexojmë 19	Kur të vijmë mendtë	<i>Imagjinata e drejtuar</i>	Imagjinatë e drejtuar. Pyetje-përgjigje. Punë në grupe. Ditari dypjesësh. Diskutim. Rrjeti i diskutimit	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka, biblioteka digjitale, revista.
52	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 11.	Shkruajmë tregime në mënyra të ndryshme	Shkrimi i një tregimi nisur nga ilustrimet.	Shkrim i lirë. Punë në grupe.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Shkrimi i një tregimi nisur nga ilustrimet.
53	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 20.	Mbiemri	Dallimi i mbiemrit dhe shkallëve të tij.	Zgjidhja e gjëgjës. Di/dua të di/mësoj. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.

54	Java XII Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 21.	Përshtatja e mbiemrit me emrin	Përshtatim mbiemrin me emrin.	Punë në grupe dyshe. Puna me grupe ekspertësh.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkumësa me ngjyra, fletore, fisha.
55	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 22.	Ushtrime për mbiemrin (FVK)	Punë me tekstin.	Punë individuale Puno në dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	FVK, shkumësa me ngjyra.
56	Lexojmë 20	Biri i erës (FVK)	<i>Pemë mendimi.</i>	Pema e mendimit. Punë e pavarur. Diskutim.	Vetëvlerësim	Fletore e vlerësimit të kompetencave
57	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 23.	Përemrat	Dallojmë llojet e përemrave.	Punë individuale. Puno në dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkumësa me ngjyra, fletore.
58	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 24.	Ushtrime për përemrat (FVK)	Punë me tekstin.	Punë individuale. Puno në dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkumësa me ngjyra, fletore, FVK.
59	Java XIV Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 9.	Test për tremujorin e parë	Tekste rrëfimore. Njohuri gjuhësore.	Punë individuale.	Vlerësim përmbledhës me notë.	Teste alternative, mjete shkrimi.
60	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 25.	Panair portofoli	Punimet më të mira të nxënësve.	Prezantim. Turi i galerisë.	Vlerësim me gojë. Vlerësim dhe vetëvlerësim.	Portofoli i punimeve, CD, muzikë.

Tremujori i dytë

1	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 24.	Sa zbavitëshin dikur	Flasim rreth shkollës të së ardhmes.	Imagjinata e drejtuar. Pyetje-përgjigje. Ditari dypjesësh.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka teksti.
2	Lexojmë 23	Sa zbavitëshin dikur	Puna me tekstin	Imagjinatë e drejtuar. Lexim shprehës. Puno në dyshe/shkëmbe. Ditari dypjesësh. Puno në grupe.	Vlerësim me gojë. Vlerësim dhe vetëvlerësim.	Përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka teksti.
3	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 1.	Folja	Dallojmë zgjedhimin e foljeve.	Punë individuale. Punë në grupe. INSERT. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.
4	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 2.	Folja	Puna me tekstin.	Punë individuale Puno në dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, Shkumës me ngjyra, fletor.
5	Java XIV Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 1.	Shkolla e ëndrrave të mia	Nxënësit flasin rreth H. Potter-it.	Diskutim. Puno dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka teksti.
6	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 20.	Kapela që flet	Nxënësit flasin rreth H. Potter-it.	Diskutim. Puno dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka teksti.
7	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 21.	Kapelja që flet	Puna me tekstin.	Të nxënësit me këmbime. Diagrami i Venit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka teksti.
8	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 3.	Mënyrat dhe kohët e foljes	Nx. dallojnë mënyrat dhe kohët e foljes.	Lojë zinxhir. Punë individuale. Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.
9	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 1.	Stinët në planetin e kuq	Parashikimi i pjesë nisur nga titulli.	Diskutim. Kllaster. Lexim zinxhir.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, teksti

10	Dëgjimë 4	Diktim	Nxënësit do të përdorin drejt rregullat drejtshkrimore..	Diktim teksti.	Vlerësim me notë dhe me shkrim	Tekste të shkurtra, mjete shkrimi.
11	Java XV Të shkruarit për qëllime personale 2.	Shkruajmë me imagjinatë	Të shkruajmë një tregim me imagjinatë.	Punë individuale. Punë në grupe. Turi i galerisë.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Fletore e punëve me shkrim, modele shkrimi, foto.
12	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.	Shumë mënyra për të dëgjuar anektoda	Të shkruajmë një tregim me imagjinatë.	Dëgjim i vëmendshëm. Diskutim.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	CD, magnetofon, teksti nxënësit.
13	Lexojmë 27	Fuqia e Mujit	<i>Stuhi mendimi:</i>	Stuhi mendimi. Lexim në role..	Vlerësim i vazhdueshëm	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka, biblioteka digjitale, revista.
14	Lexojmë 28	Fuqia e Mujit	<i>Mitrush Kuteli (Dhimitër Pasko)</i>	Punë në grupe. Rrjeti i diskutimit	Vlerësim i vazhdueshëm	
15	Drejtshkrim 6	Projekt: “Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore në përdorimin e gjuhës shqipe” (ora e parë)	Situata e të nxënit lidhet me planifikimin e projektit për gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore në përdorimin e gjuhës shqipe.	Punë në grupe. Punë individuale. Rrjeti i diskutimit	Vlerësim i vazhdueshëm	Harta e ideve, tabela e zezë, fletore shënimesh.
16	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 5.	Mënyra dëftore e foljes	Nx. dallojnë foljet e mënyrës dëftore në një tekst..	Punë individuale. Punë në grupe. Loja gjuhësore.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.
17	Morfologji 15	Mënyra dëftore e foljes	Puna me tekstin.	Loja zinxhir. Punë në grupe dyshe. Diskutim. Puno/shkëmbe në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore

18	Java XVI Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 3.	Zemërimi i Zeusit	Parashikimi i ngjarjes, nisur nga titulli e ilustrimet.	Imagjinata e drejtuar. Diskutim. Lexim zinxhir.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, biblioteka, mite të ndryshme.
19	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 4.	Zemërimi i Zeusit	Puna me tekstin.	Diskutim. Ditari. Dypjesësh. Shkrim i lirë.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, mite të ndryshme.
20	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 2	Renditja e ngjarjeve në një tekst	Rregullojmë strukturën e një tregimi të dëgjuar.	Dëgjim. Punë individuale.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksi mësimor, CD, libra artistikë.
21	Java XIII Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 22.	Bisedë letrare: <i>Tregime të moçme shqiptare.</i>	Krijimi i këndit: Mitrush Kuteli.	Prezantim. Pyetje-përgjigje. Turi i galerisë.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Biblioteka, vepra të Kutelit, fotografi, fletore.
22	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 23.	Bisedë letrare. <i>Tregime të moçme shqiptare.</i>	Pyetje rreth librit, përmblajtjes, analizë.	Prezantim. Pyetje-përgjigje. Turi i galerisë.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Biblioteka, vepra të Kutelit, fotografi fletore.
23	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 6.	Mënyra lidhore e foljes	Nx. dallojnë foljet e mënyrës lidhore.	Punë individuale. Punë në grupe. Loja gjuhësore.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela fletore, shkumësa me ngjyra.
24	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 7.	Ushtrime. Mënyra dëftore dhe mënyra lidhore.	Punë me tekstin	Punë individuale. Punë në grupe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkumësa me ngjyra, fletore, FVK.
25	Flasim 5	Përcjellim ide përmes artit	<i>Përshkrim. Lojë.</i>	Përshkrim. Lojë. Pyetje- përgjigje. Punë në grupe. Diskutim. Krijimtari e lirë.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Interneti, Revista, libra, albume me piktura, CD, flesh, laptop. Piktura, foto, lapsa me ngjyra, penela etj.
26	Java XVII Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 5.	Kërmilli dhe trëndafili	Vlerat e njeriut në shoqëri.	Stuhi mendimi. Lexim zinxhir. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, teksti, biblioteka.

27	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 6	Kërmilli dhe trëndafili	Puna me tekstin.	Ditari dypjesësh. Diagrami i Venit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, teksti, biblioteka.
28	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 8.	Ndajfolja	Nx. dallojnë ndajfoljet në një tekst.	Punë në grup. Punë e pavarur. Tabela koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.
29	Morfologji 19	Projekti: “Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore në përdorimin e gjuhës shqipe” (ora e dytë)	Nxënësit japin mendime rreth temës.	Bisedë e lirë. Punë në grupe.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Fotografi, përvojat e nx., biblioteka, teksti i nx., fletore.
30	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 7.	Bretkosa që desh të trashej sa një ka	Shkrimi i një situatë nisur nga fjalët kyçe.	Imagjinatë e drejtuar. Diskutim. Ditari dypjesësh. Të nxënësit me këmbime.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, teksti, biblioteka.
31	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 10.	Lidhëzat	Nxënësit dallojnë lidhëzat në një fragment.	Punë individuale. Punë në grupe. Tabela e konceptit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.
32	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 11.	Lidhëzat	Puna me tekstin.	Punë individuale. Punë në grupe. Loja gjuhësore.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.
33	Dëgjime 7	Dëgjime dhe recitime poezi	Dëgjimi i poezive të ndryshme	Punë individuale. Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	CD model e regjistruar, vëllime me poezi, teksti mësimor, ftesa e poetit.
34	Java XVII Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 8.	Bagëti e bujqësia	Jeta dhe vepra e Naim Frashërit.	Prezantim. Stuhi mendimi. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, foto, interneti.
35	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 12.	Parafjala	Dallojmë dhe analizojmë parafjalët.	Punë individuale. Punë në grupe. Tabela e konceptit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore.

36	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 4	Shkruajmë vargje me rimë	Krijimi i poezive të shkurtra me rimë.	Imagjinatë e drejtuar. Punë e pavarur. Turi i galerisë.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fletore e punëve me shkrim.
37	Shkruajmë 12	Shkruajmë vjersha me rimë	Situata e të nxënësve lidhet me shkrimin e vjershave me rima të llojeve të ndryshme.	Diskutim. Pyetje-përgjigje. Shkrim i lirë.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fletore e punës me shkrim.
38	Java XX Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 12.	Gjuha shqype	Prezantojmë poezi për gjuhën shqipe.	Interpretim. Pema e mendimit. Kllaster.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, fotografi, interneti.
39	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 13.	Gjuha shqype	Pema e gjuhëve.	Diskutim. Pyetje-përgjigje. Shkrim i lirë. Rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, fotografi, interneti.
40	Përdorimi i drejtë i gjuhës (morfologji) 13.	Ushtrime për ndajfoljet, lidhëzat, parafralët (FVK)	Punë me fisha.	Punë individuale. Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkurtesa me ngjyra, FVK.
41	Java XXI Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 15.	Zemra e liqerit	Vargje nga krijimtaria e L. Poradecit.	Interpretim. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, fotografi, interneti.
42	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 16.	Zemra e liqerit	Puna me tekstin.	Diskutim. Puno në dyshë/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, fotografi, interneti.
43	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 14	Valbona	Pamje nga lugina e Valbonës.	Prezantim. Interpretim. Diskutim. Tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, biblioteka, fotografi, interneti.
44	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 17.	Detyrë klase	Imagjinatë brendinë nisur nga titulli e ilustrimet.	Diskutim Kllaster. Pyetje/përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.

45	Morfologji 24	Projekti: “Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore në përdorimin e gjuhës shqipe” (ora e tretë)	Prezantimi i projektit.	Pyetje/përgjigje. Teknika e pyetjeve. Punë e pavarur.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve,
46	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 15.	Teksti, paragrafi, fjalë, gjymtyra.	Përvetësimi i koncepteve bazë.	Pyetje/përgjigje. Teknika e pyetjeve. Punë e pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkurtesa me ngjyra, fletore, fisha.
47	Sintaksë 2	Teksti, paragrafi, fjalë, gjymtyra (FVK)	Punë me tekstin.	Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fletore e vlerësimit të kompetencave
48	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 19	14 vjeç dhëndër	Krijimi i këndit: A. Z. Çajupi.	Krijimi i këndit: A. Z. Çajupi.	Stuhi mendimi. Pyetje-përgjigje.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka, DVD e filmit.
49	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 20	14 vjeç dhëndër	Fragmente nga filmi “Përrallë nga e kaluara”.	Prezantim. Minileksion. Diskutim. Tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka, DVD e filmit.
50	Java XXII Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 18.	Unë, biri yt	Dëgjohet këngë e flasin për Kosovën.	Pësëvargëshi. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, Biblioteka, CD, magnetofon.
51	Java XXIII Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 6.	Si të dramatizohet një tregim	Dramatizimi i një tregimi..	Imagjinatë e drejtuar. Punë në grupe. Shkrim i lirë.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fletore e punëve me shkrim, tregime të shkurtra.
52	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 7.	Si të dramatizohet një tregim	Dramatizimi i një tregimi.	Imagjinatë e drejtuar. Punë në grupe. Shkrim i lirë.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fletore e punëve me shkrim, tregime të shkurtra.

53	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 21.	Koprraci	Fragmente nga komedia e Moliërit.	Prezantim. Lexim në role. Pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nx., DVD, komedisë.
54	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 22	Koprraci	Interpretojmë në role.	Lojë në role. Të nxënit me këmbime. Shkrim i lirë.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka, DVD e komedisë.
55	Java XXIV Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 21.	Gjymtyrët kryesore të fjalisë. Kryefjala.	Ndërtojmë fjali ku kryefjala të jetë: emer, përemër, GE., numëror etj.	Punë në grup. Tabela e koncepteve. Lojë gjuhësore. Punë e pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm. Vlerësim diagnostifikues.	Teksti, tabela, shkurtesa me ngjyra, fletore, fisha.
56	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 23	Udhëtim në Disney Land	Diskutim rreth tekstit joletrar.	Stuhi mendimi. Pema e mendimit. Tryeza e rrumbullakët.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.
57	Flasim 6	Mbresa udhëtimesh	Bashkëbisedim në grupe dyshe	Bashkëbisedim në grupe dyshe. Punë në grupe. Pyetje/përgjigje. Hartë koncepti.	Teksti, tabela, shkurtesa me ngjyra, fletore, fisha.	
58	Lexojmë 49	Shtatë sorrat (FVK)	Punë me tekstin. Tekst rrëfimtari letrar, përrallë.	Punë individuale. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm	Njohuritë e nxënësve, FVK.
59	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 8.	Test për tremujorin e dytë	Tekste poetike. Njohuri gjuhësore të tremujorit.	Punë individuale.	Vlerësim përmbledhës me notë.	Teste alternative.
60	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 3.	Panair portofoli	Punimet më të mira.	Turi i galerisë. Diskutim.	Vlerësim me gojë dhe notë.	Punimet e portofolit të nx., CD.

Tremujori i tretë

1	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 1.	Vaçe Zela: I kam harruar pengjet e mia...	Dëgjohet këngë nga Artistja e Popullit, Vaçe Zela.	Prezantim. Diskutim. Kllaster. Minileksi. Puno në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, CD me këngë, magnetofon.
2	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 2	Vaçe Zela: I kam harruar pengjet e mia...	Puna me tekstin.	Karrigia e nxehtë. Të nxënësit me këmbime.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, CD me këngë, magnetofon.
3	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 18.	Fjala e përbërë	Dallimi i fjalisë së përbërë.	Punë në grupe. Bisedë e kombinuar me shpjegim. Punë pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkurtesa me ngjyra, fletore, fisha.
4	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 19.	Fjala e përbërë	Puna me tekstin.	Punë individuale. Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shkurtesa me ngjyra, fletore, fisha.
5	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 3.	Histori paqeje	Diskutojmë rreth kronikës.	Diskutim. Puno dyshe/ Shkëmbe mendime. Ditë dypjesësh. Kllaster. Minileksion.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka, biblioteka digjitale, revista.
6	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 1.	Shkruajmë artikull gazete	Shkrimi i një artikulli; kronikë, udhëpërshkrim.	Minileksion. Punë e pavarur. Diagrami i Venit.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fletore e punëve me shkrim, gazeta, revista.
7	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 5.	Nënë Tereza, nënë e dashurisë	Flasim për figurën e Nënë Terezës.	Prezantim. Stuhi mendimi.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësit, biblioteka, DVD e një dokumentari.

8	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 1.	Ngjarje të jetuara	Dëgjimi i ngjarjeve të jetuara dhe të rëndësishme.	Prezantim digjital ose me fotografi. Punë në grup. Diskutim .	Vlerësim me gojë dhe me not.	CD, magnetofon, ngjarje të regjistruara.
9	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar 1.	Festat tona	Përshkruajmë me emocion festa të ndryshme.	Prezantim digjital. Diskutim. Rrjeti i diskutimit.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.
10	Sintaksë 6	Ushtrime për fjalinë e përbërë (FVK)		Punë e pavarur. Diskutim. Puno/shkëmbe në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm	Fletore e vlerësimit të kompetencave.
11	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale 2.	Njoftime, ftesa, urime.	Shkruajmë ftesa dhe urime për miqtë.	Diskutim. Shkrim i lirë. Turi i galerisë	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fletore e punëve me shkrim, modele ftesash.
12	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 7.	Shpikje për të komunikuar	Mjete të komunikimit në ditët e sotme.	Stuhi mendimi. Pema e mendimit. Rrjeti i diskutimit	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.
13	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 8.	Shpikje për të komunikuar	Punë me tekstin.	Diskutim. Të nxënësit me këmbime. Puno dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.
14	Shkruajmë 19	Letra zyrtare	Bashkëbisedim në grupe dyshe.	Bashkëbisedim/Punë në grupe dyshe. Punë në grupe. Diagrami i Venit. Kllaster. Turi i galerisë	Vlerësim i vazhdueshëm.	modele letrash, teksti mësimit, zarf, modele e-mail-esh.
15	Leksikologji 3	Projekt: “Bëjmë një gazetë” (ora e parë)	Bashkëbisedim	Bashkëbisedim/Punë në grupe	Vlerësim i vazhdueshëm.	Gazeta të ndryshme.
16	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 9.	Funksioni dhe interpretimi i grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve.	Nx. krijojnë grafikë, tabela, ilustrime.	Të nxënësit me këmb. Shkrim i lirë. Diskutim. Punë individuale.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fletë formati, ngjyra, përvojat e nx.
17	Dëgjojmë 9	Diktim	Situata e të nxënësit lidhet me drejtshkrimin.	Diskutim. Të nxënësit me këmbime. Puno dyshe/shkëmbe.	Vlerësim i vazhdueshëm	modele letrash, teksti mësimit, zarf, modele e-mail-esh.

18	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 13.	Domethënia e ngjyrave	Nxënësit organizojnë lojën “Ngjyra ime më e dashur”.	Lojë zbavitëse. Diskutim. DDM.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Ngjyra, fletë formati, teksti, interneti.
19	Të folurit për të komunikuar dhe mësuar 2.	Pasionet, sportet, lojrat	Flasim rreth lojërave sportive.	Prezantim digjital ose fotografi. Diskutim në grup. Rrjeti i diskutimit. Diagrami i Venit.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Fotografi, CD, video, revista, albume, libra, materiale nga interneti.
20	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 2.	Gjymtyrët kryesore të fjalisë (Kryefjala)	Punë me tekstin.	Punë në grupe. Punë në dyshe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore, fisha. FVK
21	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 1.	Gjymtyrët kryesore të fjalisë (Kallëzuesi)	Nx. dallojnë kallëzuesin në një fragment.	Punë në grup. Tabela e koncepteve. Lojë gjuhësore. Punë e pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore, fisha.
22	Sintaksë 9	Gjymtyrët kryesore të fjalisë (Kallëzuesi)	Puna me tekstin.	Diskutim. Punë në dyshe. Tabela e konceptit. Punë në grupe.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore, fisha. FVK
23	Lexojmë 58	Bisedë letrare	Punë me tekstin.	Rrjeti i diskutimit, Tabela e konceptit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti, literaturë shites, .
24	Lexojmë 59	Bisedë letrare	Punë me tekstin.		Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti, fisha.
25	Shkruajmë 20	Shkruajmë receta të shëndetshme	Paraqitja e recetave të ndryshme.	Diskutim. Punë në dyshe. Tabela e konceptit. Punë në grupe.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti, interneti, përvojat e nxënësve.
26	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 15.	Unë jam Malala	Diskutojmë rreth koncepteve: arsim, dhunë tolerancë, diskriminim.	Stuhi mendimi. Pyetje-përgjigje. Rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.

27	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 16.	Unë jam Malala	Prezantimi i një shkrimi argumentues.	Diskutim. Të nxënësit me këmbime. Ditar dypjesësh.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.
28	Sintaksë 10	Ushtrime për kallëzuesin (FVK)	Pema e mendimit - Kallëzuesi.	Pema e mendimit. Puno/shkëmbime në dyshe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fletore e vlerësimit të kompetencave. Teksti.
29	Shkruajmë 21	Këshilla dhe udhëzime	Sa e njohin nxënësit përdorimin e pajisjeve të ndryshme?	Anketë. Shkrimi i udhëzimeve. Punë e pavarur. Punë në grupe	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka.
30	Sintaksë 11	Projekt: “Bëjmë një gazetë” (ora e dytë)	Situata e të nxënësit lidhet me idetë dhe diskutimet rreth përmbajtjes së gazetës, ilustrimeve etj.	Shkrimi i udhëzimeve. Punë e pavarur.	Vlerësim i vazhdueshëm	Materiale të ndryshme: foto, informacione etj.
31	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 17.	Të vërejturit, burim i çdo diturie	Nxënësit parashikojnë përmbajtjen nisur nga titulli.	Stuhi mendimi. Pyetje-përgjigje. Rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, interneti, përvojat e nxënësve.
32	Të lexuarit e teksteve let. dhe jolet. 18.	Të vërejturit, burim i çdo diturie	Nxënësit plotësojnë tezën me përgjigje	Diskutim. Pyetje-përgjigje. Tabela e koncepteve.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, interneti, përvojat e nxënësve.
33	Sintaksë 12	Gjymtyrët e dyta të fjalisë	Punë në dyshe	Punë në dyshe. Lexim i lidhur me shpjegimin. Lojë gjuhësore.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Harta semantike, tabela, skeda grafike, teksti mësimor.
34	Sintaksë 13	Ndajshtimi	Lojë gjuhësore	Punë e pavarur. Diskutim. Punë në dyshe.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Harta semantike, tabela, skeda grafike, teksti mësimor.

35	Të lexuarit e teksteve let. dhe jollet. 19.	Histori njerëzore dhe alienët	Nxënësit u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jashtëtokësorët.	Stuhi mendimi. Marrëdhënia pyetje-përgjigje.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, interneti, njohuritë e nx., fotografi.
36	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme 2.	Episode filmash dhe emisionesh për fëmijë	Nxënësit u përgjigjen pyetjeve në lidhje me filmat.	Prezantim. Pyetje-përgjigje (kuic). Lojë në role. Punë në grupe.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Teksti, histori të regjistruara, CD, magnetofon.
37	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 8.	Kundrinori i drejtë	Nxënësit formojnë fjali me kundrinorë të drejtë.	Punë në grupe. Punë në dyshe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm. Vlerësim diagnostifikues.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore, fisha.
38	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 10.	Kundrinori i zhdrejtë	Nxënësit dallojnë kundrinorët e zhdrejtë.	Punë në grup. Punë në dyshe. Diskutim.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore, fisha.
39	Sintaksë 16	Ushtrime për kundrinorët (FVK)	Punë individuale	Punë në grupe. Punë në dyshe.	Vlerësim i vazhdueshëm	Fletore e vlerësimit të kompetencave.
40	Flasim 9	Argumentojmë pse ndodh	Vëzhgojmë fotografi.	Punë në grupe. Formulimi i pyetjeve.	Vlerësim i vazhdueshëm	Teksti mësimor, mjete digjitale, diktofon, magnetofon ose tablet.
41	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 12.	Rrethanorët. Rrethanori i vendit dhe i kohës.	Nxënësit dallojnë rrethanorët në një tekst.	Punë në grupe. Formulimi i pyetjeve. Diagrami i Venit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, CD, video, revista, albume, libra, materiale nga interneti.
42	Përdorimi i drejtë i gjuhës (sintaksë) 14.	Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit	Nxënësit dallojnë rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit.	Punë në grupe. Formulimi i pyetjeve. Diagrami i Venit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti, tabela, shumës me ngjyra, fletore, fisha.
43	Lexojmë 65	Projekt: “Bëjmë një gazetë” (ora e tretë)	Situata e të nxënësve lidhet me punimin e gazetës	Prezantim. Pyetje-përgjigje (kuic). Lojë në role.	Vlerësim i vazhdueshëm	Gazeta e secilit grup.

44	Lexojmë 66	Projekt: “Bëjmë një gazetë” (ora e katërt)	Situata e të nxënësit lidhet me prezantimin e gazetës.	Diskutim, prezantim, karrigia e autorit.	Vlerësim me gojë dhe me notë.	Gazeta e secilit grup.
45	Lexojmë 67	Përshkrimi i një personi	Prezantim digjital – Diskutim	Prezantim digjital-Diskutim. DRTA. Ditari dypjesësh.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka, biblioteka digjitale, revista.
46	Të shkruarit për qëllime personale	Përshkruajmë një person	Pema e mendimit. Punë në dyshe.	Punë në grupe. Diagrami i Venit.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti, fletore e punëve me shkrim, fotografi të ndryshme.
47	Lexojmë 68	Si u zhdukën dinosaurët (FVK)	Prezantim digjital-Diskutim. DRTA. Ditari dypjesësh.	Diskutim, prezantim, karrigia e autorit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fletore e vlerësimit të kompetencave.
48	Sintaksë 19	Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë	<i>Punë me tekstin</i>	Punë e pavarur. Lexim. Pyetje-përgjigje në grupe dyshe. Diagrami i Venit.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Teksti i nxënësit, njohuritë e nxënësve.
49	Sintaksë 20	Ushtrime për rrethanorët (FVK)	<i>Punë me tekstin</i>	Puno/shkëmbje në dyshe. Diskutim. Shkrim i lirë.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Njohuritë e nxënësve, FVK.
50	Shkruajmë 23	Përshkrimi i një kafshe, mjedisi, dukurie	<i>Diskutim në dyshe. Pesëvargësh.</i>	Diskutim në dyshe. Pesëvargësh. Minileksion. Punë në grupe. Shkrim i lirë. Turi i galerisë.	Vlerësim me notë dhe me shkrim.	Teksti i nxënësit, foto të ndryshme, interneti, njohuritë e nxënësve.
51	Lexojmë 69	Shtatë krojet	Pesëvargëshi	Pesëvargëshi. Prezantim digjital. Diskutim. Kllaster. Punë në grupe.	Vlerësim i vazhdueshëm.	Fotografi, përvojat e nxënësit, interneti, biblioteka, biblioteka digjitale, revista.

52	Lexojmë 70	Shtatë krojet	Prezantim Digjital	Pesëvargëshi. Prezantim digjital. Diskutim. Kllaster. Punë në grupe.	Vlerësim me notë dhe me shkrim	teksti, interneti, materiale të krijuara nga mësuesi/ja, DVD, magnetofon etj.
53	Flasim 10	Stop diskriminimit	<i>Stuhi mendimi. Kllaster</i>	Stuhi mendimi. Kllaster. Rrjeti i diskutimit. Rrjeti i diskutimit.	Vlerësim i vazhdueshëm	Materiale nga interneti, gazeta, revista, teksti mësimor, mjete digjitale, diktufon, magnetofon, tablet.
54	Shkruajmë 24	Test për tremujorin e tretë	Tekste rrëfimore joletrare (reportazh, tekst përshkrues)	Punë individuale.	Vlerësim përmbledhës me notë.	
55	Shkruajmë 25	Panair portofoli	Punimet më të mira të nxënësve	Prezantim. Turi i galerisë. Bashkëbisedim.	Vetëvlerësim Vlerësim përmbledhës me notë.	Materiale nga interneti, gazeta, revista, teksti mësimor, mjete digjitale.

Periudha e parë: Shtator-dhjetor

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Një mjedis i ri Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënit: Nxënësit prezantohen dhe vendosen në situatën: “Më mungon një shok, ka ardhur një shok i ri”. Nxënësit e rinj prezantohen, duke krijuar atmosferë mikpritëse në klasë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit • Kompetenca e të nxënit • Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacione; - kupton, krahason dhe bën përgjithësime rreth situatave që dëgjon; - jep mendime dhe gjykime në lidhje me situatat që dëgjon; - shpreh pëlqimet dhe bën komentet e veta; - analizon mënyrën si shprehen shokët: tonin, zërin, pauzat.		Fjalët kyçe: mjedis i ri, shokë, shoqe, prezantim, ndjenja, mendime, emocione	
Burimet: teksti mësimor, materiale nga interneti, fotografi,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë e lirë. Prezantim. Lojë zbavitëse. Punë në grupe. Shkrim i lirë.			
Organizimi i orës së mësimit: Veprimtari paraprake Duke qenë se është ora e parë e mësimit, nxënësit/et ftohen të përzgjedhin një fotografi të fëmijërisë së tyre apo një histori që u ka ndodhur gjatë pushimeve të verës dhe flasin rreth historive që u kanë ndodhur, duke dëgjuar njëri-tjetrin/ën dhe duke treguar interes, përqendrim e duke bërë humor etj. Ndërtimi i njohurive të reja Udhëzohen nxënësit të hapin tekstin në fq.12 dhe të flasin në lidhje me situatën e ushtrimit.1. Si ndihen ata në ditën e parë të shkollës? Secili nxënës/e është i/e lirë të shprehë emocionet e tij, duke thënë edhe disa arsye se pse ndihet kështu. Lojë zbavitëse. Udhëzohen nxënësit/et të përshkruajnë sa më bukur portretin e shokut/shoqes, që ata mendojnë se ka ndryshuar më shumë. Dëgjojnë mendimet e 4-5 nxënësve. Punë në grupe. Nxënësit ndahen në grupe dhe flasin për situatat 3, 4, 5 të librit dhe, më pas, nxënës të ndryshëm prezantojnë mendimet e tyre në lidhje me pyetjet e paraqitura në situatë. Grupi 1. Situata 3 Grupi 2. Situata 4 Grupi 3. Situata 5 Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Si do të ishte mësuesi/ja juaj model? Komentoni cilësitë e tij/saj. Nxënësi/et do të punojnë disa minuta e më pas do të prezantojnë atë që kanë shkruar.			
Vlerësimi: Kjo orë mësimi për zhvillimin e kompetencën për të folurin në lidhje me përshtatjen në një mjedis të quhet e realizuar, nëse nxënësit/et e arrijnë të tregojnë histori, të prezantohen, apo të pyesin pjesëtarët e grupit në të cilin kanë shkruar apo kanë ardhur miq të rinj, me pyetje që nuk lëndojnë dhe kërcënojnë, por që shprehin miqësi dhe bashkëpunim. Vlerësohet përdorimi i fjalorit dhe i etikës së duhur për situata që lidhen me përshtatjen në një mjedis të ri. Fjalë të tilla, si: shok i ri, zhvendosur, miqësor, komunikues, përcjellin informacionin, idetë dhe ndjenjat e tyre rreth miqësisë.			
Dettyrat dhe puna e pavarur:			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ju dhe të lexuarit Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënit: Plotësimi i një ankete, që do të jetë bazë për nxitjen e diskutimeve në lidhje me interesin dhe aftësitë, shprehitë e nxënësve në të lexuar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit • Kompetenca e të nxënit • Kompetenca qytetare • Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet në lidhje me aftësitë dhe interesat e tij për të lexuari; - merr pjesë në bisedë në grup me moshatarët dhe të rriturit mbi temën e të lexuarit rrëfen dhe pyet shokët/ shoqet mbi aspekte të ndryshme të të lexuarit; - plotëson anketën; mban shënime për çdo pikë të anketës për çdo nxënës/e; - reflekton në mënyrë kritike për situatën dhe nivelin e tij/ të saj të shprehive të të lexuarit; - mat shpejtësinë e të lexuarit të vetën dhe të shokut, bën krahasime dhe mban qëndrim kritik; - bën përlllogaritje për buxhetin e një miniprojekti.		Fjalët kyçe: të lexuarit, përvoja, bibliotekë shpejtësi e të lexuarit, anketë, përlllogaritje	
Burimet: teksti mësimor, kronometër ose orë, anketë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi; Matematika	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim. Punë në grupe. Pyetje-përgjigje			
Organizimi i orës së mësimi: Situata e të nxënit Prezantimi i anketeve të plotësuara nga të gjithë nxënësit/et. Çdo nxënës/e paraqet anketën e tij/saj dhe të tjerët dëgjojnë e pyesin rreth atyre që thotë gjithsecili për vete në lidhje me të lexuarit. Ndërtimi i njohurive të reja. Përmes prezantimeve që i ndjekin me interes, nxënësit/et njohin përvojat e njëri-tjetrit në të lexuar dhe aftësitë e tyre folëse në lidhje me temën e të lexuarit, bëjnë pyetje për të mësuar më tepër rreth njëri-tjetrit. Në grupe diskutojnë për mënyrën e anëtarësimit dhe të funksionimit të bibliotekës dhe të ngritjes së një sipërmarrje të vogël, me qëllim pasurimin dhe mirëmbajtjen bibliotekës së shkollës. Punë në grup - Matja e shpejtësisë së leximit Klasa ndahet në grupe me nga 5 nxënës/e, që u caktohet një pjesë tregimi apo një tekst tjetër. Prej tyre kërkohet të matin shpejtësinë e të lexuarit të njëri-tjetrit në grup. Më pas çdo grup prezanton shpejtësinë e të lexuarit të shokut/shoqes, mesataren e grupit dhe më në fund mesataren e klasës. Nxënësve u lihet detyrë që, duke nisur nga kjo mesatare, deri në fund të vitit shpejtësia e leximit të jetë shtuar me 10-15 fjalë në minutë (numri përcaktohet në varësi të klasës.) Kërkohet që nxënësit/et të bëjnë një listë, ku të rendisin emrat e shokëve/shoqeve. Secilin prej tyre duhet ta vlerësojnë nga 1-10 për atë çfarë thotë, për mënyrën si flet, për aftësitë në të lexuar dhe interesin për librin. Në fund nxirren përfundime, jepen vlerësime dhe bëhet një renditje, duke i vendosur nga ai që ka marrë më shumë pikë. Bëhen përlllogaritje dhe përcaktohet mesatarja si klasë.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe

Grupi 1 - jep mendime në lidhje me mundësitë që kanë nxënësit për të pasuruar bibliotekën e shkollës.

Grupi 2 - jep mendime se si mund të nxiten nxënësit për të lexuar letërsi artistike.

Përfaqësues të grupeve shprehin mendimet e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen për prezantimet e bëra, fjalorin e përdorur, nxjerrja përmes llogaritjes e shpejtësisë së të lexuarit dhe interesi i treguar gjatë diskutimit rreth çështjes së librave e të bibliotekës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshtypje për një libër të lexuar kohët e fundit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fonetikë)		Situata e të nxënit: Përgatiten regjistrime me zë për shqiptimin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve. Nxënësit/et i dinë zanoret, prandaj ndalet te bashkëtingëlloret, duke i radhitur ato poshtë njëra-tjetrës, b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh (të zëshme) p, t, th, k, q, f, c, ç, s, sh (të pazëshme) m, nj, n, l, ll, r, rr, j (tingëlluese) U kërkohet t’i përsëritin grupet e bashkëtingëlloreve në grupe dyshe, pastaj nxënësit/et të japin fjalë që fillojnë me këto bashkëtingëllore dhe i shkruajnë në fletore.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - shqipton qartë tingujt e zanoreve e të bashkëtingëlloreve; - dallon tingullin nga shkronja; - dallon bashkëtingëlloret e zëshme, të pazëshme, tingëlluese; - shkruan drejt fjalët që fillojnë me to.		Fjalët kyçe: zanore, bashkëtingëllore, fonema, shkronja/tingulli.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur. Punë në dyshe. Diskutim. Lojë gjuhësore. Punë në grupe			

Organizimi i orës së mësim: Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Nxënësit/et punojnë me rubrikën “Kujtojmë”. Në çdo kuadrat të shkronjave të alfabetit të shqipes, nxënësit/et shkruajnë shkronjën e dorës (të madhe, të vogël). Përsëritin alfabetin me lojën zinxhir. Ndërtimi i njohurive të reja U sqarohet nxënësve se çfarë janë tingujt dhe shkronjat, si dhe kuptimi i këtyre emërtimeve. Nxënësit shkruajnë shkronjat e thjeshta, shkronjat dyshe, zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe. Në tabelat e dhëna në libër, nxënësit/et dallojnë bashkëtingëlloret e zëshme, të pazëshme, tingëlluese
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Ushtrimet 1, 2, 3, nxënësit/et i punojnë në libër me grupe dyshe, këmbajnë librat, qortojnë gabimet e njëri-tjetrit. Ushtrimi 1. (dallimi i tingujve I-II) Ushtrimi 2. (shkronjat e përbashkëta: m, b, ë) Ushtrimi 3. Nxënësit/et ngjyrosin kutitë aq herë sa është përdorur çdo tingull. Ushtrimi 4. Nxënësit/et plotësojnë tabelën me bashkëtingëlloret e zëshme, të shurdhëta dhe të tingullta. Punë në grupe në formën e një loje gjuhësore Ushtrimi 5, nxënësit/et gjejnë nga një fjalë që fillon me çdo shkronjë. Klasa ndahet në tri grupe; nga secili grup, nxënësit/et dalin njëri pas tjetrit në dërrasë të shkruajnë fjalën. Garën e fiton grupi që mbaron i pari.
Vlerësimi: Vlerësimi bëhet në bazë të situatës së të nxënësit; vlerësim i punës në grup dhe gjatë lojës gjuhësore dhe shkathësia në pjesën e garës.
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4. Nxënësit plotësojnë tabelën me bashkëtingëlloret e zëshme, të shurdhëta dhe të tingullta. Mësojnë përmendsh alfabetin, bashkëtingëlloret e zëshme, të pazëshme, tingëlluese.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Theksi i fjalës Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fonetikë)		Situata e të nxënit: Paraqiten në tabelë disa fjali për t’u treguar nxënësve rëndësinë që ka theksi i fjalës. <i>Fjala liri është e shenjtë.</i> <i>Liri është një bimë prej së cilës prodhohen veshje.</i> <i>Tufës i printe një bari.</i> <i>Bari arrinte deri në gju.</i> <i>Stoli kishte një këmbë të thyer.</i> <i>Mbante në qafë stoli të çmuara.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon theksin e fjalës, e dallon kur është fundor, parafundor, tejfundor; - thekson qartë fjalët, dallon kur fjala ndryshon kuptimin me ndryshim të theksit.		Fjalët kyçe: rrokja e theksuar, theksi fundor, parafundor, tejfundor	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe dyshe. Punë e pavarur
Organizimi i orës së mësimit Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e ushtrimeve të dhëna për t'u punuar në shtëpi. Ndërtimi i njohurive të reja 1. Nxënësit/et lexojnë në heshtje informacionin e dhënë në libër për theksin e fjalëve në gjuhën shqipe: - rrokja e theksuar në çdo fjalë; - rrokja e theksuar në fund të fjalës; - rrokja e theksuar në rrokjen e parafundit; - rrokja e theksuar në rrokjen e parë të fjalës 2. Nxënësit/et lexojnë fjalët që janë dhënë me theks fundor, parafundor, tejfundor. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit/et punojnë në dyshe ushtrimin 1, 2, 4, 5 (në libër). Më tej kontrollojnë me radhë ushtrimet, ku nxënësi/ja shqipton fjalën dhe qortojnë rastet kur kanë vendosur gabim theksin në fjalë. Një nxënës/e zgjidh ushtrimin 3 në dërrasë, shkruan fjalët që u përgjigjen figurave, vendos theksin duke i shqiptuar të plota. Vlerësimi: Vlerësimi për punën në grup, vlerësim në zgjidhjen e ushtrimeve dhe të detyrave të shtëpisë. Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 (sipas kërkesës). Fletorja e verifikimit të kompetencave (FVK)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Intonacioni dhe theksi i fjalisë	Situata e të nxënit: Përmes një minikonkursi, nxënësit/et (zgjidhen dy prej tyre) do të lexojnë me intonacionin e duhur fjalitë dhe do të nënvizojnë fjalën që theksohet më shumë. <i>Sot nuk di çfarë të shikosh më parë në televizor. Nuk di a do t'i shoh dot të gjitha. Në çfarë ore fillon emisioni? I pe lajmet e orës tetë? Ja, filloi filmi. Sa i bukur! Sa emocion!</i> Fitues shpallet nxënësi/ja që dallon saktë fjalët e theksuara.		
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fonetikë)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon intonacionin e fjalisë dhe theksin e saj në një gjymtyrë, lexon me intonacionin e duhur fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse; - lexon me intonacionin e duhur fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse; - shpreh drejt me gojë apo me shkrim një mendim për një situatë të caktuar, duke ndërvepruar në grup ose me klasën.		Fjalët kyçe: intonacion i fjalisë, vijë melodike, intonacion ngjithës, zbritës, fjalë e theksuar	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, Fletorja për verifikimin e kompetencave (FVK)		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Minikonkurs. Punë në grup. Lexim shpjegues. Bisedë			

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e ushtrimeve të dhëna për t'u punuar në shtëpi.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet një bisedë me nxënësit në lidhje theksin e fjalës dhe theksin e fjalisë. Ashtu si fjala, e cila ka gjithmonë një rrokje a një zanore që shqiptohet më fort, ashtu edhe fjalia ka gjithmonë një fjalë që theksohet më shumë. Cilat fjalë theksohen më shumë? Nxënësit shprehin mendimet e tyre, duke sjellë edhe shembuj të ndryshëm. Paraqiten në tabelë disa prej mendimeve të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Paraqiten në dërrasë fjalitë:

Ndërtimi i njohurive të reja

Paraqiten në dërrasë fjalitë:

- Detyrat i kryen rregullisht.
- Pse nuk i ke bërë sot detyrat?
- Bëji tani detyrat e shtëpisë!

Shpjegohet edhe theksi i fjalës në fjali:

- Bleva librin dje. (librin)
- Bleva librin dje. (dje)
- E bleva librin dje. (E bleva)

Nxënësit/et i lexojnë fjalitë me intonacionin e duhur dhe shpjegojnë edhe paraqitjen grafike të intonacionit. Zgjidhen 3 nxënës/e që t'i lexojnë me intonacionin e duhur dhe të shpjegojnë paraqitjen grafike të intonacionit të fjalisë. Cila fjalë theksohet më shumë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimet 1, 4, 5 punohen me gojë, nxënësit lexojnë fjalitë në tekstet e dhëna, dallojnë intonacionin e tyre ngjites, zbritës dhe theksin e fjalisë te gjymtyra. Ushtrimin 2 nxënësit/et e punojnë në libër, ndërsa dy nxënës do të punojnë në tabelë. Nxënësit lexojnë fjalitë me intonacion ngjites apo zbritës.

Vlerësimi: Vlerësimi në punë në grup për veprimet në situatë; vlerësim në zgjidhjen e ushtrimeve dhe të detyrave të shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3 (sipas kërkesës). Fletorja e verifikimit të kompetencave

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mësuesi ynë i dashur (2 orë)		Situata e të nxënës: Nxënësit diskutojnë për rëndësinë e shkollës. Sa e rëndësishme është shkolla për ju? Çfarë ndikimi kanë te ju: prindërit, mësuesit/t, shokët e shoqet në lidhje me shkollën? Situata e orës së dytë: Nxënësit analizojnë personazhet e pjesës, duke gjetur pika takimi me ta.	
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. Kompetenca qytetare.			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ora e parë. Nxënësi/ja: - dallon rolin e mësuesit/es në qetësimin e situatave të ndryshme; - lexon qartë, rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; - pasuron fjalorin me fjalë e shprehje. Ora e dytë Nxënësi/ja: - interpreton kuptimin e shprehjeve të figurshme brenda tekstit rrëfimtari; - jep mendimin e tij/e saj personal në lidhje me modelin e mësuesit/es që kërkon; - jep tiparet e tekstit rrëfimtari.	Fjalët kyçe: mësues, i dashur, edukon, frymëzon, dëgjon
Burimet: fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka, teksti i nxënësit, fletore	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim. Të nxënit me këmbime. Pema e mendimit. Pyetja binare	
Organizimi i orës së mësimi. Ora e parë. Situata e të nxënit Nxënësit/et japin mendimet e tyre, të cilat do të mirëpritën, duke qenë se secili prej tyre tregon ndodhitë e veta. Veprimet në situatë Prezantohet titulli në tabelë. Nxënësve u jepen të dhëna të shkurtra, në lidhje me jetën dhe krijimtarinë e Daniel Penak. Daniel Penak është një shkrimtar francez lind më 1 dhjetor 1944 në Kasablanka, Marok. Ai mori çmimin “Renaudot” në vitin 2007 për esenë e tij “Shkolla brengë”. Pas studimeve në Nice, Penak u bë mësues. Ai filloi të shkruante kryesisht për fëmijët, duke përdorur një stil me humor dhe imagjinatë. Libri i tij “Ashtu si një roman”, një ese pedagogjike, trajton probleme pedagogjike dhe sociale. Për fëmijë është i famshëm romani “Kamo” dhe vëllimet e tij: “Arratisja e Kamo-s”, “Kamoja dhe unë”, “Kamoja, ideja e shekullit”. Lexohet tregimi, duke aktivizuar 3 nxënës/e (jepen vlerësime për mënyrën e interpretimit) dhe shpjegohen gjërat e paqarta dhe fjalët dhe shprehjet e reja. Gjatë rileximit të tekstit “Mësuesi ynë i dashur”, nëpërmjet diskutimit me nxënësit/et, arrihet të bëhet përmbledhja e ideve lidhur me çështjet: Çfarë i shqetëson fëmijët dhe kujt i drejtohen për të gjetur përgjigje? Si i pret mësuesi/ja? Nxënësit shprehen lirshëm, duke respektuar njëri-tjetrin. Këtu nxënësit/et sjellin edhe përvojën e tyre lidhur me mësuesit/et dhe rolin e tyre në qetësimin e situatave të ndryshme. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ora e dytë. <i>Grupi I</i> - ndan fragmentin në tri pjesë dhe secilit prej tyre i vendos një titull. 1. Fëmijët janë të shqetësuar për kalimin në klasën e gjashtë. 2. Fëmijët vrapojnë të pyesin mësuesin e tyre, zotin Margarel. 3. Zoti Margarel qetëson fëmijët. <i>Grupi II</i> - plotëson hartën e personazheve të tregimit:	

Personazhet	Si është?	Çfarë thotë?	Çfarë bën?	Ku duket kjo?
Mësuesi	i qeshur, i dashur, i duruar, u jep siguri nxënësve	Gjithçka? Do të mbeten të zhgënjyer. Klasa e gjashtë është njësoj si e pesta. Në vend të një mësuesi, do të keni pesë ose gjashtë. Mësuesit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, po aq sa ju.	Dëgjon me vëmendje nxënësit Qetëson fëmijët. Argumenton se mësuesit e ndryshëm janë si puna e specialistëve.	Kur nxënësit gjatë pushimit shkojnë ta pyesin. Sqarimet që u jep për klasën e gjashtë.
Kamoja				
Lantieri				

Grupi III --Zbërthen kuptimin e shprehjeve të mëposhtme sipas situatave ku përdoren:

“...në ta ka qejfi të kalosh klasën!” (të mos ngelesh në klasë)


“i ra më të që bëhej fjalë për diçka serioze” (e kuptoi menjëherë se bëhej fjalë për diçka me rëndësi)

“mos e zër fare në gojë” (mos e përmend më)

Grupi IV -U kërkohet të nënvizojnë dialogët midis personazheve, dy fjali në të cilat rrëfëhet, dy fjali në të cilat përshkruhet, si edhe emrat e personazheve. (Ushtrimi 10).

Pasi nxënësit/et i punojnë çështjet e mësipërme, përfaqësues të çdonjërit prej tyre argumentojnë përgjigjet. (Mund të bëhen ndërhyrjet e duhura)


Shënohet në dërrasë të zezë togfjalëshi *Teksti rrëfimtar* dhe së bashku me nxënësit/et plotësohet *Pema e mendimit*



Pyetja binare (Rrjeti i diskutimit)

Vëmendja e nxënësve përqendrohet në reflektimin mbi mësuesin model, sipas pikëpamjes së tyre. **Pyetja binare (Rrjeti i diskutimit)**

Shtrohet para tyre pyetja: **A është Margareli mësuesi që të gjithë dëshirojnë? PO/JO. Pse?** Nxënësit/et përqendrohen për pak çaste e më pas sjellin gjykimet e tyre në gjithë grupin e klasës. Diskutimet e tyre orientohen drejt tipit të modelit të mësues Margarel, duke nxjerrë në pah edhe cilësitë e një mësuesi/mësueseje model.



Vlerësimi: për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Hartoni një shkrim me 10 fjali, titulli i të cilit të jetë alternativa që zgjedhët në ushtrimin 8, faqe 18.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përdorimi i shkronjës së madhe. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Drejtshtkrim)		Situata e të nxënës: Nxënësit japin disa raste që mbajnë mend për përdorimin e shkronjës së madhe. - në fillim të fjalisë; - tek emrat e përveçëm; - emërtimet e rrugëve, shesheve; - emërtimet gjeografike (male, dete, shtete, qytete, etj.).	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - përdor shkronjën e madhe duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimit; - shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë rastet e përdorimit të shkronjës së madhe.		Fjalët kyçe: shkronjë e madhe, rregulla drejtshkrimore, emërtime, tituj	
Burimet: teksti i nxënësit, fletë të bardha, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e ushtrimeve të dhëna për t’u punuar në shtëpi. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Kur përdoret shkronja e madhe? Mendimet e nxënësve paraqiten në tabelë. Ndërtimi i njohurive të reja. (Lexim, Diskutim në grupe dyshe) Një nxënës/e lexon në libër 9 rastet e përdorimit të shkronjës së madhe. Në grupe dyshe, nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit për rastet e përdorimit të shkronjës së madhe, duke dhënë edhe shembuj. Punë në grupe Ndahen nxënësit në 5 grupe dhe në fletë të bardha shkruajnë me bojëra uji (lapsa me ngjyra), 2-3 rregulla të përdorimit të shkronjës së madhe dhe i vendosin në muret e klasës. Fletët qëndrojnë aty gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (Punë e pavarur. Punë në dyshe) 1. Ushtrimi 1, një nxënës e punon në dërrasë, kurse klasa i shkruan saktë fjalët në fletore, qortojnë gabimet. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar, Teatri i Operës dhe i Baletit, Muzeu Historik Kombëtar 2. Ushtrimi 2, 3, 6, nxënësit i plotësojnë në tabelat e librit në grupe dyshe. Nxënësit kontrollojnë punën e njëri-tjetrit e më pas kontrollohen nga mësuesi/ja. 3. Tek ushtrimi 3, sqarohen nxënësit për rregullin: Emërtimet e titujve të nderit vihen në thonjëza, kur përdoren menjëherë pas fjalës “titull”, si ndajshim i paveçuar me presje: <i>Iu dha titulli “Hero i Popullit”</i> .			
Vlerësimi: Vlerësim me gojë në situatën e të nxënës. Vlerësimi në punën me grupe. Vlerësim me shkrim për saktësinë në zgjidhjen e ushtrimeve. Vlerësim për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Grupi I: Ushtrimi 4 (sipas kërkesës). Grupi II: Ushtrimi 5 (sipas kërkesës). FVK (fq. 8)			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa:VI
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve që kanë zanoren <u>e</u> në pozicione të ndryshme. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Drejtshkrim)		Situata e të nxënit: Paraqiten në tabelë disa fjalë dhe udhëzohen nxënësit të vendosin në vend të pikave bosh zanoret; e/ë . i çm_ndur, z_mëroj, sh_një, argj_nd, q_.nie; Përgjigjet e nxënësve paraqiten në tabelë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - vendos drejt zanoren <u>e</u> , në fjalë të ndryshme; - përdor drejt zanoren <u>e</u> të theksuar; - përdor drejt zanoren <u>e</u> të patheksuar te emrat e gjinisë femërore.		Fjalët kyçe: zanore <u>e</u> e theksuar, zanore <u>e</u> e patheksuar;	
Burimet: teksti i nxënësit, Drejtshkrimi gjuhës shqipe.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Punë e pavarur. Lexim. Punë në dyshe. Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e ushtrimeve të dhëna për t’u punuar në shtëpi. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Paraqiten në tabelë disa fjalë dhe nxënësit vendosin theksat e fjalëve. Veçojnë fjalët, në të cilat theksi bie mbi zanoren <u>e</u> . shemb, shpend, shishe, rrokje, nisje, vendës, dendur, penj, korrije Nxënësit formojnë fjali me fjalët që kanë zanoren <u>e</u> të theksuar. Ndërtimi i njohurive të reja. (Lexim. Diskutim) Hapet teksti në fq.163, një nxënës lexon informacionin në lidhje me shkrimin e saktë të fjalëve që kanë zanoren <u>e</u> të theksuar, kur kjo zanore ndiqet nga bashkëtingëlloret hundore: m, n, nj. Me këto zanore shkruhen edhe fjalët e prejardhura dhe të përbëra që formohen prej tyre. dhemb, dhembje, emër, emëror, femër, femëror argjend, argjendar, i argjendtë, qendër, qendror qen, qenërisht, shenjë, shënjues tremb, trembje, i trembur, i patrembur fle, dre, gdhe, pe, ngre - Zanorja <u>e</u> pastheksore (artiste, artistja, artisteje...) Punohet në tekst ushtrimi 1. Nxënësit vendosin në vend të pikave zanoret e/ë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (Punë e pavarur. Punë në dyshe) Ushtrimet 2, 3 punohen në tabelë nga dy nxënës, kurse klasa punon në fletore. Ushtrimet 5, 6 punohen në libër nga nxënësit. Më pas nxënësit këmbëjnë librat me shokun/shoqen e bankës e kontrollojnë saktësinë e përgjigjeve. Lexohen ushtrimet nga nxënës të ndryshëm.			
Vlerësimi: për pjesëmarrje aktive në orën e mësimi, saktësinë në dhënien e përgjigjeve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, fq. 164. Krijoni nga dy fjalë të prejardhura nga fjalët: zemër, shembull, gjemb, brenda, vend, i/e shtrenjtë. Formoni fjali me to.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Rrëfime personale Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		Situata e të nxënit: Nxiten nxënësit/et që të krijojnë një histori të shkurtër, nisur nga ilustrimet e fq. 19. Dëgjohen 4-5 variante nga nxënësit. Kërkohet përqendrimi i nxënësve në lidhje me historitë që do të rrëfejnë shokët/shoqet.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca digjitale.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: – zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij në lidhje me aftësitë dhe interesat e tij për të dëgjuarit; – shprehet dhe tregon histori vetjakë dhe kërkon një dëgjim të vëmendshëm nga të tjerët rreth asaj që tregon; – kërkon vëmendje nga të tjerët; – bindet se të tjerët e kanë dëgjuar me kujdes, kur ata nisin t’i bëjnë pyetje rreth rrëfimit të tij – vlerëson mënyrën se si janë shprehur nxënësit/et e tjerë; – nxjerr në pah aspekte apo situata që i kanë mbetur në mend; – bashkëpunon në grup gjatë dëgjimit dhe pas dëgjimit të situatave të caktuara dhe rrëfimeve personale të nxënësve të tjerë.		Fjalët kyçe: figura, ngjarje, histori, dëgjim, vlerësim, mbajmë mend, regjistrojmë	
Burimet: histori të regjistruara, teksti mësimor, fotografi që mund të renditen në një tregim i cili mund të shërbejë për një rrëfim, mjete digjitale diktofon, magnetofon etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet dhe TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Punë e pavarur. Dëgjim i vëmendshëm. Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi Ndërtimi i njohurive të reja. - Në varësi të mundësive, nxënësit dëgjojnë një material në CD, ose nxënësve u lexohet një histori e shkurtër; këtë lexim mund ta realizojë mësuesi/ja ose ndonjë nxënës që lexon bukur. Gjatë dëgjimit të kësaj historie, nxënësit/et do të shënojnë në tekst nëse pohimi është i vërtetë apo i gabuar. Vlerësohet vëmendja që kanë treguar nxënësit/et gjatë dëgjimit të materialit. - Pas dëgjimit të materialit, ata/ato tregojnë nga një ngjarje që lidhet me: shokët, pushimet verore, jetën në shkollë etj. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Përzgjidhet historia më e bukur dhe nxënësit do t’u përgjigjen pyetjeve që lidhen me ushtrimin nr. 4.			
Vlerësimi Kjo orë mësimi, e cila kishte për qëllim zhvillimin e kompetencën së të dëgjuarit në lidhje me dëgjimin e rrëfimeve personale nga ana e nxënësve, si dhe shprehjen e interesit të tyre në të lexuar quhet e realizuar, nëse nxënësit/et arrijnë të tregojnë histori, të prezantohen apo të reagojnë ndaj rrëfimeve të të tjerëve. Merret parasysh përqendrimi, pyetjet dhe kureshtja për rrëfimet e shokëve/shoqeve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, fq. 19 (historia mund të shkruhet, në varësi të mundësive të nxënësit/es).			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kur isha fëmijë Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jolettrare		Situata e të nxënës: Nxënësit nxiten që të parashikojnë ngjarjen, nisur nga titulli dhe ilustrimet.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. Kompetenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - tregon vlera dhe cilësi të mësueses në breza të ndryshëm; - përshkruan me gojë mbi bazën e përvojave vetjake dhe të dëgjua nga të tjerët portretin e mësuesit/es tradicional/e dhe bashkëkohor/e; - shpreh interesat dhe dëshirat e tij/ saj në lidhje me krijimin e marrëdhënieve të mira mësues-nxënë; - krahason mësuesin Margarel, tek tregimi “Mësuesi ynë i dashur”, me drejtorin.		Fjalët kyçe: mësues, nxënë, turp, pendohe, ndëshkoj, respektoj.	
Burimet: fotografi, përvojat e nxënësve, biblioteka, teksti i nxënësit, fletore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Imagjinatë e drejtuar. Diskutim. Tryeza rrethore. Rrjeti i diskutimit. Diagrami i Venit. Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënë të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e detyrës së shtëpisë. Zhvillohet situata e të nxënës. Dëgjohen 3-4 ngjarje të shkurtra, të krijuara nga nxënësit/et. Ndërtimi i njohurive të reja Prezantohet pjesa, autori dhe përzgjidhen tri nxënë për të realizuar leximin e pjesës. Karlo Kolodi , emri i lindjes Karlo Lorenzi, lindi me <u>24 nëntor 1826</u> në <u>Firence</u> dhe vdiq <u>26 tetor 1890</u> . Një nga letrarët më të famshëm për fëmijë, italianë dhe botërorë, me veprën më të njohur “ <u>Pinoku</u> ”, përralla e famshme për fëmijë. Në vitin 1853 themelon një revistë të re, “Sherri”, një gazetë teatrale ku shkruan komedi e farsa të shkurtra. Më 1856 shkruan një artikull duke përdorur për herë të parë pseudonimin <i>Kolodi</i> . Në të njëjtin vit botohen veprat e tij të para madhore: “Miqte e familjes” dhe “ <u>Një roman në avullorë</u> ” <u>Livorno</u> . Në vitin 1883 ai botoi “Aventurat e Pinokut” të përmbledhura në një vëllim. Vlerësohet interpretimi i fragmentit nga nxënësit. Shpjegimi i fjalëve të reja dhe i shprehjeve. Punohen pyetjet e rubrikës “ <u>Kuptojmë tekstin</u> ”. - Kur ka ndodhur kjo ngjarje? (<i>Shumë vjet më parë, kur autori ishte i vogël</i>) - Si e përshkruan autori shkollën e tij? (<i>shkolla ishte një dhomë e madhe, thuajse e pastër</i>). - Çfarë ndodh me dy shokët, vetë rrëfimitarin-personazh të ngjarjes dhe Silvanon? (<i>Autori i vizaton në pantallonat e bardha të Silvanos një kalë të bukur me kalorësin sipër...</i>) - Si ndihet autori për veprimin e tij ndaj Silvanos? (<i>T’ju them të drejtën, isha i kënaqur me veten.</i>) - Si reagon Silvanoja, pasi zgjohet nga gjumi? (<i>Filloi të qante dhe të ulërinte me zë të ngjirur, sikur...</i>) - Cili ishte qëndrimi i mësuesit? Po i drejtorit? (<i>Mësuesi ndenji serioz... drejtori me një zë kërcënues, që të frikësonte, më tha të shkoja në bankën e fundit.</i>)			

Nxënësit/et sjellin jo vetëm përshkrimin e fragmentit nëpërmjet zbërthimit të pyetjeve të mësipërme, por edhe interpretojnë se cilat janë qëndrimet e mësuesve ndaj sjelljeve të pahijshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësve u kërkohet të analizojnë kohën, kur është zhvilluar ngjarja. Për këtë përdoret *Tryeza rrethore*, përmes së cilës letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës/e tek tjetri/a. Çdo nxënës/e pasi e shkruan idenë e tij/saj e palos letrën me qëllim që shoku pranë të mos e lexojë. Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti që të bëjnë të mendosh për kohën që ka ndodhur ngjarja. (*shumë vjet më parë, asokohe, vite më parë, në fëmijërinë e kohës sime, dita tjetër, që nga ajo ditë, po mbaronte shkolla*)

Diskutohet me nxënësit në lidhje me temën e kësaj pjese.

Punë e pavarur. Nxënësit do të plotësojnë në tekst tabelën e ushtrimit nr. 5.

Fjala kyçe	Fjalja në tekst	Kush e thotë?	Toni i zërit
vizatim	...i vizatova një kalë të bukur me kalorësin sipër. Kalin e bëra me gojë hapur, duke ngrënë peshq të mëdhenj.	autori	i gëzuar, i kënaqur me veten.
pendim	... si një zog i lagur, ula kokën dhe u binda. U thashë që nuk duroja më. Që nga ajo ditë mendohesha mirë para se të bëja ndonjë veprim.	autori	me nota pendimi dhe reflektimi
respekt	U bëra fëmijë i mbarë. Respektoja të tjerët dhe ata më respektonin mua.	autori	i kënaqur

Ditari dypjesësh. Një nxënës do ta punojë ushtrimin në tabelë, kurse klasa do të punojë në fletore.

Shprehja	Ç'pjesë ligjërata është?
(Ishte një ditë e zezë...	mbiemër
Do ta paguash shtrenjtë vesin e keq...	
Nuk desha të humbja dashurinë...	

Diagrami i Venit. Nxënësit do të krahasojnë mësuesin Margarel dhe drejtorin. Ku ngjasojnë dhe ku ndryshojnë? Ç'do të ndodhte me personazhin e këtij tregimi nëse do të mësonte në një shkollë të kohëve të sotme? Nxënësit/et argumentojnë përgjigjet e tyre, të cilat në fundin e kësaj ore do të përmbliidhen.

Zoti Margarel Drejtori

i dashur, i qeshur
tolerant,
mirëkuptues,

i rreptë, autoritar,
kërcënues, dhunon nxënësit,
autoritar

Vlerësimi: për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Zhvilloni një shkrim me temë: Një ndodhi gazmore në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve që kanë zanoren ë në pozicione të ndryshme Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Drejtshkrim)		Situata e të nxënit: Nxënësit do të vendosin zanoren ë , në fjalët: dhëndër, shtatzënë, dëboj, dërrasë, këshillë, anëtar, dërrasë, gojëmbël, gjithëkombëtar, trekëndëshi, të errëtit, Kukësi, gjykatësi	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon rastet e përdorimit të zanores ë në pozicione të ndryshme; - përdor drejt zanoren ë paratheksore dhe pastheksore.	Fjalët kyçe: zanorja ë , paratheksore, pastheksore, drejtshkrim
Burimet: teksti, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe	
Organizimi i orës së mësimi Situata e të nxënit. Paraqiten në tabelë disa fjalë dhe udhëzohen nxënësit të vendosin, nëse duhet, në vend të pikave zanoren ë . Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet tema e re dhe udhëzohen nxënësit që të lexojnë në dyshe materialin e paraqitur në tekst. Formulojnë pyetjet për çdo rast. Për shembull: Në cilat raste përdoret zanorja ë ? - Kur zanorja ë është paratheksore? Si shkruhen fjalët e parme, të përbëra dhe të prejardhura? Në cilat raste e përdorim zanoren pastheksore? Kur nuk përdoret ë -ja pastheksore? - Listohen pyetjet në tabelë dhe nxënës të ndryshëm japin shembuj për çdo rast. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Punë në grupe. Nxënësit ndahen në tri grupe. Grupi 1. Ushtrimi 1. Nxënësit do të vendosin në vend të pikave zanoren ë të theksuar, që mungon dhe do të shpjegojnë rastin. (bëj, dëm, dhëmb, dhënë, e ëma, shkëmb...) Grupi 2. Ushtrimi 2. Nxënësit do të vendosin zanoren që mungon në fjalët: <i>dëshirë, këndoj, pëllëmbë</i> . Grupi 3. Ushtrimi 3. Nxënësit do të vendosin zanoren që mungon në fjalët: <i>drejtëz, drejtëza, blerës, blerësi, i/e cekët, të dalësh, të ndezësh...</i> Një përfaqësues i çdo grupi prezanton përgjigjet. Saktësohen pasaktësitë që mund të kenë nxënësit. Punë e pavarur. Një nxënës punon në tabelë, kurse klasa në fletore. Nxënësit shkruajnë trajtat e sakta të fjalëve, që nuk e ruajnë zanoren ë pastheksore.	
Vlerësimi: Vlerësohet pjesëmarrja gjatë orës, saktësinë në dhënien e përgjigjeve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Dalloni në tri paragrafët e parë të pjesës “Kur isha fëmijë”, fjalët që kanë zanoren ë . Tregoni se cilit rast i përket secila prej tyre.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përgatitja për procesin e të shkruarit (2 orë)		Situata e të nxënit: Nxënësit flasin në lidhje me llojet e shkrimeve që kanë realizuar më parë. Shkrim i lirë. Përshkrim. Portret. Këshilla. Përshkrim vendi. Shkrim tregimi. Vjersha Artikull gazete. Njoftime ftesa. Letra. Receta.	
Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. Kompetenca qytetare. Kompetenca digjitale.			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ora e parë Nxënësi/ja: - përgatitet dhe ndjek fazat e procesit të të shkruarit; - merr pjesë gjatë paraqitjes së fazave të procesit të të shkruarit; - bën përgjithësime kllaster për mbledhjen e ideve për temën konkrete të të shkruarit “Fëmijët sot në botë”; - mbledh ide nga burime të ndryshme; Ora e dytë Nxënësi/ja: - përmirëson draftin e parë; - shton ide dhe opinione në shkrimin e tij; - përgatit draftin final, e shkruan atë; - e kontrollon përsëri, i jep dorën e fundit për ndonjë ndryshim të mundshëm dhe për gabime strukturore drejtshkrimore dhe të pikësimit; - i jep dorën e fundit, e dorëzon dhe e publikon.	Fjalët kyçe: proces i të shkruarit, faza, temë, ide, opinione, draft, strukturë, publikim
Burimet: revistë dhe materiale të shkruara për fëmijët, materiale nga interneti, teksti mësimor, fotografi	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Punë në grupe. Punë individuale. Rrjet diskutimi. Punë në grupe dyshe. Turi i galerisë.	
Organizimi i orës së mësimi Veprimtari paraprake (Stuhi mendimesh) Prezantohet tema, e cila lidhet me hapat që duhen respektuar për realizimin e procesit të të shkruarit dhe kërkohet nga nxënësit/et që të të japin ide për një temë që ata duan të shkruajnë. Vendosin me votë se cila do të jetë tema që ata kanë propozuar dhe u pëlqen më shumë, vendoset dhe shkruhet në dërrasë. Zhvillimi i situatës (Punë në grupe, Punë individuale. Rrjet diskutimi.) Nxënësit diskutojnë gjatë për këto lloje të shkruarit dhe i përshkruajnë ato ashtu siç i dinë dhe thonë edhe se cilin lloj të shkruarit e kanë përdorur edhe më parë. Pasi mblidhen përvojat e nxënësve/eve përmes kësaj veprimtarie, vendoset edhe me miratimin e nxënësve që ata të hartojnë një shkrim të lirë me temën “Fëmijët sot nëpër botë”. Përcaktohen hapat dhe nxënësi/ja vepron sipas këshillave, të cilat shkruhen në tabelë me shkurtesa me ngjyra. Këtu përfundon faza e parë. Nxënësit/et punojnë të udhëhequr. Ora e dytë (Shkrimi i draftit të parë). - Kthimin i ideve dhe pikave të planit në paragrafë, që lidhen nga ana kuptimore dhe logjike, duke krijuar një shkrim të lirë në draftin e parë të tij. - Nxënësit/et shkruajnë draftin e parë të punimit, duke mos u kushtuar rëndësi gabimeve ortografike, pasi ato mund të korrigjohen më vonë. - Nxënësit/et rishikojnë draftin e parë e këmbëjnë me njëri-tjetrin, japin mendime dhe i përmirësojnë ato nëse e gjejnë të drejtë. Mësuesi i ndihmon në hartimin e draftit të përmirësuar. - Redaktimi (punë individuale dhe punë në grupe dyshe). Nxënësit/et redaktojnë draftin e tyre, për t’i dhënë formë përfundimtare strukturës, fjalive dhe për të shmangur të gjitha gabimet gramatikore. - Përgatitja e draftit final. Nxënësit/et shkruajnë variantin e fundit, e shohin sërish dhe e dorëzojnë, që të printohet ose të paraqitet përpara klasës. Turi i galerisë. Prezantimi i punimeve të nxënësve në një kënd të klasës. Këto punime mund të përfshihen edhe si pjesë e punimeve të portofolit të nxënësit.	
Vlerësimi: Nxënësi/ja vlerësohet për ndjekjen me vëmendje të fazave në procesin e të shkruarit; për pjesëmarrjen gjatë përgatitjes së draftit dhe dhënien e mendimeve e të sugjerimeve; për përgjithësimet kllaster; për mbledhjen e ideve për temën konkrete të të shkruarit “Fëmijët sot në botë”; përmbledhjen e ideve nga burime të ndryshme; për shkrimin e saktë të draftit final.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve me zanoren ë fundore Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Drejtshkrim)		Situata e të nxënës: Gjëegjëzë zbavitëse Si binjake ne shkronjat jemi, veçse një ndryshim e kemi. Kam dy pika në mes ballit a e gjeni emri tim? (zanorja ë)	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon përdorimin e zanores fundore ë në fjalë të ndryshme - përdor drejt zanoren fundore ë ; - bën një përshkrim për motin, duke përdorur raste kur zanorja ë del si fundore.		Fjalët kyçe: zanore fundore ë , drejtshkrim	
Burimet: teksti, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grupe. Punë e pavarur. Punë në dyshe. Shkrim i lirë			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Udhëzohen nxënësit të shkruajnë nga tri fjalë: emra, mbiemra, numërorë, folje, që mbarojnë me zanoren ë . Ndërtimi i njohurive të reja. (Punë në grupe) Paraqiten në tabelë disa bashkësi fjalësh dhe nxënësit, të ndarë në 5 grupe do të punojnë për formulimin e rregullit përkatës. Secilit grup i jepet nga dy bashkësi me fjalë. Orientohen nxënësit se si do të mund të punojnë, duke parë klasën e fjalëve, numrin, gjininë... Shembull: bukë, fjalë, dhjetë, fletë - emra të gjinisë femërore babë, Lekë - emrat e gjinisë mashkullore, që lakohen në të shquar si emra të gjinisë femërore. Një përfaqësues i grupit prezanton në tabelë rregullin përkatës. Mund të përdoren edhe tabakë letre apo fletë formati. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe dyshe. Ushtrimet 1. a. b. c dhe Ushtrimi 2. Nxënësit do të plotësojnë në libër fjalët me zanoren që mungon, do të shkëmbejnë librin me shokun/shoqen e bankës, për të parë saktësinë në zhvillimin e ushtrimit. Lexohen fjalët dhe sqarohet ndonjë pasaktësi që kanë nxënësit në lidhje me përdorimin e zanores ë . Shkrim i lirë. Ushtrimi 4, fq.168 Nxënësit do të përshkruajnë motin, duke përdorur deri në shtatë raste të përdorimit të zanores ë fundore. Lexohen 5-6 krijime të nxënësve. Diktimit vetëkontrolli. Nxënësve mund t’u jepet teksti i diktimit, për të qortuar gabimet në përdorimin e zanoreve e, ë. Qorto gabimet (nënvizo në fillim fjalët). Rishkruaj trajtat e sakta të fjalëve. Muaji dhjetor atë vit ishte më i zëmëruar se kurrë, me shum dëborë dhe një të ftoht acar. Fusha shtrihet e bardhë dhe e zhveshur. Aty-këtu disa pemë përdredhin degët e tyre të errta , të mbushura me dëbor . Një fshat i vogël mezi duket; në qëndër të tij shtëpitë, të tulatura, njëra pranë tjetrës, duket sikur janë ngjeshur që të ngroheshin gjatë dimrit.			

Përfashta, **fmijët**, me klithma të gëzuara dhe me sy të ndritur, turren në oborrin e shkollës. Ndërtesa e shkollës, një godinë **dykatshe**, duket si kur shikon me zili lojën dhe gazin e **fëmijve**. Qeshin dhe luajnë me topa bore dhe **vallzojnë** rreth një dordoleci, që qëndron madhërishtë në mes të oborrit. Ata nuk **ndiejn** fare të ftohtë!

Herë-herë, ndonjëri prej fëmijëve rrëshqet mbi dëborë dhe bie. Shokët qeshin dhe e ndihmojnë që të ngrihet. Edhe po të ketë **dhëmbje**, gëzimi i lojës bën që të harrohet gjithçka. Ndërkohë, **Gushkuqi** dhe **Gushkuqëza**, e shoqja, po **ngriijn** dhe po thahen së **ftohëti** të shtrënguar pas njëri-tjetrit. Shohin të dëshpëruar fushën e bardhë nga bora.

Ata kanë **ftoht**, kanë uri dhe për shkak të ngricave nuk gjejnë dot mjaftueshëm ushqim. Po si mund të gjejnë për të **ngrën**, kur dëbora ka mbuluar gjithçka?

Në mëngjes të dy **vijn** fluturimthi në fshat dhe drejtohen te shtëpiza e **drunjt** e Luizës, sepse ajo te parvazi i dritares, vendos ndonjë kokërr grurë, ndonjë thërime **buk**, ndonjë zëmër molle vjeshtake, madje ndonjë copëz dhjamë. Oh, sa mirë është atëherë!

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit/et për pjesëmarrjen gjatë orës dhe saktësinë në përdorimin e zanores **ë** fundore.

Detyrat dhe puna e pavarur: ushtrimet 3, 5 sipas kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Diktim nr. 1 Përdorimi i shkronjës së madhe. Drejtshtkrimi i zanoreve e dhe ë në pozicione të ndryshme. Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënit: Janë përgatitur disa fisha me fjali, në të cilat janë paraqitur gabim rastet e përdorimit të: shkronjës së madhe, zanores e , ë , në pozicione të ndryshme. Nxënësit do të dallojnë gabimet dhe do të rishkruajnë trajtat e sakta të fjalëve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor drejt shkronjën e madhe në një tekst që i diktohet; - drejtshkruan saktë fjalët që kanë zanoret e, ë.		Fjalët kyçe: diktim, drejtshtkrim, shkronjë e madhe, zanore e , ë , ndajfolje, parafjalë.	
Burimet: teksti i nxënësit, model diktimi, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Plotësim në fisha. Diktim me të lexuar. Punë individuale.			

Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënësve. Nxënësit njihen me temën e diktimit dhe udhëzohen që të tregojnë kujdes në fjalët që kanë zanoret e dhe ë në pozicione të ndryshme dhe në drejtshkrimin e parafjalëve dhe ndajfoljeve. Ndërtimi i njohurive të reja. Lexohet i plotë teksti i diktimit dhe më pas diktohet pjesë-pjesë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënësve u lihet kohë disa minuta që ta kontrollojnë tekstin dhe më pas fletoret do të mblidhen, për t'u qortuar. Në bazë të kriterit të vlerësimit, do të vendoset nota, e cila do të hidhet në kolonë në evidencën e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi: Vlerësohen bazuar në kriterin që përcaktohet në fillim të diktimit. Nxënësit do të vlerësohen me notë. Detyrat dhe puna e pavarur:

Diktimit nr. 1 (tremujori i parë)

Tema: Përdorimi i shkronjës së madhe. Drejtshkrimi i zanoreve e dhe ë në pozicione të ndryshme.

Stuhia e egërsua dhe anija “Perla e Zezë” nisi të lëkundej si një copëz lëvozhge arre. Ishin nisur nga Azia e Vogël me një det të qetë dhe rruga në drejtim të Afrikës Jugore kishte qenë si një bekim për ta. Kishin përshkuar nën rrezet e diellit oqeanin e pafund dhe kishin mbërritur te Kepi i Shpresës së Mirë. Sapo kishin kaluar kepin, një erë e çmendur nisi të përplasej mbi drejtë e drunjtë, teksa muzgu me një ngjyrë të errët nxu gjithçka. Kishte ditë që Arusha e Madhe dhe Arusha e vogël, që shpesh i orientonin në netët me hënë, nuk dukeshin më në qiellin e errët. Në dërrasat e kuvertës së anijes nisën të binin zhurmshëm pikat e rënda të shiut. Druri i dobët dhe i thyeshëm i drekëve u shkërrmoq, ndërsa drektu kryesor mbahej akoma. Trekëndëshi i velave ishte grisur në shumë vende dhe era nuk tregonte asnjë shenjë se deti do të qetësohej. Marinarët, të trembur, nxitonin, por të gjithë dukeshin si të mpitë nga paniku. Një krismë rrufeje u dëgjua thellë në qiell. Dallgët ishin fryrë dhe gati po e mbulonin anijen. Kapiten Xhoni, ose Zemra e Detit, siç e thërrisnin marinarët, vërtitej në kuvertë dhe herë u jepte zemër djelmoshave të tij, herë komandonte timonin. Këta marinarë, ardhur që nga Gadishulli Iberik, Spanja dhe Portugalia, ishin anëtarë të një ekuipazhi të vogël, që luftonte me dallgët e një deti kaq të zemëruar, duke mbështetur fuqishëm njëri-tjetrin. Kështu kishin qenë gjithmonë: të bashkuar dhe plot besim. Luteshin që anija të mos përplasej në ndonjë shkëmb të thepisur dhe të qëndronte edhe pak kohë, sa të qetësohej stuhia.

Befas u ndie një lëkundje e fortë. Anija kishte ngecur në një cekëtinë. Era, që kishte fryrë si e marrë, më në fund kishte pushuar, ndërsa fuqia e saj e kishte nxjerrë anijen në breg.

Kriteri i vlerësimit: tri gabime, një notë


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Zeneli (2 orë)		Situata e të nxënësve: Vendoset në qendër të tabelës fotografia e Migjenit dhe nxënësit flasin se ç’dinë për këtë autor. Prezantohen pjesë të shkurtra nga krijimtaria e tij, poezi dhe prozë	
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jolettrare			

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale. Kompetenca qytetare.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - flet rreth figurës së Migjenit; - rendit tituj librash, personazhesh që i përgjigjen temës së tregimit; - u përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tregimit. Ora e dytë. Nxënësi/ja: - portretizon personazhet e fragmentit; - jep mendimin e tij/saj rreth idesë që përcjell fragmenti - analizon gjuhën e përzgjedhur nga autori - kthen në gjuhën standarde fragmente nga tregimi	Fjalët kyçe: poet, prozator, tekst letrar
Burimet: fotografi, përvojat e nxënësve, tekste letrare teksti i nxënësit.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim-Kllaster. Të nxënit me këmbime. Pema e mendjes. Puno në dyshe, shkëmbe ide. Punë në grupe. Ditari dypjesësh. Pyetje-përgjigje.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Diskutim-Kllaster A keni lexuar apo parë filma në të cilët trajtohet tema e varfërisë dhe vështirësitë që hasin fëmijët për të përballuar jetën? (heqja dorë nga dëshirat dhe rritja para kohe?) Nëse po, cilët janë këta autorë, titujt e filmave/ librave dhe personazhet përkatës? Plotësohet një kllaster nga nxënësit. Ndërtimi i njohurive të reja. U jepen nxënësve të dhëna të përmbledhura për jetën dhe krijimtarinë e Migjenit. Millosh Gjergj Nikolla, i njohur si Migjeni, lindi më 13 tetor 1911 në Shkodër dhe vdiq më 26 gusht 1938 në Torre Pelice, Itali. Ai është konsideruar si përfaqësuesi më i shquar i letërsisë kritike para Çlirimit. Lindi në Shkodër në një familje të varfër qytetare. Pasi kreu shkollën fillore në qytetin e lindjes, më 1928-1932 ndoqi mësimet e mesme teologjike në Manastir. Në vitet 1933-1937 punoi si mësues filloreje në Vrakë, Shkodër dhe në Pukë. Kjo është edhe koha kur zhvilloi veprimtarinë letrare. Shkrimet e para i botoi më 1934; bashkëpunoi në revistat “Illyria”, “Bota e re” etj. Më 1936, krijimet e veta poetike i përmbledhi në librin “Vargje të lira”, të cilin censura nuk e la të qarkullojë. Në “Poemën e mjerimit”, veprën e tij më të shquar, Migjeni përshkroi në tablo të gjallë dhe rrëqethëse të jetës së vështirë të masave të shtypura dhe të shfrytëzuara, të venitjes së tyre fizike nën grushtin e mjerimit. Në skicat “Luli i vocërr” dhe sidomos të “Zeneli”, shkrimtari vuri në dukje aftësitë intelektuale të masave dhe dëshirën e zjarrtë për ndryshime në gjendjen e tyre shoqërore. Prozat i botoi në librin “Novelat e qytetit të Veriut”. Migjeni ka marrë titullin “Mësues i Popullit”. Prezantohet titulli i fragmentit dhe njihen nxënësit me personazhin e Zenelit. Realizohet leximi i tregimit dhe më pas caktohen dy nxënës për ta rilexuar atë. Shpjegimi i fjalëve dhe i shprehjeve të reja. Gjatë rileximit të tekstit “Zeneli”, nëpërmjet teknikës Pyetje-përgjigje, kuptojmë më mirë tekstin dhe ndërkohë në tabelë plotësohet kllasteri me të dhënat përkatëse. Ku zhvillohet ngjarja? Pse mësimi nuk shkon si duhet? Cilët marrin pjesë në të? Cilat janë mendimet e mësuesit? Cilës kohe i përket? Çfarë i shqetëson fëmijët?	

Si u përgjigjet mësuesi pyetjeve të fëmijëve?
Rikujtohen me nxënësit njohuritë.



Ora e dytë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. (Diskutim. Të nxënit me këmbime. Puno në dyshë, shkëmbe ide. Ditari dypjesësh)

Diskutohen nga nxënësit pyetjet e rubrikave. Interpretojmë tekstin, Analizojmë tekstin.

Ushtrimi 2. Simpatia e mësuesit për Zenelin duket që në fjalinë e parë të tregimit: *Zeneli asht si ajo tokë e mirë...* Mësuesit i bën përshtypje zgjuarsia e tij, besimi që Zeneli ka në vetvete: *kur s'dijnë të tjerët, atij i takon me folë.*

Ushtrimi 3. Nxënësit dallojnë në tekst se dashuria e mësuesit për nxënësit duket:

Te mënyra se si i vështron. *Vërej shpirtrat e tyre të vegjël të shqetësuar...*

Nga mënyra se si shpjegon mësimin. *Për me i ngjall, me u çue moralin, u flas...*

Nga mënyra se si argumenton shqetësimet e tyre. *Pse ne jemi më të vegjël se shtetet e tjera. Por kjo...*

Ushtrimi 4.

Nxënësit sjellin argumente në lidhje me temën e këtij tregimi “varfëria dhe mjerimi shoqëror”.

Të nxënit me këmbime. (Punë në grupe)

Grupi I - Plotësoni portretin fizik dhe moral të Zenelit sipas detajeve të dhëna në tekst (Ditari dypjesësh).

Portreti fizik	Tipare të karakterit
<i>sytë e gështenjtë, dhëmbë të bardhë, fytyra e zeshkët, balli i rregullt, kryet e zgjatun për prapa, balli i rrudhun</i>	<i>inteligjent, i sigurt dhe me besim në vetvete, plot fantazi, i turpshëm, realist</i>

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit/nxënëset për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeneroni dhe shkruani disa nga të drejtat e fëmijëve.et

Model projekti

Titulli i projektit: Mjedisi dhe ne

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe *Shkalla:* III

Klasa: VI

Orë në dispozicion: 3 (ose 9 orë)

Sugjerim

Për të realizuar një thellim të punës kërkuese të nxënësve përmes projekteve, mësuesit/et mund të realizojnë gjatë vitit edhe një projekt të vetëm mësimor të shtrirë në tri periudha.

Për sa i përket vlerësimit të nxënësve, duke qenë se projekti është pjesë e portofolit personal (dosjes) të nxënësit, në çdo orë projekti, mësuesi/ja vendos si kontribut të tij materialet që nxënësi/ja sjell për çdo fazë të projektit.

Çdo kontribut do të vlerësohet me pikë.

Mësuesi/ja mund të përllogaritë orët për realizimin e fazave të projektit. Orët mund të merren nga kompetencat e tjera që lidhen kryesisht me të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit*

Nxënësi/ja:

- shpreh mendimin e vet për një temë me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth temës, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar që lidhet me temën;

- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të temës;
- shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore dhe sipas temës;
- përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në largësi nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

2. *Kompetenca e të menduarit*

Nxënësi/ja:

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- shpreh mendimin e vet për një punim letrar ose shkencor duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e temës, duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive.

3. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë*

Nxënësi/ja:

- për zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë për temën;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

4. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin*

Nxënësi/ja:

- përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë komunitet dhe e realizon atë me sukses;
- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrim (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve);
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
- merr pjesë si anëtar i një jurie, (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi artistik, duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.

5. *Kompetenca personale*

Nxënësi/ja:

- merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., si dhe raporton (me gojë, me shkrim) për përvojat personale të fituara.

6. *Kompetenca qytetare*

Nxënësi/ja:

- zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., si dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë;
- shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhe zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të ndryshme interesi;
- merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

7. Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

- përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në largësi për zhvillimin e njohurive;
- analizon, vlerëson dhe menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik);
- zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe nëse burimi është parësor apo dytësor).

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- merr pjesë në projekt me një shkrim a veprimtari praktike;
- shkruan për organizimin e veprimtarisë, si: plani i veprimtarisë ndarja në grupe, përdorimi i materialeve të ndryshme, format e ndryshme të shkrimit etj.;
- bashkëpunon në grup për realizimin e projektit;
- tregon shkaktarët e ndotjes së mjedisit;
- krijon në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit postera, shkrime të ndryshme letrare, joletrare ose materiale të shkurtra në formën e një dokumentari në lidhje me temën;
- përcjell mesazhe të rëndësishme në mbrojtje të mjedisit, duke ndikuar në ndërgjegjësimin e komunitetit.

Temat e njohurive kryesore që rimerren në projekt:

- Teksti letrar si tregimi dhe romani
- Fotografia dhe piktura, postera, artikuj të ndryshëm
- Riciklimi dhe krijimi i objekteve të dobishme

Lidhja me fushat e tjera dhe temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca. TIK. Artet.

Partnerët: komuniteti, mësues/e sipas fushave të studimit.

Numri i orëve që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit:

- Ora e parë - Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme
- Ora e dytë - Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare
- Ora e tretë - Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Numri i nxënësve në projekt: Nxënës të klasave të gjashta.

Përshkrim i projektit dhe veprimtarive që do të zhvillohen:

Ora e parë

Gjatë kësaj ore do të përcaktohet tema e projektit në bashkëpunim me nxënësit. Ndarja e nxënësve në grupe pune dhe zgjedhja e drejtuesit të çdo grupi.

Ora e dytë

Do të prezantohen materialet që kanë sjellë nxënësit, përmes bashkëpunimit të tyre në grupe. Nxënësit diskutojnë në lidhje me to, duke përzgjedhur materialet më të vlefshme.

Ora e tretë

Prezantimi i projektit.

Ora I (ose dy orë së bashku). Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Shfaqet në videoprojektor një dokumentar që trajton problem mjedisor. Mund të paraqiten edhe fotografi të ndryshme ose nxënësit/et së bashku me mësuesin/en mund të organizojnë një miniekskursion të shkurtër mjedisor në një territor të ndotur, i cili ndodhet pranë shkollës së tyre.

Pyetja kërkimore

Sa e lidhur është jeta e njeriut me mjedisin? Nxënësit paraqesin mendimet e tyre, të cilat më së shumti janë të lidhura me problemet mjedisore dhe shkaktarët kryesorë të tyre.

- Prezantohet tema dhe rezultatet që kërkohen nga projekti, të cilat mbahen shënim nga nxënësit/et.
- U sugjerojmë nxënësve se çfarë mund të përfshijnë në projekt dhe pas ndarjes në grupe lihen të lirë për të punuar sipas dëshirës dhe imagjinatës së tyre.

- Mund të sugjerohen punime, si: tregime të shkurtra, dokumentarë, postera, piktura, fotografi, objekte me materiale të riciklueshme etj.
- Nxënësit/et mund të ndahet në tri grupe të mëdha ose katër, me qëllim që të kemi një larmi materiale (kjo në varësi edhe të numrit të nxënësve në çdo klasë).

Në vazhdim, secili grup nën drejtimin e një nxënësi/eje ndan detyrat që duhet të realizojë.

Ora II. Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

- Gjatë orës së dytë, nxënësit prezantojnë materialet që kanë mbledhur, lexojnë disa prej tyre për të bërë sugjerimet e nevojshme dhe plotësojnë me ide të reja vazhdimin e projektit. Nxënësit/et bashkëpunojnë brenda grupit. Gjatë kohës që ata/ato punojnë, mësuesi/ja mban shënime për punën dhe bashkëpunimin e nxënësve në grupe.
- Në vazhdim, secili grup redakton, sipas sugjerimeve, materialet që ka dhe riformulon detyrat për realizimin e punëve përfundimtare.

Ora III. Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

- Nxënësit prezantojnë sipas grupeve dhe në kohën e caktuar materialet e tyre të projektit.
- Ata përzgjedhin vetë mënyrën e prezantimit dhe realizimin e secilit material.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Projekti ka për qëllim që, përmes rezultateve të të nxënësve, t'i pajisë nxënësit me të gjitha kompetencat e mundshme. Gjithashtu, përmes projektit, synohet ndërgjegjësimi i nxënësve, por dhe i komunitetit në lidhje me problemet mjedisore.

Prezantimi

- Çdo grup prezanton produktin përfundimtar të projektit.

Produkte të projektit:

- postera, tregime të shkurtra, artikuj të ndryshëm, revistë etj.;
- fotografi, piktura, postera të ndryshme;
- objekte të ndryshme me material të riciklueshme.

Të ftuar: prindër, mësimdhënës/e nga shkolla, përfaqësues të ndryshëm, miq, dashamirës, media.

Vlerësimet:

Vlerësimi formues (gjatë projektit)

Planet paraprake të nxënësve

Shënime

Bashkëpunimi në grup

Vlerësimi përmbljedhës (në fund të projektit)

Dosja e projekti

Raport

Vlerësimi i kolegëve

Vetëvlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i prindërve dhe të ftuarve të tjerë

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Drejtshkrimi i ndajfoljeve dhe i paraafjalëve Kompetenca: Përdorimi i drejtë i Gjuhës (Drejtshkrim)		Situata e të nxënit: Nxënësit plotësojnë fjalitë me paraafjalë dhe ndajfolje. Përcaktojnë fjalët që u përkasin klasës së ndajfoljeve dhe të paraafjalëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon paraafjalët dhe ndajfoljet në fjali të ndryshme; - përdor drejt ndajfoljet, shprehjet ndajfoljore; - përdor drejt paraafjalët njësh dhe shprehje; - njeh rastet e përdorimit të ndajfoljeve që shkruhen me vizë lidhëse në mes.		Fjalët kyçe: paraafjalë, ndajfolje, drejtshkrim, shprehje ndajfoljore, vizë lidhëse	
Burimet: tekst i nxënësit, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Punë në grupe. Punë e pavarur. Pyetje në dyshe			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Në fjalitë e paraqitura në tabelë, nxënësit do të nënvizojnë paraafjalët dhe ndajfoljet. Si janë shkruar ato: njësh, ndaras apo me vizë lidhëse në mes? Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet tema e re dhe udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin dhe të punojnë në dyshe, duke ndërtuar pyetjet në lidhje me informacionin. Pyetjet paraqiten në tabelë dhe nxënësit japin shembuj për çdo rast. Cilat ndajfolje shkruhen njësh? Çfarë janë shprehjet ndajfoljore? Si lidhen fjalët në këto shprehje? Cilat ndajfolje shkruhen me vizë lidhëse në mes? Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Klasa ndahet në dy grupe <i>Grupi 1.</i> Ushtrimi 1, fq.170. Nxënësit shkruajnë si duhet fjalët e ushtrimit. <i>ndërkohë, ndonjëherë, ndopak, ngado, nganjëherë.</i> <i>papritmas, parmbremë.</i> <i>përderisa, përveçqë, përderisa...</i> <i>për së afërmi, për së gjalli, për së mbari...</i> <i>herë pas here, kohë pas kohe, aty për aty, ballë për ballë</i> tani për tani, vit për vit, fund e krye, kokë e këmbë... <i>Grupi 2.</i> Ushtrimi 2, fq.170. ndajfoljet: po aq, përbri, ashtu, kështu, tepër, ndryshe, tepër, paraafjalët; në, nga, me, gjatë, deri në Nxënësit nënvizojnë ndajfoljet dhe paraafjalët dhe i vendosin në një tabelë. Dëgjohen përgjigjet që do të sjellin nxënësit përmes përfaqësuesve të grupeve. Nxënësit mund të qortojnë gabimet e shokëve.			
Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi/ja për pjesëmarrjen gjatë orës, saktësinë në dhënien e përgjigjeve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3, fq.170 (sipas kërkesës) FVK (fq. 11)			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Provimi		Situata e të nxënit: Diskutim-Kllaster. Shënohet në tabelë çështja për diskutim. Prindërit tanë, a janë njerëzit më të ndershëm që ne njohim? Nxënësit/et sjellin idetë dhe mendimet e tyre, të cilat pasqyrohen në dërrasë të zezë nëpërmjet kllasterit. Prindërit, njerëzit më të ndershëm Nuk pajtohen me sjelljet tona jokorrekte Na edukojnë të jemi të virtytshëm Na japin modelin e njeriut paqësor Na mësojnë respektin për të tjerët (Për çdonjërin nga tiparet e prindërve mbi parimet e ndershmërisë, nxënësit/et sjellin situata konkrete).	
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja - lexon qartë dhe rrjedhshëm tregimin; - flet për rolin e rrëfimtari në tregim; - analizon mbi temën kryesore të tregimit duke gjykuar mbi ndershmërinë si koncept; - merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon e ndihmon anëtarët e tjerë të grupit; - ndërlidh temën e re me njohuritë paraprake apo përvojën e tij/saj personale duke plotësuar pemën e mendimit sipas një lidhjeje logjike.		Fjalët kyçe: i drejtë, i ndershëm, sillem, gjykoj, besoj, i zellshëm	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Diskutim-Kllaster. Të nxënit me këmbime. Rrjeti i diskutimit. Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënit, gjatë së cilës nxënësit/et listojnë tipare të ndershmërisë së prindërve të tyre. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet tregimi “Provimi” marrë nga përmbledhja “Korrieri i vogël i familjeve”, të Xhovani Guareskit si dhe pasqyrimi i marrëdhënieve prindër-fëmijë. Xhovani Guareski ka lindur në Parma (Itali) në 1908. U nda nga jeta në 22 korrik 1968. Veprat kryesore të tij janë: “Zbulimi i Milanit”, “Fati quhet Klotilde”, “Burri në shkollën e konviktit”, “Përrallë e Krishtlindjeve”, “Italia e përkohshme”, “Korrieri i vogël i familjeve” (1954), “Jeta familjare”. Realizohet leximi i tregimit nga nxënësit. Gjatë leximit, nxënësit nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja për t’i shpjeguar në fund të leximit. Pas një rileximi të fragmentit, u drejtohen pyetjet nxënësve:			

- Përse Albertinoja i drejton pyetje babait të tij dhe si i pret ai pyetjet e djalit? (sepse atij i është kërkuar t'i përshkruajë ata në një detyrë shkolle... Babai në fillim hutohet nga pyetjet e djalit dhe më pas me qetësi i përgjigjet...)

- Si u përgjigjet babai pyetjeve të Albertinos në lidhje me ndershmërinë? Po në lidhje me profesionin e tij dhe rolin si prind? (Babai i përgjigjet me sinqeritet të birit duke i folur për ndershmërinë si individ dhe zellin që ai kryente punën e tij. Në lidhje me rolin e tij si prind, babai e la të hapur përgjigjen, pasi këtu i takonte Albertinos të jepte vlerësimin e tij).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Interpretimi i tekstit (Tryeza rrethore)

U kërkohet nxënësve të interpretojë me nxënësit/et thënien: “Lëri të tjerët të gjykojnë kush je ti”.

Përforcojeni mendimin tuaj me argumente, shembuj dhe fakte nga jeta e përditshme. Për këtë përdorni Tryezën rrethore, përmes së cilës letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës/e tek tjetri/a.

Çdo nxënës/e, pasi e shkruan idenë e tij/saj, e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij/saj të mos e lexojë.

Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti që të bëjnë të mendosh për një interpretim të saktë dhe korrekt. U shpjegohet nxënësve fjala koncept “rrëfimtari”.

Rrëfimtari:

përdor vetën e parë, kur ai vetë është pjesëmarrës në ngjarje;

përdor vetën e tretë, kur ai është vëzhgues i ngjarjeve.

Punë në grupe

Ndahet klasa në grupe (5-6 nxënës/e) dhe secili prej tyre punon me:

Grupi I - punon ushtrimin 13, nëpërmjet teknikës *Ditari dypjesësh*.

Personazhi	Cilësitë
Babai	I sinqertë, i komunikueshëm, i rreptë, mirënjohës, njeri i sakrificave, punëtor
Albertinoja	kureshtar
Nëna	e kujdesshme, e matur, e dashur, e drejtë, e arsyeshme
“Rebelja”	e zgjuar, mirëkuptuese

Grupi II - Lidhni në çifte fjalët e mëposhtme me shoqërueset e tyre në tekst. Përcaktoni ç’pjesë ligjërata janë ato:

- Provim për babanë
- Përshkrim për ndershmërinë, zellin, punën, dashurinë për atdheun, portretizim moral të prindërve
- Provokim, fëmijët shikojnë dhe dinë ca gjëra, pa qenë nevoja të shkojnë në shkollë.
- Një diskutim për cilësitë e babait. Diskutim i gjatë dhe i gjallë.(mbiemra)

Grupi III - Dalloni pyetjet e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta. Ku ndryshojnë ato?

Pyetjet e drejtpërdrejta janë pyetje të shkurtra, të cilat kërkojnë përgjigje me po ose jo.

(Baba, je i ndershëm ti? Je edhe i zellshëm, baba?)

Pyetjet e tërthorta janë pyetje të gjata dhe përgjigja e tyre nuk mund të mjaftohet me një fjalë të vetme. (Por, kur unë jam në shkollë dhe ti s’je në shtëpi, unë nuk e di se çfarë bën ti.)

Nxënësit/et punojnë në heshtje, përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Ndahet klasa në dy grupe.

Grupi I. Po ju, a keni bërë një bisedë të tillë me babanë apo nënën tuaj? Tregoni shkurtimisht rrjedhën e bisedës suaj. Përdorni dialogun, pyetjet e drejtpërdrejta, por edhe ato të tërthorta.

Grupi II. Pasi të keni bërë intervistën me prindërit tuaj, përshkruani portretin e njërit prej tyre, mbështetur në përgjigjet që ata dhanë.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Fjala dhe përbërësit e saj. Struktura e fjalës Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fjalëformim)		Situata e të nxënit: Nxënësit/et dallojnë mbaresën te fjalët: hap-a fush-at mal-et hap-i fush-ën mal-i hap-ën fush-a mal-in	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon pjesët përbërëse të fjalës, tema, mbaresa, rrënja, parashtesa; - dallon formën dhe kuptimin e një fjale; - tregon mënyrën e formimit të fjalëve; - shpreh funksionin e mbaresës element trajtëformues dhe parashtesës e prapashtesës si elemente fjalëformuese; - plotëson Pemën e mendimit - Fjala dhe përbërësit e saj.		Fjalët kyçe: formë e fjalës, formë, kuptim, tema, mbaresa, rrënja, parashtesa, prapashtesa, fjalë e prejardhur, fjalë e parme.	
Burimet: teksti i nxënësit, fletorja për verifikimin e kompetencave (FVK), libri “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pyetje. Punë në grup. Punë e pavarur e drejtuar. Pema e mendimit. Punë në dyshe.			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Rikujtohen njohuritë që nxënësit kanë marrë në klasat paraardhëse në lidhje me temën dhe mbaresën e një fjale. Nxënësve u drejtohen pyetjet: - Si e dallojmë mbaresën e një fjale? (emër, folje) - Ç’quajmë parashtesë? Ç’quajmë prapashtesë? Përgjigjet e nxënësve paraqiten në tabelë. Ndërtimi i njohurive të reja. (Punë e pavarur e drejtuar. Pema e mendimit) U sqarohen nxënësve konceptet: leksik, formë e fjalës (merret shembulli i tekstit, fjala çelës). Një nxënës/e lexon me zë informacionin në libër, dhe së bashku nënvizojmë termat: rrënjë, temë, mbaresë, parashtesë, prapashtesë, fjalë të prejardhura. Analizohen shembujt në libër dhe përkufizohen termat: - Mbaresë quhet pjesa e fjalës që ndryshon (element trajtëformues, tregon veçori gramatikore). - Rrënja është pjesa më e vogël e kuptimshme e fjalës. Ajo është pjesa e fjalës që mbetet pasi i heqim temën parashtesat, prapashtesat. - Tema e fjalës është pjesë e fjalës pasi heqim mbaresën. Ajo përbëhet nga: parashtesa, prapashtesa dhe rrënja.			

- *Parashtesa* qëndron para rrënjës dhe formon fjalë të re (element fjalëformues).
- *Prapashtesa* qëndron pas rrënjës dhe formon fjalë të re (element fjalëformues).
- *Te fjalët e parme* (të thjeshta), tema dhe rrënja janë e njëjta gjë.
- *Fjalët jo të parme* i klasifikojmë: të prejardhura, të përbëra, të përngjitura.

Plotësohet **Pema e mendimit**.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Punë në grupe

Punohen dhe diskutohen ushtrimet e fq. 172.

Grupi I. Ushtrimi 1. Nxënësit do të dallojnë formën dhe përmbajtjen e fjalëve: *tortë/a*, *dorë/a*, *mace/ja*, *libër/i* (Përdoret libri “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” për ndihmë).

Shembull.

tortë/a.

Forma: t/o/r/t/a

Kuptimi: *Ëmbëlsirë në trajtë të rrumbullakët a katërkëndëshe me përmasa të ndryshme, pa sherbet e me disa shtresa që bëhet me miell, me vezë, me sheqer, me qumësht etj., mbushet brenda, me krem, me arra të shtypura etj. dhe zbukurohet përsipër e anash; një copë nga kjo ëmbëlsirë, e prerë zakonisht në trajtë trekëndëshi* (në mungesë të fjalorit, të ndihmohen nxënësit/et në përkufizimet e kuptimeve të fjalëve).

Grupi II. Ushtrimi 2. *Kërkesë e qortuar*. Tregoni se ç’elemente janë fjalët me ngjyrë të kuqe? (nxënësit do të dallojnë mbaresat, të cilat tregojnë veçori gramatikore si gjinia, rasa, numri, trajta).

Grupi III. Ushtrimi 3. Nxënësit ndajnë temat nga mbaresat. Sqarohen që te mbiemrat do të veprohet si tek emrat për të dalluar mbaresën: (një) i motshëm (nuk ka mbaresë).

Grupi IV. Ushtrimi 4. Nxënësit dallojnë mbaresat e emrave, sipas shembujve të tabelës.

Nxënësit/et punojnë në mënyrë të pavarur dhe më pas një përfaqësues i çdo grupi prezanton përgjigjet.

Qortohen gabimet dhe sqarohen nxënësit për paqartësitë që mund të kenë.

Ushtrimi 5. (Punë në dyshe). Nxënësit plotësojnë mbaresat e fjalëve, këmbajnë tekstet me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë saktësinë e shokut/shoqes.

Lexohet ushtrimi nga një nxënës/e.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; saktësinë e punimit të ushtrimeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; zbatimin e rregullave të mirësjelljes gjatë orës së mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6, fq.172.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ushtrime për përbërësit e fjalës (FVK) Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fjalëformim)		Situata e të nxënit: Minikonkurs. Përzgjidhen tre nxënës, sipas grupeve të nxënësve, dhe secili tërheq një fish me nga dy fjalë. Nxënësit plotësojnë në tabelë përbërësit e fjalëve: <i>tema, mbaresa, parashtesa, prapashtesa, rrënja</i> . Nxënësi/ja që i plotëson më shpejt dhe saktë, fiton.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon temën dhe mbaresën e fjalës; - dallon saktë përbërësit; - formon fjalë të prejardhura me ndihmën e parashtesave dhe prapashtesave; - krijon fjali me fjalë të prejardhura.		Fjalët kyçe: fjalë e prejardhur me parashtesë, me prapashtesë, me para + prapa shtesë njëkohësisht	
Burimet: Fletorja e vlerësimit të kompetencave FVK		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Minikonkurs. Punë në grupe. Pema e mendimit. Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi. Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve (Pema e mendimit) Plotësohet në tabelë nga një nxënës Pema e mendimit - Përbërësit e fjalës. Zgjidhet një fjalë e prejardhur si shembull: përpunonte, zhvlerësim etj. Diskutohet shembulli dhe sqarohet ndonjë pasaktësi që mund të kenë nxënësit. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Udhëzohen nxënësit që të hapin FVK, në fq. 14. Punohen ushtrimet nga nxënësit. Grupi I. Ushtrimet 1, 2. Nxënësit do të dallojnë temën, mbaresën dhe rrënjën e fjalëve të dhëna. Grupi II. Ushtrimi 3. Nxënësit do të formojnë fjalë të prejardhura me prapashtesat e dhëna në tekst. Grupi III. Ushtrimi 4. Nxënësit do të lidhin fjalën e parme me fjalën e prejardhur dhe do të veçojnë prapashtesën dhe do të formojnë edhe një fjalë tjetër të prejardhur. p.sh.: punë-punëtor -tor; punëtoria			

Grupi IV. Ushtrimi 5. Nxënësit do të formojnë nga tri fjalë të prejardhura me prapashtesat e dhëna. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe më pas, përfaqësues të grupeve të ndryshme, prezantojnë përgjigjet. Nxënësit mund të qortojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës, saktësinë dhe shpejtësinë gjatë minikonkursit, saktësinë në dhënien e përgjigjeve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur: FVK Ushtrimi 6, fq. 14.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Rishkruajmë një tregim nga veta I në vetën III Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Nxënësit rrëfejnë një ngjarje që ka ndodhur më parë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - informohet për veprimtarinë që do të kryejë si punë me shkrim: shndërrimin e një tregimi nga veta e parë në të tretë; - jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth tekstit që dëgjon; - prezanton ndryshime që shihen dhe evidentohen në grup midis dy tregimeve (i njëjti tregim i shkruar në vetën e parë dhe në vetën e tretë); - përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat të diskutuara me sipër mbi ndryshimet e tekstit kur kalohet nga vetë e parë në të tretë.		Fjalët kyçe: tregim, veta e parë, veta e tretë, shndërrim, model, rregulla shkrimi.	
Burimet: teksti, libra me tregime të ndryshme, tregime të regjistruara në CD (zgjidhet forma sipas kushteve)		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Rrëfej një ngjarje. Punë në dyshe Punë e pavarur. Punë me shkrim. Prezantim.			
Organizimi i orës së mësimi. Situata e të nxënit Ftohen nxënësit/et që të tregojnë një tregim (ngjarje) që u ka ndodhur më parë dhe që rrëfohen në vetën e parë. Pasi dëgjojnë disa prej tyre, 3-4 histori, u rrëfhet një tregim i tekstit ose një tregim tjetër, përzgjedhur nga një libër me tregime: një herë sikur ngjarja ndodh në vetën e parë, sikur i ka ndodhur rrëfimitarit dhe njëherë në vetën e tretë, sikur i ka ndodhur një tjetri, pra dikush tjetër po e tregon.			
Ndërtimi i njohurive të reja Prezantimi i tregimit dhe leximi i tij libri fq. 31 (Punë në grupe dyshe)			

U kërkohet nxënësve të punojnë pak minuta me njeri-tjetrin, në grupe dyshe, për ta transformuar tregimin në vetën e tretë. Në fillim ata duhet të lexojnë me kujdes hyrjen dhe mbylljen e tregimit. Pasi diskutojnë dhe ritregojnë me gojë tregimin në vetën e tretë, ashtu si ata munden, nxënësit/et dëgjojnë 2-3 rrëfime dhe më pas punojnë të pavarur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Punë e pavarur (Punë me shkrim)

Kërkohet që nxënësit/et të nisin të shkruajnë tregimin në vetën e tretë. Mirëpriten pyetjet e tyre dhe mësuesi/ja i ndihmon kur ata kanë nevojë.

Prezantimi para klasës i krijimeve, këmbim punimesh në grupe dyshe.

Vlerësimi: Ora e mësimit quhet e realizuar, kur nxënësit/et arrijnë të përfundojnë së shkruari tregimin e shndërruar nga veta e parë në të tretë, kur ata i kanë këmbyer punimet me njëri-tjetrin, duke bërë edhe sugjerime për përmirësime të mëtejshme.

Ndërkohë, mësuesi/ja apo një nxënës/e tjetër i/e cili/a ka bërë përshtatjen më të mirë dhe pa gabime e lexon para klasës, të tjerët ndjekin me vëmendje dhe bëjnë ndryshimet e duhura në fletoret e tyre.

Mësuesi/ja jep detyrë që nxënësit/et të gjejnë një tregim tjetër dhe ta kthejnë nga veta e parë në të tretë në të njëjtën mënyrë si vepruan në klasë. Këtë detyrë, mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et ta ruajnë në portofolat e tyre personale, si një produkt që tregon një kompetencë të arrirë.

Detyrat dhe puna e pavarur: FVK, fq. 12

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

LIVRI I PRITËS PËR NËNËN MËSIMTORE				D. _____. ____	
------------------------------------	--	--	--	--	--

- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve duke përshkruar dhe karakterizuar tipare të karakterit të më të rriturve; - merr pjesë në bashkëbisedim me të rritur edhe për probleme familjare deri në ato ekonomike	
Burimet: Teksti mësimor, informacione nga interneti	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grupe dyshe. Punë e pavarur. Lojë në role. Intervistë. Prezantim	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. U kërkoj nxënësve që të punojnë me librin duke vendosur emrat e prindërve nën fig. dhe të lidhin me shigjetë prindin (nënë, babanë) duke i karakterizuar. Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe dyshe Orientohen nxënësit/et që në punë me grupe dyshe t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve të ushtrimit 2 të faqes 32. Ata shprehen lirshëm duke përcjellë ndjenja humane, shenja te edukimit ekonomik të respektimit të të drejtave të njeriut etj. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Intervista (incizime/prezantime) Më pas, nxënësit/et realizojnë intervistat që kanë kryer më parë me prindërit e tyre dhe nëse i kanë të regjistruara i japin që të dëgjojnë edhe të tjerët ose prezantojnë nëse kanë mbajtur shënime. Kërkohet dhe dëgjojnë dy intervista të bëra me nënën, babanë, gjyshin. Punë e pavarur dhe plotësim skede/punë në grupe dyshe. Punohet për pasurimin e fjalorit sipas termave të caktuara që përfaqësojnë fusha semantike të respektit, dashurisë, miqësi, bindje, mirëkuptim etj. Nxënësit/et bashkëbisedojnë në grupe dyshe ose me më shumë nxënës/e dhe përdorin fjalë/shprehje që ia drejtojnë njëri-tjetrit. Lojë në role Temat e rekomanduara në ushtrimin. 5 do të realizohen në punë me grupe dyshe ose më shumë. <i>Sikur të të mungonte një mësues/e, kam mall, dua të ngjaj me, nuk do ta harroj kurrë, dhurata më e bukur që do të bëja, dua t'i kërkoj falje</i> etj. Kërkohet të përdoren sa më shumë fjalë dhe shprehje që i përkasin fushës që përfaqëson çdo dialog.	
Vlerësimi i nxënësve për njëri-tjetrin Kjo orë mësimi jep mundësi që nxënësit/et ta vlerësojnë njëri-tjetrin në shumë aspekte të tilla si: për vlerësimin që bëjnë për prindërit e tyre duke i karakterizuar me fjalë dhe shprehje (mbiemra); për mënyrën se si bëjnë pyetje dhe si përgjigjen për probleme që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut në raporte prind-fëmijë; në shfaqen e ndjenjave humane; në mënyrën se si shfaqin tipare të edukimit ekonomik në lidhje me problemet ekonomike familjare etj.; për aftësitë që kanë treguar për realizimin e intervistave dhe lojës në role; përdorimi i tonit të zërit, pauzave, respektimit të radhës gjatë të folurit dhe respektimi i shokëve kur ata flasin. Dëgjimi me vëmendje dhe ndërhyrjet me vend përbëjnë çështje të ndryshme.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Dashuria e nënës Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Shtrohet çështja për diskutim: Ç’është dashuria për ju? ← ↙ ↓ ↘ → ëndërr ndjenjë mendim mëshirë ëndërr ndjenjë mendim mëshirë Nxënësit/et sjellin mendimet e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit bëhen të dukshme për të gjithë grupin e klasës. Më poshtë shënohet në dërrasë të zezë. Dashuria për: ← ↙ ↓ ↘ → familjen natyrën shkollën shoqërinë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon pozicionin e prindit në familje dhe në modelin që i jep fëmijës; - përcakton rendin kronologjik të ngjarjes; - portretizon personazhet duke vendosur theksin edhe në rolin e dialogut për zbërthimin e gjithsecilit; - argumenton duke vendosur veten në rolin e personazhit kryesor; - interpreton rolin dhe funksionin e figurave letrare.		Fjalët kyçe: dashuri, sakrificë, vuaj, varfëri, çmoj, shëroj.	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Të nxënit me këmbime. Tryeza rrethore. Punë në grupe. Ditar dypjesësh			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Realizohet situata e të nxënësve të zhvilluar më lart.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet titulli i pjesës, autori dhe libri prej nga është marrë.

Ramadan Pasmaçi lindi në Berat dhe shtatëvjeçaren e kreu në vendlindje.

Pas diplomimit, në degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe u emërua drejtor i shkollës së Shëngjergjit të Tiranës, prej nga u tërhoq në gazetën “Bashkimi”, tek punoi gjer në vitin 1966. Më tej shërbeu si gazetar në “Mësuesi” dhe 18 vjet kryeredaktor i revistës letraro-artistike për fëmijë “Yllkat” që nga krijimi i saj. U njoh si publicist i suksesshëm qysh nga vitet e para të punës, me botime në organet e shtypit të përditshëm e atij periodik.

Veprat e tij kryesore: “Udhëve të fëmijërisë”, “Dashuria e nënës”, “Keci bardhosh”, “Dy shokët”, “Flaka e shpresës” etj.

Realizohet leximi i pjesës. Gjatë leximit të saj, nxënësit shënojnë fjalët dhe shprehjet e reja. Puna me fjalorin. Nxënësit/et risjellin në vëmendje se çfarë është **dashuria e nënës** gjatë rileximit që i bëhet tregimit e më pas punohet ushtrimi 1 duke rilexuar dhe vendosur numra përbri çdo fjalie sipas rrjedhjes së ngjarjeve në tregim. Më poshtë, nëpërmjet Tryezës rrethore mundësohet që nxënësit/et të interpretojnë dhe vetë se si do të vepronin po të ishin në vend të djalit (ushtrimi 2).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit/et ndahen në 4 grupe.

Grupi I punon ushtrimin 3 duke përdorur Ditarin dypjesësh.

Momentet ku del: Fjalitë në tekst

sakrifica e djalit

vuajtjet e nënës

varfëria e familjes

dashuria e nënës

Grupi II liston fjalët dhe shprehjet që tregojnë kohën në rrëfim.

Grupi III punon ushtrimin 4.

Grupi IV punon ushtrimet 5, 6.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e secilit grup argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës. Nëse shihet e nevojshme, bëhen ndërhyrjet e duhura e më pas rikujtohen me nxënësit/et konceptet:

Dialogu është bashkëbisedim midis personazheve në përputhje me rolet që kanë.

Personazhet ndahen sipas rëndësisë së rolit në ngjarje. **Personazhet kryesore** janë vendimtare për të kuptuar ngjarjen. **Personazhet dytësore** kanë rol dytësor dhe nuk janë vendimtare për ngjarjen.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Grupi I dhe II. Shkruani pjesën që ju pëlqen më shumë. Argumentoni pse ju pëlqen.

Grupi III dhe IV. Ky tregim është shkruar në vetën e parë, vetë autori rrëfen ngjarjen. Kthejeni në vetën e tretë fragmentin nga ...*Dimri hyri me kohë...* deri te... *ai më vuri dorën në sup.*

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kujtime të gëzueshme Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Nxënësit/et janë porositur që më parë që të sjellin foto të bëra më përpara dhe që lidhen me ngjarje të së kaluarës. Nxënësit/et paraqesin dhe përshkruajnë foto të ndryshme. Atyre kërkohet që të veçojnë idenë e përshkrimit të një ngjarjeje që i takon së kaluarës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor formën ose modelin e shkrimit të kujtimeve mbështetur edhe në udhëzimet e dhëna për mënyrën e të shkruarit të kujtimeve; - zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij në lidhje me shkrimin e kujtimeve, të tilla si përdorimi i foljes në kohën e shkruar, përdorimi i vetës së parë, përshkrimi i vendeve kohës dhe njerëzve që kanë marrë pjesë; - jep detaje përshkruese, me fakte; - përdor fjalor të përshtatshëm në lidhje me situatën që përshkruan. - vlerëson punimet e shokëve/shoqeve.		Fjalët kyçe: kujtime, foto, çaste të bukura, rregulla, detaje, krijim.	
Burimet: teksti, interneti, fotografi, fletore punës me shkrim		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim. Minileksion. Kllaster. Punë e pavarur. Punë në grupe dyshe.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Prezantimi i fotove të nxënësve që lidhen me ngjarje të së kaluarës (në grupe dyshe). Ata i paraqesin duke përshkruar ngjarjet edhe me gojë. Pyeten nxënësit/et: Çfarë janë kujtimet? Tregohen apo shkruhen kujtimet? Nxënësit/et përgjigjen: edhe tregohen edhe shkruhen. Ndërtimi i njohurive të reja. (Minileksion) U tregohet nxënësve se kujtimet janë histori që vijnë nga e kaluara. Ato edhe tregohen edhe shkruhen. Gjatë shkrimit të kujtimeve përdoren shumë emra, mbiemra, përshkruhen shumë vende dhe përcaktohet mirë koha kur ka ndodhur, përdoren data, emërtime vendesh. Foljet përdoren në kohën e shkruar, ndërsa tregimi bëhet në vetë të parë. Përdoren zakonisht shprehjet: <i>para disa vjetësh, muajsh, një vit më parë, kur isha i vogël, ishte hera e parë</i> etj. ... Tregohen ose lexon kujtime nga jeta e vet ose e të tjerëve dhe veçohen më pas pjesët përbërëse të shkrimit në formë kujtimi hyrja, vendi, koha, ngjarja, pjesëmarrësit, përfundimi.			

U kërkohet nxënësve që të kujtojnë hapat që bëjnë përgatitjen për një shkrim të llojit kujtime. Kujtojnë hapat që bëhen gjatë realizimit të procesit të shkruarit: parashkrimi, mbledhja e ideve, përpunimi, shkrimi i draftit të parë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit plotësojnë kllasterin dhe shkruajnë idetë që iu vijnë në mendje për një kujtim nga e kaluara.

Pasi kanë mbledhur idetë i transformojnë ato në paragrafë të shkrimit që do të bëjnë, shkruajnë draftin e parë.

Punë në grupe dyshe

Nxënësit lexojnë punimet e njëri-tjetrit japin ide dhe bëjnë sugjerime.

Punë e pavarur.

Bëjnë ndryshime dhe redakte.

Krijojnë draftin final, e redaktojnë e kontrollojnë dhe e dorëzojnë apo e lexojnë para të tjerëve. Punimet do të vlerësohen dhe do të qortohen me notë.

Vlerësimi:

- për respektimin e fazave të shkruarit;
- respektimin e rregullave strukturore dhe gjuhësore për shkrimin, llojin, kujtimet;
- kontributin e dhënë për përmirësimin e drafteve të njëri-tjetrit;
- vlerësimin e punimeve të njëri-tjetrit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Si ta kontrollojmë një tekst që shkruajmë Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përgatitet dhe ndjek fazat e procesit të të shkruarit; - shton ide, zgjeron ose shkurton fjali; - ndan paragrafët; shmang përsëritjet, miraton sugjerimet; - përmirëson draftin e parë; shton ide dhe opinione në shkrimin e tij; - përgatit draftin final, e shkruan atë; - e kontrollon përsëri, i jep dorën e fundit për ndonjë ndryshim të mundshin dhe për gabime strukturore drejtshkrimore dhe të pikësimit; - i jep dorën e fundit e dorëzon dhe e publikon; - rishkruan hyrjen/mbylljen nëse nuk i pëlqen; - tregon kujdes me stilin e shkrimit;		Fjalët kyçe: tekst, paragraf, ide, draft, hyrje, zhvillim, mbyllje, gabime, shkrim, fjalor.	

- shmang fjalë apo fraza që nuk i takojnë stilit me të cilin është shkruar; - korrigjon gabimet drejtshkrimore, për të qenë të sigurt - konsultohet me fjalorin drejtshkrimor; - përmirëson shkrimin tuaj duke bërë ndreqjet sipas rastit; - bën ndreqje dhe zëvendësime sipas rastit; - bën ndreqjet e duhura qartësinë e grafikës së shkronjës, largësinë, ndarjen në fund të rreshtit në rrokje etj.	
Burimet: punime me shkrim, tabela e shenjave konvencionale, material në videoprojektor i këshillave për ndjekjen dhe kontrollin e punëve me shkrim ose një tabelë e shkruar me këto këshilla.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Punë në grupe dyshe.	
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Prezantohet tema e re, e cila lidhet me hapat që duhen ndjekur për të kontrolluar një tekst që shkruhet nga nxënësit/et. Nxiten që të japin ide për një temë që ata duan të shkruajnë apo kanë shkruar më parë. Le të marrin temën më të afërt “Shkruajmë kujtime”. Nxënësit/et flasin për strukturën që duhet respektuar (hyrje, zhvillim, mbyllje), për idetë që duhet të shkruajnë qartë, për kuptimin dhe logjikën e gjithë tekstit, për drejtshkrimin dhe pikësimin. Ndërtimi i njohurive të reja. Mësuesja/si paraqet tabelën e cila përmban disa rregulla që duhen respektuar apo duhen mbajtur mend në lidhje me një tekst që shkruajmë. Tabela paraqitet me videoprojektor në dërrasë, ose në një tabak letre, që nxënësit/et ta lexojnë dhe komentojnë të gjitha së bashku. Hapat Problemi Lloji i ndërhyrjes Hapi i parë Kuptimësia: Lexoni tekstin. Ka dalë ideja që keni pasur në mend? Është i qartë dhe i kuptueshëm? Shtoni ide. Zgjeroni ose shkurtoni fjali. Ndaj paragrafët. Shmang përsëritjet. Hapi i dytë Struktura: Lexoni shkrimin për të parë nëse dalin të qarta: hyrja, zhvillimi, mbyllja. Rishkruaj hyrjen/mbylljen nëse nuk ju pëlqen. Hapi i tretë Kujdes me stilin: Kujdes me stilin e shkrimit. Shmangni fjalë apo fraza që nuk i takojnë stilit e shkrimit. Lexoni për të kuptuar se mos keni përzier stilet.	

Hapi i katërt

Drejtshkrimi dhe pikësimi:

Kërkoni për gabime drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Korrigjoni gabimet drejtshkrimore. Për të qenë të sigurt konsultohuni me fjalorin drejtshkrimor.

Hapi i pestë

Morfologjia dhe sintaksa:

Kontrolloni përshtatjen në gjini, numër dhe rasë të emrave dhe mbiemrave, rendin e fjalëve në fjali, përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën, përdorimin e lidhëzave.

Përmirësoni shkrimin tuaj duke bërë ndreqjet sipas rastit.

Hapi i gjashtë

Leksiku dhe kuptimet e fjalëve:

Kontrolloni fjalët nëse janë përdorur me kuptimin e duhur, shmangni fjalët e huaja.

Bëni ndreqje dhe zëvendësime sipas rastit.

Hapi i shtatë

Paraqitja:

Vëreni paraqitjen e shkrimit të dorës, qartësinë e grafikëve të shkronjave, largësinë e fjalëve nga njëra-tjetra, respektimin e paragrafëve, titujve, nëntitujve.

Bëni ndreqjet e duhura qartësinë e grafikës së shkronjës, largësinë, ndarjen në fund të rreshtit në rrokje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. (Punë në grupe dyshe. Punë e pavarur)

Sipas hapave të përshkruar në tabelën e mësipërme kërkojnë në punimet e njëri-tjetrit çfarë ka ndodhur dhe bëjnë shënime anash fletës. I marrin me radhë hapat nga 1-7. Nxënësit/et përdorin edhe shenja konvencionale për të nxjerrë në pah gabimet apo pasaktësitë në punët e njëri-tjetrit. **(Punë e pavarur)**

Çdo nxënës/e sipas hapave dhe sugjerimeve bën ndreqjet e gabimeve apo sugjerimeve dhe e sjell punimin me shkrim në një nivel më të kënaqshëm se në draftin e mëparshëm.

Prezantim individual i punës së kryer (Çfarë ndreqën dhe përmirësuan)

Publikim (i draftit final) të shkruar pas sugjerimeve.

Vlerësimi. Kjo orë mësimi e cila kishte për qëllim për zhvillimin e kompetencën së shkruarit dhe përmirësimin strukturor, logjik dhe gjuhësor të punëve me shkrim quhet e realizuar, kur nxënësit/et arrijnë të përmirësojnë drafte të punëve të tyre me shkrim atëherë, kur gjejnë shmangie logjike strukturore gjuhësore nga punët e njëri-tjetrit dhe të tyre në punë me shkrim të shkruara më parë. Njëkohësisht quhet e realizuar kur nxënësit/et pranojnë shmangiet apo gabimet që kanë bërë, i kuptojnë dhe i reflektojnë ato në një draft të ri të punës me shkrim, i cila ka kaluar përmes këtij procesi kontrolli dhe përmirësimi.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Sënduku i gjyshes (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Shtrohet çështja për diskutim. A kemi sende apo objekte të çmuara të cilat na e kanë lënë trashëgimi gjyshërit apo ndoshta janë dhe më të hershme? Nxënësit/et sjellin mendimet, të shkuarën e tyre, e cila nëpërmjet diskutimit bëhet e pranishme për të gjithë grupin e klasës. Në dërrasë të zezë listojmë disa nga këto objekte: <i>sënduk,</i> <i>kostum popullor,</i> <i>këpucë,</i> <i>orë .</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - dallon rëndësinë e objekteve të vjetra (sjellja e të shkuarës nëpërmjet tyre); - lexon saktë, rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tregimin; - përcakton kohën dhe vendin, në të cilën zhvillohet ngjarja. Ora e dytë Nxënësi/ja: - portretizon personazhin e gjyshes duke vënë theksin në cilësitë që e bëjnë atë të paharrueshme; - gjykon mbi mesazhin që përcjell fragmenti në konkretizimin që i bën gjithsecili situatës. - analizon gjuhën e figurshme të tekstit.		Fjalët kyçe: sënduk, i çmuar, trashëgoj, gjyshe, e dashur	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Pyetje-përgjigje. Të nxënit me këmbime. Ditari dypjesësh. Punë në grupe.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënit, gjatë së cilës nxënësit/et flasin në lidhje me trashëgiminë materiale që ne kemi trashëguar nga të parët tanë. Mund të sillen në klasë objekte të vogla nga nxënësit ose të përgatiten foto me objekte të trashëgimisë sonë kulturore.			

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet në tabelë tema e re. Nxënësit njihen me jetën dhe krijimtarinë e shkrimtares Adelina Mamaqi. **Adelina Mamaqi** ka lindur në vitin 1939 në Tiranë, nga një familje atdhetare e letrare. Ka kryer shkollën e mesme pedagogjike dhe është diplomuar në universitetin e Tiranës, në degën Letërsi dhe Gjuhë shqipe. Punoi në Shtëpinë Botuese “N. Frashëri” në redaksinë për fëmijë. Më vonë kaloi redaktore në revistën “Nëntori”. Për 20 vjet punoi në revistën “Fatosi”, “Pionieri”. Vepra e parë e saj titullohet “Ëndrra vashërie”. Në vitin 1963 botoi “Bubi i vogël”.

Për 30 vjet botoi poezi, tregime, fabula, përralla: Orizi i milingonave (poemë), Bregu i kaltër (vjersha), Goni trazovaçi (poemë), Fishekzjarrët (vjersha), Kllçoça dhe kotelet (poemë), Si thoni ju? (vjersha humoristike), Kaltëroshi tekanjozi (poemë), Një zog gëzimi (vjersha), Mësoi Adi shkronjën A etj.

Caktohen disa nxënës për ta lexuar tregimin zinxhir. Gjatë leximit, nxënësit nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja, të cilat do të shpjegohen në fund të leximit. Me to krijojnë fjali të reja.

Pas rileximit të tekstit “Sënduku i gjyshe” nëpërmjet metodës *Pyetje-përgjigje* punohen 6 pyetjet e ushtrimit 1, për të hyrë më në brendësi të tij.

- 1) *Do të zhvendosen në një shtëpi tjetër; pasi të tyren do t’u duhen ta lënë pasi do të ndërtohet një pallat i madh.*
- 2) *Pjesëtarët e familjes e kishin ruajtur me aq kujdes sëndukun e vjetër.*

Nxënësit tregojnë përvojat e tyre personale në lidhje me dhuratat e gjysheve.

Pse gjyshja i ruan me aq kujdes sendet dhe objektet? Nxënësit përgjigjen, duke iu referuar tregimit.

U shpjegohen nxënësve konceptet: *koha dhe vendi*.

Koha dhe
vendi

Çdo histori ka një zhvillim në kohë dhe në hapësirë. Kjo dallohet nëpërmjet treguesve të kohës dhe të vendit.

Ora e dytë**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.****Punë në grupe**

Cilësitë e gjyshe	Fjalja ku del kjo cilësi
punëtore	..gjyshja që nuk di të çlodhet e të pushojë... ...gjyshja kujdesej për lulet...
e dashur	
e kujdesshme	
e ndjeshme	
atdhetare	

Grupi II. Ushtrimi 5. Nxënësit do të renditin ngjarjet në këtë tregim, duke shkruar fjalitë përmbledhëse.

Grupi III. Ushtrimi 6. Nxënësit dallojnë treguesit e vendit dhe kohës: *unë kam lindur në një shtëpi të vogël njëkatëshe, në një oborr plot me lule, pas një muaji, për dhjetëvjetorin e lindjes...*

Ushtrimi 7. Nxënësit nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e figurshme.

të zhytur mes pemëve, thesaret e jetës së saj, i përkëdhelte me vështrim, thua se ishin qenie të gjalla

Grupi IV. Ushtrimi 8. Nxënësit do të komentojnë mesazhin që përcillet në fjalët e gjyshe në fjalinë e fundit. Nxënësit/et punojnë në heshtje, përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Bëni një album me titull: “Traditat tona të vjera”. Albumin mund të përfshihet si punë në portofolin e punimeve.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Fjalët e prejardhura Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Fjalëformim)		Situata e të nxënit: Paraqitet në tabelë familja e fjalës <i>shkronjë</i> shkruaj ↑ i pashkruar ← shkronjë → shkruar ↓ shkrues ↙ ↓ ↘ shkrimor shkrimtar i përshkruar Nxënësit nënvizojnë rrënjën e çdo fjale të prejardhur dhe veçojnë parashtesat dhe prapashtesat.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon fjalët e prejardhura me pjesët përbërëse, parashtesa + rrënja + prapashtesa; - dallon fjalët e thjeshta nga fjalët jo të thjeshta; - formon fjalë të reja të prejardhura; - pasuron fjalorin me fjalë të reja; - i përdor fjalët e reja në fjali.		Fjalët kyçe: fjalë e prejardhur me parashtesë, me prapashtesë, me para + prapa shtesë njëkohësisht	
Burimet: teksti i nxënësit, libri “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grup. Punë e pavarur. Lojë gjuhësore.			
Organizimi i orës së mësimi. Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Situata e të nxënit. Nxënësit veç dallimit të parashtesave dhe prapashtesave të fjalëve të reja, të prejardhura, do të japin edhe kuptimet e tyre, duke formuar fjali të shkurtra me gojë. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet tema e re. Nxënës të ndryshëm lexojnë me zë informacionin e dhënë në libër për temën e re dhe përsëritin ç’janë parashtesat, prapashtesat, mbaresat. Dallojnë fjalitë e prejardhura me parashtesë. Dallojnë fjalitë e prejardhura me prapashtesë. Dallojnë fjalitë e prejardhura me para + prapashtesë. Me lojën zinxhir, nxënësit përsëritin parashtesat e prapashtesat që janë dhënë në tabelë, japin edhe fjalë të reja të formuara me to.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrimi 1, 2, i punojnë dy nxënës në tabelë, sipas kërkesave të ushtrimeve. Ndërkohë klasa në grupe dyshe punojnë me shkrim në fletore ushtrimet 3, 4 (sipas kërkesave). Përgjigjen nxënësit në tabelë, përgjigjen nxënësit e klasës për ushtrimet 3, 4 qortojnë gabimet, duke i ndihmuar aty ku hasin vështirësi. Ushtrimi 1. Fjalë të thjeshta: i vogël, rrinte, portës, shkollës, shikonte, droje, turp, ditë, zgjati, letër, ishte, vjershë, vargje, plot, mbeten, shprehin. Fjalë të prejardhura: çunak (me prapashtesën zvogëluese -ak), i hollë, i gjatë, të palosur, e shkruar, të thjeshta, dashuri, ngrohtësi, të paharrueshme, të pafundme (i hollë, i gjatë, janë mbiemra që formohen nga ndajfoljet përmes nyjzimit). Fjalë të përbëra: sykaltër, flokëkaçurrel, mirënjohje.
Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; vlerësim me gojë në lojën zinxhir; vlerësim në zgjidhjen e ushtrimeve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, plotësojnë tabelën me fjalë të parme, të prejardhura duke i zgjedhur nga paragrafi i parafundit dhe i fundit i pjesës “Provimi”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pianoja (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jolettrare		Situata e të nxënit. Parashikimi i ngjarjes. Paraqiten në tabelë fjalët: <i>dashuri, druajtje, dhuratë, piano, mirënjohje, krenari</i> dhe nxënësve, mbi bazën e tyre u kërkohet që të ndërtojnë një tregim të shkurtër. Nxënësit/et punojnë për pak çaste e më pas përfaqësues të secilit grup lexojnë detyrën e përgatitur.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - parashikon ngjarjet nisur nga elementet e dhëna; - lexon saktë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tregimin.		Fjalët kyçe: piano, mirënjohje, vlerësoj, krenari.	

Ora e dytë Nxënësi/ja: - dallon mesazhin e pjesës; - portretizon personazhet duke u ndalur në vlerat që përcjellin; - dallon figurën e metaforës dhe e analizon atë; - vlerëson marrëdhëniet ndërmjet personazheve duke u nisur edhe nga kuptimet e figurshme të fjalëve.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, CD me pjesë orkestrale të luajtura me piano.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Parashikim i ngjarje. Pyetje-përgjigje. Pesëvargëshi. Punë në grupe. Diskutim.	
Organizimi i orës së mësimit Ora e parë. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Realizohet situata e të nxënit. Nisur nga mundësitë, mund të përdoren në sfond pjesë muzikore në piano si: Beethoven-Fur Elise, Franz Liszt-Love dream. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet tema e re në tabelë. Nxënësve u jepen të dhëna të përmbledhura në lidhje me autoren e shkrimit. Luiza Mej Alkot lindi në 29 nëntor 1832. Ajo ishte një romanciere dhe poete amerikane e njohur më së shumti si autore e romanve “Gratë e vogla” (1868), “Jo” dhe “Djemtë”. Ajo filloi të marrë sukses kritik për shkrimin e saj në vitet 1860. Në fillim të karrierës së saj, Alkot ndonjëherë përdorte emrin e stemës A. M. Barnard, sipas së cilës ajo shkroi novela për të rriturit e rinj. Romani “Gratë e vogla”, u prit shumë mirë dhe sot është një roman i njohur për fëmijë, i ekranizuar disa herë. Luiza Mej Alkot vdiq në Boston më 6 mars 1888. Caktohen disa nxënës për ta lexuar tregimin zinxhir. Gjatë leximit, nxënësit nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja, të cilat do të shpjegohen në fund të leximit. Me to do të krijojnë fjali të reja. Gjatë rileximit të fragmentit, nxënësit/et punojnë 10 pyetjet e ushtrimit 1. Kjo realizohet nëpërmjet metodës <i>Pyetje-përgjigje</i>. Nxënësit/et i lexojnë duke: parafrazuar përgjigjet, p.sh.: Motrat e pritën Betin të ngazëlljyer... Ushtrimi 2. Nxënësit japin arsyen, referuar tekstit, se pse Beti e harroi fjalimin (lexohet momenti në tekst). Rikujtohet së bashku me nxënësit figura e metaforës. Metafora është ajo figurë letrare që emërtun një send a një dukuri me emrin e një sendi a një dukurie që i ngjan. Ajo përdoret në tregime (si pjesa që kemi shkëputur për sot), romane, vepra letrare, në prozë, e cila pasqyron një rreth të gjerë të ngjarjeve edhe në poezi, dhe në jetën e përditshme.	

Personazhi	Si është?	Çfarë thotë?	Çfarë bën?	Ku duket kjo?

Grupi III. Zbërtheni kuptimin e shprehjeve të figurshme:

- kur e dashuron muzikën;
- mbi faqen e trëndafiltë;
- dashuria e përzë druajtjen.

Grupi IV. Tregoni nënkuptimin e përdorimit të këtyre fjalëve. Komentoni me fjalët tuaja sipas kuptimit në tekst "...sepse dashuria e përzë druajtjen dhe mirënjohja di ta mundë krenarinë."

Grupi V. Formuloni mesazhin që i transmeton lexuesit ky fragment. Cilat vlera qytetare e humane vë në pah ai?

Grupi VI. Plotësohet pesëvargëshi me fjalën: Muzika

Muzika (titulli)
e bukur mbresëlënëse (2 mbiemra)
dëgjohet këndohet luhet (tri folje)
Muzika lëshon tinguj mbresëlënës. (një fjali me katër fjalë)
Melodi (sinonim i titullit)

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para klasës, mësuesi/ja ndërhyr nëse e shikon të nevojshme.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra fq. 44.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Fusha leksikore Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Leksikologji)		Situata e të nxënit: Nxënësit do të analizojnë formën dhe kuptimet e fjalëve: <i>shishe</i> dhe <i>dorë</i> .	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon formën dhe përmbajtjen e fjalës; - përdor fjalë me kuptime të figurshme; - dallon fjalët që formojnë fushën leksikore.		Fjalët kyçe: fushë leksikore, forma, kuptimi, kuptim i figurshëm	
Burimet: teksti i nxënësit, FVK, njohuritë e nxënësve, libri “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Punë në grup. Punë e pavarur. Diskutim. Punë në grupe dyshe. Lojë gjuhësore.

Organizimi i orës së mësimit.

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Paraqiten përgjigjet e nxënësve në lidhje me formën dhe kuptimin e fjalëve: shishe dhe dorë (kuptimi 1, 2, 3 dhe kuptimet e figurshme të tyre).

Ndërtimi i njohurive të reja. Diskutim. Lojë gjuhësore

Udhëzohen nxënësit që të lexojnë informacionin në libër për kuptimin e fjalëve dhe fushën leksikore. Ndalen te tabela ku jepen tri kuptimet e fjalëve (fjala bazë - kuptimet e figurshme).

Nxënësit nxjerrin çantat dhe emërtojnë të gjitha sendet që kanë në çantë: laps, ngjyra, gomë, libra, fletore, etj. Këto janë një bashkësi sendesh (fjalësh) që i përdorni për të mësuar, pra janë mjetet mësimore.

Numërojnë ç'kanë veshur: kanotiere, këmbishë, triko, çorapë, këpucë etj., pra janë veshmbathje.

Nxënësit lexojnë tabelën në libër, me fushat leksikore të ushqimeve, perimeve, frutave, fjalëve dhe përkufizojmë se ç'është fusha leksikore.

Jepen shembuj të tjerë nga nxënësit, përmes një loje të thjeshtë; njëri nxënës thotë konceptin dhe tjetri thotë fjalë të kësaj fushe leksikore dhe anasjellas.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit punojnë ushtrimet 1, 2 në grupe dyshe dhe fjalët e dhëna në fjali i përdorin për të dhënë kuptimin e figurshëm p.sh.: gojë - e njeriut, organ i të folurit.

- Le të flasim gojë e liga, mos i dëgjo.

Pasi kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, lexojnë kuptimet e figurshme të fjalëve.

- Ushtrimet 3, 4, 5, 6, 7 i plotësojnë në libër, jepet fusha leksikore, gjejnë fjalët dhe fushën leksikore.

- Kontrollonhet puna e tyre, vetë nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi: Vlerësim në situatën e të nxënës. Vlerësimi me gojë në veprimtari në situatë. Vlerësim me shkrim në zgjidhjet e ushtrimeve në libër.

Detyrat dhe puna e pavarur: Grupi 1: Ushtrimi 8 (sipas kërkesës).

Grupi 2: Me fushën leksikore: *dallgë, det, natë, rërë, baticë, plazh, anije, traget, pulëbardhë*, krijo një tekst dhe vendosi një titull.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Familja e fjalëve Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Leksikologji)		Situata e të nxënës: Paraqiten në tabelë fjalët <i>besë dhe dorë</i> . Nxënësit, të ndarë në dy grupe do të formojnë fjalë të prejardhura prej tyre. Më poshtë jepet skema e familjes së fjalës <i>dorë</i> . dorëzo ↑ mosdorëzim ← <i>dorë</i> → dorëzim ↓ dorezë Nxënësit dallojnë që në grupet e fjalëve, ka një fjalë të përbashkët, prandaj ato i quajmë <i>familje fjalësh</i>.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon fjalët që kanë një rrënjë të përbashkët; - formulon përkufizimin “familje fjalësh”; - formon një familje fjalësh; - pasuron fjalorin aktiv.	Fjalët kyçe: familje fjalësh me rrënjë me parashtesë, me prapashtesë të njëjtë.
Burimet: teksti i nxënësit, FVK, njohuritë e nxënësve libri “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grup. Punë e pavarur. Tabela e koncepteve.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Prezantohen familjet e fjalëve; <i>besë</i> dhe <i>dorë</i> . Sqarohen nxënësit për mënyrën e degëzuar të paraqitjes së një familjeje fjalësh (si modeli të situata e të nxënit). Duke patur parasysh nivelin e njohurive, bazuar në moshën e nxënësve, familjet e fjalëve paraqiten edhe të varguara. Ndërtimi i njohurive të reja. Udhëzohen nxënësit të hapin tekstin në fq. 177 dhe të shohin familjen e fjalës <i>letër</i> dhe <i>shkrim</i> . Nxënësit formulojnë përkufizimin “familje fjalësh”. Plotësohet tabela e koncepteve. Familja e fjalës punë : <i>puno-punuar-punuar-i punuar-i papunuar-i papërpunuar</i> ; punim–ripunim përpunim–ripërpunim, <i>punëtor</i> , <i>punëtori(a)</i> , <i>punishte</i> , <i>punesë</i> , <i>punëdhënës</i> , <i>punëmbarruar</i> etj. Familja e fjalës fjalë : <i>fjalim</i> , <i>fjalor</i> , <i>fjalosur</i> , <i>i fjalosur</i> , <i>i pafjalosur</i> , <i>fjalëformim</i> , <i>fjalëkryq</i> , <i>fjalëkotë</i> . Familja e fjalës lulë : <i>lulëz (bimë barishtore)</i> , <i>lulishte</i> , <i>lulishtar</i> , <i>lulishtari (punë që bën lulishtari)</i> <i>lulerritës</i> , <i>lulëzo</i> , <i>lulëzim</i> , <i>lulëzues</i> , <i>lulëzueshëm</i> , <i>jolulëzues</i> , <i>jolulëzueshëm</i> etj. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (Punë e pavarur. Punë në grupe) <i>Punë e pavarur</i> Ushtrimi 1. Me ndihmën e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, nxënësit do të formojnë familjen e fjalëve: <i>buzë</i> , <i>gojë</i> , <i>ballë</i> . buzë : <i>buzaç/buzel</i> (që ka një shenjë në buzë), <i>buzëdet</i> , <i>buzëqesh</i> , <i>buzëqeshur</i> , <i>i buzëqeshur</i> , <i>i pabuzëqeshur</i> , <i>buzëdjegur</i> , <i>buzëbardhë</i> etj. gojë : <i>gojos</i> (marr dikë në gojë), <i>gojosje</i> , <i>gojëmadh</i> , <i>gojëçorape</i> , <i>gojaç</i> , <i>gojarisht</i> , <i>gojas</i> (ndajfolje), <i>gojëmbël</i> , <i>gojartë</i> etj. ballë : <i>ballas</i> , <i>ballinë</i> , <i>përballë</i> , <i>përballoj</i> , <i>përballues</i> , <i>jopërballues</i> , <i>përballim</i> , <i>ballafaqim</i> , <i>ballafaqohem</i> , <i>ballëdalë</i> , <i>ballëflori</i> etj. Ushtrimi 2. Formohet familja e fjalëve: <i>mal</i> , <i>dritë</i> , <i>shkrim</i> . Nxënësit punojnë në fletore, kurse tre nxënës do të punojnë në tabelë. Ushtrimi 3. Përfshihen fjalët që nuk i përkasin familjes së fjalëve të dhëna.	

Punë në grupe.

Ushtrimi 6. Klasa ndahet në katër grupe. Secili grup do të formojë familjen e fjalëve:

Grupi 1 - *kokë*.

Grupi 2 - *varg*.

Grupi 3 - *këmbë*.

Grupi 4 - *mendim*.

Nga një përfaqësues i çdo grupi prezanton në tabelë familjen e fjalës së formuar.

Vlerësimi: Vlerësohen për saktësinë në dallimin e fjalëve, që kanë të njëjtën rrënjë; veprimet në situatë; formimin e familjeve të fjalëve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, fq. 18 (sipas kërkesës).

Diktim**Letra personale**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kështjella (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Ç’dimë për kështjellat? Situata e të nxënit 2. Fragment nga filmi “Skënderbeu” (ose fragmente nga romani)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë. Nxënësi/ja: - flet për kështjellat, duke iu referuar kështjellës së Krujës, si simbol i qëndresës sonë kombëtare; - lexon qartë, rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur fragmentin; - dallon romanin si pjesë përbërëse të tekstit rrëfimtari, ilustruar në veçori me veprën “Kështjella”; - u përgjigjet saktë pyetjeve të përmbajtjes. Ora e dytë Nxënësi/ja: - gjykon mbi rëndësinë e ruajtjes së burimit në kampin shqiptar; - ndërthur të vështruarit me të lexuarit për të dalluar strategjinë që përdorin dy kampet; - portretizon personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre; - interpreton rolin dhe funksionin e figurave letrare;		Fjalët kyçe: kështjellë, kështjellarë, Skënderbeu kalë, ujë, kamp, rrethim, pushtoj, qëndresë, trimëri.	

- përshkruan tensionin që vihet re në fragment; - analizon personazhet, duke sjellë detaje nga teksti; - dallon figurat letrare.	
Burimet: teksti, foto të ndryshme, njohuritë e nxënësve, interneti, filmi “Skënderbeu”, romani “Kështjella”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi (Historia)

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Hulumtim. Kolazh. Gjetja e titullit. Lexim shprehës. Diskutim. Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe. Tabela e figurave.

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Nxënësit janë udhëzuar qysh më parë për të hulumtuar (kërkuar) materiale në lidhje me kështjellat shqiptare, duke iu referuar kështjellës së Krujës.

Kolazh. Nxënësit vendosin në banka materialet që kanë sjellë, foto apo informacione të shkëputura.

Vendoset në qendër të tabelës imazhi i një kështjelle dhe nxënësit do të plotësojnë:

**Ndërtimi i njohurive të reja.**

Gjetja e titullit. Shkruhen në tabelë disa emra autorësh shqiptarë.

Naim Frashëri, Ismail Kadare, Marin Barleti, Fan Noli, Sabri Godo. Shtrohet pyetja:

Cili personazh i lidh këta autorë? Nxënësit mund të orientohen edhe me pyetje të tjera shtesë, nëse nuk gjejnë dot emrin e Skënderbeut. Listohen veprat e autorëve dhe vëmendja përqendrohet te romani “Kështjella”. Jeta dhe krijimtaria shkurt e autorit.

Ismail Kadare lindur në Gjirokastrë, më 1936, është një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë. Si shkrimtar shquhet kryesisht për prozë, por ka botuar edhe vëllime me poezi dhe ese. Nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar. Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe nëpër botë.

Kryesisht ka shkruar për të rritur. Për fëmijë ka botuar: “Kronikë në gur”, “Princesha Argjiro”, “Gurgdhendësit e vegjël”.

Kështjella është një roman i botuar fillimisht më 1970 në Tiranë.

Kjo vepër pasqyron rrethimin e një kështjelle shqiptare nga trupat turke në krye me kryekomandantin Tursun Pasha.

Romani fillon me vendosjen e trupave osmane përreth kështjellës. Hapësira aty shndërrohet në një kamp me plot tenda, reparte e pajisje të tjera. Ushtria, në fillim bën përpjekje që t’i bindë kështjellarët të dorëzoheshin. Mirëpo, meqë kjo përpjekje dështon, në Këshillin e saj të luftës kjo ushtri bën organizimin dhe planet që qëllimi ta arrijë me luftë. Sulmet e saj vazhdimisht hasin në rezistencë të madhe të kështjellarëve. Përveç të tjerash, ata mbrohen edhe me rrëshirë të valë të cilën ua hedhin ushtarëve turq, nga të cilët me mijëra mbesin të vrarë. Që në sulmin e parë verbohët poeti Sadedin, i cili kishte marrë përsipër ta përjetësojë në vargje ekspeditën turke. Të pasuksesshme dolën planet e shumta, bisedat e pafund të Këshillit të luftës, konsultimet e njerëzve të ditur si oficerë ushtarakë, astrologë, mjekë (Siri Selimi) e të tjerë. Nuk bëjnë punë as operacionet ndëshkimore për plaçkitjen e për djegien e fshatrave, as prerja e ujit.

Lexim shprehës. Realizohet leximi i pjesës nga dy nxënës që lexojnë bukur. Gjatë leximit nxënësit mund të shënojnë fjalët e reja apo shprehje që u bëjnë përshtypje. Shpjegimi i fjalorit dhe shprehjeve të reja.

(Kuptojmë tekstin)

Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e fragmentit.

Punohen pyetjet e ushtrimit 1.

Rikujtohen njohuritë që kanë nxënësit për *romanin*, si lloji më i gjatë i prozës.

Ora e dytë

Situata e të nxënit. Prezantohen, nëse është e mundur, disa fragmente nga filmi Skënderbeu ose fragmente të shkurtra nga romani. Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me atmosferën e luftës mes shqiptarëve dhe turqve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe.

A është e rëndësishme gjetja e burimit të ujit për Tursun Pashanë? Po/Jo? Pse? Disa argumente nga nxënësit prezantohen në tabelë.

Punë në grupe

Grupi I. Përshkruani veprimet e tensionuara të kalit. Sillni detaje nga teksti. Kush e rrëfen ngjarjen?

Grupi II. Figura e Skënderbeut dhe cilësitë e tij.

Grupi III. Dalloni 10 fjalë të prejardhura nga fragmenti.

Grupi IV. Personazhi i Tursun Pashait, kështjellarët dhe ushtarët turq si portretizohen në fragment?

Një përfaqësues nga çdo grupi argumenton përgjigjet. Nxënësit mund të plotësojnë njëri-tjetrin.

Tabela e figurave. Rikujtohet së bashku me nxënësit se çfarë është figura e krahasimit.

Krahasimi është përjasje ose përafrim mes dy imazheve. Ai vë përballë fjalët që shënojnë dukuri, sende a frymorë me fjalët që kanë ngjashmëri. Ato lidhen me lidhëzat: si, ashtu si, porsì.

Nxënësit do të dallojnë figurat letrare dhe do të tregojmë funksionin e tyre. Detyra e nisur në klasë do të vazhdohet në shtëpi.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; puna kërkimore (hulumtuese); argumentet që sjellin gjatë përgjigjeve të pyetjeve; plotësimin që u bëjnë përgjigjeve të shokëve; fjalori i përdorur; zbatimi i rregullave të mirësjelljes.

Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdohet puna e nisur në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Klasat e fjalëve Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Paraqitet në tabelë një paragraf i shkurtër dhe nxënësit do të përcaktojnë klasën e fjalëve. <i>Oh, sa bukur që paskan çelur lulet në oborrin tim të vogël! Tre dallëndyshe u rikthyen përsëri. Ato nuk e harruan asnjëherë follenë dhe strehën e vjetër.</i>	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon klasat e fjalëve; - emërton funksionet e tyre në fjali; - argumenton pse janë pjesë të ndryshueshme, sepse lakohen apo zgjedhohen.	Fjalët kyçe: klasa e fjalëve të ndryshueshme, të pandryshueshme
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, FVK	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Tabela e koncepteve. Diagrami i Venit. Punë në grupe. Punë në grupe dyshe.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Nxënësit kanë dalluar klasat e fjalëve, duke përcaktuar a kanë kategori gramatikore (lakohen, kanë gjini, numër, rasë). Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe. Diagrami i Venit. Njihen nxënësit/nxënëset me informacionin që jepet në libër, klasat e fjalëve, funksionet e tyre në fjali. Plotësohet tabela me fjali për të dhënë funksionet e emrit, mbiemrit, përemrit, numërorit, foljes, ndajfoljes. Disa nxënës/e lexojnë fjalitë dhe japin përkatësitë: pjesë ligjërata-funksion. Ndahet klasa në grupe me 5 nxënës/e dhe punojnë në libër ushtrimet 1, 2. Një grup prezanton zgjidhjen e ushtrimeve, grupet e tjera qortojnë gabimet (për pjesët e pandryshueshme dhe pjesët e ndryshueshme). Paraqitet në tabelë Diagrami i Venit për të përcaktuar dallimet dhe ngjashmëritë midis pjesëve të ndryshueshme e të pandryshueshme. 1. Fjalët e ndryshueshme ndryshojnë formë gjatë ligjërimit; kryejnë funksione të ndryshme në fjali; janë fjalë emërtuese e treguese. 1. Fjalët e pandryshueshme nuk ndryshojnë gjatë përdorimit; nuk ndryshojnë sipas trajtës, nr., rasës; janë fjalë shërbyese ose të plota. Të përbashkëtat. Ndahen në klasa në bazë të disa rregullave (sipas kuptimit, rolit). Mund të jenë fjalë të thjeshta ose jo të thjeshta. Shërbejnë për të krijuar fjali e tekste. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur. Punë në grupe dyshe. Nxënësit/et plotësojnë tabelën dhe përsëritin pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Nxënësit/et plotësojnë në libër ushtrimin 3, nënvizojnë me një vizë fjalët e ndryshueshme dhe me dy viza fjalët e pandryshueshme. Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe ushtrimin 4. Këmbejnë librin me shokun/shoqen e bankës dhe vlerësojnë njëri-tjetrin. Plotësohet FVK, fq. 20 (në varësi të kohës, mund të plotësohet në shtëpi).	
Vlerësimi: vlerësimi në punën me grupe; vlerësimi me gojë dhe me shkrim në detyrat e shtëpisë; vlerësimi me pikë i FVK.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, sipas kërkesës. Për zhvillimin e ushtrimit, fjalët mund të vendosen në një tabelë.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Bisedë letrare (2 orë) Libër rrëfimtari në prozë (tregime ose roman) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Libër i përzgjedhur në bashkëpunim me nxënësit (tekst rrëfimtari letrar, tregime ose roman).	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisi Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - prezanton jetën dhe krijimtarinë e autorit; - përmbledh shkurt përmbajtjen e librit; - prezanton personazhet, duke renditur cilësi fizike dhe morale të tyre; - zbulon temën, idenë kryesore dhe nënidetë e librit apo tregimeve; - jep argumente në lidhje me pjesët më të bukura; - veçon figura dhe shprehje frazeologjike dhe tregon rolin e tyre; - ndërhyt në strukturën e librit, duke dhënë hyrje, zhvillime dhe mbyllje sipas imagjinatës së vet; - ilustron me vizatime episode apo personazhe nga libri; - reflekton në lidhje me jetën e personazheve; - dramatizon pjesë të përzgjedhura nga libri; - shkruan një letër për autorin/autoren e librit; - vlerëson punën e realizuar nga shokët/shoqet.		Fjalët kyçe: libër, krijimtari, prozë, ngjarje, personazh, temë, ide, figura letrare, përmbajtje, vend, kohë, ndërhyrje në strukturë.	
Burimet: libër në prozë, biblioteka, interneti, fotografi, përvojat e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Këndi i autorit/autore. Prezantim. Diskutim. Pyetje-përgjigje. Tabela e personazheve. Karrigia e nxehtë. Dramatizim. Shkrim i lirë. Turi i galerisë.			

Organizimi i orës së mësimi

Librat për bisedë letrare zgjidhen në bashkëpunim me nxënësit, në fillim të çdo tremujori (periudhe) ose në fillim të vitit mësimor. Mund të shfrytëzohen autorë që janë pjesë e librit të nxënësit ose libra të tjerë, të cilat janë në përshtatje me moshën dhe brenda programit të klasës së 6.

Nxënësve u jepen qysh në fillim edhe çështjet që do të trajtojnë gjatë bisedës letrare (rezultatet e të nxënit).

Krijimi i këndit të autorit/autore

Nxënësit/et krijojnë një kënd, në një tryezë në krye të klasës, në të cilin do të vendosin foto të autorit/autore, vepra të tyre etj. Librat mund të sigurohen në bibliotekën e shkollës ose nga vetë nxënësit apo mësuesi/ja.

Krijimi i këtij këndi krijon një atmosferë sa më ftuese, në të cilën nxënësit/et do të bashkëbisedojnë lirshëm.

Biseda letrare mund të zhvillohet edhe në mjedisin e bibliotekës së shkollës apo bibliotekës së qytetit.

Pyetje-përgjigje

Klasa ndahet në dy grupe

Grupi I. Ligjëruesit (referuesit)

Grupi II. Dëgjuesit (audienca)

Grupi I. Ligjëruesit

Nxënësit e këtij grupi do të prezantojnë një ose disa nga çështjet që u janë dhënë për të trajtuar qysh më parë (rezultatet e të nxënit).

Gjatë prezantimit të pikave, nxënësit në rolin e dëgjuesit (audiençës) janë të lirë t'u drejtojnë pyetje në lidhje me materialet që ata/ato po referojnë.

Pyetjet mund të lidhen me përmbajtjen, personazhet, pjesët më të bukura, figurat letrare, idetë dhe nënidetë etj.

Karrigia e nxehtë

Përmes kësaj teknike, nxënësit vendosin veten e tyre në rolin e njërit prej personazheve më të parapëlqyera të pjesës. Përmes pyetjeve do të tregojnë se si do të vepronin ata, nëse do të ishin në situata të tilla.

Shkrim i lirë

Nxënësit mund të ndërhyjnë në strukturën e veprës duke sjellë hyrje, zhvillim të ngjarjes apo mbyllje, sipas pëlqimeve të tyre, duke ruajtur logjikën e ngjarjeve dhe stilin e veprës.

Mund të realizohet edhe shkrimi i një letre imagjinare drejtuar autorit/autore së librit, në të cilën ata të shprehin vlerësime për librin, ndjesitë që kanë përjetuar gjatë leximit të tij etj.

Dramatizim

Nxënës të ndryshëm mund të kenë përzgjedhur pjesë të shkurtra për t'i interpretuar në grupe të vogla.

Nxënësit/et mund të ndihmohen në këtë proces edhe gjatë zhvillimit të orëve të lëndës: Teatër.

Turi i galerisë

Prezantohen libërthat e krijuara nga nxënësi/et. Gjithë materialet që nxënësit kanë punuar për bisedën letrare mund të paraqiten në formën e një libërthi me kopertinë dhe ilustrime.

Nxënësit mund të realizojnë bisedën letrare edhe në formë të digjitalizuar, përmes *slide*-ve.

Vlerësimi: Vlerësohen me notë dhe vetëvlerësim (pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm).

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Klasa e emrave Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Paraqitet në tabelë një paragraf i shkurtër dhe nxënësit dallojnë se ç’tregojnë emrat e nënvizuar. <u>Mali</u> i Dajtit ndodhet në <u>Tiranë</u> . Në <u>dimër</u> , kur mbulohet nga <u>dëbora</u> e bardhë, ai është një <u>mrekulli</u> . Kur je në teleferik mund të shohësh me <u>qartësi</u> gjithë qytetin e Tiranës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon emrat kur janë të përgjithshëm, të përveçëm, kur janë konkretë, abstraktë; - përdor emrat e përveçëm, konkret, abstraktë në fjali të ndryshme.		Fjalët kyçe: emër, i përgjithshëm, konkret, abstrakt, i përveçëm	
Burimet: teksti i nxënësit, FVK, tabela, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimit. Punë në dyshe. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.


Zhvillohet situata e të nxënës. Përmes shembujve, nxënësit prezantojnë njohuritë që zotërojnë në lidhje me emrin (konkret, abstrakt, i përgjithshëm, i përveçëm, gjini, numër, rasë, trajtë, lakim).

Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe dyshe. Pema e mendimit.

Nxënësit/et lexojnë në heshtje informacionin në libër për emrat e përgjithshëm, të përveçëm, konkretë, abstraktë. Anash librit shkruajnë pyetjet për fjalët e paqarta (konkret - abstrakt).

Punojnë në grupe dyshe ushtrimin 2 (gjejnë emrat konkretë dhe abstraktë). Kontrollon punën e njëri-tjetrit. Një nxënës/e në dërrasë shkruan emrat konkretë. Çfarë i dallon ata nga njëri-tjetri? Nxënësit paraqesin mendimet e tyre.

Plotësohet *Pema e mendimit*: Emri.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit/et punojnë në libër ushtrimet 1, 3 për emrat e përgjithshëm, të përveçëm.

Në grupe dyshe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Ndalen te drejtshkrimi i emrave të përveçëm (me shkronjë të madhe, thonjëzat).

Nxënësit/et punojnë ushtrimin 4,5 në libër për emrat konkret dhe abstraktë.

Dy nxënës/e punojnë ushtrimin 6 në dërrasë, shkruajnë vetëm emrat abstraktë, shpjegojnë kuptimin e tyre duke i përdorur në fjali.

Në varësi të kohës mund të plotësohet FVK. Në rast të kundërt, jepet për t'u punuar në shtëpi (fq. 22).

Vlerësimi: Vlerësohen për punën në grup; vlerësim me gojë dhe me shkrim, në klasë e shtëpi.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një histori të shkurtër ku të përdorin emra të përveçëm e të përgjithshëm, konkretë dhe abstraktë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Identifikimi dhe zgjidhja e problemit në një tekst tregimtar. Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.		Situata e të nxënës: Nxënësit japin mendime në lidhje me sinqeritetin dhe gënjeshtërinë.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: – zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij në lidhje me aftësitë dhe interesat e tij për të dëgjuarit; – dëgjon me vëmendje dhe shpreh interes dhe kuptimësi rreth asaj që ka dëgjuar mbi rrëfimet e dëgjua; – identifikon problemin e ngritur në një tekst; – propozon rrugëzgjdhje për zgjidhjen e problemit; – nxjerr në pah aspekte apo situata që i kanë mbetur në mend gjatë dëgjimit; – bashkëpunon në grup gjatë dëgjimit dhe pas dëgjimit të situatave të caktuara dhe rrëfimeve personale të nxënësve të tjerë; – reflekton rreth situatave të cilave kërkojnë identifikim problem dhe rrugëzgjdhje.	Fjalët kyçe: dëgjim, problem, identifikim, tekst, sinqeritet, gënjeshtër, bashkëpunim, miqësi
Burimet: histori të regjistruara, teksti mësimor, mjete digjitale diktofon, magnetofon etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. DLTA-dëgjim i drejtuar, i ndërprerë dhe i shoqëruar me anë të pyetjeve. Punë e pavarur. Rrjeti i diskutimit.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. U kërkohet nxënësve për pak minuta të diskutojnë rreth temës “Sinqeriteti dhe gënjeshtër”. Nxënësit/et japin mendime, raste, shkaqe, pasoja përfundime. Tregojnë episode vetjake. Ndërtimi i njohurive të reja. U kërkohet nxënësve të tregojnë vëmendje maksimale në të dëgjuar. Lexohet një fragment nga tregimi me titull “Sekreti”. Nxënësit për pjesën që dëgjojnë duhet t’u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme: Ndalesa e parë. Pyetje <i>Cila është çështje apo tema e tregimit?</i> <i>Pse e mendoni kështu?</i> <i>Cilat janë ato fjalë që ju çojnë drejt kësaj gjetjeje?</i> <i>Mendoni edhe ju se miqësia është gjëja më e rëndësishme në botë?</i> <i>Mendoni se bashkëpunimi mes dy djemve e forcon miqësinë?</i> <i>Do ta donit dhe ju këtë lloj bashkëpunimi?</i> Lexohet nga mësuesi/ja ose jepet e regjistruar fragmenti i dytë i tregimit. Mësuesi/ja kërkon përsëri kuptimin e nxënësve nga të dëgjuarit të pjesës që ata kanë dëgjuar.	

Ndalesa e dytë.

Pyetje:

*Cila është biseda që bën nëna me djalin e saj?**Cilat janë pyetjet që nëna i bën djalit të saj?**Ju pëlqejnë përgjigjet e djalit?**Ju pëlqen komunikimi mes nënës dhe djalit? Pse?***Ndalesa e tretë.**

Kalohet në dëgjimin e fragmentit të tretë të tregimit.

Nxënësit/et dëgjojnë me vëmendje maksimale.

Pas dëgjimit, mësuesi/ja shpalos grupi e tretë të pyetjeve.

Pyetje:

*Çfarë bëri djali me pas?**U tregua i singertë apo jo me nënën e tij?**Cila është shprehja që përdor djali për gënjeshtren e tij?***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve të tjera të cilat janë te ushtrimit 2 të mësimit në libër.

Përgjigjuni pohimeve të mëposhtme:

Problemi kryesor në këtë tregim është:

miqësia • loja • sinqeriteti • mësime.

Djali e gënjen nënën e tij, sepse:

• kërkon të luajë • bën veprime të fshehta • nuk është i singertë.

Punë e pavarur.

Plotësoni skedën. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të plotësojnë skedën sipas kërkesave që ajo ka, gjejnë problemin dhe argumentin.

Si e vlerësoni miqësinë e djalit me shokun e tij? Çfarë cilësish vihen gjatë komunikimit të djalit me nënën e tij? E vlerësoni si të drejtë shqetësimin e nënës? Argumentoni. Gjatë komunikimit me prindërit sa jeni të singertë dhe sa të gënjeni?	Problemi	Argumenti
---	----------	-----------

Rrjeti i diskutimit.Gjykojnë mbi situatën: Pasi keni dëgjuar dialogun midis djalit dhe nënës, gjykoni kush ka të drejtë: *djali apo nëna? Pse?*Tregojnë raste të ngjashme me të djalit dhe reflektojnë. *Si e keni zgjidhur problemin?*

Diskutoni rreth shprehjes “Kur ke një shok të mirë, jeta të bëhet më e bukur dhe më e lehtë.”

Propozojnë zgjidhje për situatën duke plotësuar edhe skedën.

Plotësohet tabela.

Problemi	<i>Zgjidhja që i jep djali..</i>
Miqësia	
Loja	
Marrëdhëniet	
Gënjeshtra	
Detyrimet	

Vlerësimi i orës. Vlerësimi i këtij mësimit do të mbështetet në vlerësimet që do të japin nxënësit/et për njëri-tjetrin për mënyrën se sa të vëmendshëm u treguan, për mënyrën se si rrëfyer tregimet e tyre, për fjalorin që përdorën, intonacionin tonin etj. Mësuesi/ja bën edhe një përmbledhje vlerësimi për tërë orën e mësimit dhe për nxënës/e të veçantë/a.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Rasat dhe trajta e emrit Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Paraqitet në tabelë një paragraf dhe nxënësit. Dallojnë emrat dhe përcaktojnë rasat dhe trajtën e secilit prej tyre. Listohen pyetjet për çdo rasë: <i>Kush? I/e kujt? Kujt? Kë? Prej kujt?</i> <i>Djali</i> u nis që të takonte nënën. (pyetja...) Qetësia <i>e shokut</i> iu duk e çuditshme. (pyetja...) Një <i>shoku</i> mund t’i besosh gjithçka. (pyetja...) Takova një <i>mësues</i> . (pyetja...) Prej <i>babait</i> mësova shumë gjëra. (pyetja...) Sqarohen nxënësit se përemri pyetës <i>kush?</i> përdoret vetëm për njerëzit dhe kafshët e personifikuara, kurse <i>cili?/cila?</i> etj., për sende, objekte, dukuri.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon emrat në pesë rasa, në trajtën e shquar, të pashquar në ushtrimet e dhëna në libër; - dallon mbaresat e secilës rasë; - lakon saktë emrat në dy trajtat; - jep kuptimin e termave të reja; rasa, trajta e emrave; - dallon funksionet e emrit në rasa të ndryshme; - ndërton fjali, në të cilat emri është në rasën dhe trajtën e kërkuar.		Fjalët kyçe: pesë rasat, lakimi, mbaresat, pyetjet, trajta	
Burimet: Teksti, FVK, tabela, njohuritë e nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grupe. Punë në dyshe. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimi.

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e detyrave që janë dhënë për t'u punuar në shtëpi (detyra krijuese dhe FVK).

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Nxënësit dallojnë rasën dhe trajtën e emrave në disa fjali që do t'u paraqiten në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Nxënësit/et rikujtojnë ç'kanë mësuar për rasat dhe lakimin e emrave. Lexojnë në libër përkufizimet për rasat dhe lakimin, i përsëritin në grupe dyshe pastaj i thonë para klasës duke i shoqëruar me shembuj me emra në tri lakimet. U jepet edhe lakimi i katërt, emrat e gjinisë asnjansë.

Lakimi i katërt.

Trajta e pashquar Trajta e shquar

E. të folur të folur-it

Gj. i.. të folur-i i.. të folur-it

Dh. të folur-i të folur-it

K. të folur të folur-it

Rrj. të folur-i të folur-it

Nxënësit/et lexojnë në libër, kur emri është në trajtën e shquar, punojnë me tabelat e lakimit të emrave *motër*, *aeroplan*.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit/et punojnë ushtrimet 1 dhe 2 në grupe dyshe, me gojë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Klasa diskuton në përgjithësi për emrat: *nëna*, *libri*. Në ç'rasa janë përdorur?

Ushtrimet 3 dhe 4, nxënësit/et i punojnë në libër të ndarë në dy grupe, (çdo grup një ushtrim). Këmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, pastaj i diskutojnë me gjithë klasën, qortojnë gabimet.

Vlerësimi: Vlerësohen në punën në grup; vlerësimi me gojë dhe me shkrim në klasë e shtëpi.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, fq. 187 (sipas kërkesës).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Gjinia dhe numri i emrit Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Plotësojmë së bashku <i>Pemën e mendimit</i> . <pre>graph TD; Emri((Emri)) --> numër((numër)); Emri --> rasë((rasë)); Emri --> gjini((gjini)); Emri --> lakim((lakim)); Emri --> trajtë((trajtë));</pre> Nxënësit/et plotësojnë <i>Pemën e mendimit</i> në fletore, përsëritin kategoritë gramatikore të emrave dhe japin shembuj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - plotëson <i>Pemën e mendimit</i> me veçoritë gramatikore të emrit; - dallon tri gjinitë e emrit: mashkullore, femërore, asnjënjëse; - tregon si formohet numri shumës i emrave; - analizon emrat sipas: gjinisë, numrit, rasës.	Fjalët kyçe: gjini mashkullore, femërore, asnjënjëse, numri njëjës, shumës
Burimet: Teksti, FVK, tabela, njohuritë e nxënësve	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimit. Lexim i kombinuar me shpjegimin. Punë në grupe dyshe. Punë në grupe	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e detyrave që janë dhënë për t'u punuar në shtëpi. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Realizohet situata e të nxënit. Vëmendja e nxënësve do të përqendrohet te gjinia dhe numri i emrit. Paraqiten fjalitë në tabelë. Librat ishin radhitur bukur. <i>Ngjyrat e kapakëve të tyre të tërhiqnin vëmendjen. Dukej se në çdo histori që ata mbanin brenda kumbonin të qeshurat e fëmijëve. Ata ishin miqtë më të mirë të djalit.</i> Udhëzohen nxënësit që të dallojnë gjininë dhe numrin e emrave të nënvizuar. Shembull: librat (libri), gjinia mashkullore, numri shumës. Ndërtimi i njohurive të reja. - Prezantohet tema e re dhe nxënësit lexojnë në libër njohuritë për gjininë e emrit, duke u ndalur te gjinia asnjënjëse që e mësojnë për herë të parë (të ecurit, të folurit, të ftohtët etj.). Gjininë e emrave e dallojmë nga mbaresat, por dallojmë edhe gjininë natyrore që dallohet edhe nga mbaresa, por edhe nga rrënjë të ndryshme. gjysh – gjyshe plak – plakë dajë – teze gjel – pulë nip – mbesë etj. - Nxënësit/et lexojnë në libër kur emri është në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Dallojnë se si formohet shumësi i emrave: 1. me anë të mbaresave -ë, -a, -e etj.: (një mal) - (ca) male, (një)dijetar - (ca) dijetarë 2. me ndërrim tingulli /g/ në /gj/, /k/ në /q/: (një) zog - (ca) zogj, (një) mik - (ca) miq 3. njësoj si njëjësi: (një) fletore - (ca) fletore, (një) nxënës - (ca) nxënës 4. me ndërrim tingulli dhe mbaresë njëkohësisht: (një) breg - (ca) brigje, (një) shteg - (ca) shtigje. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe dyshe Në grupe dyshe, nxënësit/et punojnë në libër ushtrimet 1, 2, 4. Këmbejnë fletoret dhe qortojnë gabimet e njëri-tjetrit. Drejtojnë pyetje për rastet e veçanta. Punë në grupe. Klasa ndahet në tri grupe. Grupi I punon ushtrimin 3. Grupi II punon ushtrimin 3 (tri fjalitë e para). Grupi III punon ushtrimin 3 (tri fjalitë e fundit). Tre nxënës do të punojnë në tabelë. Prezantohen përgjigjet e nxënësve, ndërkohë mund të mblidhen edhe fletore për t'u vlerësuar.	
Vlerësimi: Vlerësohen për punën në grup; vlerësimi me gojë dhe me shkrim për punët në klasë e shtëpi, individualisht.	

Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një tekst të shkurtër me temë “Në prag të festave të fundvitit”, në të cilin të përdorni emra të ndryshëm. Analizoni 10 emra sipas veçorive: gjini, numër, rasë, trajtë, lakim.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Gjinia dhe numri i emrit, rasat dhe trajtat. FVK. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: <i>Lojë gjuhësore.</i> Nxënësit zhvillojnë një lojë gjuhësore në dyshe. Njëri nxënës shkruan në fletore një emër, i cili mund të jetë në numrin njëjës a shumës, trajta e shquar a e pashquar, gjinia, mashkullore, femërore a asnjansë. Shoku/shoqja e bankës e lakon këtë emër. Më pas këmbehen rolet e nxënësve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lakon saktë emra të ndryshëm; - shkruan gjininë mashkullore të emrave; - kalon në numrin shumës emrat; - grupon emrat sipas lakimeve.		Fjalët kyçe: lakim, trajtë, rasë, gjini, numër	
Burimet: teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, FVK.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Punë e pavarur. Diskutim. Lojë gjuhësore			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë në kryerjen e detyrave që janë dhënë për t’u punuar në shtëpi. Vlerësimi i nxënësve për pjesën krijuese dhe analizën e emrave. Mund të mblidhen 7-8 fletore për t’u vlerësuar. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënit, gjatë së cilës nxënësit përsëritin njohuritë në lidhje me emrin. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur në dyshe. Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur, ushtrimet 1, 2, 3, 4 fq. 23 të FVK. Pasi punojnë ushtrimet, këmbëjnë librat me shokun/shoqen e bankës dhe verifikojnë saktësinë në realizimin e kërkesave të ushtrimeve.			

Ushtrimi 1. Nxënësit do të shkruajnë gjininë mashkullore bri gjinisë femërore, sipas modelit të dhënë.

Ushtrimi 2. Nxënësit kalojnë në numrin shumës emrat e gjinisë mashkullore.

Kërkesë shtesë. Si është formuar shumësi?

(një) varg - (ca) vargje - □ me ndërrim tingulli + mbaresë

Ushtrimi 3. Nxënësit plotësojnë paragrafin me fjalët që mungojnë.

Ushtrimi 4. Lidhni me shigjetë dy pjesët e një fjale të urtë.

Nxënës të ndryshëm, pas verifikimit të saktësisë në kryerjen e ushtrimeve nga shokët/shoqet, lexojnë përgjigjet.

Ushtrimi 5. Për realizimin e këtij ushtrimi, një nxënës do të punojë në tabelë. Për të dalluar lakimin e emrave do të shfrytëzohen edhe emrat e ushtrimit 3.

Lakimi me gojë i emrave: djalë, miku, vajzë, të ushtrimit 6.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen gjatë orës; saktësinë në vlerësimin e punës së shokut/shoqes; vlerësimi në detyrën e shtëpisë, zbatimin e rregullave të mirësjelljes në klasë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Analizoni emrat e paragrafit të fundit të pjesës “Kështjella”, fq. 48 (gjini, numër, rasë, trajtë, lakim).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Njeriu që mbillte pemë Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: <i>Imagjinata e drejtuar</i> Nxënësit/et lihen për pak sekonda të vështrojnë ilustrimin në fq. 52 e më pas të lexojnë titullin e fragmentit. Duke u mbështetur në fjalët kyçe të përzgjedhura nga rrëfimi i nxit nxënësit/et të mendojnë se çfarë mund të rrëfejë autori. Nxënësit/et sjellin imagjinatën e tyre dhe përzgjidhet modeli që përputhet me fragmentin.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - parashikon zhvillimin e ngjarjes duke u nisur nga ilustrimi dhe titulli i fragmentit; - zbulon cilësitë e personazhit kryesor përmes mendimeve dhe veprimeve të tij; - dallon përdorimin e gjuhës së figurshme në ndihmë të zbërthimit të mesazhit brenda pjesës; - vlerëson teknikat e rrëfyesit për të përcjellë emocione; - realizon një krijim me temë mbrojtjen e mjedisit.		Fjalët kyçe: bari i vetmuar, mbillte lisa, plasi lufta, kërkimi i lumturisë, ndërtim, shkatërrim.	
Burimet: teksti i nxënësit/es; materiale nga interneti; materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Imagjinatë e drejtuar. Lexim shprehës. Pyetje-përgjigje. Tryeza rrethore. Punë në grupe. Ditari dypjesësh.

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet situata e të nxënës, gjatë së cilës nxënësit krijojnë një tregim të shkurtër për t'i paraprirë ngjarjes që do të lexohet.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet tema e re, autori dhe realizohet leximi shprehës i fragmentit nga romani. Gjatë leximit, nxënësit mund të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja, nëse ka, për t'u shpjeguar në fund të leximit.

Pas rileximit të fragmentit, nëpërmjet metodës *Pyetje-përgjigje*, ata punojnë ushtrimet 1-7 (për të kuptuar sa më mirë fragmentin).

1. Çfarë i bën përshtypje rrëfimitarit të bariu?

(fakti se ai mbillte shumë pemë...)

3. Si ka rrjedhur jeta e tij?

(ai ndihet tepër i vetmuar për shkak se vite më parë i ka vdekur djali i vetëm, e më pas e shoqja; kjo ka bërë që ai ta luftojë vetminë me mbjelljen e pemëve.)

7. Çfarë mësimi i dha jeta e tij autorit?

(se nëse ekziston dëshira dhe vullneti, njerëzit mund të ndërtojnë njësoj si Zoti, edhe në fusha të tjera, përveçse të shkatërronin.)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Tryeza rrethore.

Ndahet klasa në grupe.

Grupi I punon ushtrimin 2.

Grupi II punon ushtrimin 3.

Grupi III punon ushtrimin 4.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para klasës.

Përgjigjet e tyre

Ushtrimi: 3 Ngjarjen e rrëfen vetë autori. Prania e tij ndihet mjaft në këtë fragment.

p.sh. një element i dukshëm i tij është përdorimi i vetës së parë.

...vura re së në vend të bastunit mbante një shtizë hekuri...

...Besoj se pyetjet e mia këmbëngulëse...

...Në atë çast u interesova për moshën e atij burri.

...Meqenëse dhe unë, pavarësisht moshës së re... etj.

Disa nga frazat dhe fjalët që emërtojnë vend dhe kohe janë: *në vendin e duhur zuri të ngulte në tokë, pas kohës së mesditës, tre vjet, atë çast, tani, një ditë, një vit... etj.*

Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti që të bëjnë të mendosh për kohën që ka ndodhur ngjarja.

Ushtrimi 4: Mund të punohet në formën e një *Ditari dypjesësh*.

Cilësitë e bariut	Mendimet e tij	Veprimet e tij
punëtor i përkushtuar	E dinte se e kujt ishte? Nuk dinte gjë. Aq i bënte për pronarët.	Burri vijonte të mbillte njëqind lëndët me një kujdes të veçantë.
optimist për jetën	Kishte ndryshuar zanat. Më tha që s'kishte menduar fare për luftën.	Kishte vijuar të mbillte pemë, pa u merakosur për asgjë.

Ushtrimi 5.

Ato i përkasin klasës së emrave kryesisht, por dhe ndajfoljeve.

Ushtrimi 6. **Tryeza rrethore**

“Megjithatë, bëra një gabim. Moshë ime e re më shtynte ta përfytyroja të ardhmen vetëm për veten dhe kërkimin e lumturisë sime.”

“...njerëzit mund të ndërtonin njësoj si Zoti, edhe në fusha të tjera, përveçse të shkatërronin”.

Për këtë përdoret *Tryeza rrethore*, përmes së cilës letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës/e te tjetri.

Çdo nxënës/e pasi e shkruan idenë e tij, e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë.

Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një tregim të shkurtër, i cili përcjell mesazhin: “Ndryshimi fillon nga ne”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mjedisi rreth nesh Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënët: Nxënësit plotësojnë <i>Pemën e mendimit</i> në lidhje me konceptin e fjalës “mjedis”.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - realizon një <i>Pemë mendimi</i> në lidhje me konceptin e fjalës “mjedis”; - bashkëpunon në grupe për të evidentuar shkaktarët e ndotjes së: ajrit, ujit, tokës; - jep alternativa në ndihmë të mbrojtjes së mjedisit; - shkruan mesazhe në ndihmë të mbrojtjes së mjedisit; - interpreton poezi që lidhen me mjedisin.		Fjalët kyçe: mjedis, mbrojtje, pasurim, dëmtim, shkatërrim, shpërdorim, ndotje, riciklim.	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, interneti, tabakë letre, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca (Biologji, Dituri natyre)	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimit. Punë në grupe. Interpretim. Prezantim			

Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënit, gjatë së cilës nxënësit japin përkufizime të ndryshme për mjedisin, duke iu referuar njohurive të marra në lëndët shkencore. Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe Klasa ndahet në tri grupe. Secili nga grupet plotëson në lidhje me shkaktarët kryesorë të ndotjes mjedisore. Grupi I. Ndotja e ajrit Grupi II. Ndotja e ujit Grupi III. Ndotja e tokës Nxënësit punojnë në grupe dhe më pas dëgjohen përgjigjet e tyre. Nxënësit mund të plotësojnë njëri-tjetrin me dakortësi. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Si do të ndihmojmë për të shpëtuar mjedisin? Punë në grupe. Nxënësit do të paraqesin mendimet e tyre në lidhje me to. Klasa ndahet në tri grupe. Secili grup paraqet mendimet, duke i shkruar në tabakë letre ose në fletë formati. Grupi I. Mbjellja e pemëve dhe kujdesi për gjelbërimin. Grupi II. Kursimi i ujit dhe energjisë elektrike. Grupi III. Riciklimi i letrës dhe plastikës. Secili grup shkruan edhe mesazhe në lidhje me temat e zgjedhura. Prezantohet puna nga një përfaqësues i çdo grupi. Në fund të orës recitohen vargje për mjedisin.
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; përkufizimet për mjedisin; gjetjen e shkaktarëve për ndotjen mjedisore; gjetja e rrugëve për shpëtimin e mjedisit; fjalori i përdorur; bashkëpunimi në grupe.
Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kur të vijnë mendtë Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: <i>Imagjinata e drejtuar</i> Nxënësit/et lihen për pak çaste që mbi bazën e disa fjalëve të dhëna në tabelë të ndërtojnë një ngjarje të cilën më vonë ta tregojnë para shokëve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - parashikon zhvillimin e ngjarjes duke u bazuar në disa fjalë kyçe; - rendit veprimet e djemve; - shkruan pikat e planit të pjesës; - shpjegon kuptimin e shprehjeve; - përcakton elementet e strukturës së tekstit; - lidh titullin e pjesës me proverba popullore.	Fjalët kyçe: pushim, dy shokë, grindje, këshillë, pendim.
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Imagjinatë e drejtuar. Pyetje-përgjigje. Punë në grupe. Ditari dypjesësh. Diskutim. Rrjeti i diskutimit (Pyetja binare)	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënës. Lexohen 4-5 tregime të krijuara nga nxënësit/et. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet pjesa e re dhe autori i saj Sokol Jakova. Sokol Jakova lindi në <u>Tiranë</u> më <u>18 qershor 1948</u>; është shkrimtar dhe kritik letrar shqiptar. Sokoli i përket një familjeje intelektuale shqiptare të shquar që merrej me artin dhe letërsinë. Babai i tij është shkrimtari dhe dramaturgu i njohur, <u>Kolë Jakova</u>. Sokoli u arsimua në <u>Tiranë</u>. Pas përfundimit të shkollës së mesme, ndoqi studimet në Universitetin e <u>Tiranës</u>, në fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe. U diplomua në vitin <u>1970</u>. Në vitin <u>1971</u> nisi punë në redaksinë e letërsisë për fëmijë në shtëpinë botuese “<u>Naim Frashëri</u>”, ku punoi për katër vjet. Kësaj periudhe i përkojnë disa nga librat e tij të parë si përmbledhjet me tregime “<u>Shoqet</u>”, “<u>Zari me një vesh</u>”, “<u>Një ngjarje te Kroi i Nuses</u>”, “<u>Nëna e partizanëve</u>”. Në tërësi, me gjithë ribotimet, autorit Sokol Jakova i numërohen rreth 30 libra për disa prej të cilëve është vlerësuar me çmime në konkurse të ndryshme kombëtare. Romani i tij “<u>Ndodhitë e çuditshme të Mirash Guximtarit</u>” është vlerësuar me çmimin “<u>Mark Tuen</u>” dhënë nga “<u>Qendra Amerikane e Kulturës</u>” në bashkëpunim me Shoqatën Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë. Sokoli vazhdon të bashkëpunojë me shtypin letrar, veçanërisht me revistën “<u>Krahu i shqiponjës</u>” dhe gazetat “<u>Drita</u>” e “<u>Ndryshe</u>”. Realizohet një lexim shprehës i fragmentit. Pas leximit të pjesës shpjegohen fjalët e fjalorit dhe nxënësit krijojnë fjalë të reja me to. Pas rileximit të fragmentit “<u>Kur të vijnë mendtë</u>”, nxënësit/et nëpërmjet metodës <i>Pyetje-përgjigje</i> u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 1, të cilat në mënyrë të përmbledhur do të grupoheshin: 1- <i>Djemtë po kalonin pushimet pranë detit të kaltër të Himarës.</i> 2- <i>Djemtë ngriheshin herët në mëngjes, merrnin grepat, fildispanjën, kallamarin, e mekojtsen e freskët e të kriposur dhe nxitonin për të moli në veri të qytetit të vogël.</i> 3- <i>Gjuetia nisi t’ju ecte mbarë.</i> 4- <i>Dritani kapi një peshk me ngjyra.</i> 5- <i>Atë ditë fëmijëve u ndodhi diçka e jashtëzakonshme. Njëri nga peshqit hëngri njërin nga peshqit e tjerë më të vegjël.</i> 6- <i>Djemve ju ngatërruan grepat me njëri-tjetrin dhe papritmas filluan të grinden duke harruar se janë shokë të ngushtë.</i> 7- <i>Një peshkatar që peshkonte aty afër iu tërhoqi vërejtje djemve dhe i këshilloi mbi mënyrën e të sjellit.</i> 8- <i>Djemtë e kuptuan gabimin, por kjo u kushtoi dhe ikjen e peshkut, dhe këputjen e grepave, prandaj këtu zë vend shprehja e popullit “Kur të vijnë mendtë, nuk t’i hanë as qentë”.</i> Mësuesi/ja gjatë diskutimit të ushtrimeve cakton dy nxënës/e që të tregohen të kujdesshëm dhe të plotësojnë me shenjat përkatëse, e vërtetë (V) dhe e gabuar (G) pohimet e dhëna në ushtrimin 2.	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**Punë në grupe.**

Nxënësit/et ndahen në grupe.

Grupi I punon ushtrimin 3.

Grupi II punon ushtrimin 4.

Grupi III punon ushtrimin 5.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet e tyre. Mësuesi/ja në fund bën një përmbledhje përfundimtare të nxënësve.

Ushtrimi 3

Djemtë	Veprimet para peshkimit	Veprimet gjatë peshkimit	Veprimet pas peshkimit
Dritani	Ngriheshin herët në mëngjes... ...zunë vendin që zinin gjithmonë	Sa e hidhte grepin njëri... ...kapi një peshk me ngjyra ...e tërhoqi grepin me nxitim Posi, e gjete! (kundërshtonte shokun) Nisën të shahen dhe të hakërrohen	tërhoqi fildispanjën uli kokën i turpërua u pendua
Albani	Ngriheshin herët në mëngjes... ...zunë vendin që zinin gjithmonë	...kapi një peshk si lëmsh, që e kishte kokën më të madhe se trupin. -Jo, jo! Imi, jo yti!	tërhoqi fildispanjën uli kokën i turpëruar u pendua

Ushtrimi 4

Plotësimi i fjalive në mënyrë të tillë që të shërbejnë si pika plani.

Albani dhe Dritani ulën kokën të turpëruar

Gjuetia

Vështirësitë

Gabimi

Ushtrimi 5

Shpjegimi kuptimor i shprehjeve.

I kishte lënë më gisht në gojë => I kishte çuditur.

Hapi sytë mirë => vështro me kujdes.

Po bëni si gjela të egër => jeni të acaruar.

Kur të vijnë mendtë nuk t'i hanë as qentë => tashmë gabimi është kuptuar, por është shumë vonë.

Rikujtohet koncepti i strukturës së një teksti letrar.

Hyrja

Zhvillimi

Mbyllja

} Nxënësit përcaktojnë elementet e strukturës së tregimit.

Rrjeti i diskutimit (Pyetja binare)

Nxënësit/et drejtohen drejt diskutimit pro dhe kundër çështjes (ushtrimi 6).

Sipas mendimit tuaj titulli i këtij tregimi a ka lidhje me ndonjërin nga proverbat e mëposhtme? Po/Jo.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra në faqen 58. Nxënësit do të formojnë familjen e fjalës dhe fushën leksikore të fjalës *peshk*.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë tregime në mënyra të ndryshme Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Nxënësit bashkëbisedojnë në grupe dyshe në lidhje me tregimet që kanë lexuar së fundmi.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor formën ose modelin e shkrimit të tregimeve dhe mbështetur edhe në udhëzimet e dhëna për mënyrën e të shkruarit të tregimeve në mënyra të ndryshme realizon modelin e shkrimit; - zbaton rregullat e strukturës dhe paraqitjes gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur një përmbajtje të kuptueshme të një tregimi nisur nga fillestar; - strukturon tregimin sipas fazave sipas një mënyre të caktuar; - shkruan, përfundon apo plotëson hyrje dhe mbyllje të bukura.		Fjalët kyçe: tregim, hyrje, mbyllje, zhvillim	
Burimet: teksti mësimor, libra jashtëshkollorë me tregime, video filmash, fletë vetëvlerësuese.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Shkrim i lirë. Punë në grupe. Punë e pavarur. Bashkëbisedim në grupe dyshe. Diagrami i Venit.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe</i> Nxënësit tregojnë ose lexojnë tregime në mënyra të ndryshme duke u nisur nga ato që kanë lexuar, me dialog, të shoqëruar me figura etj. Ndërtimi i njohurive të reja. Lexojnë në grup tregime të ndryshme, flasin për to për hyrjen, problemin, mbylljen etj. Nxënësit/et vëzhgojnë dhe diskutojnë rreth tregimit me figura dhe me fumet që ka libri në faqen 59. U kërkohet nxënësve të vëzhgojnë tregimin e faqes 59 dhe më pas të tregojnë variantin e tyre të tregimit. Diagrami i Venit Nxënësit bëjnë dallimin mes tregimit të shkruar me fumentë dhe atij të shkruar me shkrim dore me anën e teknikës <i>diagrami i Venit</i> . Diskutojnë, nxjerrin në pah ndryshimet etj. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Shkrim i lirë. Zgjedhin variantin dhe mënyrën se si do ta shkruajnë tregimin. Nxënësi/ja shkruan variantin e vet të tregimit për disa minuta. Lexohen, komentohen dhe vlerësohen tregimet e shkruara. Një juri vlerëson tregimin më të mirë.			

Vlerësimi: Vlerësojnë punët e njëri-tjetrit duke nxjerrë në pah anët pozitive dhe negative. Bëjnë komente, konkurs, shpallin fituesin (fletë vetëvlerësuese, me kritere vlerësimi).
Detyrat dhe puna e pavarur:

Modeli i një flete vetëvlerësuese për kompetencën: *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale*

Tema e detyrës _____

Emri i nxënësit: _____ **Klasa:** _____

Kriteret	Nuk i plotëson	I plotëson pjesërisht	I plotëson
Punimi i është përmbajtur temës dhe ka qartësi mendimi.			
Janë respektuar elementet e strukturës: hyrje, zhvillim, mbyllje. Janë përdorur paragrafë.			
Fjalori është i zgjedhur, me figura letrare të thjeshta dhe llojshmëri fjalish nga ana kuptimore.			
Fjalitë janë të sakta, të qarta nga pikëpamja gramatikore. Janë përdorur drejt shenjat e pikësimit.			
Detyra është prezantuar qartë, bukur dhe është shoqëruar me ilustrim.			

Vlerësoi detyrën: _____

Vlerësimi:
Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbiemri Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Shkruhet një gjëegjëzë në vargje. Kam për rrënjë, rrënjën tënde. Veç kam parashtesën “mbi”. Linda prej nevojës sate. Për të të dhënë më qartësi. Vetitë i kam të gjithfarshme. I shpreh shpesh edhe në shkallë. Ja tek jam “i mirë”, “i bukur”. A ma gjeni emrin vallë? (Mbiemri) Cilat janë vetitë e gjithfarshme të mbiemrit? (gjini, numër, rasë, shkallë)	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon mbiemrat kur janë të nyjshëm e të panyjshëm; - i përdor në fjali mbiemrat në shkallën pohore, krahasore, sipërore.	Fjalët kyçe: mbiemri, shkalla pohore, krahasore, sipërore	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, tabela.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Zgjidhja e gjëegjëzës. DDM. Punë në grupe dyshe. Punë në grupe. Diskutim		
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Nxënësit/et rikujtojnë çfarë mësuan për mbiemrin. Lexojnë në heshtje informacionin e dhënë në libër për mbiemrin. Plotësojnë tabelën:		
Di	Dua të di	Mësoj
I nyjshëm	Si përshtatet mbiemri me emrin?	Mbiemri përdoret në tri shkallë: pohore, krahasore, sipërore
I panyjshëm		
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit diskutojnë plotësimin e tabelës dhe sistemojnë njohuritë për mbiemrin: i nyjshëm, i panyjshëm (shembuj); përshtatet me emrin në gjini, numër, rasë (shembuj); përdorimi i mbiemrit në tri shkallë: pohore (shembuj), krahasore (shembuj), sipërore (shembuj).		
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Në grupe dyshe punojnë ushtrimin 1. Gjejnë mbiemrat dhe dallojnë mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm. Diskutojnë me njëri-tjetrin. <i>Emrat:</i> plani, piraten, mish, vendin, e grackës, shtëpinë, e Alteas, krahun, korridor, muri, hyrjen, dalja, Dori, rrjetë, pritje. Mbiemrat: i përsosur, të freskët, e majtë, të ngushtë, rrethues, të lirë, të hollë, të padukshme.		
Punë në grupe. Grupi I punon ushtrimin 2. Grupi II punon ushtrimin 3. e madhe - shk. pohore; e fshehur - shk. pohore; kristalore - shk. pohore; e shkretë - shk. pohore; të gjera - shk. pohore; shumë të shpërndara - shk. sipërore; të pafund - shk. pohore; të pashqetësuar - shk. pohore; përralore - shk. sipërore (këtu duhen sqaruar nxënësit që kuptimin e sipërisë, në këtë rast e mbart vetë kuptimi leksikor i fjalës)		
Grupi III punon ushtrimin 4. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe një përfaqësues i një grupi prezanton përgjigjet.		
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit në punën në grupe dyshe; vlerësim me gojë e me shkrim për punën e realizuar në klasë.		
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, fq. 191.		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përshtatja e mbiemrit me emrin Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Zëvendëso shprehjet frazeologjike me një mbiemër: Mish e thua - i bashkuar , i lidhur fort. Kockë e lëkurë - i dobët . I bie maces me lugë - shumë i vogël . S'ka ku ta zërë qeni - i varfër . Si mos më keq - shumë i dëmtuar . S'ia ha qeni shkopin - i zoti, trim . Nxënësit/et i përdorin shprehjet e dhëna në fjali dhe i zëvendësojnë ato me mbiemrin përkatës. Disa nxënës/e lexojnë fjalitë e krijuara dhe japin kuptimin e frazeologjive.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor drejt mbiemrat si përcaktorë të emrave; - i përshtat mbiemrat në gjininë, numrin, rasën e emrave; - analizon veçoritë gramatikore të mbiemrave, referuar emrave që përcaktojnë.		Fjalët kyçe: përshtatje, emër, mbiemër, gjini, numër, rasë	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Puna në grupe dyshe. Diskutim. Punë individuale.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënit, gjatë së cilës nxënësit/et zëvendësojnë shprehjet frazeologjike me kuptimin e një mbiemri. Ndërtimi i njohurive të reja. Nxënësit/et rikujtojnë njohuritë e marra për mbiemrin, si përshtatet ai me emrin që përcakton. Hapet teksti në fq. 192. Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë dhe diskutojnë në lidhje me përshtatjen e mbiemrit me emrin dhe se si e formojnë gjininë dhe numrin mbiemrat: - duke ndërruar nyjën - i mirë, e mirë, të mirë; - duke marrë mbaresë - i kuq, e kuqe, të kuq; - del në të njëjtën formë - duarartë, zemërbardhë etj.			

Sqarohen nxënësit që mbiemrat e nyjshëm përshtaten me emrin në: gjini, numër dhe rasë, kurse mbiemrat e panyjshëm, vetëm në gjini dhe numër.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit punojnë ushtrimet 1, 4, 5, 6 në grupe dyshe, këmbëjnë punët e tyre, qortojnë gabimet. Punohen ushtrimet me radhë me të gjithë klasën, evidentohen gabimet dhe vështirësia për të dalluar gjininë dhe numrin e mbiemrave.

Ushtrimet 2 dhe 3 i punojnë dy nxënës/e në dërrasë duke dhënë përgjigjet e tyre. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve.

Ushtrimi 3 mund të punohet me tabelë.

Mbiemri	Gjinia	Numri	Rasa
të lashta	femërore	shumës	kallëzore
e lashtë	femërore	shumës	emërore
të madh	mashkullore	njëjës	kallëzore
të zotët	mashkullore	shumës	emërore
të madhe	femërore	njëjës	kallëzore

Vlerësimi: Vlerësohen për punën në dyshe; vlerësim me gojë; me shkrim, në detyrat e klasës dhe detyrat e shtëpisë (individualisht).

Detyrat dhe puna e pavarur: Grupi I punon ushtrimin 7 (sipas kërkesës).

Grupi II: Gjej 5 fjalë të urta që të kenë kuptimin e një mbiemri, p.sh.: “Besa e shqiptarit, si purteka e arit” (e shenjtë).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ushtrime për mbiemrin. FVK Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Lojë gjuhësore. Nxënësit lakojnë me gojë emra të shoqëruar me mbiemra. Vendosen në tavolinë fisha të përmbysura me grupe emërore dhe 3-4 nxënës do të tërheqin nga një fish dhe do të lakojnë grupet emërore.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lakon saktë grupet emëror; - dallon mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; - përshtat mbiemrat me emrat; - formon fjali me mbiemra në shkallë të ndryshme.		Fjalët kyçe: përshtatje, emër, mbiemër, gjini, numër, rasë, shkallë.	

Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, tabela, fisha me grupe emërore, FVK.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë gjuhësore. Pemë mendimi. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim.	
Organizimi i orës së mësimi. Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënësve. Nxënësit vlerësohen për saktësinë në lakimin e grupeve emërore. Ndërtimi i njohurive të reja. Plotësohet <i>Pema e mendimit</i>: Mbiemri. <pre> graph TD A[Mbiemri] --> B[Bën pjesë ...] A --> C[Tregon ...] A --> D[Lloji] A --> E[Veçori gramatikore] B --> B1[në klasën e fjalëve të ndryshueshme] C --> C1[cilësi dhe tipar të emrit] D --> D1[i nyjshëm] D --> D2[i panyjshëm] E --> E1[gjini numër] E --> E2[rasë] E --> E3[shkallë] </pre> Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Puno/shkëmbe në dyshe.</i> Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e FVK, fq. 26. Pas përfundimit të ushtrimeve do të këmbëjnë fletoret me shokun/shoqen e bankës, për të verifikuar saktësinë në kryerjen e ushtrimeve. Qortimet këshillohen të bëhen me laps. Nxënësit mund të mbledhin edhe pikët që ka marrë shoku/shoqja e bankës. <i>Diskutim.</i> Kalohet në diskutimin e ushtrimeve të fletores. Gjatë paraqitjes së përgjigjeve të sakta, nxënësit verifikojnë nëse shokët/shoqet kanë bërë vlerësimet e duhura. Sqarohen nxënësit për paqartësitë që mund të kenë hasur gjatë punimit të ushtrimeve. Përgjigjet e ushtrimit 6. Ai fle me sytë hapur - shumë i pavëmendshëm, tepër i hutuar... Nuk shkel në dërrasë të kalbur - tepër i kujdesshëm, mjaft i pagabueshëm, shumë i zoti... Është bërë kockë e lëkurë - shumë i dobët.	
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; punimi i detyrës së shtëpisë; saktësinë në punimin e ushtrimeve në klasë; saktësinë në qortimin e punimeve të shokëve.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Analizoni sipas gjinisë, numrit, rasës dhe shkallës mbiemrat e ushtrimit 1, të FVK.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Biri i erës. FVK Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Nxënësit rikujtojnë tiparet e tekstit rrëfimtar letrar. Plotësohet një <i>Pemë mendimi</i> . Struktura Hyrja Zhvillimi Mbyllja Teksti rrëfimtar letrar Rrëfen ngjarje reale ose imagjinare Elemente të tij: - ngjarjet vendosen në hapësirë dhe kohë - tema - mesazhi (ideja) - personazhe: kryesore, dytësore	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - liston tipare të tekstit rrëfimtar letrar; - rendit ngjarjet sipas rendit kronologjik; - analizon veprimet e personazhit kryesor, duke dhënë arsye të sjelljes së tij; - formulon mesazhin që përcjell pjesa; - i vendos fragmentit një titull të figurshëm; - realizon një mbyllje tjetër të tregimit, duke përdorur imagjinatën.		Fjalët kyçe: Biri i Erës, Luginë e Pishave, drurë të prerë, pluhur, ëndërr, realitet i trishtë, vrapim, liri.	
Burimet: FVK, njohuritë e nxënësve në lidhje me tekstin rrëfimtar letrar.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimit. Punë e pavarur. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësim**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Punë e pavarur.**

Zhvillohet situata e të nxënësve. Gjatë saj, nxënësit përsëritin njohuri në lidhje me tekstin rrëfimtar letrar, duke qenë se janë edhe para testit përmbledhës të periudhës së parë.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Udhëzohen nxënësit që të hapin FVK, në fq. 16-17, dhe të lexojnë fragmentin “Biri i Erës”. Fragmenti mund të lexohet në heshtje ose nga dy nxënës/e. Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Diskutim.

Prezantohen përgjigjet e ushtrimeve që kanë punuar nxënësit gjatë punës së pavarur.

Ushtrimi 1. Nxënësit lexojnë fjalitë sipas rendit kronologjik.

Ushtrimi 2. Tregimi është shkruar në vetën III. Tregues të vetës janë fjalitë dhe përemrat vetorë.

Ishte mëngjes me diell kur ai doli mbi malet që rrethonin Luginën e Pishave.

Ushtrimi 3.

Dëshirat e Birit të Erës. *Kishte jetuar me vite me radhë me ëndrrën e lirisë.*

Kishte ndier kaq shumë nevojë për ajrin e pastër dhe ujin e kulluar.

Realiteti i trishtë. *Liria nuk ekzistonte më..., por natyra që ndotur., pamja që i doli para syve e tmerroi..*

Ushtrimi 4.

Arsyet pse Biri i Erës nuk e njohu Luginën e Pishave:

a. *gjelbërimi që tharë;*

b. *luginë që mbushur me sheshe të zhveshura dhe stiva trungjesh;*

c. *me mijëra pemë ishin prerë;*

ç. *binte një erë tymrash dhe ngado sundonte ngjyra gri.*

Ushtrimi 5.

mbiemrat: i dëshpëruar, i vetmuar, i braktisur.

foljet: u tmerrua, i afrohej, kishte jetuar, kishte ndier, vrapoi.

Ushtrimet 6, 7, 8, 9 janë ushtrime që nxënësit i kanë plotësuar sipas gjykimeve personale. Do të pranohen të gjitha përgjigjet e mundshme që u përgjigjen kërkesave dhe kanë lidhje me përmbajtjen e tregimit.

Vlerësimi: Vetëvlerësim i nxënësve për punën e pavarur në FVK, vlerësim me notë në fletore

(paraqitet në dërrasë tabela e vlerësimit). Mblidhen fletore për t’u vlerësuar.

Pikët	0-5	6-8	9-11	12-15	16-19	20-22	23-25
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përemrat, llojet e tyre. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Çdo foljeje i shtojmë dy përemra, (para – prapa) Ju (vetor) shkoni të sigurt në rrugën tuaj. (pronor) _____ vizitova _____ _____ këndoje _____ _____ fitoi _____	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon përemrat vetorë, pronorë, dëftorë, të pacaktuar, lidhorë, pyetës, vetvetor në fjalitë e dhëna në libër; - zëvendëson në fjali përemrat që mungojnë; - dallon tiparet e përmrit vetor; - dallon trajtat e shkurtra të rasës dhanore dhe kallëzore; - plotëson fjalitë me trajta të shkurtra.		Fjalët kyçe: përemrat vetorë, dëftorë, pyetës, lidhorë, pronor, të pacaktuar	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa 6, tabelë, fisha me përemra të ndryshëm.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë e pavarur. Punë në grupe. Pema e mendimit. Diskutim. Minikonkurs.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Nxënësit/et i plotësojnë fjalitë e mësipërme në fletore dhe emërtojnë përemrat e përdorur për atë që kanë mësuar në klasën V. Nxënësit/et përsëritin përemrat që kanë mësuar në klasën e V (vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës). Ndërtimi i njohurive të reja. Pema e mendimit. Minikonkurs. Prezantohet tabela e librit me llojet e përmrave në dërrasën e zezë (me flipçart, tabak letre). Nxënësit lexojnë llojet e përmrave dhe fjalitë, në të cilat ata janë përdorur. Tabela mund të ideohet edhe si një <i>Pemë mendimi</i> xhepore. Poshtë llojeve të përmrave, ngjitet një letër e tejdukshme. Mund të përdoret edhe tabelë me spica. <i>Minikonkurs.</i> Tre nxënës tërheqin fisha me lloje përmrash dhe i vendosin poshtë përmrit të duhur. Nxënësit lexojnë llojet e përmrave dhe fjalitë në të cilat ata janë përdorur. Plotësohet <i>Pema e mendimit</i> .			
pronorë vetvetorë dëftorë Llojet e përmrave ↓ vetorë ↙ ↘ përdoret trajtë të shkurtër ↙ ↘ në veta të ndryshme dhanore kallëzore pyetës të pacaktuar lidhorë			

Vëmendja e nxënësve përqendrohet te përemri vetor dhe trajtat e shkurtra të tij, rasat dhe vendi i tyre. Jepen shembuj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Punë në grupe.

Ushtrimi 1. Nxënësit përgjigjen me gojë, për të përcaktuar llojet e përemrave.

Nxënësit ndahen në tri grupe.

Grupi I punon ushtrimin 2. Nxënësit do të dallojnë përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra.

Përemrat vetorë: *unë, ai, me (a)to*

Trajtat e shkurtra: *duke e vështruar, s'i dija, më shpjegonte, m'i ka përshkuar (trajtë e shkurtër e bashkuar), më ka folur.*

Grupi II punon ushtrimin 3.

Motra ime **më** do shumë. (rasa kallëzore)

Motra ime **më** dha një lajm të bukur. (rasa dhanore)

Ky klloun **të** argëton. (rasa kallëzore)

Kllounit **i** buzëqeshin fëmijët. (rasa dhanore)

I ka blerë Beni këta libra? (rasa kallëzore)

Atij **i** dhuruan libra. (rasa dhanore)

Librat **i** kemi miqtë tanë. (rasa kallëzore)

Sot **na** dhanë dëftesat. (rasa dhanore)

Ju **ju** ftuan në festë? (rasa kallëzore)

Juve **ju** përgatitën një festë. (rasa dhanore)

A **i** kanë biçikletat me vetë? (rasa kallëzore)

Atyre u dhuruan lodra. (rasa dhanore)

Grupi III punon ushtrimin 4. Nxënësit plotësojnë fjalitë me trajtat e shkurtra që mungojnë.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para klasës, mësuesi/ja ndërhyr nëse e shikon të nevojshme.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; saktësinë në dhënien e përgjigjeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, fq. 195. (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore. Përemrat. Përemrat vetorë. Ushtrime – FVK. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin, FVK.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon llojet e përemrave; - formon fjali me lloje të ndryshme përemrash; - lakon saktë përemrat vetorë; - dallon trajtat e shkurtra të rasës dhanore dhe kallëzore.	Fjalët kyçe: lloje përemrash, përemër vetor, trajtë e shkurtër
Burimet: FVK, njohuritë e nxënësve, tabela e lakimit të përemrave vetorë.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grupe. Diskutim. Puno në dyshe/shkëmbe.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënës të ndryshëm për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj.	
Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. <i>Puno në dyshe/ shkëmbe.</i> Udhëzohen nxënësit që të hapin FVK, në fq. 28-29. Plotësojnë në tekst ushtrimet 1 të faqeve. Këmbejnë fletoret me shokun/shoqen e bankës dhe verifikojnë saktësinë në kryerjen e ushtrimeve. Rikujtohen njohuritë për llojet e përemrave dhe përemrin vetor.	
Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi I punon ushtrimet e faqes 28 - Përemrat. Grupi II punon ushtrimet e faqes 29 - Përemrat vetorë.	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para klasës, mësuesi/ja ndërhyr nëse e shikon të nevojshme. Aktivizohen sa më shumë nxënës në dhënien e përgjigjeve.	
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; saktësinë në punimin e ushtrimeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Përsëritje për testin përmbledhës të periudhës së parë.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Testim përmbledhës për periudhën e parë... Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënit: Tekst rrëfimtar letrar Tregimi. Njohuritë e nxënësve do të testohen përmes një teksti rrëfimtar letrar.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - emërton llojin e krijimit në prozë; - dallon temën dhe mesazhin; - dallon vetën e rrëfimit të ngjarjes; - emërton figurat letrare dhe tregon funksionin e tyre; - identifikon problemin dhe zgjidhjen e tij; - përcakton personazhet kryesore dhe dytësore; - dallon theksin e fjalës dhe të fjalisë; - qorton gabimet në përdorimin e zanoreve dhe të shkronjës së madhe; - analizon përbërësit e fjalës; - përcakton klasën e fjalëve të ndryshme; - ndërton një fushë leksikore dhe një familje fjalësh; - dallon rasën e emrave; - përcakton shkallën e mbiemrit.	Fjalët kyçe: poezi, pyetje, njohuri letrare, njohuri gjuhësore, pikë, tabelë.
Burimet: poezi, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë individuale	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.	
Vlerësimi: Testet do të vlerësohen me notë, e cila do të hidhet në regjistër në kolonën: VTp.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore Dita e portofolit tim (Panair portofoli)		Situata e të nxënit: Punimet më të mira të nxënësve	
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton me shokët për punët e arkivuara në dosje; - vlerëson dhe vetëvlerëson punët në portofol/dosje.		Fjalët kyçe: portofol, vlerësim, vetëvlerësim	
Burimet: portofoli i punimeve, CD, muzikë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim. Turi i galerisë. Bashkëbisedim.			
Organizimi i orës së mësimi. Mund të vendoset muzikë e lehtë në sfond për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore. Sistemi i bankave në klasë mund të ndryshohet, në mënyrë që punimet e nxënësve në portofol të mund të shihen nga të gjithë nxënësit, si një ekspozitë punimesh. Gjatë orës mund të ftohen edhe prindërit. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Bashkëbisedim Bashkëbisedoj me nxënësit në lidhje me mënyrat e vlerësimi. Portofoli i punimeve, si një mënyrë vlerësimi për arritjet e nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit realizohet me pikë, nisur nga lloji i detyrës dhe pesha që ka ajo. Pikët konvertohen në notë, sipas një table që nxënësve u është dhënë qysh me përcaktimin e detyrave, që do të dokumentohen në portofol gjatë periudhës së parë, shtator-dhjetor. Ndërtimi i njohurive të reja. Nxënës të ndryshëm do të flasin për detyrat e realizuara gjatë periudhës së parë, kënaqësitë për realizimin e tyre dhe vështirësitë që mund të kenë hasur. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Turi i galerisë. Nxënësit do të prezantojnë një pjesë të punimeve të tyre, të konsideruara si më të mirat. Secili nga nxënësit vlerëson detyrën e vet. Nxënësit e tjerë japin mendime pozitive në lidhje me punimet e paraqitura nga shokët.			
Vlerësimi: Vlerësohen për cilësinë e realizimit të punimeve; vlerësim me notë dhe vetëvlerësim.			
Detyrat dhe puna e pavarur:			

Periudha e dytë: janar-mars

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Sa zbaviteshin dikur (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Imagjinata e drejtuar.</i> Nxënësit/et nxiten të mendojnë mbi çështjen: Si do të dëshironit ju të ishte shkolla? Nxënësit/et përqendrohen për pak çaste e më pas gjithsecili sipas fantazisë së tij sjell modelin që dëshiron. Këtu mësuesja/si së bashku me ta prek fantazinë, si elementin kryesor të ndërtimit të modelit të përgjigjes së nxënësve. Po kështu, gjendet rasti për të rimarrë edhe koncepte që dinë nxënësit/et mbi tregimin dhe plotësohet: Tegimet fantastiko-shkencore Janë lloj i rrëfimeve me fantazi. Këto tregime vendosen në të ardhmen, në hapësirë, në një kohë ose univers të ndryshëm.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - gërsheton elemente të fantazisë me realitetin për të plotësuar dëshirat e tij; - realizon një lexim shprehës të tregimit; - u përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen; - identifikon tipare të tregimit fantastiko-shkencor. Ora e dytë Nxënësi/ja: - portretizon personazhet duke nxjerrë në pah anë të kundërta të karakterit të tyre; - krahason duke nxjerrë në pah të përbashkëta dhe dallime në modelin e dy shkollave.		Fjalët kyçe: zbaviteshim, shkollë, mësues, tregim fantastiko-shkencor.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Imaginatë e drejtuar. Lexim shprehës. Puno në dyshe/shkëmbe. Ditari dypjesësh. Punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënësve. Paraqiten disa prej mendimeve të nxënësve dhe vlerësohet imagjinata që shpalos secili prej tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet titulli në tabelë. U flitet nxënësve në lidhje me autorin dhe librin.

Isak Asimov lindi më 2 janar 1920 në Petroviç (Bjellorusi); vdiq më 6 prill 1992 në N. York. Ka qenë një biokimist amerikan dhe një nga shkrimtarët më të njohur dhe më produktiv të letërsisë fantastiko-shkencore. Në fakt, Isak Asimov është konsideruar një nga shkrimtarët më të mëdhenj të fantashkencës të të gjitha kohërave. Suksesi i tij ka ardhur nga ndërthurja e mrekullueshme midis trillimit letrar dhe së vërtetës shkencore, çka arrin t'i bëjë librat e tij të besueshëm dhe fantastikë njëkohësisht, pasqyra të vërteta të së ardhmes. Në mjediset letrare vlerësohet edhe talenti i tij satirik e ironik, që shfaqet në disa prej veprave të tij, sidomos në parathëniet e tyre.

Libri i parë i autorit në letërsinë fantastiko-shkencore do të ishte përmbledhja me proza të shkurtra "Ndajnatë" 1941, i cili shpesh është konsideruar libri më i mirë i të gjitha kohërave për proza të shkurtra fantastiko-shkencore.

Libri "Unë, Roboti", botuar më 1950, ndikoi pa masë në mënyrën sesi shkrimtarët më vonë i trajtuan makinat inteligjente. Asimov shkroi seritë fantastiko-shkencore *Lucky Star* (Yll me fat), të romaneve për fëmijë duke përdorur pseudonimin Pol Frenç.

Vepra e tij, shumë prodhimore, në rreth 300 libra, është e karakterizuar gjerësisht, përveç nga fantazia, edhe nga humori, ironia dhe satira.

Realizohet një lexim shprehës i fragmentit. Gjatë leximit të pjesës, nxënësit nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja, për t'u shpjeguar në fund të leximit. Nxënësit krijojnë nga një fjali me to.

Gjatë realizimit të fragmentit "Sa shumë zbavitëshim dikur", nxënësit/et së bashku me mësuesin/en diskutojnë rreth tij:

Kuptojmë tekstin

Për çfarë flet libri i lashtë?

Çfarë mendon Marxhi për shkollën?

Shkolla e Marxhit është shumë e veçantë. Ku gjendet shkolla? Si zhvillohen mësimet?

Pse i pëlqen Marxhit shkolla e kohëve të shkuara?

Ritregoni shpjegimet e Tomit për shkollën e kohëve të shkuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**Punë në grupe.**

Nxënësit ndahen në tri grupe.

Grupi I. Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve të ushtrimeve 2, 3.

Grupi II. Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve të ushtrimeve 4, 5.

Grupi III. Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve të ushtrimeve 6, 7.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para klasës, mësuesi/ja ndërhyr nëse e shikon të nevojshme. Aktivizohen sa më shumë nxënës në dhënien e përgjigjeve.

Puno në dyshe/shkëmbe. Nxënësit do të punojnë ushtrimin 8. Vlerësoni anët negative dhe pozitive të shkollës së Tomit dhe të Marxhit.

Punon individualisht	Mësohesh me vetminë
Mëson të përqendrohesh	Humbet komunikimin
Ka mësues të vërtetë.	Ka mësues mekanik.

Nxënësit/et punojnë për pak çaste e më pas shkëmbejnë mendimet me njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur: Realizoni një tregim fantastiko-shkencor. Tregimin mund ta shoqëroni edhe me ilustrime.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Folja, zgjedhimi Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënësve: Paraqitet në tabelë, në një tabak letre ose një fisha një paragraf. Kërkesat për nxënësit: Punë në grupe dyshe. Gjeni foljet në fragmentin e mëposhtëm: Kishte mbjellë shumë lisa gjatë jetës së tij. Ishte gëzuar si një fëmijë, kur ata rriteshin. E dinte se pemët kërkonin një kujdes të veçantë. Nxënësit/et në grupe dyshe gjejnë foljet, analizojnë ato: kohë, vetë, numër, mënyrë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon foljet në një paragraf të dhënë; - dallon kur foljet janë përdorur në kuptim të plotë dhe kur përdoren si folje ndihmëse; - i ndan foljet në tri zgjedhime, duke dalluar edhe foljet e parregullta; - mëson se folja ka këto veçori; vetë, kohë, numër, diatezë, zgjedhim; - zgjedhon folje në formën veprorë dhe formën joveprorë.		Fjalët kyçe: zgjedhim, mënyra, kohë të thjeshta, të përbëra, folje ndihmëse kam, jam, folje të parregullta, forma veprorë, diatezë, forma joveprorë.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, fletorja për verifikimin e kompetencave, tabela.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. DDM. Shpjegim. Puno/shkëmbe në dyshe. Punë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatë. Nxënësit, analizojnë në grupe dyshe foljet, sipas njohurive që kanë marrë në klasën 5. Ndërtimi i njohurive të reja. Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në faqen 196-197, dhe, pasi të lexojnë informacionin në heshtje, të plotësojnë tabelën DDM.			

Di	Dua të di	Mësova
Folja është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës.	Kur folja përdoret në kuptim të plotë dhe kur është ndihmëse?	
Folja tregon veprim ose gjendje.	Cilat folje janë të parregullta?	
Folja përshtatet me kryefjalën në vetë e në numër.	Kur folja është në formën veprorë dhe kur është në formën joveprorë?	
Folja ka tri zgjedhime.	Ç'veçori të tjera ka folja?	
Folja ka: mënyrë, kohë, vetë, zgjedhim.		
Folja përdoret në këto mënyra: dëftore, lidhore, habitore, urdhërore, dëshirore dhe kushtore.		
U shpjegohen nxënësve atë çka duan të dinë në lidhje me foljen, duke dhënë shembuj për çdo rast. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Puno/shkëmbe në dyshe. Në grupe dyshe, nxënësit/et punojnë ushtrimet 1, 3 dhe 4, në libër, i plotësojnë dhe këmbëjnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Më pas ushtrimet lexohen nga nxënës të ndryshëm. Ushtrimet 2 dhe 6 i punojnë dy nxënës/e në tabelë, kurse nxënësit e tjerë punojnë në fletore. Nxënësit japin përgjigjet e tyre, ndërsa klasa verifikon saktësinë në kryerjen e ushtrimeve.		
Vlerësimi: Vlerësohen për veprimet në situatë; pjesëmarrjen gjatë orës; saktësinë në dhënien e përgjigjeve dhe qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.		
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5, fq. 198.		

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Folja, zgjedhimi, mënyrat. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës. (Morfologji)		Situata e të nxënit: Nxënësit plotësojnë <i>Pemën e mendimit-Folja</i> , nisur nga njohuritë që kanë marrë për të. <pre>graph TD; Folja((Folja)) --> klaska[klasa]; Folja --> emërton[emërton]; Folja --> zgjedhimi[zgjedhimi]; Folja --> mënyrat[mënyrat]; Folja --> forma[forma]; Folja --> përdoren[përdoren];</pre> kohët bazë format e pashtjelluar Plotësohet nga nxënësit duke dhënë edhe shembuj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon zgjedhimin e foljeve; - gjen temën dhe mbaresën e foljeve të ndryshme; - analizon foljet sipas: mënyrës, kohës, vetë, numrit, zgjedhimit.		Fjalët kyçe: folje, zgjedhim, mënyrë, kohë, vetë, numër, kohë të thjeshta, kohë të përbëra.	
Burimet: FVK, njohuritë e nxënësve, tabela.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimit. Punë e pavarur. Diskutim. Puno/shkëmbe në dyshe.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë në kryerjen e detyrës që është dhënë për t’u punuar në shtëpi. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënit, gjatë së cilës, nxënësit rikujtojnë njohuritë që kanë marrë në lidhje me foljen. Sqarohet ndonjë paqartësi që mund të kenë nxënësit. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur. Udhëzohen nxënësit të hapin FVK në fq. 30. Ushtrimet 1, 3 do të punohen në tabelë nga dy nxënës, kurse klasa do të punojë në fletore. Dëgjohen përgjigjet e nxënësve. Puno/shkëmbe në dyshe. Në grupe dyshe, nxënësit/et punojnë ushtrimet 2, 4, 5, FVK, i plotësojnë dhe këmbajnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Më pas ushtrimet lexohen nga nxënës të ndryshëm.			
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës, saktësinë në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.			
Detyrat dhe puna e pavarur:			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkolla e ëndrrave të mia Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënësve: <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe.</i> Kërkohej që nxënësit/et me vizatime, me fjalë apo me leximin e ndonjë tregimi të shprehesh për shkollën që ata ëndërrojnë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shkruan duke përdorur imagjinatën; - zbaton rregullat e strukturës dhe paraqitjes gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur një përmbajtje të kuptueshme të një shkrimi që mbështetet në imagjinatë; - strukturon shkrimin sipas fazave, sipas një mënyre të caktuar; - shkruan, përfundon apo plotëson hyrje dhe mbyllje të bukura; - shkruan një ese me temë “Shkolla ime pas dhjetë vjetësh”.		Fjalët kyçe: shkollë, ëndërroj, klasa, mjedise sportive, kompjuter, bibliotekë, mësim, pushime, ekskursione, fantazi.	
Burimet: video dhe filma me temën e shkollës të së ardhmes, teksti mësimor, libra jashtëshkollore me tregime, magnetofon, CD.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Imagjinatë e drejtuar. Punë në grupe. Punë e pavarur. Bashkëbisedim në grupe dyshe. Shkrim i lirë.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës të së nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Nxënësit/et të drejtuar nga mësuesi/ja imagjinojnë shkollën e tyre të së ardhmes. Teksa punojnë, në sfond vendoset një muzikë e lehtë që nuk i shqetëson. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje. Dëgjojnë një përshkrim për një shkollë që nuk e kanë parë dhe as imagjinuar që i takon një shoqërie pas 50 vjetësh, përshkrimi mund të jetë dhe i regjistruar ose krijuar enkas për këtë orë mësimi. Tregimi i mësuesit/es shoqërohet me pauza me ndryshim zëri etj. Më pas, mësuesi/ja kërkon e nxënësit/et të tregojnë si ndjehen në lidhje me ato që dëgjuan. Nxënësit/et të emocionuar tregojnë atë që kanë ndjerë gjatë qëndrimit me kokë ulur dhe dëgjimit të tregimit të imagjinuar, të regjistruar apo edhe të lexuar nga mësuesi/ja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur. Nxënësit/et punojnë me ushtrimin 1 të librit dhe e plotësojnë atë sipas nënndarjeve. Plotësojnë tabelën me veprimtari të tjera që i takojnë çdo grupi. Karakteristika Si ishte Si do ta doje Shkrim të lirë me imagjinatë Nxënësit shkruajnë një shkrim të lirë me imagjinatë me temë “Shkolla ime pas 10 vjetësh”.			

Vlerësimi i orës. Nxënësit/et vlerësojnë punët e njëri-tjetrit duke nxjerrë në pah anët pozitive dhe mangësitë. Bëjnë komente, konkurs, shpallin fituesin.
Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kapelja që flet (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Puno dyshe/shkëmbe mendime. Mësuesi/ja shënon në dërrasë të zezë Harri Poter dhe i nxit nxënësit/et të sjellin ndërmend episode, të cilat i kanë pëlqyer. Nxënësit/et punojnë në dyshe e më pas shkëmbejnë informacionet me njëri/a-tjetrin/ën.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - flet për personazhin e Harri Poter; - realizon një lexim shprehës të fragmentit; - u përgjigjet pyetjeve të përmbajtjes. Ora e dytë Nxënësi/ja: - personazheve të pjesës; - zbulon funksionin e kapelës dhe rëndësinë që ka ajo në personazhe e pjesës; - krahason variantin e librit me atë të filmit duke u mbështetur më së shumti në elementet fantastike; - shkruan një tregim me elemente fantastike, sende dhe personazhe të trilluara.		Fjalët kyçe: kapele, flet, frikë, magji, dëshira, dridhet, shtëpi etj.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, biblioteka, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Puno/shkëmbe në dyshe. Lexim shprehës. Pyetje-përgjigje. Diskutim. Diagrami i Venit. Punë në grupe.			

Organizimi i orës së mësimit.**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Puno në dyshe/shkëmbe**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënës, përmes së cilës nxënësit sjellin në kujtesë personazhin e famshëm Harri Poter dhe episode nga filmi apo romani.

Ndërtimi i njohurive të reja. Lexim shprehës. Pyetje-përgjigje.

Prezantohet titulli i pjesës dhe caktohen katër nxënës/e për të realizuar një lexim shprehës të fragmentit. Gjatë leximit të tij, nxënësit do të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja, për t'u shpjeguar pas leximit. Mund të realizohet edhe një rilexim zinxhir i fragmentit, për të përfshirë sa më shumë nxënës. Ndërtimi i fjalive nga nxënësit, me fjalët e reja, është një mundësi që ata të pasurojnë fjalorin e tyre aktiv.

Punohen pyetjet e rubrikës: Kuptojmë tekstin.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1.

Ora e dytë**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Diagrami i Venit**

Nxënësit/et ndahen në grupe (5-6 nxënës).

Grupi I punon ushtrimin 2.

Grupi II punon ushtrimin 3.

Grupi III punon ushtrimin 5.

Grupi IV punon ushtrimin 6.

Grupi V punon ushtrimet 7, 8.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet.

Bëhen ndërhyrjet e duhura.

Nëpërmjet Diagramit të Venit punojnë ushtrimin 8, duke nxjerr në pah të përbashkëta dhe dallime mes librit dhe filmit.



Nxënësit/et punojnë në heshtje. Në minutat e fundit, Diagrami i Venit plotësohet edhe në dërrasë të zezë.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një tregim të shkurtër me elemente fantastike, sende dhe personazhe të trilluara magjike. Vendosni një titull krijimit tuaj dhe përpikuni ta shoqëroni me një vizatim apo foto, e cila përputhet me të. Detyra mund të përfshihet edhe si punim portofoli, si detyrë krijuese.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mënyrat dhe kohët e foljes Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës. (Morfologji)		Situata e të nxënës: <i>Punë në dyshe.</i> Si e shprehin veprimin foljet e nënvizuara? <u>Hapni</u> një llogari kursimi dhe <u>vlerësoni</u> përparësinë që ju <u>sjell</u> sigurimi i një depozite personale. Depozitim e rregullt në llogarinë e kursimit <u>vlerësojeni</u> si një shpenzim të pashmangshëm, njëllon si pagesën e faturës së energjisë elektrike. Mund të <u>veproni</u> kështu dhe do të keni përfitime. <u>hapni</u> , <u>vlerësoni</u> , <u>vlerësojeni</u> (urdhër, këshillë) <u>sjell</u> (veprim i sigurt, dëftore) <i>të veproni (veprim i mundshëm, lidhore)</i>	

Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit		
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon gjashtë mënyrat e foljes; - dallon kohët bazë të foljes: e tashme, e shkuar, e ardhme; - njeh format e pashtjelluara të foljes; - analizon foljet sipas: mënyrës, kohës, vetës, numrit; - formon fjali me folje në kohë të ndryshme.	Fjalët kyçe: mënyra, kohë të thjeshta, të përbëra, kohë bazë, e tashme, e shkuar, e ardhme, format e pashtjelluara.	
Burimet: teksti i nxënësit, njohuritë e nxënësve, tabela.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. DDM. Punë e pavarur.		
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë në kryerjen e detyrës që është dhënë për t’u punuar në shtëpi. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatë. Nxënësit, nisur nga njohuritë që kanë marrë në klasën 5, dallojnë mënyrat e foljeve. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet titulli i mësimi dhe paraqitet në tabelë fjala-koncept <i>mënyrë</i> . <i>Mënyra</i> të foljes quajmë format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim si të sigurt, si mundësi, si dëshirë, si urdhër, si habi. Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në fq. 196-197, dhe, pasi të lexojnë informacionin në heshtje, të plotësojnë tabelën DDM.		
Di	Dua të di	Mësova
Folja ka 6 mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, dëshirore, habitore, urdhërore	Ç’janë format e pashtjelluara të foljes?	
Kohët bazë të foljes: e tashmja, e shkuara, e ardhmja dhe ndarjet e tyre.	Si emërtohen format e pashtjelluara të foljes?	
Vëmendja do të përqendrohet te format e pashtjelluara, pasi janë njohuri që nxënësit e marrin për herë të parë. Paraqiten format e pashtjelluara dhe jepet nga një shembull me secilën prej tyre. <i>Lagur</i> me lot, <i>djegur</i> me flakë. (pjesore) <i>Ecte duke kënduar</i> një këngë të vjetër. (përcjellore) <i>Pa punuar</i> , nuk arrin gjë. (mohore)		

Shkoi për të takuar mësuesen. (paskajore)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Punë e pavarur.

Punohen ushtrimet 1 dhe 2 në tabelë nga dy nxënës, kurse klasa punon në fletore. Prezantohen përgjigjet nga nxënësit. Mund të mblidhen edhe fletore për t'u vlerësuar me notë.

Punë në dyshe.

Ushtrimi 3 punohet në libër. Nxënësit këmbëjnë librat me njëri-tjetrin dhe verifikojnë saktësinë në kryerjen e tij.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës, saktësinë në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 4, 5 fq. 201 (punë në dy grupe)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Stinët në Planetin e Kuq Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Diskutim-Kllaster: Nxënësit/et nxiten drejt diskutimit që ka lidhje me vetë titullin e fragmentit. <i>Takimi i kalamajve të tokës me Presidentin e Planetit të kuq.</i> Për çfarë mendoni se rrëfen autori? Tregohet kujdes me përgjigjet që sjellin nxënësit/et dhe sapo ata fillojnë të fantazojnë mbi personazhin e trilluar prej tyre, shënohen në tabelë: <i>Personazhi i trilluar:</i> Gjendet në rrëfimet më fantazi. Ndërtohet mbi bazën e imagjinatës së autorit. Shpreh sinqeritetin dhe dëshirën e njeriut për të arritur të pamundurën. Kapërcen kufijtë e realitetit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - ndërton ngjarje duke u bazuar në titullin e pjesës; - zbulon elementet fantastike dhe emocionet që ato përcjellin te personazhet e pjesës; - jep mendimin e tij duke mbajtur qëndrim në lidhje me situata të ngjashme si e pjesës.		Fjalët kyçe: presidenti, planet, galaktikë, kozmocelulari, teleciklopedi, gjigand, artificial, fantazoj etj.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Diskutim-Kllaster. Imagjinatë e drejtuar. Punë në grupe. Tryeza rrethore.

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë në kryerjen e detyrës që është dhënë për t'u punuar në shtëpi, aftësinë e tyre krijuese dhe pjesën ilustruese.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënës.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet titulli i pjesës dhe paraqiten të dhëna në lidhje me jetën dhe krijimtarinë e shkrimtarit Bedri Dedja.

Bedri Dedja lindi në 20 nëntor të vitit 1930 në Korçë, studioi në Moskë psikologjinë dhe pedagogjinë e letërsisë për fëmijë, është shkrimtar shqiptar. U nda nga jeta në 13 prill të vitit 2004.

Bedri Dedja, Akademik dhe profesor në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë, ka qenë një personalitet shumëplanësh në krijimtarinë letrare shqiptare për të vegjlit dhe atë shkencore për të rriturit: poet e prozator, përrallëtar e dramaturg, tregimtar e publicist, novelist e romancier, përkthyes, gazetar e kritik, studiues i psikologjisë, pedagogjisë e historisë së arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, studiues e teoricien i historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë. Fitues i shumë çmimeve letrare, “Qytetar Nderi” i Beratit, mbajtës i “Çmimit të Republikës”, “Urdhërit Naim Frashëri” dhe titullit “Mjeshtër i Madh”, Bedri Dedja është vlerësuar gjithashtu nga Qendra Ndërkombëtare e Biografive në Kembrixh, duke zënë vend në Vëllimin e XVI të biografive si autor i shquar i shekullit XX.

Novela: “Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit”, “Një udhëtim i rrezikshëm”, “Kërcënimi i thonjve kozmikë” etj. “Vëllime me tregime e përralla”, “Përralla popullore mbi kafshët”, “Përralla e shpatave të arta”, “Përralla e lepurit dhe e breshkës”, “Përralla të zgjedhura” etj.

Vjersha dhe poema: “Numrat”, “Shkolla e pyllit”, “Artan Borizani dhe çeta e tij”, “Patoku në plazh” etj.

Romane: “Shoku i braktisur”, “Kalamajtë e pallatit tim”, “Republika e 1100 çudirave”, “Nëpër korridoret e thella të Jonit”, “Presidenti i Planetit të Kuq” (botuar pas vdekjes) etj.

Aktivizohen nxënës/e për të realizuar një lexim shprehës të fragmentit .Gjatë leximit të tij, nxënësit do të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja, për t'u shpjeguar pas leximit. Mund të realizohet edhe një rilexim zinxhir i fragmentit, për të përfshirë sa më shumë nxënës në lexim. Ndërtimi i fjalive nga nxënësit, me fjalët e reja, është një mundësi që ata të pasurojnë fjalorin e tyre aktiv.

Punohen pyetjet e rubrikës: **Kuptojmë tekstin.**

Nxënësit u përgjigjen 9 pyetjeve të ushtrimit 1.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Diskutim.

Klasa ndahet në grupe.

Grupi I punon ushtrimet 2, 3.

Grupi II punon ushtrimin 4.

Paragrafi 4 (plotësohen tekat e tekanjozëve)

Paragrafi 5 (vendimi)

Paragrafi 6 (pjesa 2. nga fjalja: Dyzet kalamaj, tekanjozët më të tërbuar...)

Grupi III punon ushtrimin 5.

1. Autobus 2. I presidencës

2. Kozmotelulari 6. Kalamajve

3. Teleciklopedi 3. Galaktikës

4. Ditë 4. Artificiale

5. Planet 1. Kozmetik

6. Ekspedita 5. Gjigand

Të gjithë këta *togfjalës* përfaqësojnë elementet fantastike.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet për grupet e klasës. Bëhen ndërhyrjet e duhura.

Tryeza rrethore.

A mendoni se ndonjëherë prindërit u ngjasojnë robotëve të komanduar duke u plotësuar çdo tekë fëmijëve?

Letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës te tjetri. Çdo nxënës/e pasi e shkruan idenë e tij e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë. Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti që të bëjnë të mendosh për kohën që ka ndodhur ngjarja.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një tregim të shkurtër fantashkencor me titull “Me ekspeditën e parë të kalamajve marsianë, për në “Jupiter” ose “Po ju a do të dëshironit t’i ndryshonit stinët si marsianët e vegjël?”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

LËNDA: FUSHAT MËSIMORE		D. _____. ____	
------------------------	--	---	--

Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet situata e të nxënësve. Nxënësit njihen me temën e diktimit dhe udhëzohen që të tregojnë kujdes në drejtshkrimin e lidhëzave, ndajfoljeve dhe parafjalëve. Nxënësit mund t'u diktohet teksti ose mund t'u jepet një tekst për t'u redaktuar. Kjo lihet në dëshirë të mësuesit/es. Ndërtimi i njohurive të reja. Lexohet i plotë teksti i diktimit dhe më pas ai diktohet pjesë-pjesë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënësve u lihet kohë disa minuta që ta kontrollojnë tekstin dhe më pas fletoret do të mblidhen, për t'u qortuar. Në bazë të kriterit të vlerësimit, do të vendoset nota, e cila do të hidhet në kolonë në evidencën e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi: Vlerësohen bazuar në kriterin që përcaktohet në fillim të diktimit. Nxënësit do të vlerësohen me notë. Detyrat dhe puna e pavarur:
--

Tekste për diktimin nr. 2

Tema: Drejtshkrimi i lidhëzave, ndajfoljeve dhe parafjalëve

Ditët e para të nëntorit i ngjanin një pranvere të vogël. Toka ishte tharë nga erërat dhe ngado që të hidhej sytë, shihje vetëm drurë të tharë dhe gjethe të zverdhura. Toka u bë e thërrmuar si bukëvale dhe natyrshëm njerëzit mendonin se stinët ishin ndërruar. Plugjet e rënda në fushë kafshonin me gojën e tyre të hekurt plisat, ndërsa dheu gëlltiste në gji barërat e thata. Me qëllim që të mbaronin shpejt plugimin e tokës, bujqit ngriheshin që me natë.

Sapo zbardhte agu i ditës, fushat i shihje plot me njerëz. Kjo vjeshtë e stërzgjatur u kishte dhënë më tepër kohë njerëzve, që të mbaronin punët e tyre dhe të përgatiteshin për dimrin, i cili në këto anë ishte shumë i ashpër.

Në qoftë se do të shkoje mik në këto anë, do të takoje fare pak njerëz në sheshin e vogël të fshatit. Secili ishte i zënë me punët e veta. Kështu kishte ndodhur brez pas brezi në këto anë. Njerëzit ishin tepër të lidhur pas tokës dhe e çmonin vlerën e saj. Jetonin mes maleve, por shëndetshëm në atë që u jepte kjo tokë, sepse gjithmonë i kishin shërbyer asaj dhe ajo bujarisht u kishte kthyer çdo pikëz djerse të derdhur për të.

Kriteri i vlerësimit: tri gabime një notë.

Kërkesë shtesë. Nënvizoni me një vizë parafjalët, me dy viza lidhëzat dhe me vizë të lakuar ndajfoljet.

Diktim nr. 1 (tremujori i dytë) Emri i nxënësit _____

Tema: Drejtshkrimi i lidhëzave, ndajfoljeve dhe parafjalëve

Qorto gabimet (nënvizo në fillim fjalët). Rishkruaj trajtat e sakta të fjalëve.

Ditën e luftës ndrinte e shkëlqente pranvera, po rsi ajo nusja me tela. Vërtet që për para lindjes së diellit, kishte rënë pakëz shi dhe ndër mjet pushimeve, djemtë dilnin nëpër dritare prej nga vështronin motin thellësisht të vlerësuar dhe plot frikë, se pse shiu mund t'u prishte punë.

Për se duhet të merakoseshin kaq shumë? Përpara mbarimit të orës së fundit, shiu pushoi, retë u shkrinë lehtësisht, ndër sa qielli u bë qelq. Një diell mjaftë i bukur pranveror përhapte anë mbanë gëzimin, udhët u pastruan dhe u thanë. Ajri u pastrua dhe çdo gjë shihej qart.

Pa prituri fëmijët vërshuan vrullshëm në rrugët e kalldrëmta të qytetit, zhurmshëm dhe me hare. Me gjithë këtë gëzim që përhapnin zërat e tyre, kalldrëmet e gurta, ende fshihnin zymtësi. Ngado që ata shkonin, linin pas një vazhdë gëzimi, duke gjallëruar rrugët dhe sheshet.

fjalë e shkruar gabim	trajta e saktë	fjalë e shkruar gabim	trajta e saktë	fjalë e shkruar gabim	trajta e saktë

Kriteri i vlerësimit: tri gabime, një notë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë me imagjinatë Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.			Situata e të nxënit: Lexohet teksti “Bota e mistereve”. <i>Imagjinatë e drejtuar.</i> Nxiten nxënësit që të krijojnë një ngjarje të shkurtër me temë “Takim me një jashtëtokësor”. Nxënësit do të veprojnë sipas situatës së faqes 72. Dëgjohen disa prej krijimeve të nxënësve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shkruan duke përdorur imagjinatën; - zbaton rregullat e strukturës dhe paraqitjes gjatë shkrimit të një rrëfimi të shkurtër; - krijon një titull dhe hyrje interesante; - lidh ngjarjet, duke i vendosur ato në hapësirë dhe kohë; - krijon konflikte mes personazheve, duke përcjellë mesazhe që lidhen me kurajën, guximin, vullnetin dhe shkathtësinë e tyre; - ilustron shkrimin me vizatim, fotografi etj.; - vetëvlerëson punën e tij dhe vlerëson pozitivisht punimin e shokut/shoqes.			Fjalët kyçe: rrëfim, imagjinatë, personazhe fantastike, strukturë, ngjarje, hapësirë, kohë.	
Burimet: teksti i nxënësit, interneti, histori me alienë, libra dhe albume me dinozaur.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Imagjinatë e drejtuar. Shkrim i lirë. Turi i galerisë.				

Organizimi i orës së mësim Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Imagjinatë e drejtuar. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënës. Ndërtimi i njohurive të reja. Shkrim i lirë. Udhëzohen nxënësit që të shfrytëzojnë njërën prej temave të paraqitura në faqen 73. Paraqiten në një tabak letre ose videoprojektor hapat që duhen ndjekur për realizimin e shkrimit me imagjinatë. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në fletore ose në fletë formati. Punimet, ata mund t'i ilustrojnë me vizatime, fotografi. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Turi i galerisë. Nxënësit, sipas dëshirës, prezantojnë punimet e tyre para klasës dhe nxënësit e tjerë vlerësojnë pozitivisht punën e realizuar nga shokët/shoqet, duke patur parasysh se sa u janë përmbajtur rregullave të shkrimit.
Vlerësimi: Vlerësohen me notë; me gojë; vetëvlerësim.
Detyrat dhe puna e pavarur:

Vetëvlerësim ose vlerësim për detyrën

Punë me shkrim.

Tema e detyrës _____

Emri i nxënësit: _____

Kriteret	Nuk i plotëson	I plotëson pjesërisht	I plotëson
Punimi i është përmbajtur temës dhe ka qartësi mendimi.			
Janë respektuar elementet e strukturës: hyrje, zhvillim, mbyllje. Janë përdorur paragrafë.			
Hyrja është interesante dhe nxit lexuesin.			
Ngjarjet vendosen në hapësirë dhe në kohë.			
Personazhet pasqyrojnë tipare si: guximi, vullneti, kurajoja.			
Fjalitë janë të sakta, të qarta nga pikëpamja gramatikore. Janë përdorur drejt shenjat e pikësimit.			
Detyra është prezantuar qartë, bukur dhe është shoqëruar me ilustrim.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shumë mënyra për të dëgjuar anekdota Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.		Situata e të nxënit: <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe</i> Nxënësit/et tregojnë vëmendje rreth fabulës “Ujku dhe qengji” që shfaqet e regjistruar ose e lexon dhe kërkon prej tyre të gjejnë se çfarë lloj rrëfimi është, përrallë, anekdotë apo fabul? Nxënësit/et gjejnë dhe dallojnë anekdotën nga fabula dhe përralla vetëm përmes dëgjimit. Ata tregojnë edhe se cilat elemente gjuhësore i ndihmojnë që të bëjnë këtë dallim.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon dhe tregon vëmendje (tregon, përmbajtjen, bën pyetje, iu përgjigjet pyetjeve); - dëgjon me vëmendje dhe përqendrim: duke shikuar në sy personin që flet e duke mbajtur trupin në një pozicion korrekt; - jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon; - kupton dhe rrëfen për të tjerët personale (anekdota gojore, fabula, përralla); - dëgjon dhe ndjek me vëmendje; - reagon ndaj subjekteve që dëgjon; - bën pyetje për të sqaruar më tej atë që dëgjon; - bën dallimin mes anekdotës, fabulës dhe përrallës.		Fjalët kyçe: dëgjim i vëmendshëm, fabul, përrallë, pyetje.	
Burimet: fabula, anekdota dhe përralla të regjistruara. teksti mësimor, video dhe CD, mjete digjitale, diktofon, magnetofon.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe dyshe. Dëgjim i drejtuar DLTA. Diagrami i Venit. Rrjeti i diskutimi. Punë në grupe. Pyetje-përgjigje.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënësve. Nxënësit përsëritin njohuritë që kanë marrë në lidhje me fabulën. Nxënësit vërejnë me kujdes fabulën e ilustruar në mënyra të ndryshme dhe mendojnë se si ta tregojnë atë për të tjerët për të nxjerrë ndryshimet që shfaqen në variantet e ndryshme të ilustrimeve për të njëjtën fabulë.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Pyetje-përgjigje.

Në të gjitha ilustrimet, ujku paraqitet me pamje të egërsuar. Sipas jush pse?

Në cilin ilustrim, qengji është paraqitur shumë i trembur? Thoni pse?

Cili ilustrim ju bën për të qeshur dhe pse?

Cili ilustrim ka elemente të forta kontrasti?

Cili ilustrim i afrohet më tepër përmbajtjes së fabulës?

Cili ilustrim duket më i përshtatshëm për fëmijët e vegjël dhe pse?

Dëgjojnë dhe tregojnë anekdota

Dëgjojnë anekdota të lexuara nga mësuesi/ja ose nxënësit/et në grupe pune.

I përgjigjen pyetjes se ku qëndron humori në anekdota? etj. Paraqitet se ç'është anekdota.

Anekdotat janë thënie të mençura, tregime të shkurtra shpottitëse e satirike, përmes së cilave interpretohen dukuri të ndryshme shoqërore.

Nxënësit dëgjojnë dhe tregojnë anekdota të ndryshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.


Punë në grupe.

Nxënësit rindërtojnë strukturën e përrallës orientuar nga ilustrimet.

E dëgjojnë përrallën në dy-tri variante. Zgjedhin variantin më të saktë dhe tregojnë pse është më i sakti.

Diagrami i Venit.

Krahasojnë përmes një Diagrami Veni anekdotën, fabulën dhe përrallën. Nxjerrin në pah ato elemente që i bashkojnë (në mënyra të ndryshme të treguari dhe çfarë i dallon).

**Rrjeti i diskutimit**

Analizojnë tiparet e personazhit (majmunit përmes situatave të rastit të ushtrimit 3).

Bashkëbisedoni për çështjen: “Çfarë përfaqësojnë sjelljet e majmunit në këtë përrallë”, mbështetur në dëgjimin e variantit final të saj.

Vlerësimi i orës. Kjo orë do të quhet e suksesshme atëherë kur nxënësit/et të bashkëpunojnë në punë me grupe duke dëgjuar me vëmendje atë çfarë iu afrohet (tekste të ndryshme) kur të bëjnë dallimet strukturore dhe përmbajtësore të tyre, si dhe kur të japin mendime dhe të bëjnë karakterizime mbi personazhet që ofrojnë tekstet e ofruara.

Dialogu *pyetje-përgjigje* dhe reflektimi përmes tij në mënyrë kritike është një shenjë tjetër e suksesit të kësaj ore mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Fuqia e Mujit (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Stuhi mendimi:</i> A keni dëgjuar ndonjëherë për ciklin e Kreshnikëve? Po për autorin Mitrush Kuteli? Nxënësit/et paraqesin mendimin e tyre të cilat do të jenë të ndara në dy drejtime. Cikli i kreshnikëve këngë legjendare luftonin kundër krajlit kreshnikët Muji Halili Gjergj Elez Alia <i>Mitrush Kuteli (Dhimitër Pasko)</i> Tregimet e tij janë të veçanta dhe i afrohen mënyrës së rrëfimit popullor. Disa prej tyre janë: “Pylli i gështenjave”, “Baltë nga kjo tokë”, “Tregime të moçme shqiptare”.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - prezanton njohuritë në lidhje me Ciklin e Kreshnikëve dhe autorin Mitrush Kuteli; - lexon pjesën në role; - u përgjigjet pyetjeve të përmbajtjes. Ora e dytë Nxënësi/ja: - përshkruan mjediset, personazhet dhe veprimet që kryejnë ata; - analizon figurën e hiperbolës; - shpreh mendimet e tij/saj duke i argumentuar ato në lidhje me çështjet që shtrihen në këtë pjesë; - krahason personazhin e Mujit me Gjergj Elez Alinë; - zgjeron përshkrimin fantastik të mjedisit të rrëfenjës.		Fjalët kyçe: Cikli i Kreshnikëve, fuqi, zana, Muji, zgjedhje, shpërblej.	

Burimet: teksti i nxënësit, biblioteka, interneti, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Lexim në role. Punë në grupe. Rrjeti i diskutimit.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënës, përmes së cilës nxënësit sjellin në kujtesë njohuritë që kanë marrë në lidhje me Ciklin e Kreshnikëve dhe autorin Mitrush Kuteli. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet titulli i pjesës dhe personazhi i Mujit. Realizohet një lexim shprehës emocional i pjesës. Pjesa ndahet në rolet; autori, Muji, zanat. Vlerësohet interpretuesi/ja më e mirë. Puna me fjalorin dhe fjalët e reja. Shpjegohet figura e hiperbolës, si një nga figurat stilistike bazë të Ciklit të Kreshnikëve. Hiperbola është figurë stilistike që ndërtohet mbi bazën e zmadhimit jashtë mase, deri në tepri, të qenieve, sendeve a tipareve të tyre, për të bërë përshtypje a për të theksuar mendimin. Kalohet në punimin e pyetjeve të rubrikës <i>Kuptojmë tekstin</i> . Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1, që kanë të bëjnë me përmbajtjen e pjesës. Ora e dytë Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Rrjeti i diskutimit. Nxënësit/et ndahen në dy grupe dhe çdonjëri prej tyre punon me: Grupi I punon ushtrimet 2, 3. Grupi II punon ushtrimet 4, 5. Grupi III punon ushtrimet 6, 7.	
Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues/e të secilit grup komentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Bëhen ndërhyrjet e nevojshme. <i>Rrjeti i diskutimit (Pyetja binare)</i> Ushtrimi 8. A mendoni se njeriut i shpërblehen gjithmonë për të mirat që bën? <pre> graph TD A[Pse?] --> B[Po] A --> C[Jo] B --> D[] C --> D style D fill:none,stroke:none </pre> Nxënësit/et do të diskutojnë për disa minuta dhe do të japin argumente që mbështesin mendimet e tyre. Dëgjohen me vëmendje diskutimet e nxënësve. Disa prej tyre mbahen shënim.	
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 9 dhe detyra në faqen 79, sipas dëshirës së nxënësve.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mënyra dëftore e foljes Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës.		Situata e të nxënit: Shkruhen në tabelë fjalitë: - <u>Mendojmë</u> për këtë. (e tashme) - <u>Kam menduar</u> unë për këtë. (e shkuar) - <u>Do të mendoj</u> unë për këtë. (e ardhme) Si paraqitet veprimi i foljeve të nënvizuara? Nxënësi/ja nga analiza e fjalive për nga kuptimi, nxjerrin se folja në mënyrën dëftore tregon një veprim të sigurt në çastin që flasim, në të shkuarën apo në të ardhmen.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon foljet në mënyrën dëftore; - jep përkufizimin për kuptimin që shpreh folja në mënyrën dëftore; - dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra (folja ndihmëse kam); - zgjedhon foljet në mënyrën dëftore.		Fjalët kyçe: veprim i sigurt, kohë të përbëra, folje ndihmëse	
Burimet: teksti mësimor, tabela, FVK.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Loja zinxhir. Punë në grupe dyshe. Diskutim. Puno/shkëmbe në dyshe.			
Organizimi i orës së mësimet. Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Lojë zinxhir. Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen në ndarjen e kohëve të mënyrës dëftore: 4 të thjeshta, 4 të përbëra, si ndërtohen ato (mjetet gjuhësore që shërbejnë). Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe me tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrën dëftore me folje në të tria zgjedhimet. Ndalen në dallimin e temës dhe mbaresës së foljeve dhe në foljen ndihmëse kam, e cila formon kohët e përbëra. Ushtrimin 1, në faqen 203 çdo nxënës/e e plotëson në libër, pastaj me anë të <i>Lojës zinxhir</i> , nxënësit/et zgjedhojnë foljet: <i>mendoj, pi, pres</i> në tetë kohët e mënyrës dëftore. Nxënësi/ja që gabon, e zgjedhon foljen me shkrim në fletore. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Puno/shkëmbe në dyshe. Ushtrimet 2, 3, 6, 7, i punojmë në libër, këmbëjnë librat dhe gjejnë gabimet e njëri-tjetrit. Pastaj, ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen zgjidhjet e drejta të ushtrimeve. Ushtrimi 5 punohet në tabelë nga tre nxënës/e, kurse klasa punon në fletore. Mund të mblidhen edhe fletore për t’u vlerësuar. Veç foljes <i>shkruaj</i> do të zgjedhohen edhe foljet <i>mbjell</i> (zgjedhimi II) dhe <i>zë</i> (zgjedhimi III).			

Vlerësimi: Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit; vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4, fq. 204.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mënyra dëftore e foljes. FVK. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës.		Situata e të nxënit: <i>Pemë.</i> Plotësohen nga nxënësit një kllaster me kohët e thjeshta dhe kohët e përbëra të mënyrës dëftore. Si shembull zgjidhen tri folje, nga të tria kohët. Mënyra dëftore Kohët e thjeshta Kohët e përbëra	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon foljet sipas mënyrave; - zgjedhon saktë foljet në kohët e thjeshta të mënyrës dëftore, duke ndarë mbaresat; - kthen foljet nga njëra kohë në kohën tjetër.		Fjalët kyçe: Mënyrë dëftore, kohë të thjeshta, kohë të përbëra, zgjedhim, mbaresë.	
Burimet: teksti i nxënësit, FVK.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pemë mendimi. Puno/shkëmbe në dyshe. Punë individuale.			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në situatën e të nxënësve. Përsëriten njohuritë në lidhje me mënyrën dëftore dhe kohët e saj.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Puno/shkëmbe në dyshe. Punë individuale.*

Nxënës/et punojnë në grupe dyshe ushtrimet 2, 4, 5 të faqes 31 FVK.

Këmbejnë librat dhe gjejnë gabimet e njëri-tjetrit. Pastaj i diskutojnë ushtrimet me klasën dhe jepen zgjidhjet e sakta të ushtrimeve.

Punë individuale.

Ushtrimet 1, 3 do të punohen në tabelë nga dy nxënës, kurse klasa do të punojë në fletore.

Ushtrimi 1. Nxënës/et do të gjejnë mënyrat në të cilat janë përdorur foljet e fjalive.

m. dëftore – *është, kam, mbaron, thashë* (të-ja para është trajtë e shkurtër).

m. lidhore – *të dalim, të(i) presim, të mësonte*

m. habitore – *folka*

m. dëshirore – *qofshi, u trashëgoqshi*

m. kushtore – *do ta(ë) kalonte*

m. urdhërore – *hapma*

Ushtrimi 3.

lexonim – lexuam, prisnin – pritën, vishte – veshi, bisedonin – biseduan.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; saktësinë në dhënien e përgjigjeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; zbatimin e rregullave të mirësjelljes në klasë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Analizoni foljet e mënyrës dëftore në paragrafin e fundit të pjesës “Fuqia e Mujit”, fq. 78.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Zemërimi i Zeusit (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Imagjinata e drejtuar.</i> Nxënësit/et lihen për pak çaste të vështrojnë ilustrimin figurativ të faqes 81 e më pas lexojnë edhe titullin e fragmentit. Duke u mbështetur në këto dy elemente, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të mendojnë se: Për çfarë mund të rrëfejë autori? Nxënësit/et sjellin imagjinatën e tyre dhe përzgjidhet modeli që i përshtatet fragmentit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë. Nxënësi/ja: - parashikon zhvillimin e ngjarjes duke u bazuar në zhvillimin e ngjarjes dhe fantazinë e tij; - lexon fragmentin në role; - u përgjigjet pyetjeve të përmbajtjes. Ora e dytë. Nxënësi/ja: - portretizon personazhet e pjesës duke shprehur edhe qëndrimin e vet ndaj tyre; - dallon dhe emërton figurat letrare; - vlerëson mesazhin që Prometeu u ka lënë brezave; - përdor imagjinatën në përshkrimin e Olimp, vendit të hyjnive.	Fjalët kyçe: zemërim, Olimp, Zeus, Promete, dashuri për njerëzit, servil.								
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet								
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Imagjinata e drejtuar. Lexim në role. Diskutim. Marrëdhënia pyetje-përgjigje. Punë në grupe. Shkrim i lirë.									
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Rrëfëhet miti i Prometeut. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Lexim në role. Pyetje-përgjigje. Ditari dypjesësh.</i> Prezantohet titulli i pjesës dhe përmes leximit në role caktohen nxënës/e për të interpretuar fragmentin. Shpjegimi i fjalëve të reja dhe ndërtimi i fjalive me to. <i>Pyetje-përgjigje.</i> Punohen 8 pyetjes e rubrikës <i>Kuptojmë tekstin</i>, të ushtrimit 1. Ora e dytë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë në grupe. Ditari dypjesësh.</i> Nxënësit ndahen në grupe për të punuar pyetjet e rubrikave. Grupi I punon ushtrimet 2, 3, 4. Nxënësit sjellin argumente në lidhje me pyetjet e tekstit. Grupi II punon ushtrimin 5.									
<table border="1"> <tr> <td>Argumentet e Prometeut</td><td>Argumentet e Zeusit</td></tr> <tr> <td>I ka pikë të dobët njerëzit.</td><td>Kërkon t'i mbajë të nënshtruar.</td></tr> <tr> <td>Duhet t'u japë kohë që të zhvillohen.</td><td>Kërkon respektin e tyre.</td></tr> <tr> <td>I vlerëson njerëzit, i shihte si fëmijët e vet.</td><td>Njerëzit janë parazitë.</td></tr> </table>	Argumentet e Prometeut	Argumentet e Zeusit	I ka pikë të dobët njerëzit.	Kërkon t'i mbajë të nënshtruar.	Duhet t'u japë kohë që të zhvillohen.	Kërkon respektin e tyre.	I vlerëson njerëzit, i shihte si fëmijët e vet.	Njerëzit janë parazitë.	
Argumentet e Prometeut	Argumentet e Zeusit								
I ka pikë të dobët njerëzit.	Kërkon t'i mbajë të nënshtruar.								
Duhet t'u japë kohë që të zhvillohen.	Kërkon respektin e tyre.								
I vlerëson njerëzit, i shihte si fëmijët e vet.	Njerëzit janë parazitë.								

Nxënësit sjellin argumente për përdorimin e këtyre mënyrave.

Grupi III. Figurat letrare.

Fjalët e Zeusit	Mënyra e foljes
Farkëto ca hekurishte	Urdhërore
Merreni dhe mbërthejeni	Urdhërore
Mos u përziej!	Urdhërore

Nxënësit sjellin argumente për përdorimin e këtyre mënyrave.

Grupi III. Figurat letrare.

Figurat letrare	Lloji i tyre
tërbimi i çmendur	epitet
Tërbimi i çmendur e mbërtheu	metaforë
Një ujëvarë nisi të bjerë dhe fiku zjarret	hiperbolë
shprehjen e ashpër	epitet
E shtyu dashuria	metaforë
Ato jetë të errëta si nata	epitet, krahasim
I mbërthyer në përjetësi	hiperbolë

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruani Olimpin, vendin e hyjnive (detyra fq. 82).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Renditja e ngjarjeve në një tekst Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.		Situata e të nxënit: <i>Parashikim me terma paraprakë.</i> U jepen nxënësve të shkruara në dërrasë disa terma “luan, ari, forcë, dinakëri, rrëmbim, mbetën me gisht në gojë, dhelpër”. Nxënësit me termat e mësipërme do të ndërtojnë për pesë minuta një tregim të shkurtër me 6 fjali. Dëgjohen tregimet e njëri-tjetrit, bëhen komente për strukturën e tregimeve të krijuara.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - ndjek me vëmendje: tregime të shkurtra; - merr njohuri përmes dëgjimit; - mban shënime gjatë të dëgjuarit; - identifikon strukturën e tekstit (hyrje zhvillim mbylljen); - gjen shkakun dhe pasojën e ngjarjes në një tekst që dëgjon; - përcakton qëllimin e të dëgjuarit (për informacion); - pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët; - kujton njohuritë paraprake.	Fjalët kyçe: fabul, dëgjim i vëmendshëm, rend kronologjik, paragrafë, ilustrime.
Burimet: libra jashtëshkollorë, teksti mësimor, video dhe CD, mjete digjitale diktofon, magnetofon.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Parashikim me terma paraprakë. Dëgjim i drejtuar. Dora e fshehtë-Lojë. Punë në grupe. Punë e pavarur.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës të së nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Lexohet ose paraqitet e regjistruar fabula “Gjinkalla dhe milingona”. Nxënësit, pasi kanë dëgjuar me vëmendje, do të vendosin numrat në figurë, sipas rendit të zhvillimit të ngjarjes. Ritregohet ngjarja nga dy nxënës, duke vlerësuar se sa të vëmendshëm kanë qenë ata gjatë dëgjimit. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Punë e pavarur.</i> Nxënësit/et do të renditin ngjarjet e tekstit të faqes 83. Teksti i renditur lexohet apo ritregohet nga 2-3 nxënës/e. <i>Dora e fshehtë-Lojë.</i> Zgjidhen tre nxënës. Vendosen disa fjali të shkurtra mbi tavolinë që janë pjesë përbërëse e tri tregimeve. Nxënësve u jepet titulli i tregimit, i cili përmban fjalë kyçe të përmbajtjes dhe ata do të renditin ngjarjet. Lexohen ngjarjet dhe vlerësohet saktësia dhe shpejtësia në renditjen e ngjarjeve. <i>Punë në grupe.</i> Mësuesi/ja lexon tregimin me titull “Fluturimi” të plotë dhe vetëm një herë. Më pas kërkon që nxënësit/et të rindërtojnë tekstin e faqes 84 duke lidhur pjesët e paragrafëve, duke vendosur numra në krahun e djathtë, kur gjen pjesën që vijon të çdo paragrafi. Nxënësit/et pasi kanë dëgjuar me vëmendje e rindërtojnë atë dhe e lexojnë më pas në grupe.	
Vlerësimi i orës. Kjo situatë mësimore do të quhet e suksesshme atëherë kur nxënësit/et, pasi kanë dëgjuar tregimet e bashkuara, i kanë ndarë ata dhe u kanë vënë nga një titull, kur kanë rindërtuar përrallën e shprishur dhe kur kanë rindërtuar tregimin duke bashkuar pjesë të paragrafëve përbërës. Ndjekja me vëmendje e udhëzimeve të dhëna nga mësuesi/ja ka ndikuar në suksesin e nxënësve në këtë orë mësimore.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Bisedë letrare (2 orë) Libër me poezi Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Libër i përzgjedhur në bashkëpunim me nxënësit (tekst poetik)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisi Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - prezanton jetën dhe krijimtarinë e autorit; - përmbledh shkurt përmbajtjen e librit; - prezanton tematikën e poezive; - zbulon temën, idenë kryesore të disa prej poezive; - jep argumente në lidhje me poezitë më të bukura; - veçon figura letrare të mësuara dhe tregon rolin e tyre; - analizon poezinë sipas elementeve të metrikës; - interpreton bukur dhe me ndjenjë poezi që i kanë lënë më shumë mbresa; - ilustron poezi të ndryshme, sipas imagjinatës së vet; - krijon poezi të shkurtra apo shton strofa të poezive të ndryshme, duke iu përmbajtur frymës që përcjell poezia; - vlerëson punën e realizuar nga shokët/shoqet.		Fjalët kyçe: libër , krijimtari, prozë, ngjarje, personazh, temë, ide, figura letrare, përmbajtje, vend, kohë, ndërhyrje në strukturë.	
Burimet: libër me poezi, biblioteka, interneti, fotografi, përvojat e nxënësve, CD, magnetofon, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Këndi i autorit/autos. Prezantim. Diskutim. Pyetje-përgjigje. Tabela e figurave letrare. Interpretim. Shkrim i lirë. Turi i galerisë.			

Organizimi i orës së mësimi

Librat për bisedë letrare zgjidhen në bashkëpunim me nxënësit, në fillim të çdo tremujori (periudhe) ose në fillim të vitit mësimor. Mund të shfrytëzohen autorë që janë pjesë e librit të nxënësit ose libra të tjerë, të cilat janë në përshtatje me moshën dhe brenda programit të klasës së 6.

Nxënësve u jepen qysh në fillim edhe çështjet që do të trajtojnë gjatë bisedës letrare (rezultatet e të nxënit).

Krijimi i këndit të autorit/autore

Nxënësit/et krijojnë një kënd, në një tryezë në krye të klasës, në të cilin do të vendosin foto të autorit/autore, vepra të tyre etj. Librat mund të sigurohen në bibliotekën e shkollës ose nga vetë nxënësit apo mësuesi/ja.

Mund të vendoset në sfond muzikë e qetë ose të shfaqen në videoprojektor imazhe që kanë lidhje me poezitë.

Krijimi i këtij këndi krijon një atmosferë sa më ftuese, në të cilën nxënësit/et do të bashkëbisedojnë lirshëm.

Biseda letrare mund të zhvillohet edhe në mjedisin e bibliotekës së shkollës apo bibliotekës së qytetit.

Pyetje-përgjigje

Klasa ndahet në dy grupe

Grupi I. Ligjëruesit (referuesit)

Grupi II. Dëgjuesit (audienca)

Grupi I. Ligjëruesit

Nxënësit e këtij grupi do të prezantojnë një ose disa nga çështjet që u janë dhënë për të trajtuar qysh më parë (rezultatet e të nxënit).

Gjatë prezantimit të pikave, nxënësit në rolin e dëgjuesit (audiençës) janë të lirë t'u drejtojnë pyetje në lidhje me materialet që ata/ato po referojnë.

Pyetjet mund të lidhen me librin, poezitë më të bukura, figurat letrare, temën, idenë etj.

Karrigia e nxehtë

Përmes kësaj teknike, nxënësit vendosin veten e tyre në rolin e autorit të librit. Përmes pyetjeve që do t'u drejtohen nga klasa, nxënësit/et në rolin e poetit/poetes do t'u përgjigjen pyetjeve të ndryshme në lidhje me librin apo poezi të veçanta.

Shkrim i lirë

Nxënësit mund të realizojnë krijime të shkurtra: strofa apo poezi të ngjashme në tematikë me poezitë e librit. Natyrisht këtë veprimtari nuk e realizojnë të gjithë, por nxënësit e talentuar në fushën e shkrimit. Gjithsesi nxiten të gjithë nxënësit në procesin e krijimit.

Interpretim

Nxënësit interpretojnë poezitë që u kanë lënë më shumë mbresa. Vendoset në sfond muzikë. Nxënësit/et vlerësojnë interpretuesit më të mirë.

Turi i galerisë

Prezantohen libërthat e krijuara nga nxënësi/et. Gjithë materialet që kanë punuar për bisedën letrare mund të paraqiten në formën e një libërthi me kopertinë dhe ilustrime.

Nxënësit mund të realizojnë bisedën letrare edhe në formë të digjitalizuar, përmes *slide*-ve.

Vlerësimi: Vlerësohen me notë dhe vetëvlerësim (pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm).

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mënyra lidhore e foljes. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës.		Situata e të nxënit: Diskutohen me nxënësit/et fjalitë: <u>Ta mbrojmë</u> mjedisin! (veprim i dëshirueshëm) <u>Duhet të shkruash</u> më bukur! (veprim i detyrueshëm) <u>Mund të bëjmë</u> më tepër për mbrojtjen e mjedisit (veprim i mundshëm) Nga diskutimi i nxënësve, ata formulojnë vetë përkufizimin, për kuptimin që shpreh folja në mënyrën lidhore. Një veprim që mund të kryet ose mund të ishte kryer, pra i mundshëm (Mjeti dallues, pjesëza të) .	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon foljet në mënyrën lidhore; - jep përkufizimin për kuptimin saj; - zgjedhon foljen në mënyrën lidhore; - i përdor ato në fjali; - dallon pjesëzën të të foljes në mënyrën lidhore nga të si trajtë e shkurtër e përemrit vetor.		Fjalët kyçe: veprim i mundshëm, pjesëza të, kohët e përbëra, folje ndihmëse kam.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Pyetje në dyshe. Puno/shkëmbe në dyshe. Lojë gjuhësore. Punë individuale.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Pyetje në dyshe.</i> Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër për foljen në mënyrën lidhore. Nxënësit/et në grupe dyshe përgatisin pyetje rreth temës: Ç’regon folja në mënyrën lidhore? Cili është mjeti gjuhësor që dallohet mënyra lidhore? Sa kohë ka mënyra lidhore? Si formohen kohët e përbëra të foljes në lidhore? Disa nxënës/e lexojnë pyetjet e përgatitura, të përgjigjen. Ata zgjedhjnë foljen la j në katër kohët e mënyrës lidhore. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Lojë gjuhësore. Punë individuale</i> Nxënësit/et plotësojnë ushtrimin 1, tabelën me zgjedhimin e foljes <i>mendoj</i> në lidhore, qortojnë punën e njëri-tjetrit. Në Lojën gjuhësore zinxhir, aktivizohen të gjithë nxënësit/et për të zgjedhuar foljet: <i>di, hap</i> në të katërta kohët e lidhores.			

Ushtrimet 3 dhe 4 nxënësit/et i punojnë në libër dhe qortojnë punën e njëri-tjetrit. Pastaj, ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen zgjidhjet e drejta të ushtrimeve. Ushtrimin 2 e punon një nxënës/e në dërrasë, dallon trajtën e shkurtër të të përemrit vetor, nga pjesëza të e foljes në mënyrën lidhore. Prezantohen përgjigjet dhe sqarohen paqartësitë që mund të kenë nxënësit/et.
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra fq. 206 (sipas kërkesës).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mënyra lidhore e foljes, kohët e saj. FVK. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës.		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe.</i> Paraqiten në tabelë disa folje. Nxënësit të ndarë në dyshe do të vendosin foljet në kohët e kërkuara të mënyrës lidhore dhe do të ndërtojnë fjali me to. t’i vështroje (e pakryer, lidhore) _____ zinim (më se e kryer, lidhore) _____ hapnim (e tashme, lidhore) _____ kisha besuar (e kryer, lidhore) _____	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon kohët e mënyrës lidhore; - formon fjali, ku folja e paraqet veprimin si të mundshëm; - kthen foljet nga mënyra dëftore në mënyrën lidhore; - analizon folje të mënyrës lidhore.		Fjalët kyçe: mënyra lidhore, kohë, veprim i mundshëm.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, njohuritë e nxënësve, FVK - Fletorja e vlerësimit të kompetencave.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Punë e pavarur. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektësia në kryerjen e tyre.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Puno/shkëmbe në dyshe. Punë individuale.

Ushtrimet 1 dhe 2, nxënësit/et i punojnë në libër, qortojnë punën e njëri-tjetrit. Pastaj ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen zgjidhjet e drejta të ushtrimeve.

Ushtrimet 3, 4, 5 i punojnë tre nxënës në dërrasën e zezë, kurse klasa i punon në fletore. Ushtrimet diskutohen me gjithë klasën. Saktësohen paqartësitë që mund t'u kenë dalë nxënësve gjatë zhvillimit të tyre.

Punë individuale.

Shkruhen në tabelë fjalitë dhe nxënësit do të analizojnë foljet e mënyrës lidhore (koha, veta, numri, zgjedhimi).

Kur shfleton poezinë popullore, ke dëshirë të jetosh, të dashurosh, të lindësh fëmijë. Mund të kishte ardhur me të. A mund të ngrihet njeriu kundër këtyre zakoneve? Ai duhet të bënte përpara që ta harronte këtë ngjarje të trishtë. Unë kërkoj që të shkoj me ta. Është e domosdoshme që të arrijmë një marrëveshje sa më të favorshme. Vajzat rendnin të mbushnin ujë në krua. Po të mbajë koha, do të shkojmë në kopshtin zoologjik. Të mendojem një herë, pastaj flasim me qetësi. Të luash këmbë e duar, që të hash bukë e lakruar. Të nisesh menjëherë aty ku të thanë, se koha nuk pret më. Ta kishte parë me sytë e tij, nuk do të kishte reaguar në atë mënyrë. Të isha stërvitur edhe unë me ta. Le të mësohemi me magjinë që përcjell bota e madhe e librit. Ajo mund të takohej me të në fshehtësi, pa e marrë vesh kush.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdohet në shtëpi puna e nisur në klasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përcjellim ide përmes artit. Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.		Situata e të nxënit: <i>Përshkrim. Lojë.</i> Nxënësve u kërkohet që të përshkruajnë ilustrimin (pikturën e fq. 85 dhe pasi ta përshkruajnë si pikturë të përshkruajnë një nga lojërat që luhen atje. Nxënësit/et përshkruajnë lojëra që shohin në pikturë. Mund të luajnë së bashku një lojë në grup. Nxënësit/et luajnë në role disa nga lojërat që njohin.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - kupton dhe përdor bisedat, diskutimet dhe debatet; - zhvillon aftësitë dhe shkathtësitë e tij për të bashkëpunuar me të tjerët; - përshtat të folurin me qëllimin; - zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij; - merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve; - identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë përshkrime ose porosi nëpërmjet veprave të artit; - merr pjesë në mënyrë modeste për të vlerësuar vepra arti; - përdor fjalor të përshtatshëm për përshkrimin e veprave të artit.	Fjalët kyçe: Art, ide, pikturë, forma, ngjyra, lojëra.
Burimet: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, teksti mësimor, informacione nga interneti, piktura të ndryshme, materiale për vizatim.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Përshkrim. Lojë. Pyetje-përgjigje. Punë në grupe. Diskutim. Krijimtari e lirë.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Diskutim në grupe.</i> Udhëzohen nxënësit që të shohin me vëmendje figurat me temë: Kafshët dhe fëmijët përmes pikturës. Nxënësit në fillim do t'i përshkruajnë ato dhe më pas do të komentojnë format, ngjyrat dhe objektet e përfshira në to. Nxënësit/et diskutojnë në grupe për format e objekteve në figura, për ngjyrat. Shpjegojnë pse janë përdorur ato, çfarë ka dashur piktori të shprehë përmes tyre. Çfarë iu pëlqen më tepër në çdo pikturë? Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Vizatojnë kafshën e preferuar në letër dhe e përshkruajnë atë. Nxënësit bëjnë portrete të njëri-tjetrit dhe i prezantojnë ato. Përdorin me saktësi materiale për vizatim.	
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; dhënien e ideve interesante; fjalorin e përdorur; bashkëpunimin në grup; aftësitë krijuese; zbatimin e rregullave të mirësjelljes.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kërmilli dhe trëndafili (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Pyetje e shtruar për diskutim. Çdo të thotë të jesh i dobishëm në shoqëri? Nxënësit/et sjellin idetë e tyre të cilat, nëpërmjet diskutimit bëhen të gjalla për të gjithë grupin e klasës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ora e parë Nxënësi/ja: - dallon njeriun me vlera në shoqëri; - lexon fragmentin në role; - ritregon subjektin duke respektuar ligjëratën e Drejtë. Ora e dytë Nxënësi/ja: - vlerëson rolin dhe funksionin e figurës letrare të personifikimit ilustruar në personazhet e pjesës; - dallon shprehjet frazeologjike; - krahason personazhet; - shkruan një mbyllje tjetër për përrallën.		Fjalët kyçe: i dobishëm, kërmilli, trëndafili, sakrifikon, përfiton, vlera.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Lexim në role. Punë në grupe. Ditari dypjesësh. Diagrami i Venit.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet titulli i pjesës dhe u jepen nxënësve të dhëna plotësuese për autorin, Hans Kristian Andersen. Andersen, lindi më 2 prill 1805 dhe ndërroi jetë më 4 gusht 1875. Edhe pse ishte një shkrimtar prodhimtar që shkroi kujtime udhëtimesh, novela dhe poezi, i famshëm u bë përmes përrallave nga bota e zanave dhe shtojzovallëve. Popullariteti i Andersenit nuk është i kufizuar te fëmijët; tregimi i tij, quajtur eventyr në danisht, ose “përralla” në gjuhën angleze, shpreh tema që e tejkalojnë moshën dhe kombësinë. Përrallat e Andersenit, të cilat janë përkthyer në më shumë se 125 gjuhë dhe ngulitur në vetëdijen kolektive të lexuesve anë e kënd botës, janë kryesisht të preferuara nga fëmijët. Disa nga krijimet e tij më popullore janë përrallat magjike si “Sirena e Vogël”, “Rosaku i vogël e i shëmtuar”, “Bilbili”, “Rrobat e reja të mbretit” dhe shumë të tjera. Tregimet e tij kanë frymëzuar drama, shfaqje të baletit, si dhe filma të animuar Disney.			

Fragmenti lexohet një herë nga mësuesi/ja. Përmes leximit në role caktohen nxënës/e për të interpretuar fragmentin. Shpjegimi i fjalëve të reja dhe ndërtimi i fjalive me to.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të rubrikës: *Kuptojmë tekstin*.

Sqarohet figura e personifikimit.

Personifikimi

- Figurë stilistike që i vesh kafshës apo sendit tipare njerëzore.
- Gjërat pa shpirt veprojnë, mendojnë e flasin si njerëz (fabula, përralla).

Ushtrimi 2. Çfarë vlerësonte kërmilli? *Për kërmillin ishte me vlerë të rrinte i mbyllur brenda guaskës së tij...*
Çfarë vlerësonte trëndafili? *Trëndafili fitoi kënaqësinë që i fali jeta, të kënaqë të tjerët...*

Ushtrimi 3. Çfarë personifikon trëndafili/Po kërmilli? Nxënësit japin mendimet e tyre, duke iu referuar edhe jetës reale.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. *Punë në grupe. Diagrami i Venit. Ditari dypjesësh.*
Grupi I punon ushtrimin 4 (*Tema e kësaj përralle ka të bëjë me qëndrimet e ndryshme që mbajnë edhe vetë njerëzit ndaj njëri-tjetrit dhe vetë jetës*). Mesazhi i pjesës.

Grupi II punon ushtrimin 5. Nxënësit renditin të gjitha fjalët e kërmillit drejtuar trëndafilin. Ata argumentojnë nëse qëndrimi i tij ka ndryshuar me kohë.

- *Çfarë i kam dhënë? Çfarë t'i jap? E kujt i hyn në punë...*

Grupi III punon ushtrimet 6, 7. Nxënësit dallojnë elementet fantastike të përrallës, nisur nga veçoritë e saj.

Frazat që përcaktojnë vendin, kohën dhe zhvillimin e ngjarjes.

Vendi: përreth kopshtit, gardh lajthish, mu në mes të kopshtit.

Koha: vitin tjetër, kaloi vera, erdhi vjeshta, filloi të binte borë, erdhi përsëri pranvera, vitet kaluan njëri pas tjetrit.

Zhvillimi i ngjarjes: lulëzonte një trëndafil, nën dhe qëndronte një kërmill, me nge, u plaken, iu gëzuan jetës, kërmilli u struk.

Grupi IV punon ushtrimin 8. *Ditari dypjesësh.*

Shprehjet frazeologjike	Fjala përkatëse
merret vesh	kuptohet
keni vrarë mendjen	keni menduar
nuk i hyn në punë	nuk ka vlerë
i mbaj mend gjithë jetën	i kujtoj

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Më pas, përfaqësues të grupeve prezantojnë përgjigjet.

Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura.

Diagrami i Venit.

Ushtrimi 9. Nxënësit krahasojnë kërmillin me trëndafilin, idetë që dalin nga secili, sjelljet dhe veprimet gjatë përrallës.



Punohet në tabelë nga një nxënës.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Përmbledhni shkurt me 2-3 fjali formën tuaj të mbylljes për përrallën.

Argumentoni arsyet e zgjedhjes suaj (detyra fq. 88).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ndajfolja Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe.</i> Analizoni fjalitë e mëposhtme: Ajo fliste <u>qartë</u> e <u>shkurt</u> për problemet e klasës. Kjo situatë të çon <u>shumë larg</u> në mendime. Është e mbyllur <u>plotësisht</u> dritarja. Nxënësit/et analizojnë fjalitë që janë dhënë në tabelë. Fjalët: <i>qartë, shkurt, larg</i> , plotësisht, janë ndajfolje që emërtojnë një tipar, të një veprimi (fjalë 1, 2) a të një gjendjeje (fjalë 3), pra një rrethanor të kryerjes si një veprim të shprehur nga folja. Kështu, nxënësit/et formulojnë përkufizimin për ndajfoljen si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon ndajfoljet; - tregon vendin që zë ndajfolja në fjali; - kthen mbiemrat në ndajfolje duke përdorur trajtat e sakta të fjalëve; - dallon llojet e ndajfoljeve; - vendos ndajfoljet në shkallë të ndryshme.		Fjalët kyçe: ndajfolje, vendi, kohe, mënyre, shkaku, sasi, shkallët e ndajfoljeve, pohore, shkalla sipërore, shkalla krahasore.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, njohuritë e nxënësve, FVK - Fletorja e vlerësimit të kompetencave.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Shpjegim i lidhur me diskutimin.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektesia në kryerjen e tyre. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Punë në dyshe.</i> Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër fq. 207-208, për ndajfoljet. Ky informacion për ndajfoljen tregon: - ku e ka vendin në fjali; - sa llojesh janë ato; - në sa shkallë përdoren ndajfoljet. Nxënësit/et punojnë me tabelën për llojet e ndajfoljeve, i përsëritin në dyshe për të mbajtur mend sa më shumë ndajfolje, pyesin njëri-tjetrin.			

U shpjegohet nxënësve shkalla e ndajfoljes. Jepen shembuj për çdo shkallë. Kërkohet nga nxënësit/et që me ndajfoljet e tabelës të formojnë fjali, duke i përdorur ato në tri shkallët. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënësit/et punojnë në libër ushtrimet 1, 3, 5 në grupe dyshe. Kontrollonjë punën e njëri-tjetrit në grupe dyshe. Pastaj i punojnë në të gjithë klasën. Qortohen gabimet që mund të kenë bërë. Ushtrimet 2, 4 punohen në tabelë nga dy nxënës, kurse klasa punon në fletore. Për ushtrimin 2, sqarohen nxënësit se mbiemrat vijnë nga ndajfoljet, me nyjëzim dhe zakonisht kur kthejmë në ndajfolje mbiemrat, zanorja ë fundore bie. <i>i drejtë – drejt</i> Nxënësit prezantojnë përgjigjet. Verifikohet saktësia nga nxënësit e tjerë, duke qortuar gabimet.
Vlerësimi: Vlerësohen me gojë në situatën e të nxënit; vlerësimin në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim; vlerësimi për detyrën e shtëpisë.
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 4, 5, fq. 208.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Bretkosa që desh të trashej sa një ka. Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Imagjinata e drejtuar.</i> Nxiten nxënësit/et që nëpërmjet disa fjalëve kyçe, të cilat shënohen në dërrasë të zezë, të ndërtojnë një rrëfim të shkurtër sipas imagjinatës së tyre <i>zili, mburrje, bretkosa, kau, plasi.</i> Nxënësit/et përqendrohen në fjalët e dhëna e më pas e shfrenojnë fantazinë për të realizuar rrëfimet e tyre. Disa prej nxënësve, me dëshirë, e lexojnë rrëfimin para grupit të klasës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - ndërton një rrëfim, bazuar në fjalë kyçe; - interpreton me role fabulën; - njeh dhe dallon figurën e antitezës; - dallon veçoritë e fabulës duke i konkretizuar secilën prej tyre; - gjykon mbi vlerën e kësaj fabule duke shqyrtuar aktualitetin e saj; - kthen fabulën në prozë; - dramatizon fabula të shkurtra.		Fjalët kyçe: zili, mburrje (mburrej), bretkosa, kau, plasi.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, biblioteka.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Imaginatë e drejtuar. Interpretim. Pyetje-përgjigje. Punë në grupe. Ditari dypjesësh.

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektësia në kryerjen e tyre.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Nxënësit krijojnë një ndodhi, bazuar mbi fjalë kyçe.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet titulli i fabulës, nxënësve u flitet për autorin dhe përmenden krijime të tjera nga La Fonten.

Zhan de la Fonten lindi më 8 korrik të vitit 1621 dhe u nda nga jeta më 13 prill të vitit 1695.

Ai ishte Poeti Kombëtar i Francës, një ndër krijuesit më prodhimtarë në botë që shkroi pothuaj në të gjitha gjinitë, por shkëlqeu veçanërisht me fabulat e mrekullueshme, të cilat e vunë në radhët e fabulistëve më të mëdhenj të botës.

Fonteni e njohu gjithë traditën e pasur të fabulës greke, latine dhe orientale. Por ai e ripërtëriu zhanrin e fabulës antike. Rëndësia e La Fontenit në letërsinë botërore është se ai krijoi një zhanër të ri të fabulës. Në vitin 1668 dolën në dritë gjashtë librat e parë me fabula, me një titull modest: “Fabula të Ezopit”, përshtatur në vargje; botimi i dytë, që përmbante tashmë 11 libra doli më 1678, kurse i treti përfshiu librin e 12 dhe të fundit, më 1694. La Fonteni, ky fabulist botërisht i njohur është përkthyer pjesërisht edhe në shqipe nga mjeshtra të penës si: Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi, Vedat Kokona, Omer Nishani e Sotir Caci.

Prezantohet fabula dhe më pas dy grupe nxënësish e interpretojnë atë në role. Kërkohet nga nxënësit/et që të vlerësojnë interpretimet e shokëve.

Pyetje-përgjigje.

Më pas nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve:

Çfarë dëshiron bretkosa?

Si vepron ajo?

Cilat janë fjalët e bretkosës drejtuar shoqeve?

A i dëgjon ajo këshillat e shoqeve?

Si e pëson bretkosa ziliqare?

Nxënësit/et argumentojnë përgjigjet dhe nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Ritregohet fabula me 5-6 fjali.

Ushtrimi 2. Nxënësit/et qarkojnë alternativën që përkon me mesazhin e kësaj fabule.

U shpjegohet se çfarë është antiteza.

Antiteza

përftohet nga vënia përballë e dy anëve, dy gjendjeve, dy dukurive të kundërta.

Ajo ndërtohet mbi antonime: ve-deve, gëzimet janë tonat/hidhërimet gjithashtu.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe. Ditari dypjesësh

Nxënësit ndahen në grupe, për të punuar pyetjet e rubrikave.

Grupi I. *Ditari dypjesësh.*

Veprimet e bretkosës në fabul. Foljet	Mënyra e foljeve
pa, la, desh, vu, vate, u shtri, thërrit’, e thoshte, thoshnë, u fry, plasi, u rrita, mendohen, mburren, lëvdohen.	dëftore
të trashet, të fryhet,	
shihni, shikoni	lidhore urdhërore

Grupi II punon ushtrimet 4 dhe 5. Grupi III punon ushtrimin 6. Përfaqësues të grupeve paraqesin përgjigjet. Nxënësit mund të plotësojnë mendimet e shokëve/shoqeve. Ushtrimi 7. <i>Gjykoni mbi vlerën e kësaj fabule duke shqyrtuar aktualitetin e saj.</i> Nxënësit/et punojnë në heshtje. Në minutat e fundit, 2-3 prej tyre paraqesin detyrën para grupit të klasës. Disa përfundime të rëndësishme shënohen në dërrasë të zezë.
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur: Shndërrojeni fabulën në prozë. Vendosni një titull tjetër për rrëfimin tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Lidhëzat Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe.</i> Nxënësit/et lexojnë fjalitë dhe dallojnë lidhëzat, (sipas njohurive që kanë marrë në klasën 5). Ana bleu në treg fruta dhe zarzavate. (dy fjalë) Bleu edhe vezë, kurse djathin e bleu te dyqani i pallatit. (dy fjali) I ra rrugës shkurt, sepse ishte me vonesë për punë. (dy fjali) Nxënësit/et dallojnë lidhëzat kur lidhin dy fjalë në fjalinë e thjeshtë, dy pjesë në fjalinë e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje. U kërkohet nxënësve që të formojnë përkufizimin për lidhëzat si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon lidhëzat kur lidh dy fjalë dhe kur lidh dy fjali; - dallon lidhëzat bashkërenditëse shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse; - njeh llojet e lidhëzave nënrenditëse; - i përdor lidhëzat në fjali.		Fjalët kyçe: lidhëza bashkërenditëse, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse, nënrenditëse.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, njohuritë e nxënësve, FVK - Fletorja e vlerësimit të kompetencave.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Punë në dyshe. Lojë gjuhësore. Praktikë e drejtuar. Diskutim. Punë në dyshe. Punë individuale.

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektësia në kryerjen e tyre (ushtrime për ndajfoljen).

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Nxënës/et punojnë në grupe dyshe për t'u njohur me lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse. Punojnë në dy tabelat e llojeve të lidhëzave.

Përsëritin me njëri-tjetrin llojet e lidhëzave bashkërenditëse, pyesin njëri-tjetrin.

Lojë gjuhësore:

Përmes kësaj veprimtarie, njëri nxënës/e thotë lidhëzën, nxënës/ia gjen ç' lloj lidhëze është. Aktivizohen të gjithë nxënës/et për të mbajtur mend 4 llojet e lidhëzave bashkërenditëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Praktikë e drejtuar. Punë në dyshe.

Punohet bashkë me nxënës/et ushtrimi 1. Nxënës/et dallojnë llojet e lidhëzave.

Tek ushtrimin 3 dallojnë kur lidhëzat lidhin dy fjalë dhe kur lidhin dy fjali.

Punë në dyshe

Ushtrimet 2, 4 nxënës/et i punojnë në libër në grupe dyshe, qortojnë punën e njëri-tjetrit.

Punë individuale

Ushtrimet 5, 6 i punojnë dy nxënës/e në dërrasë, përdorin në fjali llojet e lidhëzave që janë dhënë dhe dallojnë llojet e lidhëzave të paragrafi i parë të pjesa "Dashuria e nënës".

Vlerësimi: Vlerësimi në situatën e të nxënësve; vlerësimin të punës në grup dhe gjatë lojës gjuhësore; vlerësimi për punimin e ushtrimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 7, fq. 211 sipas kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Lidhëzat. Fletorja e vlerësimit të kompetencave. FVK. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: Pema e mendimit – Lidhëzat <pre>graph TD; A[Lidhëzat] --> B[Shërbejnë]; A --> C[Llojet]; B --> D[]; B --> E[]; D --> D1[]; D --> D2[]; D --> D3[]; D --> D4[]; E --> F[]; E --> G[]; F --> F1[]; F --> F2[]; F --> F3[]; F --> F4[]; F --> F5[]; F --> F6[]; F --> F7[]; F --> F8[]; G --> G1[]; G --> G2[]; G --> G3[]; G --> G4[]; G --> G5[]; G --> G6[]; G --> G7[]; G --> G8[]</pre>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - plotëson <i>Pemën e mendimit</i> – Lidhëzat; - dallon llojet e lidhëzave; - vendos lidhëzat në fjali të ndryshme; - i përdor lidhëzat në fjali.	Fjalët kyçe: lidhëza bashkërenditëse, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse, nënrenditëse, lidhëza nënrenditëse.
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, njohuritë e nxënësve, FVK- Fletorja e vlerësimit të kompetencave	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pemë mendimi. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim. Punë individuale.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektesia në kryerjen e tyre. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Nxënësit/et përsëritin njohuritë në lidhje me lidhëzat, duke iu referuar kryesisht lidhëzave bashkërenditëse. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Puno/shkëmbe në dyshe. Hapet FVK në faqen 36. Nxënësit do të punojnë në fletore ushtrimet 1 dhe 3. Këmbejnë librat me shokun/ shokën e bankës dhe verifikojnë saktësinë në kryerjen e ushtrimeve. Përgjigjet lexohen nga nxënës të ndryshëm para klasës. Ushtrimet 2, 4, 5 do të paraqiten në tabelë nga tre nxënës. Nxënësit e tjerë punojnë në fletore. Prezantohen përgjigjet nga nxënësit që kanë punuar në dërrasën e zezë, kurse të tjerë verifikojnë saktësinë në kryerjen e tyre.	
Vlerësimi: Vlerësohen për saktësinë në punimin e ushtrimeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; pjesëmarrjen gjatë orës së mësimi.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Dalloni në tre paragrafët e fundit të pjesës “Kërmilli dhe trëndafili” llojet e lidhëzave që janë përdorur. Tregoni se çfarë lidhin ato.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Dëgjomë dhe recitojmë poezi. Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.		Situata e të nxënit: Zhvillohet një kuic përmes të cilit recitohen vargje nga poetë të ndryshëm, duke kërkuar nga nxënësit/et të gjejnë autorin apo titullin e poezisë që recitohet (poezitë të jenë edhe nga ato që nxënësit mund të kenë mësuar më parë në shkollë). Nxënësit/et marrin pjesë aktive që pas dëgjimit t’u përgjigjen kërkesave të kuiceve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon poezi dhe shpreh kënaqësi gjatë dëgjimit të poezive; - shpjegon dhe komenton kuptimin e vargjeve të ndryshme nga poezi të ndryshme të cilat i kanë pëlqyer; - shpreh pëlqimet mbi interpretimet e shokëve duke i ilustruar me vargje nga tekstet e recituara; - analizon me thjeshtësi gjuhën e figurshme në tekste poetike; - mbledh poezi; - krijon album në bashkëpunim me grupin; - bashkëbisedon lirshëm me poetin.		Fjalët kyçe: poezi, vargje, ndjenjë, gjuhë poetike, poet/e.	
Burimet: teksti i nxënësit, libër me poezi		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Kaic. Punë në grupe. Konkurs. Takim poetik.			

Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Punë në grupe. Konkurs</i> Një orë më parë, janë porositur nxënës/et që të sjellin vëllime me poezi nga autorë shqiptarë dhe të huaj. - Nga vëllimet poetike që kanë sjellë përzgjedhin dhe recitojnë nga një poezi. - Prezantojnë poezitë nga çdo nxënës në grupet përkatëse. - Lexojnë poezi dhe i komentojnë ato. - I bëjnë pyetje njëri-tjetrit. - Shprehin pëlqim për vargjet që dëgjojnë. Në çdo grup dëgjojnë dhe recitojnë poezitë e librit nga autorë shqiptarë. Nxënës/et i lexojnë të gjitha poezitë. - Ata përzgjedhin një poezi që duan ta mësojnë apo të recitojnë në grup. - Nga çdo grup një nxënës/e lexon poezinë e tij para të tjerëve. - Juria e ngritur që më parë shpall fituesin. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënës/et në grupe të formuara që më parë zgjedhin nga një poezi dhe krijojnë së bashku albumin e tyre poetik (në formë libri). I vënë një titull. Provojnë ta shpërndajnë brenda një kostoje modeste për nxënës/e të klasave të tjera, duke nxjerrë kështu koston e kopertinës dhe të letrës, ose e këmbëjnë me diçka tjetër që iu duhet. <i>Takim me një poet/e.</i> Sipas mundësive që kanë, bëjnë një takim me një poet/e e pasi bisedojnë dhe i bëjnë pyetje të ndryshme, i dhurojnë një buqetë me lule dhe lexojnë poezi nga vëllimet poetike të poetit/es duke ia recituar.
Vlerësimi i orës së mësimit. Ora quhet e realizuar, kur nxënës/et arrijnë të zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë dhe ndjenjat e tyre përmes poezisë; recitojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin, kur dëgjojnë me vëmendje, kur përgatisin produkte e material pune, në rastin tonë albumin poetik, kur i publikojnë ato. Konkursi dhe çmimet janë vlera të punës së kryer.
Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Bagëti e bujqësia Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënët: <i>Stuhi mendimi</i> Nxiten nxënësit drejt diskutimit në lidhje me çështjen. Çfarë dini ju për jetën dhe krijimtarinë e Naim Frashërit? <i>Lindi në Frashër të Përmetit (1846-1900)</i> <i>Mësimet e para i mori në vendlindje.</i> <i>Studimet e para mori në gjimnazin Zosimea të Janinës.</i> <i>Punoi si doganier në Sarandë e Berat.</i> <i>Veprat letrare</i> <i>“Bagëti e Bujqësi” “Historia e Skënderbeut”, “Lulet e verës”, “Vjersha për mësonjëtorët e para” etj.</i> Nxënësit/et sjellin mendimet e tyre të cilat nëpërmjet diskutimit bëhen të dukshme për gjithë klasën. Më pas, nxënësit/et recitojnë vjersha të Naim Frashërit të mësuara në klasat 1-5.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njeh jetën e veprën e Naim Frashërit duke recituar poezi të ndryshme të tij; - njihet me poemën, si lloji më i gjatë i tekstit poetik; - njeh dhe dallon rimën; - dallon figurat letrare; - kthen fjalët dialektore në gjuhën standarde; - zbulon temën kryesore dhe mesazhin e poemës duke ilustruar përmes vargjeve; - interpreton rolin dhe funksionin e figurës së apostrofit.		Fjalët kyçe: Shqipëri, nder, male, fusha atdhetdashuri, burra, trima, zemër, shqiptar.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, biblioteka.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Interpretim. Pyetje-përgjigje. Shkrim i lirë. Shpjegim. Diskutim. Punë në grupe.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektesia në kryerjen e tyre. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës të së së nxënët. Ndërtimi i njohurive të reja.			

Prezantohet titulli i pjesës dhe shpjegohet se çfarë është poema.

Poema është vepër e gjatë e shkruar në vargje, në të cilën autori krahas ndjenjave përfshin edhe ngjarjen. Poema “Bagëti e bujqësia” është poemë lirike. Në të pasqyrohen vetëm ndjenjat e poetit.

Interpretohet poezia, në fillim nga mësuesi/ja dhe më pas nga dy nxënës/e.

Gjatë rileximit të fragmentit të poemës “Bagëti e bujqësia”, nxënësit/et punojnë pyetjet e rubrikës: Kuptojmë përmbajtjen.

1. Autori poemën ia kushton bukurisë së atdheut nga dashuria e madhe që ka për të. Thirrja e tij i drejtohet kujtdo që e ndjen veten shqiptar.

2. Autori ndjen mall për vendlindjen pasi ai jeton larg. Kjo duket në vargun e tretë dhe të katërt.

3. Poeti ndihet krenar, i malluar për gjithçka që lidhet me atdheun e tij.

4. Vargjet që shprehin bukurinë e atdheut: lisat e gjatë, fushat e gjëra, bregore bukuroshe, lumenj të kulluar...

5. Ky lloj krahasimi bëhet me qëllim për të treguar lidhjen e fortë mes tij dhe atdheut. Poeti nuk mund të jetojë larg atdheut edhe pse has shumë pengesa e vështirësi në rrugën e tij.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Punë në grupe

Do të diskutohen në grupe pyetjet e rubrikave të tekstit.

Grupi I punon ushtrimin 2. Nxënësit, përmes *Shkrimit të lirë*, do të sjellin përfytyrimin që u lind, kur lexojnë katër vargjet e para dhe katër vargjet e fundit të poemës.

Grupi II. Nxënësit do të plotësojnë tabelën e figurave letrare.

epiteti	lisat e gjatë, fushat e gjëra, bregore bukuroshe, lumenj të kulluar...
krahasimi	qysh e le qengji koponë, ashtu dhe zemëra ime...

Grupi III punon ushtrimin 5. Nxënësit nënvizojnë fjalët dialektore dhe shkruajnë bri tyre gjegjëset në gjuhën standarde.

Fjala dialektore	Gjegjësjë në gjuhën standarde
këndonj	këndo
mëndjen	mendjen.....

Përfaqësues të grupeve paraqesin përgjigjet. Nxënësit mund të plotësojnë mendimet e shokëve/shoqeve.

Nxënësve u shpjegohet rima dhe llojet e saj.

Rima është përputhja e tingujve në fund të dy a më shumë vargjeve. Ajo bazohet në përsëritjen e zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Llojet e rimës: AABB (e përputhur), ABAB (e alternuar), ABBA (e përmbyllur). Jepen shembuj nga teksti.

Ushtrimi 4. Nxënësit dallojnë rimën e poezisë (AABB).

Ushtrimi 6. *Shkrim i lirë*. Nxënësit individualisht shkruajnë idetë dhe mesazhin e poemës. Lexohen disa nga detyrat që ata kanë realizuar. Idetë dhe mesazhi paraqiten në tabelë në mënyrë të përmbledhur.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjenero poezi të autorëve të tjerë që kanë përdorur bukurinë e atdheut. Mësojini përmendësh.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Parafjala Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe.</i> Nxënësit lexojnë fjalitë dhe dallojnë parafjalët, (sipas njohurive që kanë marrë në klasën 5). - E njoha nga afër atë vend. (para ndajfoljes) - Do të shkoj në kinema me motrën. (para emrit) - Duhet të mësohesh edhe nga ata. (me përemër) - Me dhjetë euro mund ta blesh lodrën. (me numëror) Nxënësit/et dallojnë parafjalët, para cilave fjalë qëndrojnë ato, ç’marrëdhënie shprehin.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon parafjalët duke treguar gjymtyrët që ato u prijnë; - dallon parafjalët sipas rasave; - dallon kur e njëjta fjalë është ndajfolje dhe parafjalë.		Fjalët kyçe: parafjalë, rasat emërore, kallëzore, rrjedhore, emër, përemër, numëror	
Burimet: libri i gjuhës shqipe, klasa VI, njohuritë e nxënësve, FVK - Fletorja e vlerësimit të kompetencave.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pyetje-përgjigje. Punë në dyshe.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Përsëriten njohuritë që nxënësit i kanë marrë në klasën 5.

Ndërtimi i njohurive të reja. Pyetje-përgjigje në dyshe

Nxënësit/et njihen me informacionin e dhënë në libër për parafjalën dhe përgatisin pyetje për çështjet kryesore:

- Cili është kuptimi i parafjalës?
- Para cilave fjalë qëndrojnë parafjalët?
- Cilat rase mund të marrin parafjalë?
- Cilat janë parafjalët në rasën emërore?
- Cilat janë parafjalët në rasën kallëzore?
- Cilat janë parafjalët në rasën rrjedhore?
- Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe me pyetjet, provojnë t'u përgjigjen. Pastaj disa nxënës/e lexojnë pyetjet dhe të tjerë u përgjigjen.
- Nxënësit/et punojnë me tabelën për ndarjen e parafjalëve në rase, i dallojnë ato nga njëra-tjetra.
- U sqarohet nxënësve kur e njëjta fjalë në fjali mund të përdoret edhe si parafjalë, edhe si ndajfolje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në dyshe

Nxënësit/et punojnë në libër ushtrimet 1, 2, 3, 5 në grupe dyshe. Pastaj i punojnë në të gjithë klasën.

Qortohen gabimet që mund të kenë bërë.

Nxënësit/et vendosin ndajfoljet ose parafjalët e ushtrimit 6 në tabelë

Kontrollojnë punën e njëri-tjetrit në grupe dyshe.

Ushtrimi 7. Nxënësit argumentojnë përse gjymtyrët e nënvizuara dalin herë si parafjalë, e herë dalin si ndajfolje.

Aktivizohen nxënës të ndryshëm në dhënien e përgjigjeve.

Ushtrimet 8, 9 do të punohen nga dy nxënës në tabelë, kurse nxënësit e tjerë do të punojnë në fletore.

Prezantohen përgjigjet. Mblidhen fletoret për t'u vlerësuar.

Vlerësimi: Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënësve; vlerësimin në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim; vlerësimi për detyrën e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Te pjesa “Kapelja që flet”, fq. 65, dalloni dhe emërtoni parafjalët sipas rasave.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë vjersha me rimë (2 orë) Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënit: Nxënësit dëgjojnë poezi të ndryshme të regjistruara. Ata mund të recitojnë poezi nga librat që kanë sjellë në klasë. Nxënësit komentojnë dhe shprehin pëlqimet e tyre mbi vargjet dhe strofat që lexuan.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Orë e parë Nxënësi/ja: - interpreton poezi dhe shpreh pëlqimet në lidhje me vargjet; - diskuton për llojet e rimës që përdoren në një poezi; - kthen një prozë poetike në një poezi, duke përdorur lloje të ndryshme të rimave. Ora e dytë Nxënësi/ja: - shkruan poezi duke përdorur imagjinatë; - zbaton vargun dhe rimën duke përdorur edhe imagjinatën; - shkruan poezi deri në tri strofa; - përdor figura letrare.	Fjalët kyçe: poezi, varg, ndjenjë, frymëzim, figura letrare, strofë.
Burimet: libra me poezi, teksti i nxënësit.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe vepritaritë e nxënësve Interpretim. Minileksion. Punë në grup. Puno/shkëmbe në dyshe. Shkrim i lirë. Turi i galerisë.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Minileksion</i> Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit flasin për vargun dhe rimën dhe dallojnë llojet e strofave: ABAB, AABB, ABBA etj. U jepet informacion shtesë në lidhje me këto njohuri mbi vjershërimin. Përcaktojnë rrokjet fundore në poezi, si dhe ndonjë figurë letrare: krahasim, epitet, metaforë. <i>Puno/shkëmbe në dyshe</i> Ushtrimi 2. Nxënësit përcaktojnë llojin e rimës të poezia “Mëmëdheu”. Këmbejnë mendime me shokun/shoqen e bankës. Ushtrimi 4. Nxënësit do të kthejnë prozën poetike të Faik Konicës “Bora”, në një poezi, duke përdorur lloje të ndryshme të rimave (AABB, ABAB, ABBA). Prezantim në grupe dyshe. Më pas disa prej krijimeve të nxënësve do të lexohen para klasës. Ora e dytë Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. <i>Shkrim i lirë. Turi i galerisë</i> Shkruani një poezi me katër strofa. Zgjidhni titullin që dëshironi. Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur. Më pas, përmes <i>Turit të galerisë</i>, nxënësit prezantojnë punimet para klasës. Vlerësohen punimet më të mira. Punimet do të mblidhen dhe do të vlerësohen me notë.	
Vlerësimi i orës. Kjo orë mësimore është e suksesshme dhe e arrirë në momentin që nxënësit kanë ndjekur të gjithë hapat e mësipërm deri në hapin final. Nxënësit e finalizojnë këtë situatë të nxëni duke vlerësuar punët e njëri-tjetrit, duke nxjerrë në pah anët pozitive dhe mangësitë. Komentojnë, bëjnë konkurs, shpallin fituesin.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Gjuha shqype (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Stuhi mendimi.</i> Çfarë dini ju për veprën e Fishtës? Nxënësit/et sjellin mendimet e tyre. Ndërkohë me to, plotësohet <i>Pema e mendimit</i> - Gj. Fishta. Gjergj Fishta poet pasardhës i gjuhëtar dramaturg patriot prift Nxënësit/et recitojnë vargje për gjuhën shqipe dhe realizohet një diskutim për: - origjina (pellazgjishtja); - vjetërsinë e saj (dokumenti i parë Formula e pagëzimit, Pal Engjëlli, 1462); - dialektet (gegërishtja, toskërishtja); - flitet në të gjitha trojet ku ka shqiptarë; - i kanë kënduar: Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Ismail Kadare etj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe veprimtarinë e Fishtës; - kupton drejt vargjet e poezisë; - diskuton mbi përdorimin e bukur e të gjetur të dialektit gegë në vargjet e kësaj poezie. Ora e dytë Nxënësi/ja: - dallon vendin e gjuhës shqipe në mesin e gjuhëve të botës. - tregon rolin dhe funksionin e figurës së anaforës; - jep qëndrimin e tij si mesazhi poetik i Fishtës është ende aktual edhe sot.		Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, e bukur, ushtimë tërmeti, kënga e zogut të verës, zë i ëmbël, bashkon, mallkon.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, biblioteka.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Pemë mendimi. Lexim shprehës. Diskutim. Punë në dyshe. Rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet poezia, e cila më pas do të interpretohet nga dy nxënës. Shpjegimi i fjalëve të fjalorit dhe ndërtimi i fjalive të reja.

Gjatë rileximit me intonacionin e duhur të poezisë “Gjuha shqype” e Fishtës, nxënësit/et punojnë në dyshe ushtrimet 1, 2.

1. Në strofën e parë të poezisë, autori përcakton **bukurinë** e gjuhës shqipe.

2. Në strofën e dytë të poezisë, na tregon se gjuha shqipe është **historia e një populli**.

3. Në strofën e tretë të poezisë, autori na tregon se gjuha shqipe **bashkon shqiptarët kudo që janë**.

Ushtrimi 2 (qëllimi i kësaj lirike është të himnizojë gjuhën shqipe).

Ora e dytë**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.***Diskutim*

Ushtrimi 3. Nxënësit këtu do të interpretojnë edhe vargje nga poezia me intonacionin e duhur.

Lavdëron gjuhën amtare (zëri i qetë, i ngadaltë...).

Mallkon atë që mohan këtë gjuhë (zëri i rreptë, i prerë, i fortë).

Këto vargje shënohen edhe në dërrasë të zezë.

Porsi kanga e zogut t' verës

që vallzon n'blerim të pyllit

porsi i ambli fllad i erës

që lëmonn gjit e dronda fillit

porsi vala e bregut t' detit

porsi gjama e rrfes zhgjetare

njashtu ashtu gjuha jon shqyptare...


Nënvizohen në këto vargje fjalët që përsëriten dhe u shpjegohet nxënësve roli dhe funksioni i tyre.

Shpjegohet figura e anaforës

Anafora është përsëritja e një fjale a togu fjalësh në fillim të dy a më shumë vargjeve ose frazave. I jep vargut muzikalitet dhe thekson atë që do autori.

Ushtrimet 5, 6. Nxënësit dallojnë anaforat dhe tregojnë funksionin e tyre.

Rrjeti i diskutimit (Pyetja binare)



Ushtrimi 7.

Po A mendoni se mesazhi i Fishtës Jo

është aktual edhe sot?

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Në minutat e fundit dy-tre prej tyre e lexojnë detyrën para klasës. Përfundimet më të rëndësishme shënohen në dërrasë të zezë.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra, fq. 97. Mësoni përmendsh 20 vargje nga poezia.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ushtrime për ndajfoljet, parafjalët. (FVK) Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Morfologji)		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe.</i> Paraqiten në tabelë disa fjali. Nxënësit do të dallojnë në dyshe klasën e fjalëve të nënvizura. <i>Kishte ikur <u>larg</u> dhe nuk kishin marrë lajme.</i> <i><u>Larg</u> tyre ndihej i malluar.</i> <i><u>Përtej</u>, maleve të larta, ndodhej fshati i tij.</i> <i>Shikimi iu ndal <u>përtej</u> dritares.</i> <i>Ishin larguar <u>matanë</u> kodrave të bleruara.</i> <i>Hidhemi <u>matanë</u> njëherë, pastaj flasim.</i> <i>Vendosi <u>para</u> një saks me lule.</i> <i><u>Para</u> tij u ndal një makinë e kuqe.</i> Nxënësit, në grupe dyshe, emërtojnë fjalët e përdorura si ndajfolje dhe si parafjalë. Prezantohen përgjigjet nga nxënës të ndryshëm.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kur e njëjta fjalë përdoret si ndajfolje dhe si parafjalë; - emërton ndajfoljet sipas llojit të tyre; - përdor ndajfoljet në shkallë të ndryshme; - dallon parafjalët sipas rasave; - i përdor parafjalët në fjali.		Fjalët kyçe: ndajfolje, parafjalë, përdorim, rasë, shkallë, fjali.	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, FVK.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Punë në grupe. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektesia në kryerjen e tyre.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Nxënësit argumentojnë rastet kur e njëjta fjalë përdoret si ndajfolje dhe si parafjalë.

Ndërtimi i njohurive të reja.**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe**

Nxënësit ndahen në dy grupe.

Grupi I punon ushtrimet e faqes 35 të FVK - Ndajfolja. Nxënësit do të punojnë individualisht në fletoret e punës.

Grupi II punon ushtrimet e faqes 37 të FVK - Lidhëzat. Nxënësit do të punojnë individualisht në fletoret e tyre.

Pas përfundimit të punës, nxënës të ndryshëm prezantojnë përgjigjet e ushtrimeve. Bëhen ndërhyrjet e duhura aty ku është e nevojshme.

Mund të mblidhen edhe fletore të nxënësve, për t'u vlerësuar me notë, në kompetencën: Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Vlerësimi: Vlerësoni për situatën e të nxënësve; saktësinë në plotësimin e ushtrimeve të fletores së punës; në detyrën e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Zemra e liqerit (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënët: Prezantim digjital. Interpretim. Diskutim Nxënësve në videoprojektor u shfaqen pamje të ndryshme, në të cilat vendin kryesor e zënë ato për liqenin e Poradecit, por dhe ilustrimi i poezisë “Vdekja e Nositit” apo ajo e “Gjeniut të anijes”. Në pamundësi të tyre, nxënësve u interpretohen disa vargje nga poezitë e Lasgush Poradeci. Pas leximit të tyre shtrohet çështja për diskutim. Për çfarë ka shkruar autori në këto poezi? Nxënësit/et sjellin mendimet e tyre me anë të të cilave plotësohet edhe kllsteri. Lasgush Poradeci shkruan për: <pre>graph TD; A([Poezia lasgushiane]) --> B[natyrën]; A --> C[dashurinë]; A --> D[sakrifikimin]; A --> E[vetëflirimin për artin];</pre>	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe krijimtarinë e autorit; - interpreton me ndjenjë poezinë e u përgjigjet pyetjeve të përmbajtjes; - komenton titullin e poezisë. Ora e dytë Nxënësi/ja: - përshkruan lidhjen shpirtërore të poetit me liqenin; - dallon si natyra shkrihet njësh me poetin; - dallon figurën e aliteracionit dhe shpjegon rolin e tij; - zbërthen rolin dhe funksionin e figurave letrare.	Fjalët kyçe: natyrë, liqer i kaltër, zall, lundër, mall, dashuri, sakrifikim, vetëflim, jetë, art.
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, biblioteka, CD, magnetofon.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim digjital. Diskutim. Kllaster. Pyetje-përgjigje. Punë në grupe.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektësia në kryerjen e tyre. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet poezia, e cila më pas do të interpretohet nga dy nxënës. Shpjegimi i fjalëve të fjalorit dhe ndërtimi i fjalive të reja. Pas interpretimit të poezisë “Zemra e liqenit” të autorit L. Poradeci, nëpërmjet metodës <i>Pyetje-përgjigje</i> nxënësit/et punojnë ushtrimin 1. Ushtrimi 2. Nxënësit japin mendime në lidhje me titullin e poezisë “Zemra e liqerit” (metaforë). Si e sheh poeti liqenin? (si një qenie e gjallë që frymon, që ka ndjenja) Nxënësit ilustron mendimet e tyre me vargje nga poezia. Ora e dytë Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe Poezia interpretohet nga 2 nxënës. Mund të vendoset muzikë në sfond klasike. Nxënësit ndahen në grupe, për të punuar pyetjet e rubrikave të tekstit. Grupi II punon ushtrimin 3. <i>(Jo, liqeni nuk përfaqëson një element të vetëm por ai është i lidhur ngushtë me vetë poetin...)</i>	

Grupi III punon ushtrimin 4. (*imazhi i lexuesit ndryshon nga një strofë në tjetrën*)

Grupi IV punon ushtrimin 5. *Nxënësit konkretizojnë me vargje imazhin që krijojnë: liqeni që dergjet, rrëmbimin e zemëruar të valëve, pasqyrimin shndritës të liqenit, vorbullën e zemëruar të ujit.*

Grupi V punon ushtrimin 7. Nxënësit përshkruajnë me pesë fjali ndjesitë që u shkakton poezia.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura.

Sqarohet figura e aliteracionit.

Aliteracioni është përsëritja e bashkëtingëlloreve të njëjta, në të njëjtin varg.

Ushtrimi 6. Nxënësit dallojnë figurën e aliteracionit në poezi dhe argumentojnë efektet që ai krijojnë.

(I jep vargut shprehësi tingullore)

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Mësoni përmendësh poezinë duke e recituar bukur atë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Valbona Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënësve: <i>Prezantim digjital</i> U mundësohet nxënësve që me ndihmën e videoprojektorit të shfaqen bukuritë e lumit malor të Valbonës. Nxënësit/et diskutojnë rreth tyre, madje nëse ka nga ata që kanë qenë lejohet të tregojnë si i kanë përjetuar këto bukuri. 2. Në varësi të mundësive, mund të vendoset në tabelë harta e Shqipërisë dhe nxënësit nxiten që të flasin për Alpet e Shqipërisë, duke iu referuar lumit të Valbonës, që vijon rrugëtimin në luginën me të njëjtin emër. Mund të prezantohen pamje ose kartolina të ndryshme. Mund të vihet për t’u dëgjuar kënga “Dy Valbonat”, kënduar nga Fatmira Breçani.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - hulumton në bukuritë e natyrës shqiptare duke sjellë pamje, foto etj.; - interpreton me ndjenjë poezinë; - zbulon idenë që kërkon të përcjellë autori përmes vargjeve; - interpreton rolin, funksionin e figurave letrare duke u ndalur veçanërisht te pyetja retorike.		Fjalët kyçe: lumë, Valbona, brigje, shushurimë, kaltërsi	

Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, DVD, magnetofon, kompjuter.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim digjital. Interpretim. Diskutim. Punë në grupe. Puno/shkëmbe në dyshe. Pesëvargësh.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektësia në kryerjen e tyre. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet titulli i poezisë. Plotësohet në tabelë skeda për jetën dhe krijimtarinë e shkrimtarit Dritëro Agolli. <u>Dritëro Agolli</u> lindi më 13 tetor 1931 në <u>Menkulas të Rrethit të Devollit</u> afër <u>Korçës</u> dhe u nda nga jeta më 3 shkurt 2017 në Tiranë. Pasi mori mësimet e para në vendlindje, vazhdoi gjimnazin e <u>Gjirokastrës</u>, një shkollë me mjaft traditë. Ai vazhdoi studimet e tij në Fakultetin e Arteve në <u>Shën Petersburg</u>. Ka punuar shumë kohë si gazetar në gazetën e përditshme “<i>Zëri i popullit</i>”, dhe për shumë vjet ka qenë Kryetar i <i>Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë</i>. Për tridhjetë vjet me radhë Dritëro Agolli u zgjodh deputet. Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenarë filmash etj. Në veprën e Agollit e pa veten si protagonist bujku dhe bariu, fshatari dhe studenti, malësori dhe fusharaku. Agolli i bë poeti i tokës dhe i dashurisë për të, shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes njerëzore. Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës së madhe. Vepra poetike “Hapat e mia në asfalt” (1961), “Shtigje maresh dhe trotuare” (1965), “Devoll – Devoll” (1964), “Mesdite” (1968), “Baballarët” (1969), “Nënë Shqipëri” (1974), “Fjala gdhend gurin” (1977), “Udhëtoj i menduar” (1985), “Pelegrini i vonuar” (1993), “Lypësi i kohës” (1995), “Fletorkat e mesnatës” (1999). Vepra në prozë: “Komisari Memo”, “Njeriu me top”, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, “Arka e djallit” etj. (të dhënat paraqiten të përmbledhura në dërrasë). Interpretohet poezia dhe sqarohet kuptimi i fjalëve të reja. <i>Pyetje-përgjigje.</i> Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1, që lidhen me kuptimin e përmbajtjes. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. U shpjegohet nxënësve se ç’është pyetja retorike. <pre> graph LR A[Pyetja retorike] --> B[Figurë letrare.] A --> C[Ndërtohet duke pyetur dhe pa kërkuar përgjigje] A --> D[I jep vargut ngarkesë emocionale.] A --> E[Tërheq vëmendjen e dëgjuesit apo lexuesit.] </pre>	

Punë në grupe.

Grupi I punon ushtrimet 2, 3.

Grupi II punon ushtrimi 4. Nxënësit plotësojnë tabelën e figurave letrare.

vargu	kuptimi	figura letrare
Të duket si një qiell i dytë	Lumi, ka kaltërsinë e qiellit,	
Hedh vallen vala shushurimë	është po aq i kthjellët sa ai	krahasim
	Valët, këtu nuk rrjedhin, por	metaforë
	vallëzojë, sepse janë pjesë e një	
	bukurie kaq mahnitëse, ato janë	
	valltare që luajnë magjishëm	
Me gotë lumin krejt ta pimë?	përmes shushurimës.	
	Peti dëshiron, sepse tundohet	
	nga kjo kaltërsi dhe kaltërsi, që	pyetje retorike
	ta pijë lumin krejt, të ngopet e të	
	shuajë etjen me të.	
Andej nga shkon ta pinë brigjet	Poetit i dhimbset lumi, nuk do që	
	ai të mbetet brenda tij, prandaj	
	dëshiron që ai të rrjedhë e të	metaforë
	freskojë e hijeshojë brigjet	

Grupi III punojnë ushtrimi 5. Nxënësit analizojnë poezinë sipas elementeve të metrikës: rima, vargjet.

Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura.

Pesëvargëshi Valbona. Nxënësit punojnë dhe shkëmbejnë idetë me shokun/shoqen e bankës.

Emër Valbona

dy mbiemra i kaltër, i kthjellët

tri folje rrjedh, shushurin, vallëzon

Fjali me 4 fjalë Lumi i kaltër vallëzon brigjeve.

Fjalë sinonime me fjalën e parë Kaltërsia

Paraqitet në tabelë modeli i një pesëvargëshi.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Mësoni përmendësh poezinë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Detyrë klase Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Cila është lidhja që ekziston mes ilustrimeve figurative dhe titullit të poezisë të fq. 102? Nxënësit/et sjellin mendimet e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit bëhen të dukshme për gjithë grupin e klasës. Paraqiten në tabelë disa prej mendimeve të tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - parashikon lidhjen që ekziston midis ilustrimeve dhe titullit të poezisë; - zbulon temën e poezisë mbështetur në vargjet e saj; - jep mendimin e tij personal në rëndësinë e përzgjedhjes së gjuhës për të krijuar efektin e dëshiruar emocional nga ana e autorit; - dallon figurat letrare dhe tregon rolin e përsëritjes artistike; - argumenton rolin e lojërave në jetën e një fëmije.		Fjalët kyçe: mësues, djalë, zog, shikon, thërret, mbledh, etj.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Imagjinatë e drejtuar. Interpretim. Punë në grupe. Diskutim. Tabela e figurave.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me interpretimin e poezisë “Valbona”, e cila u është dhënë nxënësve për t’u mësuar përmendsh një orë më parë. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet në tabelë emri i poetit francez Zhak Prever. Prezantohen të dhëna në lidhje me jetën dhe krijimtarinë e tij. Zhak Prever (4 shkurt 1900 – 11 prill 1977), poet dhe skenarist francez. Suksesi dhe popullariteti i shfaqet në moshën 46 vjeç, me rastin e botimit të përmbledhjes me vjersha <i>Paroles</i> (Fjalë). Poet popullor, falë gjuhës së thjeshtë dhe lojës së guximshme të fjalëve, ai vazhdon të lexohet me ëndje nga të mëdhenjtë dhe të vegjlit. Poezia lexohet në heshtje nga nxënësit dhe më pas interpretohet nga 2-3 nxënës.			

Ushtrimi 1. Nxënësit u përgjigjen 4 pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e poezisë.

Ushtrimet 2, 3. Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me atmosferën e poezisë dhe stinën për të cilën bëhet fjalë. A janë ndier ndonjëherë si fëmija i poezisë? Rrëfejnë histori të shkurtra personale, që përngjasojnë me motivin e poezisë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

U shpjegohet nxënësve përsëritja artistike.

Përsëritja artistike krijohet duke përdorur disa herë me radhë të njëjtën fjalë, grup fjalësh apo fjali të njëjta, me qëllim theksimin artistik të tyre.

Punë në grupe

Grupi I punon ushtrimin 4. Nxënësit qarkojnë alternativën e duhur, duke e ilustruar edhe me vargje nga poezia.

Grupi II punon ushtrimin 5. Nxënësit veçojnë vargjet që përsëriten dhe emërtojnë figurat letrare (*figura e anaforsë, fëmija e shikon/fëmija e pret/fëmija e thërret*).

Grupi III punon ushtrimin 6. *Ditari dypjesësh*

metaforat	kuptimi i tyre
Fëmija i thërret shpëtomë luaj me mua zogu zbret zogu lot (luan) me të ia dëgjojnë muzikën tetë e tetë ikin fluturim dy e dy zhduken fare muret e klasës shemben xhamat bëhen prapë rërë boja bëhet ujë bankat bëhen pemë shkumësi bëhet gur pena bëhet zog	

Nxënësit/et përqendrohen, punojnë në heshtje e më pas përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës.

Shtrohet për diskutim pyetja: “A është e dobishme loja në jetën e një fëmije?”

Përgjigjet e nxënësve paraqiten të përmbledhura në dërrasën e zezë.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Mësoni përmendsh 15 vargje nga poezia.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Teksti, paragrafi, fjalia, gjymtyra. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Paraqitet në tabelë, në tabak letre ose në videoprojektor teksti i faqes 216. Udhëzohen nxënësit që në dyshe të përcaktojnë paragrafët, fjalitë dhe gjymtyrët e fjalive të tekstit. Më pas nxënësit do t’u përgjigjen pyetjeve në dyshe: <i>Çfarë është fjalia?</i> <i>Çfarë një paragraf?</i> <i>Sa grupe dallojmë në fjalinë e thjeshtë?</i> <i>Si i quajmë grupet e fjalisë së thjeshtë?</i> Nxënësit, pasi punojnë në dyshe, prezantojnë përgjigjet. Përgjigjet e nxënësve paraqiten të përmbledhura në tabelë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon paragrafin, fjalinë dhe gjymtyrët e fjalisë në një tekst; - dallon fjalinë e thjeshtë nga ajo e përbërë; - formulon përkufizimin për fjalinë e thjeshtë; - dallon gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta; - jep shembuj me fjali të thjeshta.		Fjalët kyçe: teksti, paragrafi, fjalia, gjymtyrë, fjali e thjeshtë.	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Lexim me kodim teksti. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi fillon me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës të shtëpisë, saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Shkruhen në tabelë përkufizimet dhe nxënësit i përsëritin në dyshe, për t'i mbajtur mend.

Ndërtimi i njohurive të reja. Lexim me kodim teksti. Diskutim

Udhëzohen nxënësit që të hapin librin e gjuhës në faqen 217. Lexojnë informacionin e paraqitur në tekst dhe shënojnë me numra përgjigjet e pyetjeve që u shkruhen në tabelë.

1. Si i klasifikojmë fjalitë nisur nga folja-kallëzues?

2. Ç'quajmë fjali të thjeshtë të pazgjeruar?

3. Ç'quajmë fjali të thjeshtë të zgjeruar?

4. Ç'quajmë fjali të përbërë?

Nxënësit, pasi punojnë në mënyrë të pavarur, prezantojnë përgjigjet e pyetjeve, të cilat shkruhen në dërrasë me shkumësa me ngjyra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Puno/shkëmbe në dyshe

Nxënësit do të punojnë në libër ushtrimet 1, 3. Do të këmbëjnë librat me shokun/shoqen e bankës dhe do të verifikojnë saktësinë e zgjidhjes së ushtrimeve. Më pas përgjigjet lexohen para grupit të nxënësve të klasës.

Ushtrimet 2, 4 do të punohen në dërrasën e zezë nga dy nxënës, kurse klasa do të punojë në libër. Vlerësohet saktësia në kryerjen e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; për punimin e ushtrimeve me gojë e me shkrim; për saktësinë në realizimin e detyrës së shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni 10 fjali të thjeshta edhe me një fjalë të vetme në pjesën e leximit "Fluturimi" dhe shkruajini në fletore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Teksti, paragrafi, fjalia, fjalia më e vogël. Fletorja e vlerësimit të kompetencave. FVK. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënës: Minikonkurs. Lojë zbavitëse me pazëlla. Shkruhen në fisha grupe me fjalë. Fishat vendosen në tavolinë dhe tre nxënës bëhen pjesëmarrës të një loje gjuhësore. Nxënësit do të zgjedhin nga tre fisha me GE dhe tre fisha me GF. Do t'i kombinojnë me njëra-tjetrën dhe do të formojnë fjali. Fjalitë formojnë së bashku një tekst të shkurtër. Nxënësit do të lexojnë fjalitë. Formohen tre paragrafë dhe një nxënës i përmbledh si një tekst të tërë. Nxënësi/ja që punon më saktë dhe më shpejt shpallet fitues.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - bashkon GE dhe GF duke formuar paragrafët e një teksti; - përcakton paragrafët dhe fjalitë në një tekst të dhënë; - krijon fjali duke bashkuar GE; - zgjeron GE kryefjalë dhe GF.	Fjalët kyçe: tekst, paragraf, fjalia më e vogël, GE, GF, zgjerim, zvogëlim.
Burimet: njohuritë e nxënësve, FVK.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Minikonkurs. Diskutim. Puno/shkëmbe në dyshe. Punë individuale.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi fillon me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës të shtëpisë, saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Përmes saj rikujtohen njohuritë që kanë marrë nxënësit një orë më parë. Ndërtimi i njohurive të reja Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura <i>Puno/shkëmbe në dyshe.</i> Udhëzohen nxënësit që të hapin FVK, fq. 41. Ushtrimet 1, 2, 3 do të punohen nga nxënësit në tekst. Pasi punojnë ushtrimet, nxënësit këmbëjnë fletoren me shokun/shoqen e bankës për të verifikuar saktësinë në punimin e ushtrimeve, duke qortuar edhe gabimet. Prezantohen përgjigjet nga nxënës të ndryshëm. Ushtrimet 4, 5, 6 do të punohen në tabelë nga tre nxënës, kurse klasa do të punojë në fletore. Diskutohen ushtrimet që nxënësit kanë punuar. Bëhen ndërhyrjet e duhura, nëse është e nevojshme. Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; saktësinë në dhënien e përgjigjeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; për realizimin e detyrës së shtëpisë. Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 14 vjeç dhëndër (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Nxiten nxënësit/et drejt një diskutimi ne lidhje me temën. Ç’дини ju në lidhje me jetën e Çajupit? Nxënësit/et sjellin mendimet e tyre që nëpërmjet diskutimit bëhen të qarta për të gjithë klasën. Andon Zako Çajupi (27 mars 1866 - 11 korrik 1930) ishte poet, dramaturg, patriot dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare. Më 1902 botoi librin “<u>Baba Tomorri</u>”, një nga veprat më të shquara të letërsisë së <u>Rilindjes Kombëtare</u>. Në pjesën e parë dhe të dytë të librit janë vendosur me radhë vjershat patriotike dhe ato me temë dashurie; vjershat me karakter shoqëror dhe fabulat e shqipëruara nga La Fonten, janë përfshirë në pjesën e tretë të librit, që përmbyllet me komedinë “14 vjeç dhëndër”. Vjersha e gjatë “<u>Baba Tomori</u>”, me të cilën hapet përmbledhja, është një grishje e zjarrtë drejtuar bashkatdhetarëve që të zgjohen dhe të përpiqen për atdheun e robëruar. Patriotizmi i flaktë shquan edhe një varg krijimesh të tjera poetike, si: <i>Mëmëdheu, Ç’jemi?, Ku kemi lerë?, Vaj.</i> Nxënësve mund t’u shfaqen sekuenca nga filmi “Përrallë nga e kaluara” ose nga komedia “14 vjeç dhëndër”.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe krijimtarinë e Çajupit; - interpreton komedinë në role; - u përgjigjet pyetjeve të përmbajtjes; - tregon qëllimin kryesor të autorit. Ora e parë Nxënësi/ja: - portretizon personazhet përmes dialogut të tyre; - zbulon situatat komike; - mban qëndrimin e tij/saj në lidhje me rëndësinë e dialogut dhe mimikës në realizimin e tekstit dramatik; - interpreton në role fragmentin.		Fjalët kyçe: burrë, grua, martesë, djalë, 14 vjeç, bota, thotë.	

Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, fragmente nga komedia, filmi “Përrallë nga e kaluara” ose komedia “14 vjeç dhëndër”.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Lojë në role. Minileksion. Diskutim. Punë në grupe.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet titulli i komedisë dhe nxënësit udhëzohen që ta lexojnë komedinë në heshtje. Pas leximit, nxënësit kanë nënvizuar fjalët e reja, që kryesisht janë dialektologjizma, kalohet në shpjegimin e tyre. Caktohen dy grupe nxënësish për ta lexuar në role komedinë. Vlerësohen nxënësit për interpretimin në role. <i>Minileksion.</i> U shpjegohet nxënësve se ç’është komedia. Komedia është një tekst dramatik ku personazhet, duke u përballur me vështirësitë e jetës, zbulojnë dobësitë e tyre, vese e të meta. Ata përfshihen në situata plot humor, që përcillen me një gjuhë të pasur. Zakonisht kanë fund të lumtur. Punohet ushtrimi 1, i cili lidhet me të kuptuarit e përmbajtjes. Ushtrimi 2. Nxënësit qarkojnë alternativën që ata mendojnë se përkon me qëllimin e autorit. Ora e dytë Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe Nxënësit/et ndahen në grupe. Grupi I punon ushtrimet 3, 4. Grupi II punon ushtrimet 5, 6. Grupi III punon ushtrimi 7. Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Bëhen ndërhyrjet e duhura nëse është e nevojshme.	
Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).	
Detjrat dhe puna e pavarur: Interpretimi fragmentin në role. Interpretimi në skenë, kujdesuni për kostumet, gjestet e lëvizjet.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Unë, biri yt Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Pesëvargësh: Shënohet në dërrasë të zezë fjala <i>Kosova</i> dhe i nxit nxënësit/et të ndërtojnë një pesëvargësh me të. Lexohen disa prej punimeve të nxënësve dhe njëri prej tyre shënohet edhe në dërrasë të zezë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon temën e poezisë; - zbërthen rolin dhe funksionin e gjuhës poetike, parë në këndvështrimin emocional; - komenton idenë patriotike duke e lidhur me aktualitetin.		Fjalët kyçe: unë, biri yt, Kosovë, vuajtje, të njoh, gëzime, brenga.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pesëvargëshi. Interpretim. Diskutim. Punë në grupe.			

Organizimi i orës së mësimi

Interpretohen vargjet e poezisë “Detyrë klase” që nxënësit i kanë patur detyrë për t’i mësuar. Vlerësohet interpretimi i nxënësve dhe saktësia në përcjelljen e vargjeve të poezisë.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Nxënësit mund të dëgjojnë edhe këngën “Unë, biri yt”, bazuar mbi poezinë e poetit Ali Podrimja, kënduar nga Inva Mula.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet titulli i poezisë dhe nxënësve u jepen të dhëna në lidhje me jetën dhe krijimtarinë e poetit **Ali Podrimja**.

Ali Podrimja lindi me 28 Gusht, 1942 Gjakovë, Kosovë, ku pati një fëmijëri të vështirë. Ali Podrimja është autor i më shumë se dhjetë vëllimeve me poezi dhe mbahet sot nga kritika si përfaqësuesi më tipik i poezisë së sotme shqiptare dhe si një poet me emër dhe në shkallë kombëtare. Studioi gjuhë dhe letërsi shqiptare në Universitetin e Prishtinës ku dhe jetoi tërë jetën.

Në 1961, Ali Podrimja botoi përmbledhjen e parë me vargje elegjiake “Thirrje”. Më pas vijonë përmbledhjet “Shamijat e përshëndetjeve” (1963), “Dhimbë e bukur” (1967), “Sampo” (1969), “Torzo” (1971) etj., deri në veprën e tij mjeshtërore “Lum, lumi” (1982), që shënoi një kthesë në poezinë bashkëkohore kosovare.

Në vitet ’80 e ’90, ai do të vazhdojë të botojë libra poetikë si “Zari”, “Buzëqeshje në kafaz” etj., deri te dy librat në prozë: “Burgu i hapur” (1998) dhe “Harakiri” (1999).

Interpretohet poezia nga nxënës të ndryshëm.

Gjatë rileximit të poezisë së A. Podrimës “Unë, biri yt”, nëpërmjet pyetje-përgjigjeve kuptohet më mirë brendia e saj.

Cila është tema e kësaj poezie? (*Kjo është poezi atdhetare, pra i kushtohet atdheut*)

Kujt i drejtohet poeti që ë vargun e parë? (*Poeti i drejtohet Kosovës, ashtu si biri nënës*)

Cila është lidhja e tij me atdheun? (*Është një lidhje e fortë që përcillet mes vargësh plot emocion*)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Përsëritet me nxënësit figura e epitetit.

Epiteti është një mbiemër artistik që i shtohet një emri për t’i pasuruar kuptimin (male krenare, ditë të gëzuara).

Punë në grupe

Grupi I punojnë ushtrimin 2.

Grupi II punojnë ushtrimet 3, 4.

Grupi III punojnë ushtrimin 5. “Ti njoh vuajtjet, gëzimet, vdekje”. Vargjet janë në *antitezë* me njëra-tjetrën.

Autori plot ndjenjë është bashkatdhetar si i vuajtjeve, ashtu dhe i rimëkëmbjes së vendit të tij.

Figura letrare e përdorur te vargjet: “Ta di gjakun që ti vlon në gji, dallgën kur të rreh netëve t’pagjumta” është figura e *metaforës*.

Grupi IV punojnë ushtrimet 6, 7.

Udhëzohen nxënësit që përgjigjet t’i ilustrojnë me shembuj nga poezia.

Nxënësit/et përqendrohen, punojnë në heshtje e më pas përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Kërkoni në revista, në bibliotekën tuaj apo në internet për poezi të autorëve kosovarë kushtuar dashurisë së tyre të madhe për atdheun.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Si të dramatizojmë një tregim. Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe</i> Nxënësit dëgjojnë të regjistruar një fragment drame, ose fragmenti u lexohet dhe mësuesi/ja u kërkon të tregojnë se nga është marrë dhe si mund ta tregojnë në formë tregimi. Nxënësit në grupe, e çdramatizojnë fragmentin, duke e sjellë në formën e një tregimi.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shkruan pjesë në dramë, duke përdorur elemente gjuhësore që ndihmojnë këtë proces; - shkruan një skenar drame të një pjese letrare të lexuar më parë; - kërkon, gjejnë dhe zbatojnë rregullat gjuhësore të ndërtimit të një skenari; - përdor gjuhë të përshtatshme për personazhet; - përdor rregullat e pikësimit të domosdoshme gjatë shkrimit të një skenari.		Fjalët kyçe: tekst në prozë, tekst dramatik, skenar drame, rregulla gjuhësore, rregulla pikësimi.	
Burimet: libra jashtëshkollorë, teksti mësimor, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe dyshe. Diagrami i Venit. Punë në grupe. Konkurs.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe u paraqiten në tabelë tetë hapat që duhen ndjekur për të dramatizuar një tregim:

1. Përzgjidhni tregimin, të cilin do të dramatizoni. Pëlqimi dhe interesi juaj për pjesën është një element mjaft i rëndësishëm në shndërrimin me sukses të tij në dramë.
2. Nënvizoni saktë fjalët e personazheve, duke i dalluar ato nga fjalët e autorit.
3. Reflektoni për karakteret e personazheve të pjesës, personazhin kryesor dhe ata dytësorë.
4. Zbërtheni qartë konfliktin, duke mbajtur parasysh se ai do të jetë dhe boshti juaj i përmbytjes së dramës.
5. Përmbytja e tregimit nuk do të ndryshojë nga ajo e tregimit. Ajo që ndryshon është forma.
6. Fjalët e personazheve do të jenë edhe dialogët e dramës suaj.
7. Nga fjalët e autorit, ju do të merrni të dhëna për skenën, mjedisin, kohën dhe rendin e veprimeve.
8. Tregohuni të kujdesshëm me shenjat e pikësimit, përdorimin e ligjëratës së drejtë.

Diagrami i Venit

Prezantohet një model i thjeshtë duke evidentuar së bashku me nxënësit diferencat. Nxënësit bëjnë një diagram Veni dhe tregojnë anët e përbashkëta dhe ndryshimet e një tregimi dhe një pjesë të dramatizuar.

Tregimi	Tregimi i dramatizuar
Mos e prej... Një druvar iu afrua trungut të një druri të vjetër. Ushqimtarja e motosharrës e prishi qetësinë e pyllit. Drurët u drodhën nga frika. - Mjerë ne! - i pëshpëritën ata njëri-tjetrit. - Ciu-ciu-ciu! Mos e prej këtë dru. - e luti një bilbil. - Nuk do të kem ku ta ngre folenë. - Quk-uk-uk! Mos e prej! - tha qukapiku. - Nuk kam ku të ha krimba. - Gër-gër-gër! - Mos e prej! - tha ketri. - Nuk kam ku ta bëj strofullin. - Më duhet ta prej, - tha druvari. - Ky dru është shumë i vjetër. - Edhe pak e do të thahet fare. Unë do ta pres e trungjet e tij do t'i shpie në fabrikë. Atje do të bëjnë mobilie të bukura prej tyre. Ndërkaq, këtu do të mbjell drurë të rinj, që do të rriten së shpejti. Kështu, bilbili, qukapiku dhe ketri u shpërngulën përkohësisht në një dru tjetër. Toka u bë gati të ushqente drurët e rinj.	Druvari: - Po dal të pres ca trungje. Sharrën e kam gati. Po i zgjedh Zogjtë: - Mjerë ne! Bilbili: - Ciu-ciu-ciu! Mos e prej këtë dru. - Nuk do të kem ku ta ngre folenë. Qukapiku: - Quk-uk-uk! Mos e prej. - Nuk kam ku të ha krimba. Ketri: - Gër-gër-gër! - Mos e prej! - Nuk kam ku ta bëj strofullin. Toka: - Mos e prej! - Bie shiu e më gërren, më shpie poshtë në lumë. Druvari: - Më duhet ta prej, ky dru është shumë i vjetër. Edhe pak e do të thahet fare. Unë do ta pres e trungjet e tij do t'i shpie në fabrikë. Atje do të bëjnë mobilie të bukura prej tyre. Ndërkaq, këtu do të mbjell drurë të rinj, që do të rriten së shpejti.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe.

Nxënësit në grupe katërshe zgjedhin një tregim të shkurtër dhe shkruajnë tregimin duke e transformuar në një pjesë dramatike. Kontribuojnë të gjithë për këtë veprimtari (mund të punojnë edhe në grupe më të vogla, dyshe ose individualisht).

Nga çdo grup prezantohen dhe vlerësohen punët e bëra. Fillimisht lexohet tregimi dhe më pas varianti i kthyer në dramë.

Konkurs

Çdo grup vlerëson me 1-10 pikë punimet e grupeve të tjera. Vlerësohet punimi i grupit më të mirë

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; zbatimin e rregullave të kthimit të një pjese të shkurtër në një tekst dramatik; kontributin në grup; vlerësimin që i bën punës së shokut/shoqes.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Koprraci (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Prezantim digjital. Puno dyshe/shkëmbe ide. Nxënësve nëpërmjet videoprojektorit iu mundësohet të shikojnë pjesë të zgjedhura nga komedia e Molierit: “Koprraci”. Ndërkohë që nxënësit/et shikojnë, mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fleta të bardha dhe i nxit që nëpërmjet punës dyshe (me shokun e bankës) të vizatojnë ose të ndërtojnë karikatura të personazhit kryesor të komedisë. Pas minutave të vëna në dispozicion, mësuesi/ja i vendos punët e nxënësve në dërrasë të zezë dhe së bashku me ta diskuton rreth mesazhit që përcjell puna e çdo bankë. Në pamundësi të sekuencave filmike, mundësohen fotografi të komedisë, aktorëve të saj dhe përmbajtja e subjektit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Ora e parë Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe krijimtarinë e Molierit; - gërsheton të vështruarit me mesazhin individual që përcjell puna e tij; - interpreton në role komedinë. Ora e dytë Nxënësi/ja: - zbërthen rolin dhe funksionin e figurës letrare të simbolit, lidhja e tij me pjesën; - gjykon mbi gjendjen shpirtërore të Harpagonit, në momentin e vjedhjes së parave; - dallon vesin që dënon autori në këtë komedi; - portretizon Harpagonin përmes gjuhës së figurshme dhe monologut të tij; - shpjegon si e kupton dukurinë e koprracisë.		Fjalët kyçe: koprrac, hajdut, drejtësi, shohin, qeshin, ves.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, biblioteka, kompjuter, DVD, foto.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Prezantim digjital. Puno/shkëmbe ide në dyshe. Minileksion. Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet në tabelë titulli i komedisë. U flitet nxënësve në lidhje me jetën dhe krijimtarinë e Molierit.

Molieri lindi më 15 janar 1622 e vdiq më 17 shkurt 1673.

Molieri (Zhan Batist Poklen) është një nga figurat më të ndritura të letërsisë botërore, që hodhi themelet e komedisë franceze. Ai e jetoj veprimtarinë e vet dramatike në të ashtuquajturin “shekull të artë” të monarkisë absolute, që shënonte etapën më të lartë të feudalizmit si rend shoqëror dhe fillimin e shpërbërjes së tij.

Së bashku me disa dashamirë të vet, formon një trupë me nëntë aktorë, të cilën e quan “Teatri mbretëror”, pikërisht në këtë kohë e ndërroi emrin dhe u quajt Molier. Ai ushtronte në të njëjtën kohë detyrën aktor, regjisor, drejtues trupe dhe autor tekstesh.

Veprat më të njohura të Molierit mbahen: “Tartufi”, “Don Zhuani”, “Mizantropi”, “Kopraci” dhe “Borgjezi fisnik”.

Në komedinë “Kopraci”, Molieri demaskon me forcë të madhe fuqinë shkatërruese të parasë dhe godet koprracinë, që ishte tipar karakteristik i borgjezisë në zhvillim. Ai e dënon si një ves të ulët me pasoja shumë negative. Harpagoni, koprrac e fajdexhi jeton në ethe e parave. Ai ka humbur dinjitetin e ndjenjat prindërore dhe dashurinë e fëmijëve. Këta të fundit, jo vetëm që s’e duan më, por edhe e urrejnë. Harpagoni mbetet një nga figurat më negativë, antipatikë e qesharake njëkohësisht, që ka krijuar pena e Molierit.

Prezantohet komedia dhe më pas caktohen nxënës për ta interpretuar në role.

Minileksion.

Shfaqja teatrale ndahet në akte, pjesë të cilat përbëhen nga disa skena, por që bashkohen në një bosht ngjarjeje.

Simboli është figurë me kuptim të dyfishtë. Paraqet një send, një frymor a një dukuri nëpërmjet një sendi, një frymori a një dukurie tjetër që bëhet përfaqësuese.

Monologu është biseda që një personazh zhvillon me vetveten, por që u drejtohet lexuesve apo shikuesve në një shfaqje teatrale. Personazhi shfaq mendimet e tij në lidhje me një çështje të rëndësishme.

Pas rileximit të ndarë në role, nxënësit/et së bashku me mësuesin/en diskutojnë mbi pyetjet pas në lidhje me fragmentin:

Ushtrimi 1.

Ku zhvillohet ngjarja?

Çfarë e ka tronditur dhe alarmuar Harpagonin?

Ku dyshon Harpagoni?

Çfarë masash kërkon të marrë ai për gjetjen e hajdutit?

Çfarë zotohet se do të bëjë ai?

Sa është shuma e parave që i kanë vjedhur Harpagonit?

Cila është kërkesa e Harpagonit ndaj hetuesit për kapjen e hajdutit?

Çfarë këshille i jep komisari?

Ora e dytë

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit/et nëpërmjet metodës *Rrjeti i diskutimit* argumentojnë pro dhe kundër çështjes.

Po

A e justifikoni gjendjen
shpirtërore
të Harpagonit në momentin e
vjedhjes së parave?

Jo

Nxënësit/et punojnë në heshtje dhe më pas argumentojnë përgjigjet.

Punë në grupe.

Grupi I punon ushtrimet 3, 4.

Grupi II punon ushtrimet 6, 7.

Grupi III punon ushtrimin 8.

Udhëzohen nxënësit që përgjigjet t'i ilustrojnë me shembuj nga komedia.

Nxënësit/et përqendrohen, punojnë në heshtje e më pas përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruani vetëm me mbiemra gjendjen emocionale të Harpagonit. Mësoni përmendësh monologun e famshëm të Harpagonit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Grupet kryesore të fjalisë së thjeshtë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Punë në dyshe. Paraqiten në një tabak letre ose në dërrasën e zezë disa fjali. Nxënësit në dyshe do të nënvizojnë me një vijë grupin emëror GE dhe me dy vija grupin foljor GF. Një flutur krahëshkruar qëndroi mbi një lule. Në tryezë qëndronte fotografia e saj. Vizatimi yt u pëlqye shumë nga vizitorët. Djemtë dhe vajzat e pallatit tim luajnë në këndin e ri sportiv. Dëgjohen përgjigjet e dhëna nga nxënësit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon grupet kryesore në fjalinë e thjeshtë që GE ka si bërthamë kryefjalën, GF foljen; - dallon përbërësit e GE; - dallon përbërësit e GF; - bën zvogëlimin ose zgjerimin e fjalisë së thjeshtë.		Fjalët kyçe: GE, GF, fjalë bërthamë, fjalia më e vogël.	

Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Diskutim. Punë në grupe. Pema e mendimit.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektesinë në realizimin e tyre.	
Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.	
Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet tema e re në tabelë dhe nxënësit orientohen në informacionin e dhënë në tekst në fq. 219-220. Nxënësit komentojnë figurat dhe ndërtojnë nga një fjali për secilën prej tyre. Lexohen fjalitë dhe diskutohet me nxënësit zvogëlimi shkallë-shkallë i tyre. Konkluzionet që dalin gjatë shembujve të dhëna në ushtrimet e librit shkruhen në dërrasën e zezë me shkumës me ngjyra.	
1. Fjalja e thjeshtë përbëhet nga dy grupe themelore: GE, GF. 2. Ka fjali pa kryefjalë edhe pa kallëzues, por nënkuptohen (nga konteksti dhe intonacioni). 3. Fjalët plotësuese të GE mund të hiqen ose të shtohen. 4. Grupi i kryefjalës ndërtohet:	
emër (bërthama) + → emër → mbiemër → përemër → numëror	
5. Grupi foljor i kallëzuesit ndërtohet nga:	
emër (bërthama) + → kundrinor i drejtë → Folja (bërthama) + kundrinor i zhdrejtë → rrethanaorë → përcaktor kallëzuesor	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Nxënësit ndajnë ne etiketa grupin emëror nga ai foljor në fjalitë e ushtrimit 1, pastaj i zvogëlojnë grupet deri në fjalinë më të vogël: kryefjalë + kallëzues. Ushtrimet 2, 3, 4, 5, 6, i punojnë në libër në grupe dyshe. Këmbejnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, qortojnë gabimet. Kontrollohen ushtrimet dhe lexohen para klasës nga nxënës të ndryshëm.	
Vlerësimi: Vlerësohen në situatën e të nxënësve. Vlerësim me gojë e me shkrim në zgjidhjen e ushtrimit në punën e pavarur. Vlerësimi në detyrën e shtëpisë.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një tekst me 8-10 fjali me temë: “Pranvera po troket”. Nënvizoni me një vijë GE dhe dy vija GF.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Udhëtim në <i>Disney Land</i> Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Pema e mendimit. Imagjinatë e drejtuar</i> Mësimi fillon me diskutimin: “Ç’ dini për tekstin joletrar?” Nxënësit sjellin idetë e tyre, të cilat i përzgjedhin duke i plotësuar, nëse është e nevojshme. Në dërrasën e zezë paraqitet <i>Pema e mendimit</i>. Teksti rrëfimtari joletrar Ka funksion praktik që përcaktohet nga qëllimi i autorit. Mbështetet në fakte reale, copëza nga jeta e personave. Intervista, udhëpërshkrimi, kronika, ditari, letra, reportazhi, biografi, shkrime gazetas, gazetash, autobiografi etj. Nxiten nxënësit, që nisur nga titulli i pjesës, të tregojnë se për çfarë mund të flasë ky shkrim. Shkruhen në tabelë disa prej mendimeve të nxënësve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - dallon udhëpërshkrimin si lloj i tekstit joletrar rrëfimtari; - analizon nëpërmjet ushtrimeve elementet e udhëpërshkrimit; - jep mendimin e tij/saj mbi mënyrën si përshkruan dhe çfarë efekti lë te lexuesi autori i tekstit.		Fjalët kyçe: udhëtim, udhëpërshkrim, personazhet e filmave vizatimorë, fantastik, shpik, falënderoj.	
Burimet: teksti i nxënësit, interneti, biblioteka.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Imagjinatë e drejtuar. Pyetje-përgjigje. Punë në grupe. Tryeza rrethore.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Realizohet leximi i pjesës nga dy nxënës. Gjatë rileximit të pjesës “Udhëtim në Disney”, nëpërmjet metodës *pyetje-përgjigje*, nxënësit u japin përgjigje 4 pyetjeve të ushtrimit 1.

- 1) *Vendet që viziton autori në Disney janë: Shpella e Tmerit, Malet Ruse...*
- 2) *Autorit i bën përshtypje pothuajse çdo gjë në këtë vend pasi përjeton moment të pakrahasueshme kudo ku shkon...*
- 3) *Udhëtimi ishte fantastik.*
- 4) *Autori e falënderon me zemër këdo që e ka shpikur Disney-n.*

Me përgjigjet e nxënësve ndalemi dhe shpjegojmë së ç’është udhëpërshkrimi si lloj i tekstit rrëfimtari.

Udhëpërshkrimi:

Lloj i veçantë i rrëfimit joletrar.

Pikënisjen e merr nga udhëtimi dhe nga mbresat që lë në kujtesën e autorit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**Punë në grupe**

Grupi I punon ushtrimin 2 fq. 115.

Grupi II punon ushtrimin 3 fq. 115.

Grupi III punon ushtrimin 4, 5 fq. 115.

Nxënësit punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura.

Ushtrimi 6.

Përmes metodës *Tryeza rrethore*, letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës te tjetri. Çdo nxënës pasi e shkruan idenë e tij, e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij mos e lexojë.

Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra fq. 115, sipas kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbresa udhëtimesh Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar.		Situata e të nxënit: Bashkëbisedim në grupe dyshe Kërkohet që nxënësit të shprehin mbresa të udhëtimeve që kanë bërë me shokë, me familjen apo në mënyra të tjera, siç ju kanë ardhur mundësitë për të udhëtuar, duke i shoqëruar edhe me fotografi.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (e fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje te të tjerët; - jep informacione, ide, ndjesi, emocione duke përdorur fjalorin e duhur; - përshtat të folurin në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës; - përdor gjuhën standarde në situata formale dhe joformale, duke përfshirë edhe diskutimet në klasë; - zgjedh fjalët dhe frazat e duhura për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.	Fjalët kyçe: udhëtim, mbresë, shëtitje, drejtim, udhëzime, destinacion.
Burimet:	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe dyshe. Punë në grupe. Pyetje/përgjigje. Hartë koncepti.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe. Nxënësit punojnë në grupe dhe shprehin mbresa e kujtime nga udhëtimet e bëra brenda dhe jashtë vendit, duke përdorur një gjuhë të pastër, të pasur, të kuptueshme, të mbushur plot fjalë të reja vendesh, njerëzish dhe emocione. Pyetje/përgjigje – Punë në grupe Nxënësit vazhdojnë bisedat e tyre në punë në grupe, duke i çuar më tej bashkëbisedimet përmes dialogut pyetje/përgjigje, përcjellin edhe gjendje shpirtërore duke argumentuar edhe pse. Cilat kanë qenë udhëtimet më të bukura që ke bërë? • brenda vendit; • jashtë vendit. Si jeni ndjerë gjatë një udhëtimi me avion? Thuaj pse. • i lumtur; • i emocionuar; • i trembur. Si jeni ndjerë gjatë një udhëtimi me traget? Thuaj pse? • i lodhur; • i qetë; • i lumtur. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Hartë koncepti Nxënësit në grupe përgatisin një hartë, ku vendosin vendet në të cilat kanë udhëtuar, e shoqërojnë me fotografi, përshkruajnë të veçantat e çdo udhëtimi, duke përshkruar me sa më shumë elemente mbresëlënëse. Punë në grupe Nxënësit vërejnë fotot e fundit të faqes 116 dhe përshkruajnë jo vetëm fotot, por edhe udhëtimet që mund të kenë bërë në këto vende. Ndërkohë nga interneti/<i>youtube</i> mësuesi/ja, por edhe nxënësit mund të kenë shkarkuar pamje udhëtime turistësh nga këto vende dhe i komentojnë gjatë shfaqjes së imazheve në videoprojektor.	

Vlerësimi i orës. Kjo orë mësimore vlerësohet e suksesshme mbështetur në diskutimet dhe emocionet e shkruara nga nxënësit për udhëtimet e bëra prej tyre, brenda dhe jashtë vendit. Pasuria e fjalorit, e emërtimeve gjeografike, e emocioneve, e të papriturave dhe shoqërimi i tyre edhe me elemente vizuale, fotot, video etj., janë elemente të tjera që rrisin suksesin e kësaj ore mësimore.
Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shtatë sorrat (FVK) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Punë me tekstin. Tekst rrëfimtari letrar, përrallë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - liston veçori të përrallave; - lexon tekstin dhe u përgjigjet pyetjeve të përmbajtjes; - dallon detajet që tregojnë gjendjen shpirtërore të vajzës, sakrificat e saj; - përshkruan mjedise, duke përdorur detaje nga pjesa; - jep kuptimin e fjalëve e shprehjeve; - argumenton qëndrimin e personazhit, duke ilustruar me shembuj nga teksti.		Fjalët kyçe: përrallë, vajzë, sorra, pagëzim, mallkim, Ylli i Mirë, kockëz, xhuxhi, unazë.	
Burimet: njohuritë e nxënësve, FVK.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë individuale. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Rikujtohen me nxënësit elementet e tekstit rrëfimtari letrar, duke iu referuar përrallës. Nxënësit listojnë veçori të përrallave, të cilat shkruhen në dërrasën e zezë.

Ndërtimi i njohurive të reja

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstin në fq. 24 te pjesa “Shtatë sorrat”. Përralla mund të lexohet me zë nga dy nxënës ose mund të lexohet në heshtje nga nxënësit/et. Pas leximit të saj, nxënësit/et do të diskutojnë se pse ky krijim është një përrallë, duke iu referuar veçorive që janë paraqitur në dërrasën e zezë. Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur në Fletoren e vlerësimit të kompetencave. Gjatë punës individuale, nxënësit/et mund të kërkojnë ndihmë nga mësuesi/ja.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënës të ndryshëm prezantojnë përgjigjet e pyetjeve të ushtrimeve. Nxënësit/et mund të plotësojnë dhe të qortojnë gabimet.

Përgjigje të mundshme

1.a. Vëllezërit shkuan te pusi për të marrë ujin e bekuar.

1.b. Vajza u dëshpërua dhe nuk gjeti qetësi derisa një ditë iku fshehurazi nëpër botë për t’i kërkuar.

2. Gjendja shpirtërore e vajzës: e shkreta iku e dëshpëruar për humbjen e vëllezërve.

Misterin e zhdukjes së vëllezërve: u bë sebeb për shndërrimin e shtatë vëllezërve në sorra.

Sakrificat e vajzës: Arriti edhe në fund të diellit, por ishte shumë nxehtë dhe nuk ishte e mundur...

Gëzimin e vëllezërve: “Imzot , nëse motra jonë është këtu, do të jemi të lirë”.

3. Malet prej akulli lartoheshin në fund të botës. Gjithçka ishte e akullt dhe nuk kishte asnjë orendi. Në dhomë, vajza pa një tryezë të rumbullakët. Mbi tryezë qëndronin shtatë tasa, shtatë pjata. Tasat dhe pjatat ishin të mbushura me ushqim dhe ujë.

4. Fjala *kockës*, në këtë përrallë ka kuptimin e çelësit që mund të hapë derën e maleve prej akulli.

Ajo është një send magjik, i vetmi që mund ta hapë atë derë.

5. Arriti në fund të botës; arriti edhe në fund të diellit; arriti te yjet; ndoqi rrugën deri në fund të maleve me akull.

6. Vajzën e shtyn dashuria për vëllezërit dhe dëshpërimi për fatin e tyre të keq: “duhet të bënte diçka për të gjetur vëllezërit e saj”, “dëshironte t’i lironte në çfarëdo mënyre...”.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në situatën e të nxënësit; për saktësinë në dhënien e përgjigjeve; qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve/shoqeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Testim përmbledhës për periudhën e dytë Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënësit: Tekst poetik. Njohuritë e nxënësve do të testohen përmes një teksti poetik.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi/ja: - u përgjigjet pyetjeve që lidhen me poezinë; - dallon rimën e përdorur; - sjell argumente rreth poezisë, duke ilustruar me detaje; - emërton figurat letrare dhe tregon funksionin e tyre; - i vendos poezisë një titull tjetër të figurshëm; - analizon foljet: koha, mënyra, zgjedhimi; - përdor ndajfoljet në shkallë të ndryshme; - dallon lidhëzat dhe parafjalët.	Fjalët kyçe: poezi, pyetje, njohuri letrare, njohuri gjuhësore, pikë, tabelë.
Burimet: poezi, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë individuale	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.	
Vlerësimi: Testet do të vlerësohen me notë, e cila do të hidhet në regjistër në kolonën: VTP.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Dita e portofolit tim (Panair portofoli) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Punimet më të mira të nxënësve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton me shokët për punët e arkivuara në dosje; - vlerëson dhe vetëvlerëson punët në portofol/dosje.	Fjalët kyçe: portofol, vlerësim, vetëvlerësim
Burimet: portofoli i punimeve, CD, muzikë	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim. Turi i galerisë. Bashkëbisedim.	
Organizimi i orës së mësimit. Për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, mund të vendoset muzikë e lehtë në sfond. Vendi i bankave në klasë mund të ndryshohet, në mënyrë që punimet e nxënësve në portofol të mund të shihen e gjithë klasa, si një ekspozitë punimesh. Gjatë orës mund të ftohen edhe prindër të nxënësve. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Bashkëbisedim Bashkëbisedoni me nxënësit në lidhje me mënyrën e vlerësimit, edhe pse nxënësit janë njohur qysh në periudhën e parë. Portofoli i punimeve, si një mënyrë vlerësimi për arritjet e nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit realizohet me pikë, nisur nga lloji i detyrës dhe pesha që ka ajo. Pikët konvertohen në notë, sipas një table që nxënësve u është dhënë qysh me përcaktimin e detyrave, që do të dokumentohen në portofol gjatë periudhës së dytë, janar-mars... Ndërtimi i njohurive të reja. Nxënës të ndryshëm do të flasin për detyrat e realizuara gjatë periudhës së dytë, kënaqësitë për realizimin e tyre dhe vështirësitë që mund të kenë hasur. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Turi i galerisë. Nxënësit do të prezantojnë një pjesë të punimeve të tyre, të konsideruara si më të mirat. Secili nga nxënësit vetëvlerëson detyrën e tij. Nxënësit e tjerë japin mendime pozitive në lidhje me punimet e paraqitura nga shokët.	
Vlerësimi: Vlerësohen për cilësinë e realizimit të punimeve; përmbushjen e kriterëve të detyrës; vlerësim me notë dhe vetëvlerësim.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

Periudha e tretë: prill-qershor

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Vaçe Zela: I kam harruar pengjet e mia(2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Prezantim Digjital – Diskutim – Kllaster Shënohet në dërrasë të zezë pyetja: Ç’dini për artisten Vaçe Zela? Mund të shfaqet një videoprojektor një këngë nga kjo këngëtare ose mund të dëgjohet në magnetofon. Nxënësit sjellin idetë e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit bëhen të dukshme për gjithë grupin e klasës Me përgjigjet e tyre plotësohet kllasteri në tabelë të zezë. Vaçe Zela	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe veprimtarinë artistike të këngëtares Vaçe Zela; - dallon elementet e strukturës së tekstit rrëfimtari joletrar; - dallon intervistën si një komunikim mes dy individësh; - interpreton duke shprehur gjykimin e tij mbi fjalët e këngëtares dhe përjetimet e saj. Ora e dytë Nxënësi/ja - analizon formën e organizimit të këtij shkrim; - interpreton si ndihet këngëtarja përmes mbiemrave dhe ndajfoljeve përkatëse; - jep mendimin e tij mbi interpretimin e nëntekstit të titullit.		Fjalët kyçe: Vaçe Zela, këngëtare, zë i ëmbël, vlerësim, të rrëqeth, këndon, harron, peng.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, DVD, magnetofon, youtube.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK. Artet (Muzika)	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Prezantimi digjital/Diskutim/kllaster. Marrëdhënia pyetje-përgjigje. Minileksion. Puno dyshe/Shkëmbe mendime. Punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Nxënësit përmendin tituj këngësh të kësaj këngëtareje të madhe të skenës shqiptare.

Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantohet titulli i mësimit dhe njihen nxënësit me intervistën.

Intervista është një komunikim në formë pyetje-përgjigje midis dy individësh për çështje të rëndësishme që mbështetën në fakte dhe opinione.

Realizohet leximi i intervistës nga dy grupe nxënësish. Gjatë rileximit të intervistës së Vaçe Zelës, “I kam harruar pengjet e mia”, nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimit 1-4.

1. *Koncerti për nder të Vaçe Zelës titullohet “Vaçe Zela, një grua, një zë një mit”.*
2. *Dëshira e Vaçe Zelës është të kthehet në Shqipëri...*
3. *Asaj i mungon publikut shqiptar, Shqipëria dhe e pamundura për t’u ngjitur në skenë.*
4. *Ndërsa kujton jetën e saj, ajo vlerëson lidhjen e fortë dhe dashurinë që ndien për publikun.*

Minileksion. Struktura e tekstit rrëfimtari jolettrar.

→ Ndryshon në varësi të llojit të tekstit.

→ Ndjek rendin: hyrje, zhvillim, mbyllje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten nxënësit që të punojnë në dyshe ushtrimin 2, në faqen 119.

Si i kuptoni fjalët e Vaçe Zelës: “Ai vend më bëri këtë që ju thoni se unë vazhdoj të jem për ju”.

Nxënësit punojnë në heshtje për pak çaste. Më pas, përfaqësues të ndryshëm të klasës, lexojnë përgjigjet e tyre.

Dy-tri më të realizuarat shënohen në dërrasë të zezë.

Ushtrimi 3.

Formulohen dy pyetje nga secili nxënës, të cilat do të dëshironin t’ia drejtonin këngëtares. Paraqiten disa prej tyre në tabelë.

Ora e dytë**Punë në grupe**

Nxënësit ndahen në grupe (5-6 nxënës).

Grupi I punon me analizën e formës së organizimit të këtij shkrimi. *Ushtrimi 4*

Grupi II punon duke analizuar sesi ndjehet këngëtarja, referuar mbiemrave dhe ndajfoljeve që përcaktojnë gjendjen e saj. *Ushtrimi 5*

Grupi III rendit tri fakte nga jeta e të intervistuarës dhe tri tipare të gjuhës së intervistës. *Ushtrimet 6, 8*

Grupi IV zbërthen nëntekstin e titullit. Si është i ndërtuar ai nga ana gjuhësore? *Ushtrimi 7*

Nxënësit punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura.

Diskutim i lirë.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 9.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Intervistoni një figurë të njohur e të dashur për ju. Prezantoheni intervistën para klasës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Fjalja e përbërë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxëni Paraqiten në tabelë fjalitë: Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta këtu, mes jush. Aty pa shkollën ku kishte mësuar për pesë vjet. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të gjejnë foljet, të rumbullakosin lidhëzat, sipas llojit të lidhëzave të përcaktojnë llojin e fjalive: me bashkërenditje, me nënrenditje.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje nisur nga lidhëzat dhe kuptimi që shprehin; - dallon fjalitë nënrenditëse mbi bazën e varësisë të pjesës së varur nga kryesorja; - shndërron fjalitë me bashkërenditje në fjali me nënrenditje dhe anasjelltas; - zgjeron fjalitë me nënrenditje; - formon fjali me bashkërenditje e nënrenditje me dy pjesë.		Fjalët kyçe: fjali e përbërë me bashkërenditje, nënrenditje, lidhëza bashkërenditëse	
Burimet: teksti, tabela, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Lexim i lidhur me shpjegimin. Lojë gjuhësore. Punë në dyshe. Punë në grupe.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Lexim i lidhur me shpjegimin. Lojë gjuhësore. Prezantohet tema e re dhe udhëzohen nxënësit që të hapin librin në fq. 222-223. Një nxënës lexon me zë informacionin që jepet në libër për fjalitë e përbëra me bashkërenditje: a) shtuese (pjesët radhiten, shtohen njëra pas tjetrës); b) veçuese (pjesët përjashtojnë njëra-tjetrën); c) kundërshtuese (pjesë e dytë kundërshton të parën); d) përmbyllëse (pjesa e dytë përmbledh kuptimin e fjalisë). Udhëzohen nxënësit të përsëritin llojet e lidhëzave, bashkërenditëse, mund të organizohet Loja gjuhësore, thuhet një lidhëz dhe kërkohet përgjigja duke i marrë me radhe nxënësit. Ai që nuk përgjigjet veçohet nga loja. Për fjalinë me nënrenditje diskutohen me nxënësit shembujt që jepen në libër për të shpjeguar te nxënësit se pjesa e varur nuk mund të qëndrojë pa pjesën kryesore. Prezantohen skemat e fjalive të paraqitura në situatën e të nxënit.			

Paraqiten edhe skemat e fjalive.

P.P

P.P

P.K

P.N

Sqarohen nxënësit për marrëdhëniet mes pjesëve.

Punohen shembujt e tabelës për të dalluar llojet e fjalive me nënrenditje për të cilat do të flitet më gjerësisht në klasën e VII.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimet 1, 2, 3, nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe. Këmbejnë librat, kontrollojnë punën e njëritjetrit, qortojnë gabimet, argumentojnë përmbajtjen e tyre.

Klasa ndahet në dy grupe sipas rreshtave.

Grupi I punon ushtrimi 4.

Grupi II punon ushtrimi 5.

Pasi mbarojnë grupet (me shkrim në fletore), një nxënës për çdo grup jep përgjigjen e ushtrimeve.

Nëse është e nevojshme, bëhen ndërhyrjet e duhura.

Vlerësimi: Vlerësohen për veprimet në situatë; për zgjidhjen e ushtrimeve me gojë e me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 224

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __. __. __

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Histori paqeje Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Diskutim. Shkruhet në tabelë pyetja: - Ç’lloj shkrimesh përfshihen në një gazetë apo revistë? Nxënësit, të cilët kanë sjellë gazeta dhe revista për të rinj, listojnë disa prej artikujve që gjenden në to. Shkrimet që përfshihen në gazetë apo kronikë: - kronika - reportazhi - njoftimi etj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - dallon kronikën si lloj i tekstit joletrar rrëfimtari; - analizon elementet ndërtimore të kronikës; - zgjeron njohuritë mbi kronikën duke ilustruar në pjesën e zgjedhur “Histori paqeje”; - ilustron me shembuj nga teksti ose detyra e shtëpisë çdo element të kronikës; - rrit frymën e bashkëpunimit në grup duke respektuar mendimin e njëri-tjetrit; - jep mendim mbi mesazhin që përcjell kronika të çdonjëri prej tyre.	Fjalët kyçe: kronikë, tekst informativ, rrëfen, histori paqeje, duan, luftë, paqe.
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Puno dyshe/Shkëmbe mendime. Ditar dypjesësh. Kllaster. Minileksion.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në realizimin e intervistës. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Veçohet kronika dhe u shpjegohet nxënësve se çfarë është ajo. <i>Minileksion</i> Kronika është një tekst/shkrim informativ në të cilin rrëfohen faktet sipas kohës kur kanë ndodhur. Në të shmangen opinionet personale dhe komentet. Informacioni u përgjigjet pyetjeve: <i>Çfarë? Ku? Kur? Kush? Si? Pse?</i> Kronika karakterizohet nga: 1- përdorimi i fjalive të shkurtra të thjeshta e të përbëra me bashkërenditje e të përzieria; 2- përdorimi i foljeve kryesisht në kohën e kryer, e kryer të thjeshtë, e tashme të mënyrës dëftore por edhe në lidhore; 3- përdorimi i mbiemrave; 4- ndërtimi i titujve me fjali emërore; 5- përdorimi i foljeve në mënyrën kushtore, për lajme të pasigurta; 6- përdorimi i thonjëzave për të shprehur fjalët e protagonistëve. Zgjedhja e titullit: Në bazë të qëllimit: - Titull tregues - Titull shpjegues - Titull fantazie Në bazë të mjeteve gjuhësore: - Titull emëror - Titull foljor Ndërtimi i njohurive të reja Prezantohet pjesa që lexohet dy herë nga nxënësit/et. Nxiten nxënësit/et që nëpërmjet metodës <i>Puno dyshe/Shkëmbe mendime</i>, të plotësojnë ushtrimin 1.	

Rindërtoni kronikën duke vendosur para fjalive numrin që i takon sipas variantit 1.
Ky ushtrim i ndihmon nxënësit që të renditin ngjarjen sipas rrjedhës kronologjike p.sh.:

1. Fryma e Krishtlindjeve u manifestuar në vitin 1914...

2. Duke filluar që në mbrëmjen e 24 dhjetorit e kështu me radhë.

Nxënësit punojnë për pak çaste. Përfaqësuesit e klasës e lexojnë detyrën para grupit të klasës (Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënësit plotësojnë tabelën e ushtrimit 2, nëpërmjet metodës *Ditari dypjesësh*.

Tema e kronikës	
Çfarë synon të rrëfejë autori?	
Struktura 1. Çfarë tregohet në hyrje? Çfarë karakteristikash gjuhësore ka ajo?	
2. Çfarë tregohet gjatë zhvillimit? Çfarë karakteristikash gjuhësore ka?	
3. Çfarë tregohet në mbyllje? Çfarë karakteristikash gjuhësore ka?	

Nxiten nxënësit/et që në mënyrë individuale të punojnë me ushtrimin 3.

Përkufizoni me njëzet fjalë mesazhin e kësaj kronike.

Nxënësit punojnë në heshtje. Në minutat e fundit, 2-3 prej tyre e lexojnë detyrën para grupit të klasës.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një kronikë për një ngjarje reale.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë artikull gazete Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Veprimtari paraprake. Bashkëbisedim në grupe dyshe Bëhet një kuic në të cilin lexohen fragmente nga artikuj të ndryshëm dhe nxënësve iu duhet të gjejnë se çfarë lloj artikujsh janë: kronikë, reportazh përshkrim, intervistë etj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shkruan artikull të thjeshtë, të llojit mediatik; - shkruan artikull duke respektuar strukturën e shkrimit; - zbaton rregullat gjuhësore të ndërtimit të një reportazhi ose kronike; - përdor gjuhë të përshtatshme dhe të pasur me elemente përshkrimi, fakti etj.; - përdor rregullat e pikësimit të domosdoshme gjatë shkrimit të një reportazhi/kronike etj.; - respekton standardin e gjuhës shqipe gjatë të shkruarit.	Fjalët kyçe: artikull, artikull kryesor, shkrim, gazetë, revistë, kronikë, reportazh, intervistë, strukturë, media.
Burimet: Videoprojektor, teksti mësimor, libri “Drejtskrimi i gjuhës shqipe” artikuj gazetash, revistash etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe dyshe. Minileksion. Punë e pavarur. Punë në grupe. Diagram i Venit.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Minileksion Shfaqen në videoprojektor ose në tabak letre, disa nga llojet e shkrimeve gazetareske. <i>Kronika</i> - është një tekst informativ, në të cilin rrëfohen në rend kronologjik faktet. Në të shmangen opinionet personale dhe komentet. <i>Artikulli</i> - shkrim me përmbajtje publicistike a shkencore, që trajton një çështje të caktuar dhe që botohet në një gazetë, në një revistë ose në një përmbledhje. <i>Artikull kryesor</i> - Artikull kritik (shkencor, informativ); Artikull përkujtimor etj. <i>Intervista</i> - është një ligjëratë dialogjike midis dy individësh mbi çështje të rëndësishme që mbështeten në fakte dhe opinione të folësit. <i>Diagrami i Venit</i> Krahasohen llojet e artikujve gazetareskë me njëri-tjetrin dhe nxirren në pah të përbashkëtat dhe ndryshimet. Modele shkrimesh gazetareske Krahasohen llojet e artikujve gazetareskë me njëri-tjetrin dhe nxirren në pah të përbashkëtat dhe ndryshimet. Modele shkrimesh gazetareske Reportazhi Kronika Devolli, një vend i panjohur Devoll, Shqipëri, një emër i madh, një vend i begatë, dhunti e mrekullisë së natyrës “nënës natyre”, por edhe e dorës së njeriut, me pasuri të çmuara natyrore e shoqërore. Ky emër është simboli i fushës së saj pjellore, lumi me të njëjtin emër si bir i saj që buron e lodron në mes të luginës, të rrethuar nga malet përreth, mençuria intelektuale e bijve e bijave të saj, mjeshtër të mëdhenj, bujq e ndërtues, me shpirt artisti, që sintetizohen e simbolizohen me emrin e të madhit, poet të Devollit, Dritëro Agolli, Homeri i gjallë i Ballkanit, por edhe më tej, kolosi i letrave shqipe i kalibrit botëror, Nobelisti i së ardhmes. Paraditen e së mërkurës është gjetur një trup i pajetë në Liqenin Artificial të Tiranës. Viktima, siç transmeton një televizion, mësohet se është mashkull i moshës 35-40 vjeç, i veshur me të zeza dhe flokë të kapura bisht. Dyshohet se personi është mbytur 3-4 ditë më parë.	

Intervista

Intervista me drejtorin e World Vision, Rein Dekker:

Pyetje: **Cili është mendimi juaj për rinjtë shqiptarë?**

Fëmijët shqiptarë janë të ekspozuar ndaj dhunës në internet dhe ky është një shqetësim i cili kërkon vëmendje të madhe, jo vetëm nga shoqëria, por edhe qeveria të ndërmarrë masat për të parandaluar pasojat e rënda.

Po për problemet e arsimit çfarë mund të na thoni?

Një tjetër shqetësim është edhe arsimi.

“Shqipëria investon shumë më pak për arsimin, sa i takon buxhetit, në krahasim me vendet europiane. Prandaj duhet të rritet”....

Ora News, gazeta L. Karadaku.

Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë në faqen 122. Cilat janë kriteret që duhet të përmbushë një artikull?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Punë në grup

1. Bëni një shkrim për një aktivitet që keni zhvilluar në shkollë. Vendosini një titull dhe shoqërojeni atë me një ilustrim.

2. Shkruani një artikull me temë shkencore, lidhur me një projekt që keni prezantuar në shkollë.

3. Përgatitni një intervistë sipas shembullit të dhënë në faqen 118. Mund të intervistoni një mësues, një këngëtare të shquar në shkollë apo një figurë mediatike.

4. Shkruani një udhëpërshkrim për një vend, i cili ju ka lënë mbresa të paharrueshme.

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup zgjedh llojin e artikullit për të cilin do të shkruajë. Zgjedhin temën e cila duhet të lidhet me problematikën e jetës së tyre shkollore dhe nisin të shkruajnë variantin e parë dhe më pas e ripunojnë.

Nga çdo grup prezantohen dhe vlerësohen punët e bëra dhe artikujt përkatës. Artikujt e nxënësve mund të mblidhen për t'u prezantuar në formën e një gazete apo reviste.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për bashkëpunimin në grup; për respektimi i kriterëve të shkrimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Nënë Tereza, nëna e dashurisë Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënësve: Shënohet në dërrasë të zezë: “Ç’ dini për Nënë Terezën?” Nxënësit shkruajnë në letër informacionin që dinë për të. Ndërkohë, përmes videoprojektorit, ose materialeve të sjella në klasë, prezantohet jeta dhe veprimtaria humanitare e Nënë Terezës Recitohen vargje dhe thënie të saj.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon tekstin informues si lloji i tekstit joletrar rrëfimtar; - analizon tekstin informues përmes pjesës “Nënë Tereza, nëna e dashurisë”; - rendit të dhënat e tekstit informues sipas rendit kronologjik.	Fjalët kyçe: tekst informues, fakt, listë të dhënash, përcjell informacion, Nënë Tereza, misionare e paqes, humanizëm.
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Diskutim. Minileksion.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në realizimin e kronikës. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja Prezantohet titulli i mësimi dhe realizohet leximi i pjesës nga dy nxënës/e. Gjatë rileximit të tekstit “Nënë Tereza, nëna e dashurisë”, për të kuptuar më mirë mbi të, nxënësit punojnë pyetjet 1-2. 1. Përse informoheni në këtë tekst? (<i>Për jetën e Nënë Terezës, veprimtarinë e saj të bamirësisë... etj.</i>). 2. Çfarë të dhënash morët? Rënditini ato sipas vendosjes në tekst. (<i>Të dhënat për veprimtarinë e saj si humaniste, vlerësimin me çmimin Nobel, lindjen, shkollimin, jetën, atdheun e saj etj....</i>). Duke marrë shkas nga përgjigjet e nxënësve, u shpjegohet: <i>Minileksion</i> Ç’është teksti informues? - Tekst që përcjell informacion. - Synon zbardhjen e fakteve duke informuar mbi tema të caktuara, situata, individë, dukuri. Teksti informues përfshin: biografitë, memorandumet, autobiografitë, informacionet e enciklopedive, CV-të, broshurat, letrat zyrtare... Veçoritë gjuhësore Gjuhë standarde Sintaksa e thjeshtë Informacionet ndjekin rendin logjik e kronologjik. Mbizotëron koha e thjeshtë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit punojnë në heshtje me pyetjen 3. Gjeni 3 tipare të gjuhës së informimit. Nënvizoni datat, vendet, personat që përmenden. Nxënësit punojnë në heshtje dhe në minutat e fundit 2-3 prej tyre e lexojnë detyrën e përfunduar para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura. Ushtrimi plotësohet edhe në dërrasë të zezë. Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës). Detyrat dhe puna e pavarur: Bëni një album me foto, piktura dhe shkrime për misionaren e paqes, Nënë Terezën. Ky album mund të përfshihet si punim portofoli.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ngjarje të jetuara Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		Situata e të nxënit: Prezantim digjital. Punë me tekstin. Shfaqen në videoprojektor ose shkruhen në tabelë, shoqëruar me disa foto, disa data dhe titujt që lidhen me to. Nxënësit reagojnë se me çfarë ngjarjesh të jetuara lidhen ato: stema e 100 Vjetorit të Pavarësisë; hyrja e Shqipërisë në NATO; Pavarësia e Kosovës; rrugëtimi i Ismail Qemalit. Mund të jepen imazhe që lidhen me historinë tonë, në varësi të mundësive që ka mësuesi/ja. Mund të jepen të regjistruara fragmente nga ngjarjet e mësipërme të nxjerrja nga <i>youtube</i> . Nxënësit reagojnë dhe shprehin emocione në lidhje me to. (shfrytëzohen fotot e librit, fq. 124)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - ndjek me vëmendje regjistrime autentike nga ngjarje të jetuara që i kanë lënë mbresa; - merr pjesë në bisedë në grup me moshatarët, duke treguar një dëgjim të vëmendshëm ndaj situatave që iu ofrohen; - tregon vëmendje për të marrë të saktë dhe të plotë informacionin që vjen nga burime të ndryshme nga rrëfimet e mësuesit/es, të njëri-tjetrit apo edhe përmes mjeteve elektronike/digjitale të komunikimit; - kupton, krahason merr mesazhe/diferencon/krahason situata, ngjarje, tekste etj.; - pyet kur e ndjen të nevojshme për ta qartësuar situatën; - reagon, shpreh interes dhe kuptimësi rreth asaj që ka dëgjuar mbi rrëfimet e dëgjuara; - tregon histori vetjake që i kanë lënë mbresa; - kërkon një dëgjim të vëmendshëm nga të tjerët rreth asaj që tregon; - kërkon vëmendje nga të tjerët; - bindet se të tjerët e kanë dëgjuar me kujdes, kur ata nisin t’i bëjnë pyetje rreth rrëfimit të tij; - vlerëson mënyrën se si janë shprehur nxënësit/et e tjerë/a.		Fjalët kyçe: dëgjim i kujdesshëm, regjistrim, ngjarje historike, ngjarje të jetuara, emocione, pyetje, përgjigje.	

Burimet: histori të regjistruara, teksti mësimor foto që lidhen me një ngjarje të shënuar, mjete digjitale: diktofon, magnetofon etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim digjital. Punë me tekstin. Dëgjim i vëmendshëm. Pyetje-përgjigje. Lojëra dëgjimore me role.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. U kërkohet nxënësve që mbi bazë të vëzhgimit të mendojnë dhe të tregojnë një mbresë në lidhje me ngjarjet e jetuara. Kërkohet që nxënësit/et të tregojnë vëmendje maksimale rreth rrëfimeve që dëgjojnë. Njëkohësisht, pas çdo rrëfimi apo përjetimi, kërkohen edhe reagime të nxënësve. Ata duan të shtojnë diçka ose të përmirësojnë apo pasurojnë më tej ngjarjen për të cilën rrëfihen episode. Kjo situatë dëgjimore zgjat aq sa mendohet që nxënësit/et të shprehin mbresat e tyre dhe nxjerrin në pah tablonë reale të ngjarjeve të jetuara përmes rrëfimeve ose përdorimit të imazheve dhe videove (apo ndonjë materiali tjetër figurativ që nxit rrëfimin). Shfaqen regjistrime nga përshëndetjet që janë bërë nga personalitete të ndryshme, artikuj gazetash revistash, informacione nga interneti. Gjatë këtij momenti kërkohet vëmendje maksimale. Nxënësit/et japin mendime rreth mënyrës së të folurit të tyre dhe mesazhet që ata kanë përcjellë (materialet mund edhe të lexohen nga mësuesi/ja). <i>Situata 3</i> Pas dëgjimit, nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur tabelën 4. Dëgjojnë disa nga mendimet e nxënësve. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Pyetje-përgjigje Nxënësit/et tregojnë për ngjarje të rëndësishme e me jehonë në gjithë globin. Dëgjojnë njëri-tjetrin dhe reagojnë duke shtuar apo saktësuar informacionin. Bëjnë pyetje dhe marrin përgjigje. <i>Lojëra dëgjimore me role, me data me emra, me foto.</i> Nxënësit/et punojnë në grupe dhe shfaqin emra, data, vende, fotot etj. Të tjerët pasi i shohin dhe dëgjojnë, gjejnë emra njerëzish, vendesh, ngjarjesh etj. Nxënësit zbaviten dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.	
Vlerësimi: Vlerësohen për mënyrës se si nxënësit tregojnë ngjarje të përjetuara; për mënyrën se si i prezantojnë ato qartë, bukur, me fjalor të pasur me emocione; për dëgjimin e vëmendshëm, duke kujtuar të veçantat e çdo ngjarjeje për të cilën dëgjojnë dhe rrëfejnë.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Festat tona Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënësve: <i>Bashkëbisedim në grupe</i> Shfaqet një video me festimet e Vitit të Ri, Ditës së Verës ose të ndonjë feste tjetër. Mund të prezantohen edhe foto ose mësuesi/ja organizon një bisedë në lidhje me festat. Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë ditë festash, të cilat janë disa karakteristika të vendit të tyre.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (të fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje të tjerët; - flet me emocion për festimet në festa të ndryshme dhe mënyrën e organizimit të veprimtarive; - përdorur fjalor të pasur me fjalë dhe shprehje rreth kësaj teme; - përshtat të folurin në varësi të situatës së rrëfimit, dhe interesit për dëgjuesit; - përdor gjuhën standarde; - zgjedh fjalë dhe fraza të përshtatshme me qëllim për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.	Fjalët kyçe: festë, organizim, qëllim, pjesëmarrës, veshje, dekor, muzikë, gatime, historik.
Burimet: teksti i nxënësit, përvojat e nxënësve, fotografi, interneti, video.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe. Punë në grupe. Rrjeti i diskutimit.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Punë në grupe. Rrjeti i diskutimit Nxënësit/et të ndarë në grupe zgjedhin njërin nga fotot në libër në faqen 125 dhe përshkruajnë festën për të cilën bëhet fjalë në atë foto. Kujtojnë mënyrat sesi festohen festa të ndryshme, veprimtaritë që kryen, veshjet, ritet që respektohen etj. Një nxënës/e nga çdo grup prezanton festën që kanë përshkruar në grup, mirëpret pyetje dhe përgjigjet rreth tyre. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Bashkëbisedim në grupe katërshe Nxënësit/et diskutojnë për festën që iu pëlqen më shumë, duke përcjellë ide dhe argumente se pse iu pëlqen më shumë. Nxjerrin në pah karakteristikat e festës që pëlqejnë, madje shprehen edhe me entuziazëm për festën në fjalë (ditëlindje, 1 Qershori, mbyllja e vitit shkollor, hapja e vitit shkollor, festat kombëtare etj.). Flasin për festa popullore, lojërat me djem, me vajza, veshjet etj. U drejtohet pyetja nxënësve: “A duhen festuar të gjitha festat?” Kërkohen mendime pro dhe kundër, të shoqëruara me argumente bindëse. Nxënësit/et shprehen lirshëm dhe japin opinione personale. <pre> graph LR PO[PO] --- Pse[Pse] Pse --- JO[JO] PO --> Pse JO --> Pse </pre>	
Vlerësimi: Vlerësohen për diskutimet dhe përshkrimet me emocion; për pëlqimet dhe kënaqësitë që ndiejnë në festa; për rolet që luajnë dhe bashkëpunimin që bëjnë për të përgatitur festa të ndryshme; për argumentet që sjellin.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Projekt në grup. Përgatitni një plan organizimi për një festë, duke u përkujdesur për çdo detaj (zbukurimi, veshjet, gatimet, muzika, lista e shpenzimeve).	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ushtrime për fjalinë e përbërë. FVK Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe</i> Nxënësit dallojnë fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra, duke u nisur nga folja-kallëzues. Atë pasdite vonë, u shtri barkas majë një kreshte të vogël dhe vështroi livadhin e vogël poshtë. Parvana njohu atë lloj shkatërrimi, i cili shkaktohet nga bombat. Për më shumë se njëzet vjet, Afganistani qe ngërthyer nga luftërat. Poshtë nuk po lëvizte asgjë, përveç një copë bezeje që valëvitej jashtë një hapësire dere. Paragrafi mund të përgatitet qysh më parë në një tabak letre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra; - ndan në pjesë fjalitë e përbëra dhe tregon llojin e tyre; - krijon fjali të përbëra nga dy fjali të thjeshta.		Fjalët kyçe: fjali e thjeshtë, fjali e përbërë me bashkërenditje, fjali e përbërë me nënrenditje, mjet lidhës	
Burimet: Fletore e vlerësimit të kompetencave, pjesë letrare, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë e pavarur. Diskutim. Puno/shkëmbe në dyshe.			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në punimin e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Nxënësit saktësojnë se fjalitë me një folje-kallëzues janë fjali të thjeshta, kurse fjalitë e përbëra kanë më shumë se dy folje-kallëzues.

Ndërtimi i njohurive të reja

Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin FVK, në faqen 42. Ushtrimet do të punohen në fletore, në mënyrë individuale. Më pas, nxënësit do të këmbëjnë librin me shokun/shoqen e bankës, për të verifikuar saktësinë në punimin e ushtrimeve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënës të ndryshëm prezantojnë përgjigjet e ushtrimeve. Ndërhyhet nëse shihet e nevojshme.

Ushtrimi 1.

lidhëza bashkërenditëse: dhe, si edhe lidhëza nënrenditëse: se (ishulli..)

Ushtrimi 2.

Pjesa kryesore	Pjesa e nënrenditur
I hynë mirë e mirë proshutës së ftohtë...	sepse i griu uria.
Më vonë u ulën në hije	që të kuvendonin.
të tjerët dëgjonin me vëmendje.	Kur fliste njëri

Ushtrimi 4.

Liza pa në ëndërr, /se po binte në një pus të thellë. (lidhëz ftilluese)

Pusi ishte i frikshëm, /**prandaj** filloi të ulërasë. (lidhëz bashkërenditëse përmyllëse)

U zgjua menjëherë/ **dhe** nisi të qetësohet ngadalë. (lidhëz bashkërenditëse shtuese)

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; për saktësinë në punimin e ushtrimeve; për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; për detyrën e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Dalloni te pjesa “Biri i Erës” nga katër fjali të thjeshta, të përbëra me bashkërenditje dhe të përbëra me nënrenditje. I shkruani ato në fletore (FVK, fq. 16).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Njoftime, ftesa, urime. Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe</i> Janë dërguar me zarfe disa ftesa, njoftime, urime. Nxënësit/et, të organizuar në grupe, lexojnë sipas llojit urimet, njoftimet dhe ftesat. Nxënësit/et shprehin përvojat e tyre nëse kanë shkruar ndonjëherë njoftime, urime apo ftesa. Ata/ato dallojnë elemente përbërëse të strukturës dhe të përmbajtjes së tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor formën ose modelin e shkrimit të ftesave, urimeve, njoftimeve, mbështetur edhe në udhëzimet e dhëna për mënyrën e të shkruarit të tyre; - zbaton rregullat e strukturës dhe të paraqitjes gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, ide dhe mendime; - përdor fjalor të përzgjedhur për modelin e të shkruarit; - përdor elemente vizuale dhe imazhe në përshtatje me llojin e shkrimit; - përdor kompjuterin për të formatuar modelin; - sheh ilustrime, pamje, piktura etj., të cilat shërbejnë si stimul (nxitjeje) për imagjinatën e tij dhe realizimin e modelit të shkrimit.	Fjalët kyçe: urime, ftesa, njoftime, rregulla shkrimi, ide, fjalor, elemente vizuale.																		
Burimet: modele njoftimesh, urimesh, ftesash, zarfe të stilizuara, teksti i nxënësit.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.																		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe dyshe. Minileksion. Ditar trepjesësh. Punë në grupe. Turi i galerisë.																			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. <i>Minileksion. Ditar trepjesësh.</i> Lexohen modelet e njoftimeve, ftesave dhe urimeve, të paraqitura në tekst në faqen 126. Pasi lexohen modelet, paraqiten përmes <i>Ditarit trepjesësh</i> veçoritë e secilës prej tyre.																			
<table><tr><th>Njoftimet</th><th>Urimet</th><th>Ftesat</th></tr><tr><td>Ka datë</td><td>Destinacion</td><td>Datë</td></tr><tr><td>Destinacion</td><td>Tekst</td><td>Destinacion</td></tr><tr><td>Tekst</td><td>Përshëndetje</td><td>Ditë, orë</td></tr><tr><td>Përshëndetje</td><td></td><td>Tekst</td></tr><tr><td></td><td></td><td>Falënderim</td></tr></table>	Njoftimet	Urimet	Ftesat	Ka datë	Destinacion	Datë	Destinacion	Tekst	Destinacion	Tekst	Përshëndetje	Ditë, orë	Përshëndetje		Tekst			Falënderim	
Njoftimet	Urimet	Ftesat																	
Ka datë	Destinacion	Datë																	
Destinacion	Tekst	Destinacion																	
Tekst	Përshëndetje	Ditë, orë																	
Përshëndetje		Tekst																	
		Falënderim																	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në grupe Nxënësit shkruajnë sipas grupit, llojin e punës me shkrim, këmbajnë ide për letrat që do të shkruajnë në grupe dyshe, zgjedhin shokun të cilit do t'i drejtohen. Nxënësit shkruajnë modelet që kanë zgjedhur për të shkruar (njoftim, urim, ftesë). I këmbajnë me njëri-tjetrit dhe bëjnë sugjerime për mënyrën si i kanë shkruar, përmirësojnë tekstin, duke bërë ndërhyrjet e duhura. Turi i galerisë Punimet e tyre i vendosin nëpër mure, në formën e një <i>Turi galerie</i>, me grupe. Të gjithë nxënësit lexojnë punët e njëri-tjetrit dhe bëjnë vlerësime.																			
Vlerësimi i orës: Kjo orë mësimore do të quhet e suksesshme atëherë kur nxënësit të shkruajnë modele njoftimesh, urimesh, ftesash, duke i shoqëruar edhe me elemente vizuale dhe stilizim. Kur japin sugjerime dhe vlerësime për punën e njëri-tjetrit.																			
Detyrat dhe puna e pavarur:																			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shpikje për të komunikuar (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Stuhi mendimi. Pema e mendimit Hidhet për diskutim çështja: - Cilat janë arsyet e komunikacionit me distancë? - Cilat mjete përdorin njerëzit? Nxënësit sjellin idetë e tyre, të cilat me anë të diskutimit bëhen të dukshme për gjithë grupin e klasës. Me përgjigjet e nxënësve plotësohet <i>Pema e mendimit</i>. <pre> graph TD A([Mjetet e komunikimit]) --> B[celulari] A --> C[telefon fiks] A --> D[kompjuteri] A --> E[posta elektronike] </pre>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - rendit mjetet e komunikimit në distancë; - jep mendimin e tij mbi epërsinë që ka mjeti i tij i preferuar me të tjerët. Ora e dytë Nxënësi/ja: - argumenton duke sjellë fakte rreth organizimit gjuhësor të këtij teksti; - përshkruan epërsinë e çdo mjeti komunikacioni me të tjerët; - zbulon fjalinë kyçe në çdonjërin nga paragrafët e tekstit; - shpreh me fjalë të tjera fjalë e shprehje të përdorura në këtë tekst.		Fjalët kyçe: shpikje, komunikoj, telefon, celular, posta elektronike, e-mail, kompjuter.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, mjete digjitale.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Pema e mendimit. Tryeza e rrumbullakët. Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet pjesa dhe caktohen nxënës për ta lexuar atë. Gjatë rileximit të tekstit “Shpikje për të komunikuar”, mësuesi/ja i nxit nxënësit të punojnë 4 pyetjet e ushtrimit 1, për të kuptuar më mirë brendësinë e tekstit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Përmes metodës së *Tryezës së rrumbullakët* nxënësit interpretojnë mbi:

Po ju me cilin nga këto mjete preferoni të komunikoni? Pse? Ushtrimi 2.

Letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës te tjetri.

Çdo nxënës pasi e shkruan idenë e tij e palos letrën, me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë.

Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme.

Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti.

Ora e dytë**Punë në grupe**

Punohen në grupe pyetjet e rubrikave të tekstit. Grupi I punon ushtrimi 4.

(disa nga datat dhe shifrat janë: lindja e telefonisë së lëvizshme në vitet '80, videotelefoni, ka lindur në vitin 2004, ndërmjet viteve 1939 dhe 1944.....etj.)

Grupi II punon ushtrimin 5.

9 fjalitë kyçe në paragrafin e parë: I gjithë rrjeti telefonik mund të transportojë jo vetëm zërin tonë por edhe faksat ose mesazhet e postës elektronike, e kështu me radhë...

Grupi III punon ushtrimin 7.

(revolucion të dytë, këtu është fjala për një përsosmëri më të lartë të komunikimit. Videotelefoni ka filluar në vitin 2004, videotelefoni është shpikur në këtë vit pra 2004)

Përgjigjet e ushtrimeve prezantohen përmes përfaqësuesve të grupeve. Nxënësit mund plotësojnë njëri-tjetrin. Ushtrimi 6.

Përmes metodës *Rrjeti i diskutimit* punohet ushtrimi 6.

Gjuha e këtij teksti është objektive apo subjektive? Pse? Nxënësit përqendrohen e më pas arsyetojnë qëndrimin. Bëhen ndërhyrjet e duhura, nëse është e nevojshme.

Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 8.

Përmbledhimi me 1-2 fjali secilin nga paragrafët.

Nxënësit përqendrohen dhe shkëmbejnë idetë me njëri-tjetrin. Këto ide shënohen në dërrasë të zezë.

Më pas u kërkohet që këto fjali t'i bashkojnë në një tekst të vetëm. Në minutat e fundit, 2-3 prej tyre e lexojnë tekstin e plotë para klasës.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për përgjigjet me gojë; për argumentet e përdorura; për fjalorin e përdorur.

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra në faqen 128 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Letra zyrtare Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe</i> Lexohen dy-tre letra të modelit personal dhe zyrtar, të shkruara me shkrim dore ose me e-mail. Kërkohet ku ndryshon shkrimi i një letre me shkrim dore nga një letër e shkruar në kompjuter përmes postës elektronike. Nxënësit/et diskutojnë dhe japin mendime.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor formën ose modelin e shkrimit të letrave zyrtare, mbështetur edhe në udhëzimet e dhëna për mënyrën e të shkruarit të letrave zyrtare dhe modelin e shkrimit; - zbaton rregullat e strukturës dhe paraqitjes gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet në lidhje me shkrimin e një letre zyrtare; - përdor fjalor të përshtatshëm në lidhje me situatën që përshkruan.	Fjalët kyçe: Letër zyrtare, rekomandim, motivim, kërkesë, emërim, falënderim, ftesë për mbledhje.
Burimet: modele letrash, teksti mësimor, zarf, modele <i>e-mail</i> -esh.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim/Punë në grupe dyshe. Punë në grupe. Diagrami i Venit. Kllaster. Turi i galerisë	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Lexim, diskutim në dyshe Lexohet informacioni i paraqitur në faqen 129 nga nxënësit. Nxënësit/et bëjnë dallimin mes letrës personale dhe letrës zyrtare, përmes një Diagrami Veni. Ndalim në elementet përbërëse të letrës. Letra ka: - datë; - fjalët përshëndetëse; - hyrjen; - trupin e letrës ose përmbajtjen; - mbylljen, fjalët mbyllëse dhe përshëndetjen formale. U kërkohet nxënësve të zgjedhin nga një temë dhe të mendojnë për të shkruar një letër zyrtare. Shkruhen në dërrasë disa tema për të cilat mund të shkruhet nga nxënësit/et një letër zyrtare: - drejtorit të shkollës; - mësuesit kujdestar; - përgjegjëses së bibliotekës; - senatorit të shkollës. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit shkruajnë modelet e letrave që kanë zgjedhur në mënyrë individuale. I këmbëjnë me njërin-tjetrin, japin mendime dhe vlerësime. Nxënësit lexojnë punimet e njëri-tjetrit në grupe të vogla dyshe dhe japin sugjerime për përmirësime të mëtejshme. Turi i galerisë Pasi kanë përfunduar draftin final të letrës, e fusin në zarf dhe ia dërgojnë me postë (një nxënës luan rolin e postierit dhe ua shpërndan nxënësve në klasë letrat që u adresohen atyre). Letrat i vendosin nëpër muret e klasës apo në këndin e punimeve. Nxënësit lexojnë dhe vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit.	

Vlerësimi: Vlerësohen për shkrimin e letrave sipas strukturës dhe kërkesave që ka shkrimi i një letre zyrtare; për këmbimi i letrave me njëri-tjetrin; për bashkëpunimin në dyshe dhe në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Funkcioni dhe interpretimi i grafikëve, tabelave, pikturave dhe ilustrimeve Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Diskutim.</i> Diskutohet me nxënësit çështja: Cili mendoni se është funksioni i grafikëve, tabelave, pikturave dhe ilustrimeve? Nxënësit sjellin mendimet e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit bëhen më të dukshme në gjithë grupin e klasës. <i>Ilustrimet figurative, tabelat, grafikët, pikturat ndihmojnë në qartësimin e çështjes, paraqitjen e detajuar të objektit që do të shpjegohet.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përcakton funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave dhe ilustrimeve; - dallon funksionin dhe qëllimin e tekstit shpjegues, bazuar në tekstin e mësimit; - shpjegon duke shprehur në forma të ndryshme kuptimin e disa fjalive të këtij teksti; - zbulon sipas fjalorit kuptimin e parë të fjalëve të përzgjedhura; - analizon strukturën e tekstit shpjegues mbështetur në tekstin mësimor; - përpilon grafikë të tjerë për të vendosur të dhënat e tekstit në një formë ndryshe.		Fjalët kyçe: funksion, grafik, tabela, piktura, ilustrim, shpjegon, ndihmon zgjeron, informon.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, libri “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Minileksion. Punë në grupe. Punë në dyshe. Punë individuale.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantohet pjesa e re dhe nxënësve u jepen të dhëna në lidhje me tekstin shpjegues.

Teksti shpjegues:

- ka si qëllim të shpjegojë një çështje, një dukuri, një temë, një personalitet, një ngjarje etj.;
- shpjegon duke thelluar idetë në një fushë të caktuar.

Shpjegimi ndërthuret me informacionin duke analizuar shkaqet dhe duke paraqitur pasojat e një fenomeni të caktuar.

Në themel të tekstit shpjegues qëndron pyetja: *PSE?*

Realizohet leximi i pjesës nga dy nxënës/e.

Gjatë rileximit të tekstit “Funksioni i grafikëve, tabelave, pikturave dhe ilustrimeve”, nxënësit punojnë mbi të, duke përdorur shenjën **V** për informacionet e vërteta dhe **G** për ato të gabuarat.

Pohim. Në vitin 2004 popullsia e Tiranës u rrit me 33000 banorë, G, e kështu me radhë.

Për çdonjërin nga ushtrimet e dhëna, nxënësve do t’u duhet të shpjegojnë me një *Pse* për çdonjërin arsyetim.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Grupi I interpreton kuptimin e fjalisë: “Studimi i banorëve të ardhur në Tiranë dhe i atyre të larguar prej saj është shumë interesant”.

Grupi II interpreton fjalinë: “Prirja për ardhjen drejt kryeqytetit është shumë natyrale”.

Nxënësit punojnë në heshtje. Lexohet detyra para grupit të klasës. Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e duhura.

Analiza e tekstit. U kërkohet nxënësve të nënvizojnë informacionet më të rëndësishme dhe të bëjnë komentet e duhura. *Ushtrimi 3*

Nxënësit përqendrohen për pak çaste e më pas shpjegojnë mbi nënvizimet e bëra.

Nxënësit punojnë sipas metodës *Puno në dyshe/shkëmbe*, ushtrimin 4 të tekstit.

A ka një hyrje ky tekst? Nënvizoni fjalitë në të cilat krahasohen të dhënat (*fjalë e parë shërben si hyrje*).

Në fjalitë që nënvizuat në ushtrimin e mësipërm, dalloni se me çfarë mjete gjuhësore është realizuar krahasimi?

Nxënësit përqendrohen duke shkëmbyer idetë dhe argumentet me njëri-tjetrin.

Nxënës të veçantë (brenda dyshe) argumentojnë përgjigjet para grupit të madh të klasës.

Nëse është e nevojshme bëhen ndërhyrjet e nevojshme.

Nxënësit/et gjejnë në fjalor kuptimin e parë të fjalëve *prirje dhe stabilizim*.

Prirje: vetitë e karakterit ose bindjet që e shtojnë njeriun të veprojë, të silllet a të mendojë në një mënyrë të caktuar. Prirjet politike. Prirje intelektualiste. Prirje e huaj. Prirje për rehati vetjake. Kishte prirje për të kritikuar vend e pa vend.

Stabilizim: lidhet me kuptimin e foljes stabilizoj. E bëj diçka të qëndrueshme duke mënjanuar çrregullimet dhe lëkundjet e panevojshme a të dëmshme; vendos një gjendje të qëndrueshme. *I stabilizoi çmimet.*

E stabilizoi gjendje.

Punë individuale

Nxiten nxënësit të punojnë në heshtje për t’i vendosur të dhënat e tekstit në një tip tjetër grafiku.

Nxënësit punojnë në heshtje. Disa nga punimet e nxënësve vendosen në dërrasë të zezë. Bashkërisht zgjedhin grafikun më të realizuar dhe nxënësit e tij vlerësohen me notë.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për përgjigjet me gojë; për argumentet e përdorura; për fjalorin e përdorur.

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra në faqen 131 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Diktim nr. 3. Teksti, paragrafi, fjalia, fjalia e përbërë, ndajshtimi. Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënit: Nxënësve u shpërndahet një tekst, në të cilin mungojnë: ndarjet e paragrafëve, presjet në fjalitë e përbëra, thonjëzat në ndajshtime. Nxënësit do të punojnë individualisht.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon paragrafët në një tekst të dhënë; - vendos presjet në fjalitë e përbëra; - përdor thonjëzat në ndajshtime; - dallon ndajshtimet, duke i nënvizuar ato.		Fjalët kyçe: paragraf, fjali, tekst, ndajshtim, thonjëza, fjali e përbërë, drejtshkrim	
Burimet: Tekste të hartuara për diktim, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë individuale. Diktim. Vetëqortim, sipas një modeli.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Nxënësit njihen me njohuritë që do të jenë pjesë e vlerësimit të diktimit. Rikujtohen shkurt njohuritë, duke kërkuar nga nxënësit që të japin përkufizimet përkatëse. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Teksti edhe mund t’u diktohet nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura			
Vlerësimi: Vlerësohen me notë, bazuar mbi kriterin e vlerësimit.			
Detyrat dhe puna e pavarur:			

Diktimit nr. 3**Tema:** Teksti, paragrafi, fjalia. Ndajshtimi

Përcakto paragrafët në tekstin e mëposhtëm, duke vendosur numra për secilin. Qorto gabimet gjatë përdorimit të ndajshtimeve, duke nënvizuar ndajshtimet.

Kishte lexuar disa tregime nga vëllimi Rrëmbimi të shkrimtarit Faik Ballanca, por pjesa që i ngeli më shumë në mendje ishte tregimi Mësim i përgjakur. Vendosi që të hidhte në letër disa radhë nga ky tregim. Ngjarja zhvillohet në kohën kur Shqipëria e Veriut që pushtuar nga serbët. Gruaja kishte marrë një plumb në pupël dhe ata nuk ia kishin hequr dot. Po e shpinin në një bazë. Kur erdhi xherahu (mjeku popullor) ajo deshi të ngrihej më këmbë, por Sadriu nuk e la. Donte të shërohej e të luftonte përsëri. E nuk klithte, nuk dinte të klithte, sepse gjoksi i saj ishte i gjerë e i qetë, si gjoks nëne që buron jetë. Dhe xherahu u çudit me qëndrimin burrëror të gruas. Ai kishte mjekuar që dhjetë vjeç, por kurrë nuk kishte parë femër të tillë që të duronte ashtu. - Duhet ta nxjerrësh plumbin, xherah, - tha ajo përsëri.

- Pa këmbë është vështirë të luftohet. E plagosura u ngrit ngadalë ndenjtur dhe hoqi nagantin(revolen) që poshtë jastëkut. Naganti rënkonte në dorën e saj, sikur të ndillte krisma. Burrat heshtën të zymtë e panë njëri-tjetrin. “Ç’do të bëjë? - pyeti veten ai. - Do të më vrasë kështu si lepur? Do të më vrasë një grua? Befas ajo vendosi tytën e nagantit mbi plagën e plumbit dhe e tërhoqi këmbëzën. U dëgjua një krismë e mbytur. Plumbat rrëshqitën në pulpë. E njohën njëri-tjetrin dhe ranë në dysheme. Ky tregim i kushtohet luftëtares Shote Galica. Për nder të saj një shkollë në qytetin tonë quhet Shote Galica dhe një dramë Nusja e maleve, i bën jehonë jetës së saj në mbrojtje të lirisë. Shote Galica mbetet një luftëtare e madhe që u përkund në djepin e trimërisë, fshatin Drenicë. Luftoi me trimëri përkrah luftëtarit Azem Galica, bashkëshortit të saj në 40 aksione luftarake.

(Marrë me shkurtime nga tregimi i Faik Ballancës)

Kriteri i vlerësimit: një gabim, një notë.

Teksti i saktë

- 1) Kishte lexuar disa tregime nga vëllimi “Rrëmbimi” të shkrimtarit Faik Ballanca, por pjesa që i ngeli më shumë në mendje ishte tregimi “Mësim i përgjakur”. Vendosi që të hidhte në letër disa radhë nga ky tregim.
- 2) Ngjarja zhvillohet në kohën kur Shqipëria e Veriut që pushtuar nga serbët.
- 3) Gruaja kishte marrë një plumb në pupël dhe ata nuk ia kishin hequr dot. Po e shpinin në një bazë.
- 4) Kur erdhi xherahu (mjeku popullor), ajo deshi të ngrihej më këmbë, por Sadriu nuk e la.
- 5) Donte të shërohej e të luftonte përsëri. E nuk klithte, nuk dinte të klithte, sepse gjoksi i saj ishte i gjerë e i qetë, si gjoks nëne që buron jetë. Dhe xherahu u çudit me qëndrimin burrëror të gruas.
- 6) Ai kishte mjekuar që dhjetë vjeç, por kurrë nuk kishte parë femër të tillë që të duronte ashtu
- 7) - Duhet ta nxjerrësh plumbin, xherah, - tha ajo përsëri. - Pa këmbë është vështirë të luftohet.
- 8) E plagosura u ngrit ngadalë ndenjtur dhe hoqi nagantin (revolen) që poshtë jastëkut. Naganti rënkonte në dorën e saj, sikur të ndillte krisma. Burrat heshtën të zymtë e panë njëri-tjetrin.
- 9) “Ç’do të bëjë? - pyeti veten ai. - Do të më vrasë kështu si lepur? Do të më vrasë një grua?
- 10) Befas ajo vendosi tytën e nagantit mbi plagën e plumbit dhe e tërhoqi këmbëzën. U dëgjua një krismë e mbytur. Plumbat rrëshqitën në pulpë. E njohën njëri-tjetrin dhe ranë në dysheme.
- 11) Ky tregim i kushtohet luftëtares Shote Galica. Për nder të saj një shkollë në qytetin tonë quhet “Shote Galica” dhe një dramë “Nusja e maleve”, i bën jehonë jetës së saj në mbrojtje të lirisë.
- 12) Shote Galica mbetet një luftëtare e madhe që u përkul në djepin e trimërisë, fshatin Drenicë. Luftoi me trimëri përkrah luftëtarit Azem Galica, bashkëshortit të saj në 40 aksione luftarake.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Domethënia e ngjyrave Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Diskutim-Prezantim digjital.</i> Vendosen me videoprojektor pamje të cilat i vendosin ngjyrat në kontrast me njëra-tjetrin dhe u drejton nxënësve pyetjen: Çfarë ndjesish ju përcjellin këto pamje? Po ngjyrat që mbizotërojnë në to, a e ndihmojnë perceptimin tuaj? Mund të përdoren letra me ngjyra të ndryshme, të cilat vendosen në kontrast përballë njëra-tjetrës. Nxënësit sjellin mendimet e tyre, të cilat mirëpritën të gjitha pasi kanë të bëjnë me botëkuptimin individual të nxënësit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan përmes shpjegimit ndjesitë që përcjellin ngjyrat e ndryshme vjollcë, e bardhë, e kuqe, jeshile; - jep mendimin e tij mbi të veçantën (Interpreton se përse është i dhënë pas një ngjyre të veçantë); - vendos përballë çdo ngjyre një simbol të veçantë.		Fjalët kyçe: ngjyra, informacion, pëlqej, simbolizon, e kuqe, e bardhë, e verdhë, e gjelbër, vjollcë.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Prezantim digjital. DDM. Tryeza rrethore. Dramatizim (Lojë në role)			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në realizimin e detyrës.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet pjesa, e cila lexohet nga nxënës të ndryshëm. Pas rileximit të pjesës, plotësohet tabela DDM.

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi 3. Përmes metodës *Tryeza rrethore* i nxit nxënësit të shpjegojnë sipas këndvështrimit të tyre se pse x ngjyrë është e preferuara e tyre. Letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës te tjetri. Çdo nxënës pasi e shkruan idenë e tij, e palos letren me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë.

Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike, mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, idetë lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti.

Dramatizim. Lojë me role

Ushtrimi 4. Nxënësit/et dramatizojnë (luajnë) në role, duke personifikuar ngjyrën e tyre më të parapëlqyer.

Mund të përdoren kapele të thjeshta me ngjyra të ndryshme, ose rrathë kartoni.

Përgëzohen nxënësit për interpretimin.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënësve; për pjesëmarrjen në diskutim; për interpretimin në role dhe realizimin e detyrës së shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Realizohet projekti në grup në faqen 132. Nxënësit mund të organizojnë takime edhe pas procesit mësues, për realizimin e këtij projekti, i cili mund të paraqitet edhe si një ekspozitë me punime.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pasionet, lojërat, sportet. Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënësve: <i>Prezantim digjital. Bashkëbisedim.</i> 1. Shfaqet një video me lojëra të ndryshme që bëjnë fëmijët e moshës 10-12 vjeç. 2. Ftohen nxënësit të përshkruajnë lojërat që bëjnë dhe të kryejnë një apo dy lojëra individualisht apo edhe në grup. Kujtojnë dhe përshkruajnë lojërat që kanë luajtur në fëmijëri dhe ato që vazhdojnë ende t'i luajnë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (të fjalëve dhe fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe ndalesat për të bërë përshtypje te të tjerët; - flet me emocion për pasionet, lojërat, sportet; - përdor fjalor të pasur me fjalë dhe shprehje nga fusha e lojërave, sporteve; - përshtat të folurin në varësi të situatës së rrëfimit, dhe interesit për dëgjuesit; - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit; - zgjedh fjalë dhe fraza interesante, me qëllim për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.	Fjalët kyçe: lojë, sport, argëtim, lojë, fitore, skuadër, pasion.
Burimet: teksti, përvojat e nxënësve, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Edukim fizik, sporte dhe shëndet. TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim digjital. Bashkëbisedim. Punë në grupe. Diagrami i Venit.	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et, të ndarë në grupe, flasin për pasionet që kanë në lidhje me lojërat dhe sportet. Ata shprehin interesat e tyre për sporte të ndryshme dhe përpjekjet që bëjnë për t'i ushtruar këto sporte. Bëjnë lista me titujt e interesave që kanë dhe që ende janë në përpjekje për t'i arrirë. Nxënësit punojnë me pyetjet 2, 3, 4 të tekstit. U lexohet një lojë nxënësve. Në bazë të veprimeve, nxënësit përcaktojnë emrin e lojës që dëgjuan dhe plotësojnë udhëzimet, duke shfrytëzuar tabelën e ushtrimit 4. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Pune në grup <i>Në këtë fazë të orës, nxënësit mund të shkojnë në terrenin sportiv të shkollës.</i> Nxënësit ndahen në grupe dhe zgjedhin të luajnë njërin nga lojërat e paraqitura në tekst, duke paraqitur edhe instruksionet e zhvillimit të saj.	
Vlerësimi i orës së mësimi: Kjo orë mësimore vlerësohet e suksesshme mbështetur në diskutimet dhe përshkrimet me emocion të nxënësve, për pëlqimet dhe kënaqësitë që ndiejnë gjatë lojërave që bëjnë dhe sporteve që ndjekin. Demonstrimet, përshkrimet, krahasimet, këshillat që japin, janë një element tjetër vlerësues për performancën e tyre.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Krahasoni lojërat elektronike me lojërat që zhvillohen në ajër të pastër.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Gjymtyrët kryesore të fjalisë. Kryefjala Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Në dërrasë shkruhen fjalitë dhe nxënësit i analizojnë: Ana është nxënësja ime. (Kush?) Shkolla jonë është në qendër të Fierit. (Cila?) Ajo ka një mjedis sportiv funksional. (Cila?) Palestra ndodhet brenda shkollës. (Cila?) Nxënësit kanë njohuri për kryefjalën, prandaj formulojnë përkufizimin për të: Është gjymtyrë kryesore e fjalisë, e cila gjendet duke iu drejtuar foljes me pyetjet <i>kush?</i> , <i>cili?</i> , <i>cila?</i> , <i>cilët?</i> .	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kryefjalën në fjali me anë të pyetjeve <i>kush?</i> , <i>cili?</i> ; - thotë me ç’mjete gjuhësore shprehet, pozicionin që zë ajo në fjali; - krijon fjali me kryefjalë të shprehur me grup emëror, me emër, me përemër.		Fjalët kyçe: kryefjala, pyetja, me se shprehet, gjymtyrë kryesore.	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Punë në dyshe. Tabela e konceptit. Punë në grupe.			

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në realizimin e detyrës.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Tërhiqet vëmendja e nxënësve në tekst në faqen 225.

Nxënësit komentojnë figurat, japin përgjigjet e pyetjeve dhe gjejnë kryefjalën.

Ata punojnë me tabelën (Tabela e konceptit): Fjalja - Pyetja – Përgjigjja; në çdo rast të kryefjalës shkruajmë me se është shprehur: *me emër; për emër; grup emëror*.

Një nxënës lexon me zë rubrikën “Mbani mend” dhe nënvizojnë se kryefjala:

- shprehet me gjymtyrë homogjene;
- kur mungon në fjali, ajo nënkuptohet;
- formon grupin emëror në fjali;
- zakonisht qëndron në krye të fjalisë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në dyshe. Punë në grupe

Nxënësit punojnë në grupe dyshe në libër, plotësojnë me laps përgjigjet e ushtrimeve 1, 2, 3. Pastaj këmbëjnë librat e kontrollojnë përgjigjet.

Ushtrimi 4 mund të punohet kështu: klasa ndahet në 6 grupe kolonë siç janë në banka, çdo grup do të përdorë në fjali grupin emëror si kryefjalë. Çdo grupi i japim nga një fletë A4. Secili/a nxënës/e që shkruan fjalinë, e palos si fizarmonikë dhe ia pason shokut pas, i cili vepron si nxënës i parë e kështu me radhë deri në fund. Fiton grupi që ka shkruar fjali të bukura e shpejt. Edhe vetë nxënësit vlerësojnë punën e tyre.

Ushtrimi 5 do të punohet në tabelë nga një nxënës. Klasa do të punojë në fletore.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënësve; punimin e ushtrimeve; detyrën e shtëpisë; punën në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 226.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Gjymtyrët kryesore të fjalisë. Kallëzuesi Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënësve: Punë në dyshe Paraqiten në tabelë disa fjali dhe nxënësit në dyshe do të nënvizojnë kallëzuesit. Me cilat pyetje i gjetët kallëzuesit? Nxënësit përshkruajnë stinën e pranverës. Albani është nxënës i dalluar . Në teatër kishin ardhur shumë të ftuar. Shiu vazhdonte të binte litarë-litarë. Mund ta kishe zgjidhur edhe ti. Paraqiten në tabelë përgjigjet e nxënësve. Tregohet kujdes te kallëzuesi foljor i përbërë dhe ai emëror, të cilët do të trajtohen gjatë kësaj ore.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kallëzuesin në fjali me anë të pyetjeve <i>ç' bën?, ç' bëjnë?</i>; - dallon llojet e kallëzuesit emëror, foljor; - kthen kallëzuesin emëror në kallëzues foljor; - përdor në fjali lloje të ndryshme kallëzuesish.	Fjalët kyçe: kallëzues, emëror, foljor, përshtatja me kryefjalën, folje gjysmëndihmëse.
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve, tabela.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Pema e mendimit. Diskutim. Punë në grupe.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në realizimin e detyrës.	
Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.	
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit bashkë me mësuesin/en komentojnë figurën, gjejnë foljet kallëzues në tekstin e dhënë. Një nxënës/e lexon me zë llojet e kallëzuesve që jepen në tabelë në libër, të tjerë ndjekin dhe në grupe dyshe i thonë njëri-tjetrit përkufizimin për kallëzuesin. Pastaj disa nxënës e thonë para klasës. Shpjegohen me shembuj llojet e kallëzuesit, duke plotësuar <i>Pemën e mendimit</i> .	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Ushtrimi 1 punohet me gojë, nxënësit gjejnë kallëzuesin në çdo fjali. Ushtrimi 2 e punon një nxënës në dërrasë. Sipas shembullit, nxënësi/ja shkruan fjalitë dhe në fund shpjegon kur foljet <i>filloj, zuri, nis</i> , janë më vete dhe kur janë gjysmëndihmëse për kallëzuesin (kur shoqërohen nga një folje në lidhore). Ushtrimet 3, 4, 5, nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe. Kontrollon puna e tyre dhe ndalemi në komentimin e fjalëve të urta, si i kuptojnë nxënësit dhe plotësohet mendimi i tyre.	
Me një ka nuk bëhen pendë. Me një tra nuk mban shtëpia. } Miku i mirë, vlen sa një thesar. Miku është mik kur nuk përzihe në hallet e shtëpisë. t } Bashkimi bën fuqinë Të dimë të vlerësojmë mikun e vërtetë.	
Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënit; për zgjidhjen e ushtrimeve me gojë e me shkrim; për detyrën e shtëpisë.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 228	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI								
Tema mësimore: Kallëzuesi Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: <i>Punë me fisha.</i> U shpërndahen nxënësve fisha me ushtrime. Përgatiten tri fisha, sipas grupeve të nxënësve. Modeli i një fishe <i>Nënvizoni kallëzuesit në fjalitë e mëposhtme, duke drejtuar pyetje për secilin prej tyre. Emërtoni llojin e kallëzuesit. Tregoni me se është shprehur.</i> Nxënësit përgjigjet e tyre mund t'i paraqesin edhe me tabelë. Dimri dalëngadalë ishte larguar. Kishte nisur të vinte pranvera. Këtë gjë mund ta shihje kudo. Pemët kishin bulëzuar sythe. Në ajër ndihej një aromë dehëse e luleve të fushave. Pranvera ishte një stinë e bukur. Njerëzit tani ishin më të qeshur. Disa re pupëlore lundronin butësisht në qiellin e ftohtë. Sytë të deheshin nga ajo pamje. Së shpejti fëmijët do të dilnin lëndinave.									
		<table border="1"> <tr> <td>Kallëzuesi</td><td>Pyetja</td><td>Lloji</td><td>Shprehet</td></tr> <tr> <td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </table>		Kallëzuesi	Pyetja	Lloji	Shprehet				
Kallëzuesi	Pyetja	Lloji	Shprehet								
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale											
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kallëzuesin në fjali të ndryshme; - emërton llojet e kallëzuesit; - tregon me se është shprehur ai; - kthen kallëzuesit foljorë në emërorë dhe anasjelltas; - tregon përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën; - krijon një tekst duke përdorur disa lloje kallëzuesish.		Fjalët kyçe: kallëzues, pyetje, kallëzues emëror, kallëzues foljor i thjeshtë, kallëzues foljor i përbërë, fjali.									
Burimet: teksti, fisha të përgatitur nga mësuesi/ja, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.									

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Punë në grupe. Diskutim. Shkrim i lirë.

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në realizimin e detyrës.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Aktivizohen nxënës të ndryshëm në dhënien e përgjigjeve.

Ndërtimi i njohurive të reja**Punë në grupe**

Për realizimin e kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të shfrytëzojë pjesë nga leximi, në mënyrë që nxënësit të përvetësojnë sa më mirë, përmes shembujve, njohuritë që kanë marrë në lidhje me kallëzuesin.

Secilit grup i jepet nga një paragraf. Nxënësit do të punojnë duke kombinuar pyetje të tilla si:

1. Nënvizoni kallëzuesit dhe tregoni llojet e tyre.
2. Ktheni kallëzuesit foljorë në emërorë dhe anasjelltas. Stina e pranverës nisi të vinte. Stina e pranverës erdhi.
3. Tregoni me se janë shprehur kallëzuesit.
4. Ktheni në shumës ose në njëjës kryefjalën e fjalive. Si ndryshon kallëzuesi?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Përfaqësues të grupeve prezantojnë përgjigjet në tabelë. Nxënësit mund të qortojnë njëri-tjetrin. Nëse është e nevojshme, bëhen ndërhyrjet e duhura.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për veprimet në situatë; për punën në grup; për saktësinë në dhënien e përgjigjeve; për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; për punimin e detyrave të shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkrim i lirë. Krijoni një tekst të shkurtër, 8-10 fjali, për lojërat dhe sportet, ku të përdorni lloje të ndryshme kallëzuesish.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shkruajmë receta të shëndetshme Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Paraqiten disa lloje gatimesh me videoprojektor ose receta të sjella nga mësuesi/ja, në meny a tabakë letre dhe në formën e një loje gjuhësore me <i>quiz</i> -e u kërkohet nxënësve të gjejnë emrin e gatimit dhe të shprehen se cilat nga gatimet që shfaqen iu pëlqen në shumë: gjellët, ëmbëlsirat etj. Mësuesi/ja pyet nëse ndonjë prej tyre e ka qejf gatimin dhe pse? Çfarë mendimi kanë për emisionin e “Master shefit” që jepen në televizion? Shikojnë disa fragmente ne <i>youtube</i> dhe diskutojnë rreth tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përgatitet dhe ndjek fazat e procesit të të shkruarit; - merr pjesë gjatë paraqitjes së fazave të procesit të të shkruarit; - zgjedh temën – recetën e gatimit, llojin e gatimit; - mbledh ide rreth mënyrës si përgatitet dhe i rreshton në formë këshillash; - bën lista me përbërësit e gatimit; - shkruan me fjali të plota hapat që do të ndjekë. - zgjeron ose shkurton fjali; - ndan paragrafët, shmang përsëritjet. - miraton sugjerimet; - shkruan draftin e parë të recetës; - shton ose heq instruksione; - përgatit draftin final, e shkruan atë; - e kontrollon përsëri, i jep dorën e fundit për ndonjë ndryshim të mundshëm dhe për gabime strukturore.		Fjalët kyçe: gatim, recetë, këshilla, instruksione.	
Burimet: punime me shkrim, modele recetash gatimi, libri “Arti i gatimit”, material në videoprojektor me imazhe dhe receta gatimi, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim në grup. Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe. Shkrimi i recetës.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Diskutim në grup. Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe

Nxënësist do të diskutojnë në grupe.

Thuhet se disa ushqime janë ushqimet e humorit. Të ndarë në grupe, nxënësist flasin për:

Gr. 1 - Konsumoni sa më shumë karbohidrate, ato ju qetësojnë!

Fasulet, frutat dhe drithërat integrale janë sheqerna që na qetësojnë, pasi nuk shkaktojnë luhajtje drastike të sheqerit.

Gr. 2 - Mos konsumoni këto lloj karbohidratesh, ato ju acarojnë!

Ëmbëlsirat e pasura në sheqer të bardhë, krem pasticerie, miell të bardhë dhe yndyra të tipit margarinë, shkaktojnë shpesh luhajtje të humorit, siç shkaktojnë edhe luhajtje të sheqerit në gjak.

Gr. 3 - Konsumoni ushqimet e gëzimit!

Shumë nga ne ndihen mirë pas konsumit të një çokollate, të një gote qumësht, të një bananeje apo dhe të gjetheve jeshile, si rukola, spinaqi etj., pasi të gjitha këto lidhen me gjendjen e pëlqyeshme të humorit.

Gr. 5 - Një kombinim i shijshëm

Një përzierje e shijshme e frutave, perimeve, qumështit, arrave është mundësia më e mirë për ta nisur ditën në mënyrë të shëndetshme. Mësoni si t'i kombinoni ushqimet për ta bërë lëngun tuaj me shije të pëlqyeshme.

Kombinimet më të mira për një pije shumë të shijshme:

1. banane, spinaq, ananas, qumësht;
2. avokado, kastravec, qershi të grira, qumësht;
3. banane, mango, qumësht, arrë kokosi;
4. banane, majdanoz, ananas, qumësht.

Mësuesi/ja prezanton disa receta gatimi (lexon ose paraqet me PP).

Paraqet strukturën e shkrimit të recetës së gatimit.

Struktura e recetës

Emri i gatimit:

Përbërësit:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë e pavarur. Turi i galerisë

Nxënësist/et kanë kërkuar më parë për receta gatimi, kanë lexuar në revista apo në libra “Arti i gatimit”, kanë zgjedhur recetën që do të prezantojnë dhe e shkruajnë atë.

Përgatisin draftin final të recetës dhe e lexojnë edhe për të tjerët.

Nxënësist/et i vendosin punët me shkrim në faqet e mureve të klasës, me qëllim që të gjithë të kenë mundësi t'i lexojnë, të japin sugjerime dhe të vlerësojnë.

Vlerësimi i orës së mësimit. Kjo orë mësimi, e cila kishte për qëllim zhvillimin e kompetencës së të shkruarit në lidhje me një recetë gatimi, vlerësohet e suksesshme edhe e arrirë, atëherë kur nxënësist pasi kanë lexuar punët e tyre me shkrim, japin vlerësime, bëjnë komente për punët me shkrim të njëri-tjetrit.

Punimi ruhet në portofolin individual të punimeve të nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Unë jam Malala Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Stuhi mendimi. Pema e mendimit Hidhet çështja për diskutim. Si mendoni cila është marrëdhënia e fjalës kyçe arsim me fjalët dhunë, diskriminim, intolerancë? Nxënësit sjellin mendimet e tyre të cilat përmes diskutimit bëhen të dukshme për gjithë grupin e klasës. Me përgjigjet e vlefshme të nxënësve, mësuesi/ja plotëson Pemën e mendimit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - vendos në marrëdhënie fjalët kyçe duke patur si element thelbësor të kësaj lidhjeje argumentin; - dallon tekstin argumentues si pjesë të tekstit joletrar mbështetur në fragmentin e tekstit; - argumenton qëndrimet e tij/saj në lidhje me çështjet e trajtuara në tekst; - dallon shprehjet e figurshme dhe përsëritjet, duke treguar funksionin e tyre; - harton një tekst të shkurtër argumentues.		Fjalët kyçe: tekst argumentues, bind, fakte, opinione, shembuj, tezë argument, të drejta, arsimim, vendosmëri.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Pema e mendimit. Pyetje- përgjigje. Minileksion. Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe. Ditari dypjesësh.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Prezantohet titulli në tabelë dhe lexohet shkrimi për Malala Jusufsai. Lexohet pjesa nga dy nxënës/e. Pas rileximit të tekstit “Unë jam Malala”, orientohen nxënësit që nëpërmjet metodës Pyetje-përgjigje të punojnë 6 pyetjet e ushtrimit 1 për të hyrë më në brendësi të tij. 1. Malala është aktiviste pakistaneze e njohur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për arsim. 2. Fjalimin e saj ua drejton të gjithë atyre djemve e vajzave, të cilët kanë pasur të njëjtin hall me të.... (Kështu vazhdohet në të gjitha pyetjet) Nga mënyra se si kërkohen përgjigjet e ushtrimeve të mëposhtme, nxënësve do t’u duhet të argumentojnë përgjigjet e tyre. Prej këtej, përmes Minileksionit, u shpjegohet nxënësve se: Ç’është dhe cili ishte qëllimi i tekstit argumentues?			

Teksti argumentues:

1. Ka si qëllim të bindë lexuesin për një çështje të caktuar nëpërmjet fakteve, shembujve, provave, gjykimeve praktike.
2. Autori i një teksti argumentues formulon një tezë, e cila shfaqet e gatshme për lexuesin ose është e nënkuptuar.
3. Teza është një pohim, një ide kyçe, mbi të cilin ndërtohet i gjithë teksti.
4. Vërtetësia e kësaj teze dhe e argumentimit të saj varet nga opinionet e autorit, argumentet që ai sjell për ta mbështetur atë dhe për ta bindur kështu lexuesin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit nëpërmjet metodës *Rrjeti i diskutimit* argumentojnë pro dhe kundër çështjes:

A ju bën përshtypje jeta e Malalas?**Po****Pse?****Jo**

Nxënësit punojnë në heshtje e më pas argumentojnë përgjigjet e tyre para grupit.

Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe për të punuar pyetjet e rubrikave të tekstit.

Grupi I punon ushtrimin 3.

Grupi II punon ushtrimin 4.

Grupi III punon ushtrimin 5.

Grupi IV punon ushtrimin 7.

Nxënësit punojnë dhe më pas përfaqësues të ndryshëm prezantojnë përgjigjet. Nxënësit mund të plotësojnë njëri-tjetrin.

Ditari dypjesësh. Ushtrimet 6, 7. Ushtrimi punohet në tabelë nga një nxënës/e, kurse klasa punon në fletore.


Shprehjet e figurshme	Përsëritjet
që ka ngritur zërin, plumbat do të na bënin të fështnim...	e çdo gruaje, e çdo djali, ...

Diskutim. Nxënësi/et diskutojnë rreth çështjes. “Vlerësoni ndjenjën e përgjegjësisë së Malalës për ta bërë botën një vend më të mirë dhe më të qetë”.

Nxënësit diskutojnë lirshëm, duke shprehur mendimet e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; për pjesëmarrjen në diskutim; për argumentet e sjella; për bashkëpunimin në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra në faqen 137 (sipas kërkesës).

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ushtime për kallëzuesin. FVK Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Pema e mendimit - Kallëzuesi. Paraqitet në tabelë dhe plotësohet nga nxënësit, duke dhënë shembuj. 	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - plotëson <i>Pemën e mendimit</i> për kallëzuesin; - dallon llojet e kallëzuesit; - formon fjali me lloje të ndryshme kallëzuesish.		Fjalët kyçe: kallëzues, i thjeshtë, i përbërë, emëror, folje ndihmëse, folje gjysmëndihmëse.	
Burimet: Fletore e vlerësimit të kompetencave, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimit. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Rikujtohen njohuritë që kanë marrë nxënësit në lidhje me kallëzuesin.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin FVK, në faqen 44. Ushtrimet do të punohen në fletore, në mënyrë individuale. Më pas, nxënësit do të këmbëjnë librin me shokun/shoqen e bankës, për të verifikuar saktësinë në punimin e ushtrimeve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Nxënës të ndryshëm prezantojnë përgjigjet e ushtrimeve. Ndërhyhet nëse shihet që nxënësit kanë paqartësi. Ushtrimet 1 dhe 3 mund të paraqiten edhe në tabelë.

Ushtrimi 1

kallëzues emëror: *ishte hera e parë*;

kallëzues foljor i thjeshtë: *afrohej, gjendej, hynte, kishte, kaloi*;

kallëzues foljor i përbërë: *mund të luante*.

Ushtrimi 3

kallëzues foljor: *është përtërirë, shpoi, depërtuan, fillon të ndryshojë, ndryshojnë*;

kallëzues emëror: *është pranverë, ishin të parat, është një zgjim i bukur*.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për saktësinë në punimin e ushtrimeve; për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; për detyrat e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një tekst me 7-8 fjali, në të cilin të përdorni disa lloje kallëzuesish.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Këshilla dhe udhëzime Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: Sa e njohin nxënësit përdorimin e pajisjeve të ndryshme? Paraqet në videoprojektor ose paraqiten disa foto që tregojnë përdorimin e gabuar të disa pajisjeve elektronike: celular, tabletë, laptop etj. dhe kërkohet që nxënësit/et të gjejnë gabimin që bëhet nga përdoruesit e tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - merr pjesë për përgatitjen për procesin e të shkruarit - zgjedh temën – këshilla dhe instruksione; - kërkon dhe lexon modele të listave, këshillave dhe instruksioneve; - shkruan me fjali të plota dhe të qarta për nga ana gjuhësore; - zgjeron ose shkurton fjali, duke përdorur mirë format e foljeve në mënyrën lidhore; - shmang përsëritjet; - këmben dhe merr ide nga nxënës të tjerë, shok të grupit; - miraton sugjerimet që i jepen dhe përmirëson shkrimin e tij në draftin e shkruar; - shkruan draftin e parë të këshillave; - shton ose heq instruksione; - përgatit draftin final, e shkruan atë; - e kontrollon përsëri, i jep dorën e fundit për ndonjë ndryshim të mundshëm dhe për gabime strukturore drejtshkrimore dhe të pikësimit; - i jep dorën e fundit, e dorëzon dhe e publikon.	Fjalët kyçe: këshilla, instruksione
Burimet: materiale të regjistruara në video CD, anketë foto me aparate bashkëkohore që lidhen me komunikimin, botime me këshilla/instruksione, guida për përdorimin e pajisjeve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca. TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Anketë. Shkrimi i udhëzimeve. Punë e pavarur. Punë në grupe	

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantohet tema e mësimit.

Anketë

Plotësohet anketa “*Ju dhe loja*”, në faqen 135.

Lexohen disa anketa të plotësuara nga nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Anketë

Nxënësit shpjegojnë duke arsyetuar në lidhje me këshillat e ushtrimit 2.

Shkrimi i udhëzimeve. Punë e pavarur.

Nxënësit shkruajnë dhjetë këshilla për përdorimin e tabletit. Orientohen nxënësit me disa këshilla dhe nxiten që të plotësojnë të tjerat.

Këshilla:

Ja se si duhet të përdorim një kompjuter ose tabletë:

Hapi i parë

Bëni një pushim herë pas here nga përdorimi i telefonit, kompjuterit, laptopit apo tablet.

Ushtrimet e ndryshme fizike mund t’ju ndihmojnë.

A. Këshillat që ju nevojiten gjatë përdorimit të kompjuterit janë:

- Zgjidhni të qëndroni në një karrige me bazament të mirë mbështetës ose vendosni një jastëk prapa kurrizit
- Qëndroni drejt, pa u kërrusur para.
- Mbani shpatullat të relaksuara dhe bërrylat afër me trupin.
- Mbani duart, kyçet e duarve, parakrahët dhe kofshët paralel me dyshtemenë.

Shto të tjera...

Nëse përdorni telefon:

- Përpikuni të shmangni mbajtjen e tij mes kokës dhe shpatullave.
- Investoni në një pajisje që ju lejon t’i keni duart e lira.

Shto të tjera...

Përdorimet ideale të tablet janë:

- Blini një mbështetëse që ju lejon të keni një kënd të mirë shikimi.
- Qëndroni në pozicionin ku syri të shikojë paralel me ekranin.
- Bëni pushim çdo 15 minuta.
- Merrni frymë thellë në mënyrë që trupi të marrë sasinë e oksigjenit që i nevojitet.
- Qëndrimi korrekt, larg nga ekrani, ju ndihmon në reduktimin e dëmit që mund të shkaktojë qëndrimi për një kohë të gjatë përpara kompjuterit apo tablet.

Shto të tjera...

Punë në grupe

Pasi janë ndarë në grupe dhe pasi kanë diskutuar për këshillat e mësipërme në lidhje me përdorimin e laptopit, tabletit dhe telefonit, nxënësit duhet të shkruajnë nga 5 këshilla të tjera në fletoren e punës me shkrim ose në një fletë formati.

Këmbejnë fletët e punës me njëri-tjetrin, bëjnë sugjerime dhe japin ide, shtojnë ose heqin këshilla apo instruksione në lidhje me pajisjet e mësipërme elektronike të përdorimit të përditshëm.

Të gjitha këshillat e shkruara nga nxënësit përmbledhen në një udhëzues në formë libri ose guide dhe ata e shtojnë atë si një produkt pune të dalë nga kjo orë mësimi, e cila duhet t’iu shërbejë dhe ta respektojë gjatë përdorimit të pajisjeve teknologjike që lidhen me punën e tyre të përditshme.

Vlerësimi i orës së mësimi. Kjo orë mësimi, e cila kishte për qëllim zhvillimin e kompetencës së të shkruarit në lidhje me shkrimin e këshillave apo instruksioneve, do të quhet e suksesshme kur nxënësit/et të kenë shkruar këshilla dhe udhëzime për mënyrën e përdorimit të pajisjeve elektronike që ata përdorin, si dhe kur të kenë përgatitur një *buklet* në formë guide, ku të kenë përmbledhur të gjitha këshillat dhe instruksionet e shkruara. Punimi (*bukleti*) mund të ruhet në portofolin (dosjen) individual të punimeve të nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Të vërejturit - burim i çdo diturie (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jolettrare.		Situata e të nxënit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Nxiten nxënësit që përmes titullit “Të vërejturit burim i çdo diturie”, të parashikojnë zhvillimin e ngjarjes. Nxënësit përmes diskutimit parashikojnë zhvillimin e ngjarjes. Shënohen në dërrasë disa përfundime të nxjerra nga nxënësit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - parashikon zhvillimin e ngjarjes duke pasuruar fjalorin me shprehje e fjalë të reja; - lexon fragmentin për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth kuptimit; - shpreh mendimin e tij/saj duke i lidhur ngjarjen me përvojën e tij/saj personale. Ora e dytë Nxënësi/ja: - dallon tezën që i sjell lexuesit Zh. Zh. Ruso përmes këtij shkrimi; - rendit argumentet që përdor autori për të bindur lexuesin në lidhje me tezën e shkrimit; - kthen paragrafët e tekstit në këshilla; - jep vlerësimin e tij/saj për këshillat që jep autori.		Fjalët kyçe: vërej, burim, ditori, nxënës, kureshtje, shkencë, arsye, autoritet, i qartë, i thjeshtë.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Imaginatë e drejtuar. Pyetje-përgjigje. Puno dyshe/Shkëmbe ide. Punë në grupe. Ditari trepjesësh.

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për idetë dhe argumentet që kanë sjellë përmes tekstit që kanë krijuar.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës.

Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantohet titulli i pjesës dhe nxënësit realizojnë leximin e saj.

Pas rileximit të tekstit “Të vërejturit burim i çdo diturie”, drejtohen nxënësit drejt të kuptuarit të tij. Për ta realizuar përdor teknikën *Marrëdhënia/Pyetje-përgjigje*. Ushtrimi 1. Cila është këshilla kyçe e autorit? Cilat janë gabimet e metodave që përdor një mësues/e? Cili është problemi më i madh që një fëmijë të mësojë? Cila është mënyra më e drejtë për të vënë një nxënës në pozita pune?

Puno në dyshe/Shkëmbe ide

Nxënësit punojnë ushtrimin 2 në faqen 139.

Shpjegoni thënien e autorit “*në qoftë se në shpirt të tij e zëvendësoni arsyen me autoritetin, ai s’ka për të arsyetuar më, ai s’ka për të qenë tjetër veçse një lojë e mendimeve të botës*”.

Nxënësit përqendrohen, shkëmbejnë idetë e më pas përgjigjen më të plotë, mësuesi/ja e shënon në dërrasë të zezë.

Ora e dytë**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Punë në grupe.

Nxënësit do të punojnë në grupe për t’iu përgjigjur pyetjeve të tekstit.

Grupi I punon ushtrimin 3. Nxënësit dallojnë tezën e këtij shkrimi argumentues.

Grupi II punon ushtrimin 4. Nxënësit renditin argumentet që përdor autori për të bindur lexuesin, p.sh.: *Jeta e dukurive të natyrës gjendet në zemrën e njeriut, për ta parë duhet ta ndjesh...*

Grupi IV punon ushtrimin 5. Shqyrtohen foljet e e tekstit dhe koha që mbizotëron.

Grupi V punon ushtrimin 6. Nxënësit kthejnë paragrafët e tekstit në këshilla.

Nxënësit punojnë disa minuta dhe më pas përfaqësues nga grupet prezantojnë përgjigjet.

Ditari trepjesësh. Ushtrimi 7 punohet në fletoren e klasës.

Gjërat që duhet të bëni

Gjërat që nuk duhet të bëni

Vlerësimi juaj

Prezantohet plotësimi i tabelës duke aktivizuar nxënës të ndryshëm.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një tekst argumentues të shkurtër ku të mbronit tezën “Të mësuarit zgjat gjithë jetën”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Gjymtyrët e dyta të fjalisë. Përcaktori, llojet e tij Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: <i>Punë në dyshe</i> Paraqitet në tabelë fjalitë e fragmentit të faqes 229. Veçohen disa grupe emërore dhe nxiten nxënësit të nënvizojnë fjalët përcaktuese, duke treguar se me se janë shprehur. Qarkohet bërthama e grupit emëror. Ditët e pranverës (emër) Çdo fëmijë (përemër i pacaktuar) Ditët e fundit të dimrit (mbiemër, emër) Ditët me diell (emër) Netët e ftohta me ngricë (mbiemër, emër)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon përcaktorët, llojet e tij, mbi bazën e lidhjes bërthamë + përcaktor; - përdor lloje të ndryshme përcaktorësh në fjali.		Fjalët kyçe: përcaktor me përshtatje, drejtim, bashkim, fjalë bërthamë	
Burimet: libri i nxënësit, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Lexim i lidhur me shpjegimin. Lojë gjuhësore.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve			

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënës. Nxënës, pasi emërtojnë grupet emërore dallojnë fjalët përcaktuese.

Ndërtimi i njohurive të reja. Lexim i lidhur me shpjegimin. Lojë gjuhësore

Një nxënës lexon me zë informacionin në tekst për gjymtyrët e dyta. Plotësojnë tabelën për emërtimin e tri gjymtyrëve të dyta. Së bashku me nxënës, formulohet përkufizimi për përcaktorin si gjymtyrë e dytë e fjalisë.

Vëmendja përqendrohet te tabela ku jepen llojet e përcaktorëve:

- Me përshtatje - përshtaten në gjini, numër, rasë me emrin bërthamë.
- Me drejtim - i drejtohen vetëm në rasë emrit bërthamë.
- Me bashkim - i ngjitet, i shtohet pa ndryshim emrit bërthamë.

Për t'i dalluar sa më thjesht llojet e përcaktorëve, organizohet një *Lojë gjuhësore*. Klasa ndahet në tri pjesë, për tri grupet e nxënësve sipas rreshtave. Çdo skuadër shkruan sa më shumë grupe emërore me përcaktor me përshtatje, skuadra tjetër, përcaktorë me drejtim, ndërsa skuadra tjetër, përcaktorë me bashkim. Skuadrave u lihet në dispozicion 5-6'. Vetë nxënës, pasi mbaron koha, kontrollojnë në tabelë punën e grupeve, qortojnë gabimet, numërojnë grupet emërore, shpallin fituesin: *Më i shpejti më i sakti*.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi 1 punohet me gojë, nxënës udhëzohen të vendosin shigjetat nga përcaktori te fjala bërthamë.

P.sh. babai i Brunës. Buqeta me lule.

Festë ditëlindjeje. Për këtë zgjidhje.

Ushtrimet 2, 3, 4, nxënës i punojnë në grupe dyshe ose në grupe me nga pesë nxënës (çdo grup një ushtrim) dhe paraqesin zgjidhjen e ushtrimit para klasës. Bëhen plotësime për përgjigjen e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; për veprimtarinë në lojën gjuhësore; për detyrën e shtëpisë me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5 në faqen 231 (sipas kërkesës).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ndajshtimi Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënët: Kërkohen nga nxënësit që të japin dy emra rrugësh, dy emra profesione, dy emra titujsh, të cilët paraqiten në tabelë rruga “Myslym Shyri”, rruga “5 Shkurti” mësuese Vjollca, inxhinier Arturi, profesor Bardhi, komandant Myslimi. Kërkohet nga nxënësit që t’i lakojnë këto grupe emërore. Cila fjalë nuk lakohet? Nxënësit nënvizojnë fjalën që nuk ndryshon gjatë lakimit. Fjala që nuk ndryshon gjatë lakimit, është ndajshtim (përcaktor).	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njeh ndajshtimin si përcaktor; - jep përkufizimin për të si emër i pashquar që nuk lakohet; - tregon vendin që zë ndajshtimi; - shkruan drejt rastet kur ndajshtimi është emërtim midis thonjzave.	Fjalët kyçe: ndajshtim, i palakueshëm, para dhe prapa fjalës që përcakton.
Burimet: libri i gjuhës 6, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë e pavarur. Diskutim. Punë në dyshe.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Nxënësit udhëzohen që të hapin tekstin në faqen 231. Lexohet informacioni dhe njohuritë paraqiten të përmbledhura. Grupohen ndajshtimet në dy tipe: a) Para fjalës që përcaktojmë Nënë Mira është shumë e dashur për nipërit e saj. Profesor Aleksandri është i zoti në profesionin e tij. Arkitekta Nina projektoi stadiumin e ri. b) Pas fjalës që përcaktojmë Shkrimtari Ismail Kadare ka shkruar shumë vepra artistike. Muaji maj është muaji më i bukur i pranverës. Romani “Kështjella”, është roman me temë historike. Shkolla “Emin Duraku” ndodhet në qendër të Tiranës. Nxënësit lexojnë edhe shembujt e dhënë në libër dhe përforcojnë njohuritë për ndajshtimin si një lloj përcaktori. Vëmendja përqendrohet te drejtshkrimi i ndajshtimit midis thonjzave. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Ushtrimet 1, 2, 3, nxënësit të ndarë në grupe dyshe i plotësojnë në libër. Pastaj këmbëjnë librat dhe qortojnë punën e njëri-tjetrit. Ushtrimi 5 punohet në tabelë nga një nxënës/e.	
Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënit; për veprimtarinë në punën në dyshe; për detyrën e shtëpisë me shkrim.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 232 (sipas kërkesës).	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Histori njerëzore dhe alienët Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: <i>Diskutim</i> Shënohet në dërrasë të zezë çështja për diskutim. A keni dëgjuar apo lexuar për misteret e Egjiptit? Po për jashtëtokësorët? Nxënësit sjellin mendimet e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit bëhen të qarta për të gjithë grupin e klasës. Mund të shfaqen përmes videoprojektorit fotografi të mistereve të ndryshme të shkencës ose prezantohen foto të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - argumenton mbi praninë e alienëve në qytetërimet e lashta; - jep përgjigje hap pas hapi duke thelluar argumentet bindëse përmes ushtrimeve të tekstit; - interpreton provat që vërtetojnë ekzistencën e alienëve duke mbajtur edhe qëndrimin e tij/saj personal; - përcakton tezën dhe argumentet e tekstit “Histori njerëzore dhe alienë”; - dallon veçori gjuhësore të tekstit argumentues mbështetur në tekstin e dhënë; - nxjerr përfundime më konkrete mbi bindshmërinë e provave të këtij teksti.		Fjalët kyçe: mister, Egjipt, jashtëtokësor, shkencë, legjendë, piramidë, sarkofagë, Sfinks, pergamenë, ndërtoj, alien.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Shkenca.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim. Tryeza rrethore. Diskutim. Punë individuale. Rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Lexohen disa detyra.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Prezantohet titulli i mësimi. Leximi i pjesës dhe shpjegimi i fjalorit. Ndërtimi i fjalive të reja me fjalët e fjalorit.

Pas rileximit të tekstit “Histori njerëzore dhe alienët”, nxënësit nxiten të punojnë 6 pyetjet e ushtrimit të tekstit.

1. *Në qytetërimet e lashta besohej se ekzistonin alienët...*
2. *Përveç këtyre është gjetur një pergamenë*
3. *Monumenti më i madh, i quajtur “Sfinks”...*
4. *Piramidat u janë kushtuar tre faraonëve...*
5. *Faraonët quheshin Keops, Kefren, Mikerino.*
6. *Pergamena flet për Dinastinë IV.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nëpërmjet metodës *Tryeza rrethore*, nxënësit nxiten që të interpretojnë duke shpalosur dijet e tyre mbi pyetjet e ushtrimeve 2, 3.

Po ju a besoni në ekzistencën e jashtëtokësorëve?

Jepni provat që vërtetojnë ekzistencën e tyre, duke shfrytëzuar të dhënat e tekstit.

Letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës te tjetri.

Çdo nxënës, pasi e shkruan idenë e tij e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë. Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike; mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, idetë e nxënësve lexohen e më pas ilustrohen me fjalë e shprehje nga teksti.

Përfundimet më të rëndësishme, mësuesi/ja i shënohen në dërrasën e zezë.

Teza e shkrimit dhe argumentet që sjell autori shkruhen në tabelë.

Teza:

Në të gjitha qytetërimet e vjetra ekzistojnë prova dhe legjenda për ekzistencat jashtëtokësore. Alienët kanë qenë dhe janë të pranishëm.

Argumentet:

Piramidat në luginën e Gjizës (janë tri, të cilat janë cilësuar si një nga mrekullitë e botës).

Në to janë gjetur sarkofagë, statuja, vizatime, hieroglifë.

Nxënësit qarkojnë në tekst alternativën e saktë në ushtrimin 4. *Teksti argumenton ekzistencën e jashtëtokësorëve, si ndërtues të Piramidave.*

Punë individuale

Nxënësit plotësojnë fushën leksikore të fjalës *Piramidë*. Njëri/njëra prej tyre e paraqet në tabelë.

Rrjeti i diskutimit

Ushtrimi 6

A janë bindëse për ju provat e dhëna në tekst për ndërtimin e Piramidave? Po? Jo ? Pse?

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani idetë tuaja për temën: “Sa afër dhe sa larg janë alienët”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Episode filmash dhe emisionesh për fëmijë. Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		Situata e të nxënit: Ndjekje e sekuecave të një filmi për fëmijë (i regjistruar në CD, ose mësuesi/ja mund të lexojë fragmente, të thotë batuta.). Bëhet një <i>kuic</i>. <i>Si e ka titullin filmi?</i> <i>Si quhen personazhet?</i> <i>Ku luhet ky film?</i> Nxënësit i bëjnë pyetje njëri-tjetrit: <i>Çfarë tha?</i> <i>Kush i tha këto fjalë?</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - zgjedh formën e përshtatshme për të ndjekur dhe përcjellë informacionin, mbi filma dhe emisione TV; - tregon përqendrim dhe vëmendje në grup me moshatarët, duke treguar pëlqim/ose mospëlqim ndaj situatave dhe sekuecave filmike; - kupton, merr mesazhe/diferencon/krahason situata, tekste, si dhe personazhe që shfaqen gjatë sekuecave etj.; - pyet kur e ndjen të nevojshme për ta qartësuar situatën; - shpreh interes ndaj gjuhës së personazheve dhe imiton sekuenca; - diskuton në grup rreth fragmenteve filmike ose tematikës së emisioneve që ndjek; - kërkon një dëgjim të vëmendshëm nga të tjerët rreth asaj që tregon; - bindet se të tjerët e kanë dëgjuar me kujdes, kur ata nisin t’i bëjnë pyetje rreth rrëfimit të tij; - vlerëson mënyrën se si janë shprehur nxënësit/et e tjerë/a; - nxjerr në pah ide dhe shpreh mendime rreth situatave që i kanë mbetur në mend; - bashkëpunon në grup gjatë dëgjimit dhe pas dëgjimit të situatave të caktuara dhe rrëfimeve personale të nxënësve të tjerë.		Fjalët kyçe: dëgjim i vëmendshëm, sekuenca filmike, personazhe, ngjarje kyçe, pëlqime.	
Burimet: histori të regjistruara, teksti mësimor, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, mjete digjitale, diktofon, magnetofon, TV, kompjuter, DVD.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Kuic. Dëgjim i vëmendshëm përmes punës në grupe. Dramatizim. Alfabeti i tryezës së njëpasnjëshme.
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit flasin rreth kësaj teme/situatë që lidhet me vëzhgimin që do të bëjnë në fotot e librit në faqen 142. <i>Dëgjim i vëmendshëm përmes punës në grupe</i> Shfaqen sekuenca CD nga filmi “Beni ecën vetë”. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe thonë: • titullin; • emrat e personazheve; • ngjarjen; • mbylljen; • pëlqimet dhe mospëlqimet e tyre. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura <i>Dramatizim</i> Pasi nxënësit kanë parë me fragmente të filmit “Beni ecën vetë”, i dramatizojnë ato në klasë. <i>Alfabeti i tryezës së njëpasnjëshme. - Filma për fëmijë.</i> U shpërndahet nxënësve një model alfabeti dhe ata plotësojnë, sipas alfabetit; tituj filmash, personazhe, aktorë, skenaristë etj. Duke aktivizuar nxënës të ndryshëm në dhënien e përgjigjeve prezantohet alfabeti.
Vlerësimi: Vlerësohen për ndjekjen, vëzhgimin dhe dëgjimin e fragmenteve dhe sekuencave filmike, të filmave të caktuar dhe të situatave të tjera filmike televizive; për dallimin, evidentimin dhe qartësimin e kontekstit që ato shfaqin; për bashkëpunimin dhe lojën në role; për aftësitë interpretative.
Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kundrinori i drejtë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)	Situata e të nxënësve: <i>Punë në dyshe</i> Udhëzohen nxënësit që të dallojnë funksionin e fjalëve të nënvizuara. Me cilat pyetje gjenden? Panë me vëmendje <u>nga ata</u>. <u>Atij</u> i pëlqente kjo këngë. Takoi <u>motrën e vogël</u>. Nxënësit dallojnë se gjymtyrët e nënvizuara janë kundrinorë. Përdorin pyetjet: <i>Nga kush? Kujt? Kë?</i>		
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kundrinorët si gjymtyrë e dytë e fjalisë, pjesë e grupit foljor; - dallon kundrinorët e drejtë; - tregon me se është shprehur kundrinori i drejtë; - formon fjali me lloje kundrinorësh.	Fjalët kyçe: kundrinor, kundrinor i drejtë, gjymtyrë e dytë, pyetjet: <i>Ç?</i>, <i>Çfarë?</i>, <i>Kë?</i>, <i>Kujt?</i>, <i>Me kë?</i>, <i>Për kë?</i>, grup foljor.
Burimet: teksti i nxënësit, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Diskutim. Lexim me kodim teksti. Pema e mendimit. Punë e pavarur	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Sqarohen rastet kur emrat përdoren si përcaktor dhe si ndajshtim. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në faqen 233 dhe të formojnë fjali nisur nga figurat, duke iu përgjigjur pyetjeve: <i>Ç?</i>, <i>Çfarë?</i>, <i>Kë?</i>, <i>Cilin?</i>, <i>Kujt?</i>, <i>Me se?</i>, <i>Për kë?</i>, <i>Nga se?</i>. Një nxënës lexon informacionin dhe paraqitet në tabelë përkufizimi për kundrinorët, si pjesë e grupit foljor. Vëmendja do të përqendrohet te kundrinori i drejtë. Lexim me kodim teksti Paraqiten pyetjet në tabelë dhe nxënësit lexojnë materialin në tekst, duke vendosur numrat e pyetjeve në pjesën e informacionit që u përgjigjet. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra. 1. Çfarë tregon kundrinori i drejtë? 2. Me cilat pyetje gjendet ai? 3. Cili është roli i tij në fjali? 4. Cili është vendi i tij në fjali? 5. Me se shprehet kundrinori i drejtë? Përgjigjet e nxënësve mund të paraqiten në tabelë si <i>Pemë mendimi</i>.	
 <pre> graph TD A(Kundrinori i drejtë) --> B(Tregon) A --> C(Gjendet me pyetjet) A --> D(Roli i tij) A --> E(Shprehet) A --> F(Vendi i tij) </pre>	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Ushtrimin 1 nxënësit e punojnë me gojë, gjejnë kundrinorët e drejtë dhe thonë me se janë shprehur. Ushtrimet 2, 4 do të punohen në tabelë nga dy nxënës, kurse klasa i punon në fletore. Prezantohen përgjigjet e nxënësve. Ushtrimi 5 do të plotësohet në libër. Bëhen ndërhyrjet e duhura, nëse është e nevojshme.	
Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënit; për përgjigjet me gojë; për ushtrimet me shkrim; për detyrën e shtëpisë.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 3 në faqen 234 (sipas kërkesës)	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kundrinori i zhdrejtë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: <i>Punë në grup</i> Përgatiten dy fleta pune për dy grupe nxënësish. Ata punojnë për 5 minuta dhe u japin përgjigje pyetjeve. 1) I besoj shoqes sime. <i>Kujt?</i> Këto lule do t’ia dhuroj nënës. Atyre nuk u vinte mirë për këtë. Mësuesja i dha klasës sonë librat. <i>Ç’lloj kundrinorësh janë?</i> <i>Me ç’gjymtyrë lidhen?</i> <i>Me ç’pyetje gjenden?</i> <i>Me se shprehen?</i> 2) Zana u miqësua shpejt me shoqet. <i>Me cilat?</i> Breza të tërë kanë punuar për gjuhën tonë letrare. <i>Për kë?</i> Po mësoj me motrën për mësimin e fundit. <i>Për kë?</i> Mora një letër nga xhaxhai. <i>Nga kush?</i> <i>Ç’lloj kundrinorësh janë?</i> <i>Me ç’gjymtyrë lidhen?</i> <i>Me ç’pyetje gjenden?</i> <i>Me se shprehen?</i> Këto dy fleta pune shumëfishohen, ose klasa ndahet në grupe me nga 5 nxënës, përfaqësues të grupeve japin përgjigjet e pyetjeve. Plotësohen përgjigjet, vlerësohen dhe bëhen vërejtje për punën në grup të nxënësve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kundrinorët e zhdrejtë me anë të pyetjeve <i>kujt?, cilit?, me kë?, nga kush?, prej kujt?</i> ; - tregon me se shprehen dhe ku qëndrojnë në fjali; - i përdor këta kundrinorë në fjali.		Fjalët kyçe: kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë, kundrinor i zhdrejtë me parafjalë, pyetje, parafjalë.	
Burimet: teksti i nxënësit, njohuritë e nxënësve, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grupe. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim. Punë individuale.			
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.			

Ndërtimi i njohurive të reja

Aktivizohet një nxënës që të lexojë me zë informacionin që jepet për kundrinorët e zhdrejtë me dhe pa parafralë.

Analizohen shembujt e dhënë në libër dhe paraqiten çështjet kryesore të mësimit në tabelë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimet 1, 3 dhe 4, nxënësit i punojnë në grupe dyshe duke i plotësuar në libër sipas kërkesës. Këmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe qortojnë gabimet.

Ushtrimet 2 dhe 5 punohen në tabelë nga dy nxënës/e, kurse klasa i punon në fletore. Prezantohen përgjigjet e ushtrimit. Bëhen ndërhyrjet e duhura, nëse shihet e nevojshme.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënës; për punimin e ushtrimeve; për detyrën e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 236 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Kundrinori. FVK Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: <i>Paraqitet një fragment i shkurtër; në të cilin nxënësit dallojnë funksionin e gjymtyrëve të nënvizuara.</i> <i>Paraqiten pyetjet për çdo gjymtyrë.</i> Piteri <u>e</u> kishte vrarë shumë <u>mendjen për këtë</u> . Ta zëmë se <u>atij i</u> pëlqen <u>një lodër</u> që e kishte një fëmijë në oborr; pa e bërë të gjatë e merrte <u>atë lodër</u> pa një pa dy. Shpesh <u>ne na</u> vinte inat <u>për sjelljet e tij</u> . Më shumë kjo gjë <u>u</u> bëri përshtypje <u>atyre të dyve</u> .	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon kundrinorët e drejtë dhe kundrinorët e zhdrejtë; - tregon me se janë shprehur kundrinorët; - i përdor ata në fjali të ndryshme.		Fjalët kyçe: kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë, pyetje, gjymtyrë.	
Burimet: FVK, njohuritë e nxënësve, teksti i nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë e pavarur. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Rikujtohen me nxënësit njohuritë që janë marrë për llojet e kundrinorëve. Ndërtimi i njohurive të reja Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në faqen 47. Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur dhe më pas do të këmbëjnë librin me shokun/shoqen e bankës. Ata verifikojnë saktësinë në punimin e ushtrimeve. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Ushtrimet do të lexohen nga nxënës të ndryshëm. Gjatë leximit, nxënësit do të verifikojnë saktësinë e punimit të ushtrimeve dhe qortimet që u kanë bërë shokët/shoqet. Bëhen ndërhyrjet e duhura, nëse shihet e nevojshme. Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënit; saktësinë në punimin e ushtrimeve; për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve; për punimin e detyrës së shtëpisë. Detyrat dhe puna e pavarur:
--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Argumentojmë pse ndodh Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënit: Nxënësit vërejnë fotot e ilustruara. Krijojnë një tregim duke gjetur dhe mbylljen. Argumentojnë mbylljen (krijimet tregohen para nxënësve). Çdo nxënës argumenton dhe pyet për përshkrimin e situatave dhe zgjidhjen përfundimtare të tregimit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - flet duke përqendruar vëmendjen në situata të caktuara për të cilat iu duhet të argumentojnë pse; - flet duke argumentuar për situata të caktuara; - flet duke kërkuar zgjidhje dhe qëndrime kritike ndaj argumenteve që përdorin; - përdor fjalor të pasur dhe me terma të përshtatura për temën për të cilën flet; - përshtat të folurin në varësi të situatës dhe interesit për dëgjuesit; - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit.		Fjalët kyçe: argument, ilustrim, tregim, opinion.	
Burimet: teksti, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Krijim. Prezantim. Rrjeti i diskutimit. Diskutim. Punë në grupe


Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve.**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja.**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Rrjeti i diskutimit. Punë në grupe

Pasi tregojnë subjektet e tyre, nxënësit/et vlerësojnë mënyrën e krijimit të tregimeve, sa janë përdorur argumentet, cilat janë ato fjalë që tregojnë se është përsosur argumenti etj.



Lexoni dhe dëgjoni këshilla, si të japim një opinion (fjalë dhe shprehje).

Grupi 1 - Si ta japim një opinion:

Unë mendoj...

Unë vërtet mendoj kështu...

Unë nuk mendoj kështu...

Vërtet?

Edhe ju mendoni kështu?

Vërtet është një mendim i mirë...

Grupi 2 - Pyesim për arsye. Japim arsye:

E dini ju?

Pse?

Nuk e dini

Pse nuk e dini?

Pse e thoni këtë?

Vërtet? Pse jo?

Mirë... sepse...

Edhe një tjetër mendim...

Po, sepse unë mendoj që...

Punë në grup (shprehim opinione)

Grupi 3 - Përdorni shprehje në mënyrë që të mos jeni dakord me opinionet e të tjerëve.

Shprehje:

Shprehje gjatë dëgjimit - Shprehje në mbyllje

nuk jam dakord... nuk e pëlqej këtë gjë... mund të jetë e vërtetë..., mund të jetë interesante por unë...mund të jetë e vërtetë, ndërkohë... e ndjej që diçka... nuk mendoj se keni të drejtë...

Mendoj se kemi opinione të kundërta..., ne ndahemi në këtë çështje... unë do të mendoj akoma rreth kësaj gjëje..., ndoshta e shoh përsëri..., ne nuk biem dakord në këtë çështje...

Vlerësimi: Vlerësohen për mënyrën se si flasin nxënësit; sa përdorin argumente, duke u mbështetur në zhvillimin e mendimit kritik dhe duke përdorur fjalë dhe shprehje bindëse dhe ndihmëse për gjetjen e argumentit dhe bindjen e bashkëfolësit për situata të caktuara dhe problematike, për të cilat kërkohen zgjidhje; për fjalorin e pasur i mbështetur në fusha të caktuara semantike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Rrethanorët. Rrethanori i vendit dhe i kohës. Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon rrethanorët e vendit, kohës me pyetjet Ku?, Kur?; - tregon me se shprehen dhe ku qëndrojnë në fjali; - krahason të përbashkëtat me të veçantat e rrethanorit të vendit dhe të kohës; - i përdor ato me fjali.		Fjalët kyçe: rrethanor vendi, kohe, gjymtyrë e dytë jo e domosdoshme, plotësuese.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe 6, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lexim në heshtje. Pyetje-përgjigje në dyshe. Diagrami i Venit. Punë në grupe. Diskutim.			
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Punë me tekstin: Nxënësit kanë njohuri për llojet e rrethanorëve të vendit, kohës, mënyrës, sasisë. Nxënësit lexojnë në heshtje informacionin në faqen 237 (tabelën për gjithë llojet e rrethanorëve). Ndërtimi i njohurive të reja. Pyetje-përgjigje në dyshe Nxënësit punojnë në grupe dyshe për të formuluar pyetje për rrethanorët: • Ç'gjymtyrë fjalië janë rrethanorët? • Sa llojesh janë ata? • Me ç'pyetje gjenden në fjali? • Me se shprehen rrethanorët? Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve. Një nxënës lexon me zë informacionin që jepet për rrethanorët e vendit dhe kohës. Në grupe dyshe, nxënësit punojnë Diagramin e Venit për dy llojet e rrethanorëve.			
← rr. vendit → është gjymtyrë e dytë; i përgjigjet pyetjes Ku? Shprehet me ndajfolje, emër, rr. kohës është gjymtyrë e dytë; i përgjigjet pyetjes Kur?; shprehet me: ndajfolje, emër, GE, përemër GE. përemër, formë të pashtjelluar përemër. janë gjymtyrë të dyta; formojnë GE me kallëzuesin; shprehen me ndajfolje.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**Punë në grupe**

Grupi I punon ushtrimet 1, 2 (punohen në libër).

Grupi II punon ushtrimet 3, 4 (punohen në libër).

Përfaqësues të grupeve prezantojnë përgjigjet. Nxënësit e tjerë qortojnë gabimet që mund të bëjnë shokët/shoqet.

Ushtrimi 5 punohet me gojë.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për saktësinë në punimin e ushtrimeve; për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 239 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Paraqiten në tabelë fjalitë. Nxënësit në dyshe do të dallojnë se cili është funksioni i fjalëve të nënvizuara. Shtëpia buçiste <u>nga zëri i ngritur i televizorit</u> dhe <u>nga zëri i lartë i djaloshit</u> . Oshtinin pa kuptim <u>për të shprehur</u> gjallërinë e tyre për ardhjen e një dite të re. Nxënësit dallojnë se këto fjalë tregojnë shkakun ose qëllimin e kryerjes së veprimit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon rrethanorët e shkakut, qëllimit me pyetjet <i>Pse?, Përse?</i>; - tregon me se shprehen këta rrethanorë; - tregon vendin e tyre në fjali; - krahason të përbashkëtat dhe të veçantat mes tyre; - i përdor këta rrethanorë në fjali.		Fjalët kyçe: rrethanor shkak, qëllimi, pyetjet pse, përse, gjymtyrë fjalie jo e domosdoshme, plotësuese.	
Burimet: libri i gjuhës shqipe 6, njohuritë e nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në dyshe. Pyetje-përgjigje. Diagrami i Venit. Lojë gjuhësore.			

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantohet titulli i mësimi në tabelë. Një nxënës lexon me zë informacionin e paraqitur në libër. Pas leximit, nxënësit formojnë në dyshe pyetjet.

Ç'gjymtyrë fjali janë këta rrethanorë?

Me ç'pyetje gjenden ata në fjali?

Me se shprehet rrethanori i shkaktut?

Me se shprehet rrethanori i qëllimit?

Ku qëndrojnë zakonisht në fjali?

Nxënësit lexojnë rubrikën *Mbani mend* dhe plotësojnë *Diagramin e Venit* për dy rrethanorët.


gjymtyrë plotësuese;

tregon shkaktut;

i përgjigjet pyetjes *pse?*;

shprehet: me ndajfolje, emër,

GE, përcjellore.



është gjymtyrë plotësuese;

tregon qëllimin e kryerjes së veprimit;

i përgjigjet pyetjes *përse?*;

shprehet: me ndajfolje, emër, GE, paskajore.

Nxënësit prezantojnë *Diagramin e Venit* duke plotësuar punën e njëri-tjetrit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimet 2, 3, 4, nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe, këmbajnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Nxënësit prezantojnë punën e tyre, ndërsa mësuesi/ja plotëson përgjigjet e nxënësve.

Një nxënës punon ushtrimin 1 në tabelë, shkruan fjali me dy llojet e rrethanorëve. Ose mund të organizohet loja zinxhir; çdo nxënës/e thotë nga një fjali me rrethanorët e shkaktut dhe qëllimit. Ai/ajo që gabon, shkëputet nga loja dhe futet në lojë më vonë.

Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënësve; punën në dyshe; punimin e ushtrimeve; detyrën e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5 në faqen 241 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përshkrimi i një personi Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Prezantim digjital – Diskutim Nxënësi/ja përmes videoprojektorit sheh personazhin e Skënderbeut, fotografi të bustit të tij vendosur në sheshe të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. U lihet koha e mjaftueshme për të përshkruar sipas dëshirës njërin nga ilustrimet e paraqitura. Mund të përdoren edhe foto apo piktura të ndryshme të Heroit Kombëtar, ose mund të zgjidhen personazhe të tjera sipas mundësive. Nxënësit lexojnë përshkrimin e realizuar dhe nga përgjigjet e tyre dalin disa nga karakteristikat, tiparet e heroit, të cilat shënohen në dërrasë të zezë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon tekstin përshkrues si lloj i veçantë i tekstit joletrar; - analizon realizimin e përshkrimit të një personi; - krahason duke nxjerrë në pah të përbashkëtat dhe dallimet mes përshkrimit objektiv dhe subjektiv.		Fjalët kyçe: përshkrim, objektiv, subjektiv, tipare, karakteristika, person, objekt, përshkruan, tekste, emocion.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, njohuritë e nxënësve, foto dhe piktura.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim digjital-Diskutim. DRTA. Ditari dypjesësh.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja.

Duke marrë shkas nga përshkrimet që realizuan nxënësit, shtrohen para nxënësve pyetja:

Ç'quajmë tekst përshkrues?

Nxënësit sjellin mendimet e tyre, të cilat shpjegohen, zgjerohen dhe saktësohen.

Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë, duke informuar dhe treguar si është ndërtuar një objekt apo cilat janë tiparet e një personi, të një kafshe, të një mjedisi apo të një dukurie.

Përshkrimi objektiv nuk mbështetet në opinionet e dikujt, por në të dhënat reale.

Përshkrimi subjektiv mbështetet në emocionet, përshtypjet dhe opinionet e njerëzve që e krijojnë atë.

Lexohet tekst me ndalesa, *DRTA: e ndërsa* nxënësit dëgjojnë, bëhen ndalesa dhe në secilën prej tyre u kërkohet nxënësve të nxjerrin në pah tipare, veçori dhe qëllimin e shkrimit nga ana e autorit.

Ndalesa 1: Lexohet teksti “Gjeniu i vogël” S. Cvajg.

Ç’lloj përshkrimi kemi? Pse?

Cili është qëllimi i përshkrimit?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit ndahen në dy grupe dhe çdonjëri prej tyre përmes metodës *Ditari dypjesësh* punon me mënyrën si realizohet përshkrimi i një personi:

Grupi i parë punon me përshkrimin objektiv.

Grupi i dytë punon me përshkrimin subjektiv.

Përshkrimi objektiv	Përshkrimi subjektiv

Përfaqësues të grupeve prezantojnë përgjigjet.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen gjatë orës; për saktësinë në dhënien e përgjigjeve.

Detyrat dhe puna e pavarur: Paraqitni përmes Diagramit të Venit, të përbashkëtat dhe dallimet e përshkrimit objektiv dhe subjektiv.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përshkruajmë një person Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënit: <i>Bashkëbisedim në grupe dyshe-Pesëvargësh</i> Kërkohet që nxënësit/et, në grupe dyshe, të përshkruajnë një nga shokët, ashtu si e njohin njëri-tjetrin. Mësuesi/ja kërkon që të shkruhet edhe nga një pesëvargësh për çdo shok/shoqe. Lexohen pesëvargëshat para nxënësve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - zgjedh formën e të shkruarit, përshkrim personazhi; - mbledh dhe përzgjedh informacion nga burime të ndryshme (edhe elektronike), për të realizuar një përshkrim duke përdorur ilustrime, pamje, piktura etj., të cilat shërbejnë për nxitjen e imagjinatës; - shkruan tekste koherente, duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat gramatikore; - realizon përshkrimin me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm; - përzgjedh dhe klasifikon informacionet e mbledhura; - respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje); - përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme në shkrimet e tij si p.sh., një larmi ndajfoljesh, mbiemrash etj., me qëllim që të ndikojë te lexuesi; - përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore; - përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tij; - shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	Fjalët kyçe: Përshkrim objektiv, përshkrim subjektiv, detaje.
Burimet: teksti, materiale të përgatitur nga mësuesi/ja, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bashkëbisedim në grupe dyshe -Pesëvargësh. Punë në grupe. Diagrami i Venit. Turi i galerisë.	

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja

Përshkrim me fjalë kyçe - Punë në grupe

Përshkruajmë një person/personazh në mënyrë objektive dhe subjektive.

Shembulli i një përshkrimi objektiv:

gjinia/karakteristikat fizike/veshja/pozicioni/çfarë po bën.

Lexohet modeli i paraqitur në tekst në faqen 147. - Model përshkrimi me fjalë kyçe

Ajo është një vajze rreth 11 vjeç. Gjatësia mesatare, përmasa normale.

Flokë kafe, sy gështenjë. Ajo ka veshur një fustan të kaltër, me jakë të bardhë.

Është ulur përballë pasqyrës dhe po sheh portretin e saj.

Gjuha është e pasur me mbiemra cilësorë, gjykues dhe vlerësues për personin.


Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Bëni dhe ju një përshkrim objektiv të shokut apo të shoqes suaj.

Bëni dhe ju një përshkrim subjektiv të shokut apo shoqes suaj.

Krahasohet modeli i krijuar nga nxënësit/et me modelin e paraqitur në tekst.

Plotësoni *Diagramin e Venit* për përshkrimin objektiv dhe subjektiv.



Nxënësit/et shkruajnë modelet e përshkrimeve në draftin e tyre final. I këmbëjnë me njëri-tjetrin, japin mendime dhe vlerësime.

Ripunim dhe publikim

Më pas, ata i lexojnë në grupe të vogla dyshe dhe japin sugjerime për përmirësime të mëtejshme.

Turi i galerisë

Nxënësit vendosin punimet e tyre: modelin e përshkrimit objektiv të një personazhi apo një personi përballë përshkrimit subjektiv të të njëjtit personazh.

Vlerësimi: Vlerësohen përshkrimi objektiv dhe subjektiv të një personi/personazhi sipas strukturës dhe kërkesave që ka shkrimi përshkrues; për vlerësimin dhe vetëvlerësimin që i bëjnë punëve të njëri-tjetrit; për modelin e përshkrimit të një personi/personazhi.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Si u zhdukën dinozaurët (FVK) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: <i>Diskutim</i> Zhvillohet një bisedë me nxënësit në lidhje me dinozaurët. Ç’dinë nxënësit në lidhje me ta? Disa prej mendimeve të nxënës paraqiten në tabelë. <i>Informacion plotësues</i> (marrë nga interneti) Dinozaurët ishin zvarranikë, gjigand të tokës të cilët dominuan ekosistemet tokësore në një periudhë prej rreth 160 milion vjetësh, (nga fundi i periudhës <i>Triassic</i> , rreth 230 milion vjet më parë) deri në fund të periudhës së shkumësit (65 milion vjet më parë), dinozaurët u zhdukën në periudhën e shkumësit - terciar. Rreth 10.000 specie të shpendëve janë të klasifikuara si dinozaurë. Në gjysmën e parë të shekullit XX, pjesa më e madhe e komunitetit shkencor dinte shumë pak mbi dinozaurët. Shumica e kërkimeve u filluan nga vitet 1970. Termi anglisht Dinosaur u zyrtarizua në vitin 1842 nga Richard Oenpaleontolog anglez. Termi rrjedh nga fjalët greke δεινός (<i>deinos</i> e "tmerrshme", "i fuqishëm", ose "i mahnitshëm") dhe σαύρα (<i>saura</i> "hardhucë" ose "zvarranik"). Megjithëse emri shpesh interpretohet si një referencë për karakteristika të frikshme. Në diskutimet angleze “Dinosaur” ndonjëherë përdoret për të përshkruar një gjë të pasuksesshme ose të vjetruar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - flet në lidhje me dinozaurët; - përcakton llojin e shkrimit; - përcakton paragrafët; - rendit fakte dhe tipare të shkrimit; - nënvizon lidhëzat e përdorura në fragment; - vlerëson argumentet e tekstit.		Fjalët kyçe: dinozaur, zhdukje, pyetje, ndryshime klimaterike, kometa, asteroide, klimë.	
Burimet: FVK, njohuritë e nxënësve, interneti, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Bisedë. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim.			

Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Puno/shkëmbe në dyshe Prezantohet titulli i pjesës: Si u zhdukën dinozaurët? Pjesa mund të lexohet me zë nga një nxënës ose mund të lexohet në heshtje nga nxënësit. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale dhe më pas do të shkëmbejnë fletoret me shokun/shoqen e bankës. Nxënësit do të verifikojnë saktësinë e plotësimit të pyetjeve. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura <i>Diskutim</i> Nxënësit do të diskutojnë ushtrimet e punuara në FVK. Aktivizohen nxënës/e të ndryshëm në dhënien e përgjigjeve. Vlerësimi: Vlerësohen për situatën e të nxënit; për saktësinë në punimin e ushtrimeve; për qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve. Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: <i>Punë me tekstin</i> Nxënësit vërejnë figurën në libër dhe shkruajnë dy pyetje të cilat të fillojnë me fjalët “si, sa”. <i>Si po i bie flautit artisti?</i> <i>Sa zogj fluturojnë dhe sa lepuj vrapojnë?</i> Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me fjali të plota: <i>Baba Musta po i bie flautit bukur.</i> <i>Po fluturojnë gjashtë zogj dhe po vrapojnë katër lepuj.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon rrethanorët e mënyrës dhe të sasisë me pyetjet <i>si?</i>, <i>sa?</i>; - tregon me se shprehen këta rrethanorë; - tregon vendin e tyre në fjali; - krahason të përbashkëtat dhe të veçantat mes tyre; - i përdor këta rrethanorë në fjali.		Fjalët kyçe: rrethanor mënyre, sasi, gjymtyrë plotësuese, pyetjet <i>si?</i> , <i>sa?</i> .	
Burimet: teksti i nxënësit, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë e pavarur. Lexim. Pyetje-përgjigje në grupe dyshe. Diagrami i Venit.			

Organizimi i orës së mësimit

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektësinë në kryerjen e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Për disa minuta, nxënësit lexojnë informacionin e dhënë në libër për rrethanorët e mënyrës dhe sasisë. Nxënësit të ndarë në grupe dyshe formulojnë pyetje për çështjet kryesore të rrethanorëve:

Ç'gjymtyrë fjalie janë këta rrethanorë?

Me ç'pyetje gjenden ata në fjali?

Me se shprehen?


Cili është vendi i tyre në fjali?

Kërkohej nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve duke shënuar në libër ku gjenden përgjigjet e çdo pyetjeje.

Nxënësit ndalen te rubrika "Mbani mend" dhe plotësojnë Diagramin e Venit.

rrethanori i sasisë: rrethanori i mënyrës:

- gjendet me pyetjen sa?
- tregon një sasi e caktuar në masë, kohë etj.
- shprehet me ndajfolje, GE, shprehje ndajfoljore



Janë gjymtyrë plotësuese
Gjenden me pyetje me ndajfolje
Shprehen me ndajfolje, GE.

- është gjymtyrë plotësuese
- i përgjigjet pyetjes *si*?
- tregon mënyrën si kryet veprimi
- shprehet me: GE, ndajfolje, formë përcjellore, emër

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimet 1, 3, 4, nxënësit i punojnë në grupe dyshe në libër. Ata këmbëjnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimet 2, 5 i punojnë me gojë nën drejtimin e mësuesit/es, sepse kanë të njëjtën kërkesë, por me tekste të ndryshme. Aktivizohen sa më shumë nxënës/e në dhënien e përgjigjeve.

Vlerësimi: Vlerësimi për pjesëmarrjen gjatë orës; për punimin e ushtrimeve; për saktësinë në dhënien e përgjigjeve; për detyrën e shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6 në faqen 244 (sipas kërkesës), Ushtrimin 7 (punë me projekt).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ushtrime për rrethanorët (FVK) Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës (Sintaksë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Kompetenca e të menduarit			
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon rrethanorët në një tekst të dhënë; - tregon funksionin e fjalëve dhe grupeve të fjalëve; - krijon një tekst, në të cilin përdor lloje të ndryshme rrethanorësh.	Fjalët kyçe: rrethanor: vendi, kohe, mënyre, sasi, qëllimi, shkaku, funksione të ndryshme.
Burimet: njohuritë e nxënësve, FVK.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim. Shkrim i lirë.	
Organizimi i orës së mësimi Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohen nxënësit për saktësinë dhe korrektesinë në kryerjen e saj. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Ndërtimi i njohurive të reja. Puno/shkëmbe në dyshe. Diskutim Orientohen nxënësit në FVK në faqen 44 dhe udhëzohen që të plotësojnë ushtrimet 1, 2, 3, 4 në fletore. Pas punimit të ushtrimeve, nxënësit/et do të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin për të verifikuar saktësinë e përgjigjeve. Nxënësit bëjnë shënimet e duhura me laps. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Prezantohen përgjigjet e ushtrimeve nga nxënës të ndryshëm. Tek ushtrimet 2, 3 duhet patur kujdes se veç funksionit rrethanor, fjalët kanë edhe funksione të tjera. Shkrim i lirë Ushtrimet 5, 6 Nxënësit krijojnë një tregim të shkurtër me titull “Një fletë nga ditari im”, në të cilin të përdorin gjashtë lloje rrethanorësh. Më pas përcaktojnë se me se janë shprehur këta rrethanorë. Disa nxënës/e prezantojnë punimet. Dy nxënës/e mund ta prezantojnë detyrën në tabelë.	
Vlerësimi: Vlerësohen për saktësinë në punimin e ushtrimeve; për qortimin që u bëjnë gabimeve të shokëve/shoqeve; për pjesëmarrjen gjatë orës; për detyrat e shtëpisë.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përshkrimi i një kafshe, mjedisi, dukurie Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		Situata e të nxënit: <i>Diskutim në dyshe. Pesëvargësh.</i> Nxënësit/et ndjekin me vëmendje regjistrimin, ose foto të ndryshme, emërtojnë kafshët që shohin, përshkruajnë me hollësi kafshët që njohin dhe ato që pëlqejnë më shumë. Kërkohej që nxënësit/et, në grupe dyshe, të përshkruajnë një kafshë, atë më të dashurën apo atë që pëlqejnë më tepër. Mësuesi/ja kërkon që të shkruhet edhe nga një Pesëvargësh për një nga kafshët që kanë zgjedhur. Lexohen pesëvargësat e shkruar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - zgjedh formën e të shkruarit, përshkrim personazhi; - mbledh dhe përzgjedh informacion nga burime të ndryshme (edhe elektronike), për të realizuar një përshkrim duke përdorur ilustrime, pamje, piktura etj., të cilat shërbejnë për nxitjen e imagjinatës; - shkruan tekste koherente, duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat gramatikore; - realizon përshkrimin me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm; - përzgjedh dhe klasifikon informacionet e mbledhura; - respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje); - përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme në shkrimet e tij si p.sh., një larmi ndajfoljesh, mbiemrash etj., me qëllim që të ndikojë te lexuesi.		Fjalët kyçe: kafshë, mjedis, dukuri, përshkrim objektiv, përshkrim subjektiv, detaje përshkruese	
Burimet: teksti i nxënësit, foto të ndryshme, interneti, njohuritë e nxënësve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Shkenca. Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim në dyshe. Pesëvargësh. Minileksion. Punë në grupe. Shkrim i lirë. Turi i galerisë.			

Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit. Ndërtimi i njohurive të reja. Minileksion Lexohet me zë nga nxënësit informacioni i paraqitur në faqen 148 të tekstit. Përshkrimi objektiv dhe subjektiv i një kafshe. U shpjegohet nxënësve se si ndryshon gjuha gjatë përshkrimit objektiv dhe atij subjektiv. Kalohet në leximin e përshkrimit objektiv dhe subjektiv të një mjedisi a dukurie. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Punë në grupe Nxënësit do të ndahen në dy grupe. Grupi I plotëson skedën në lidhje me përshkrimin objektiv dhe subjektiv të luanit. Grupi II plotëson skedën për përshkrimin objektiv dhe subjektiv të një dukurie a mjedisi. Përfaqësues të grupeve lexojnë skedat e plotësuar. Shkrim i lirë. Turi i galerisë Nxënësit zgjedhin për të përshkruar një kafshë, objekt a dukuri në mënyrë objektive dhe subjektive. Nxënësit/et shkruajnë modelet e përshkrimeve në draftin e tyre final, i këmbëjnë me njëri-tjetrit, japin mendime dhe vlerësime. I lexojnë njëri-tjetrit, në grupe të vogla dyshe, dhe japin sugjerime për përmirësime të mëtejshme. Nxënësit vendosin punimet e tyre: modelin e përshkrimit objektiv dhe subjektiv të një kafshe, dukurie a mjedisi. Ata bëjnë komente dhe vlerësime. Vlerësimi: Vlerësohen për përshkrimin objektiv dhe subjektiv të një kafshe, mjedisi a dukurie sipas strukturës dhe kërkesave që ka shkrimi përshkrues; për vlerësimin dhe vetëvlerësimin që i bëjnë punëve të njëri-tjetrit; për modelin e përshkrimit të një kafshe, dukurie a mjedisi. Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shtatë krojet (2 orë) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.		Situata e të nxënit: Pesëvargëshi – Prezantim Digjital Shënohet në dërrasë të zezë togfjalëshi “Bukuri shqiptare” dhe u kërkohet nxënësve që të ndërtojnë një pesëvargësh me të. Për t’u ardhur në ndihmë nxënësve, përmes videoprojektorit prezantohen pamje të ndryshme të vendeve, viseve shqiptare. Mund të përdoren edhe foto të ndryshme, kartolina ose mund të vihet në sfond melodia e këngës “Baresha” interpretuar nga Shkëlzen Doli. Nxënësit paraqesin punën para grupit të klasës. Puna më e mirë pasqyrohet në dërrasë të zezë.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ora e parë Nxënësi/ja: - dallon se si autori përshkruan livadhin; - analizon mënyrën si autori përshkruan livadhin; - shpreh mendimin e tij/saj mbi dukuri të çuditshme të natyrës shqiptare duke e përqasur me tekstin “Shtatë Krojet”. Ora e dytë Nxënësi/ja: - përcakton elementet ndërtimore që e bëjnë këtë tekst “Shtatë Krojet” një tekst përshkrues; - analizon tiparet gjuhësore të tekstit përshkrues ilustruar në tekstin “Shtatë Krojet”; - nxjerr përfundime mbi veçantinë e përshkrimit të autorit.	Fjalët kyçe: Shtatë Krojet, bukuri përrallore, hijeshon, zbukuron, livadh, shteron, dita e Shëngjergjit, mrekulli, dukuri.
Burimet: teksti, interneti, materiale të krijuara nga mësuesi/ja, DVD, magnetofon etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pesëvargëshi. Prezantim digjital. Diskutim. Kllaster. Punë në grupe.	

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me kontrollin dhe vlerësimin e detyrës së shtëpisë. Vlerësohet saktësia dhe korrektësia në realizimin e saj.

Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja

Prezantohet tema e re dhe njihen nxënësit me jetën dhe krijimtarinë e shkrimtarit Kim Mehmeti.

Kim Mehmeti ka lindur në fshatin Gërçec, Shkup në vitin 1955. Është i njohur si shkrimtar, romancier, tregimtar, eseist, publicist dhe përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Është një ndër themeluesit e së përvashmes “Lobi” e cila botohej në Shkup nga viti 2001 deri në vitin 2006. Ka qenë redaktor i revistës për kulturë “Jehona” (Shkup), redaktor i veprimtarisë botuese pranë Sh.B. “Flaka e vëllazërimit” (1991-1992).

Kim Mehmeti njihet si nismëtar i më shumë iniciativave qytetare në Maqedoni dhe në rajon.

Kim Mehmeti është fituesi i titullit “Rexhai Surroi” për romanin më të mirë shqiptar për vitin 2008, “Vitet e urithit”, botuar nga Toena, Tiranë më 2007.

Veprat e Kim Mehmetit janë përkthyer në gjuhën gjermane, franceze, bullgare, turke, kroate dhe në gjuhë të tjera.

Realizohet leximi i pjesës nga nxënës të ndryshëm dhe shpjegimi i fjalëve të reja e krijimi i fjalive me to. Pas rileximit të pjesës, nxënësit u japin përgjigje 4 pyetjeve të ushtrimit 1, për të kuptuar përmbajtjen e tekstit.

1. Si e përshkruan autori livadhin? (*e stolis një bukuri përrallore...*)
2. Në cilën pjesë të tij ndodhen Shtatë Krojet? (*aty ku livadhi formon një hark...*)
3. Ku ndryshojnë këto kroje nga krojet e tjera? (*është e vërteta se, një herë në vit, këto kroje shteren krejtësisht...*)
4. Çfarë ndodh në Shtatë Krojet ditën e Shëngjergjit? (*në çastin kur lind dielli dhe kur mbi livadh...*)

Nxënësit diskutojnë në lidhje me pyetjen e ushtrimit 2, duke sjellë përvojat e tyre vetjake.

Përfundimet më të rëndësishme shënohen në dërrasë të zezë.

Ora e dytë

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutim. Kllaster


Shënohen në dërrasë të zezë pyetjet:

Ç’lloj teksti është “Shtatë Krojet” e K. Ahmetit?

Ç’përshkruan autori në të?

Si realizohet përshkrimi?

Nxënësit i argumentojnë përgjigjet e tyre, ndërkohë me përgjigjet e tyre plotësohet Kllasteri.



Punë në grupe

Grupi I punon ushtrimin 4.

Grupi II punon ushtrimin 5.

Nxënësit punojnë në heshtje. Përfaqësues të secilit grup argumentojnë përgjigjet para grupit të klasës.

Nëse është e nevojshme, bëhen ndryshimet e duhura. Të dyja ushtrimet pasqyrohen edhe në dërrasë të zezë.

Punë e pavarur

Vëmendja e nxënësve përqendrohet drejt nxjerrjes së konkluzioneve se çfarë e bën të veçantë përshkrimin e autorit.

Nxënësit përqendrohen në punimin e ushtrimit 6. Në minutat e fundit, 2-3 prej tyre e lexojnë detyrën para grupit të klasës. Përfundimet më të goditura shënohen edhe në dërrasë të zezë.

Vlerësimi: Vlerësohen për pjesëmarrjen në mënyrë aktive të zhvillimit të orës (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur: Bëni një prezantim me temë: “Mrekullitë e natyrës shqiptare”. Prezantimi mund të jetë digjital ose mund të jetë në formën e një albumi me foto dhe informacione shoqëruese.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Stop diskriminimit Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe mësuar		Situata e të nxënit: <i>Stuhi mendimi. Kllaster</i> Shkruhet në tabelë pyetja: <i>Ç`është diskriminimi?</i> Përgjigjet e nxënësve prezantohen në tabelë në formë kllasteri. Diskriminimi nënkupton zhvlerësimin e një grupi të huaj e në veçanti të një minoriteti shoqëror brenda një shoqërie të ngritur mbi parimet e barazisë, parimit të ndalimit të dallimeve racore fetare gjinore ekonomike...	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - flet duke përqendruar vëmendjen në situata të caktuara për të cilat duhet të argumentojnë pse; - flet duke argumentuar për situata të caktuara; - flet duke kërkuar zgjidhje dhe qëndrime kritike ndaj argumenteve që përdor në lidhje me diskriminimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut; - përdor fjalor të pasur dhe me terma të përshtatur për temën për të cilën flet.		Fjalët kyçe: diskriminim, respekt, të drejtat e njeriut	
Burimet: fotografi, video, CD, kompjuter, interneti, biblioteka.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi. Artet. Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi. Kllaster. Rrjeti i diskutimit. Rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimi**Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur gjatë situatës së të nxënit.

Ndërtimi i njohurive të reja

Lexohen nga nxënësit situatat e paraqitura në tekst në faqen 152. Ata flasin rreth imazheve për jetën e fëmijëve sot në botë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**Punë në grupe. Rrjeti i diskutimit**

Grupi 1 1

Diskutoni për diskriminimin gjinor racor dhe fetar në komunitetin tuaj.

Çfarë do të bënit për ta ndryshuar situatën?

Grupi 2

Diskutoni për diskriminimin gjinor, racor dhe fetar në komunitetin tuaj.

Çfarë do të bënit për ta ndryshuar situatën?

Grupi 3

Diskutoni për konceptet: dashuri, urrejtje, paragjykim. Komentoni thënien e Mandelës:

“Askush nuk ka lindur për të urreyer një person tjetër për shkak të ngjyrës së tij të lëkurës, prejardhjes së tij apo besimit. Njerëzit mësohen të urrejnë e nëse e bëjnë këtë, ata mund të mësojnë të duan, dashuria vjen më natyrshëm te zemra e njeriut sesa e kundërta e saj.”

Grupi 4

Jeta është një dhuratë, një sfidë që kërkon guxim. Diskutoni për temën e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Cili është vendi i tyre në shoqëri? Çfarë do të bënit ju për të ndihmuar bashkëmoshatarët tuaj, të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale apo ekonomike?

Hapi i tretë

Diskutoni për thënien e Nënë Terezës: “Ne mendojmë se varfëria është të jesh i uritur, i zbathur dhe pa shtëpi. Të qenit i papranuar, i padëshiruar e jashtë kujdesit, është varfëria më e madhe. Ne duhet të fillojmë ta shfarosim nga shtëpitë tona këtë mjerim të madh.”

Përfaqësues të grupeve prezantojnë mendimet. Nxënësit plotësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Vlerësohen për mënyrën sesi flasin nxënësit; sa ata përdorin argumente duke u mbështetur në zhvillimin e mendimit kritik dhe duke përdorur fjalë dhe shprehje bindëse dhe ndihmëse për gjetjen e argumentit; si argumentojnë dhe mbajnë qëndrime, rekomandojnë rrugëzgjdhje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Projekti në grupe në faqen 152 (sipas kërkesës)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ . ____ . ____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Testim përmbledhës për periudhën e tretë (teksti joletrar, sintaksë). Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.		Situata e të nxënit: Tekste rrëfimtare joletrare (reportazh, tekst përshkrues)	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - identifikon lloje të teksteve joletrare rrëfimtare; - u përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e pjesëve; - dallon detajet përshkruese të këtyre teksteve; - ilustron mendimet e tij/saj me detaje nga teksti; - jep argumente në lidhje me tekstin; - realizon shkrime të shkurtra, të ngjashme me tekstet e dhëna; - dallon gjymtyrët kryesore të fjalisë; - emërton llojet e kallëzuesit; - dallon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; me bashkërenditje dhe nënrenditje; - ndan dhe emërton pjesët e një fjalie të përbërë; - dallon funksionin: kundrinor, rrethanor, përcaktor; - krijon fjali ku përdor gjymtyrë me funksione të ndryshme.	Fjalët kyçe: testim përmbledhës, tekst joletrar, pyetje, përgjigje, tabelë, pikë, notë, variante.
Burimet: tekste joletrare, modele testesh të përgatitura nga mësuesi/ja, njohuritë e nxënësve.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë individuale.	
Organizimi i orës së mësimi U ndahen testet nxënësve dhe udhëzohen që të punojnë me qetësi dhe me kujdes. Është e këshillueshme, që një orë më parë, nxënësve t'u bëhet një përsëritje dhe të njihen paraprakisht me natyrën e pyetjeve, në mënyrë që gjatë plotësimit të pyetjeve ata të mos kenë paqartësi dhe pyetje.	
Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Ndërtimi i njohurive të reja Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	
Vlerësimi: Vlerësim përmbledhës me notë.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. _____. _____. _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Dita e portofolit tim (Panair portofoli) Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Situata e të nxënit: Punimet më të mira të nxënësve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton me shokët për punët e arkivuara në dosje; - vlerëson dhe vetëvlerëson punët në portofol/dosje.		Fjalët kyçe: portofol, vlerësim, vetëvlerësim	
Burimet: portofoli i punimeve, CD, muzikë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim. Turi i galerisë. Bashkëbisedim.			
Organizimi i orës së mësimi Për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, mund të vendoset muzikë e lehtë në sfond. Vendi i bankave në klasë mund të ndryshohet, në mënyrë që punimet e nxënësve në portofol të mund të shihen nga të gjithë nxënësit, si një ekspozitë punimesh. Gjatë orës mund të ftohen edhe prindër të nxënësve. Lidhja e temës së re me njohuritë e mëparshme të nxënësve Bashkëbisedim Bashkëbisedim me nxënësit në lidhje me mënyrën e vlerësimit, edhe pse ata janë njohur qysh në periudhën e parë. Portofoli i punimeve, si një mënyrë vlerësimi për arritjet e nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit realizohet me pikë, nisur nga lloji i detyrës dhe pesha që ka ajo. Pikët konvertohen në notë, sipas një tablele që nxënësve u është dhënë qysh me përcaktimin e detyrave, që do të dokumentohen në portofol gjatë periudhës së tretë: prill-qershor. Ndërtimi i njohurive të reja Nxënës të ndryshëm do të flasin për detyrat e realizuara gjatë periudhës së dytë, kënaqësitë për realizimin e tyre dhe vështirësitë që mund të kenë hasur. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Turi i galerisë Nxënësit do të prezantojnë një pjesë të punimeve të tyre, të konsideruara si më të mirat. Secili nga nxënësit vetëvlerëson detyrën e tij. Nxënësit e tjerë japin mendime pozitive në lidhje me punimet e paraqitura nga shokët.			
Vlerësimi: Vlerësohen për cilësinë e realizimit të punimeve; për përmbushje të kriterëve të detyrës; vlerësim me notë dhe vetëvlerësim.			
Detyrat dhe puna e pavarur:			